


NAUM PRIETI

CEZMA E FLORIRIT

BIBLIOTEKA

8JH-32
P 93





ÇEZMA E FLORIRIT

(Dashuria e Kaçakut)

Po ta soditësh Voskopojen që nga kodrat e Shëndëllisë ose të Shënpordhromit, shpirtin ta kllapon një ndjenjë trishtimi, tek e shikon ashtu gur mbi gur, të lënë e të harruar, të mplakur dhe të fishkur para kohe nga rrebeshet dhe nga luftimet që i kanë rënë mbi krye. E sado që të mundohesh të ngjallësh me mënd atë kohë kur Voskopoja ishte qytet i bukur dhe i lulëzuar, nuk do t'ja arrish dot qëllimit. Tani, në vënd të tre mëhallëvet me shtëpija të larta, ndërtuar me gurë të bardhë e të skalitur, do të shikosh togje gërmadhash; në vënd të kopshteve të bukur plot lule, do të shikosh livadhe të lëna djerrë. Vetëm rrugët e gjëra e të drejta, të shtruara me kalldrëm, e kanë ruajtur gjer në ditët tona, formën dhe bukurinë që kanë pasur një kohë, po nëpër rrugë më nuk ndihen, si dikur, as të thirrurat e karvanarëvet e as tringëllimet e er-gjënta të zilevet të mushkave; tani rrugët janë fare të qeta e bari po i mbulon dalëngadalë, sikur përpinqet të fshehë nga sytë e njerëzvet edhe kujtimin e fundit të asaj kohë.

Voskopoja, qëndra e bukur e dikurshme, vëndi i dyzet kishavet të ndërtuara e të zografisura prej mjesh-tërvet më të mëdhenj të asaj kohe, tani është katan-disur një fshat i vogël malor, e aqë sa dikur paskësh kisha, sot mezi i ka shtëpira.

S'mbahet mënd sa herë është prishur e sa herë është djegur! E përvëluan turqit në kohët e para; e rremetisi tërmeti më vonë; e zhuriti greku dhe më së fundi e shkrrumbiti edhe Italia me zjarr e me hekur.

Veç në verë Veskopojët edhe tanë gjallërohet. Atëhere, në kodrat që gjinden për rreth, bari gjelbëron; pi- shat krenare që ngrehin kryet përpjetë, janë të luma- tura tek dëgjojnë së bashku me cicërimat e zogjve edhe cicërimat e pionierëvet që vijnë për të veruar dhe pyjet e krojet bëhen dëshmitarë të hargalisjevet të rinisë, të pëshpëritjevet në mugëtirën e mbrëmjes dhe të puthjeve të fshehta. Dhe gjer natën vonë, nga kom- pet verore të pushimit, përhapen tingujt e një muzike plot jetë e gjallëri.

Ka e s'ka fshatra me kroje, po kroje si ata të Voskopojës nuk gjen gjékundi. Të duket vetja sikur je në mes të një shatërvani dhe ta kënda të pulitësh sy- të e të èndërosh, të èndërosh...

E kush ua di numurin burimevet e krojevet të Voskopojës? Shtrugu i Vogël, Shtrugu i Madh, Zhom- bri, Pashuta, Burim' i Thanasit. Kroj' i Dembelit, Çezm' e Bezhës, Çezm' e Floririt dhe sa e sa të tjerë! Këta sikur kanë mbetur kastile nga ajo kohë e largët, dhe me gurgullimën e këngës së tyre, kanë mall të tregojnë ngjarje të lashta dhe lavdinë e kaluar që iku e u tret si tymi në qiellin e kaltërt.

Çezm' e Floririt! Ah! pse s'i thonë më mirë çezm' e Trëndafiles, çezma e vajzës që u bë kurban në 'të?

Çezma gjindet anës një përrroi, përfund të një liva- dhi, e fshehur, e tulatur, si e hequr mënjanë dhe aty pranë, si dy roje, rrjinë e i bëjnë hije dy shelgje pleq.

Po të shikosh me vërejtje brënda në burim, ke për të parë disa grimca të vogla si flori i ronitur, të cilat, të përkëdhelura nga drita e Diellit, shkëlqejnë e vezullojnë si kristale dëbore. Thonë se janë grimca prej gjerdanit të gushës të asaj fatzeze. Dhe ujërat e buri- mit rrjedhin e rrjedhin tatëpjetë, duke kënduar të njëj- tën këngë, të èmbël e përkëdhelëse. Dhe natën Hënëza

shikohet në burim si në pasqyrë e burimi ndriçon, ndriçon e gjithmonë vazhdon të këndoje këngën e pambuar e të përjetëshme dhe në këtë këngë sikur nauriset tregimi për dashurinë e një kaçaku.

* * *

Dyqint e ca vjet përparrë. Voskopoja ishte qyteti më i dëgjuar në këto anë. Këtu kryqëzoheshin aso kohe karvanet e tregtarëvet që vej' e vinin nëpër rrugët e pamatura të perandorisë otomane. Atëhere qyteti kishte shumë shkolla, shtypshkronjën e tij dhe një Akademi.

Verës, tregtarët e pasur dhe ata që e kishin xhepin të ngrohtë, vinin të argëtoheshin e të dëfrenin në këtë vënd klimaterik, të rrethuar nga të gjitha anët me male të lartë ku ajri i pastërt bije erë trendelinë dhe rrëshirë. Po a thua se vetëm era e borigavet dhe tufat e trendelinës grishnin bandillët nga an' e anës? Jo, mor, jo, se boriga dhe trendelinë kish edhe gjetkë po se ky vënd na rriste ca sorkadhe, që aman aman, të linje mënt' e kokës. E, se ka pasur gjithmonë vajza të bukura shtat-bilonja, pa kanë dalë dhe gjithato këngë për voskopojarkat.

Mos vallë ujërat e burimevet apo era e trendelinës i bën kaqë të mira? Ku ta dish? Ndofta edhe njera, edhe tjetra...

Vjete të shkuara, në qytetthin e Voskopojes, më e bukura nga gjithë të tjerat e përmi shoqet paska qenë kjo çupa e Dhaskal Sotës. Dhe aqë të bukur e kishte emrin sa ç' ishte dhe vetë. Trëndafile e quanin, dhe emër më të përshtatshëm s' mund t'i gjeje. Faqet e saj qenë të kuqe e të mbuluara me push të hollë si ato pjeshikët në qershor. Dhe kur këthehej vajza nga burimi, ngarkuar me kënaçe, atëhere përmbi pushin e fagjet i ndritnin pikëzat e imta të djersës e dukeshin si vesa e mëngjezit mbi fletët e trëndafilit. Gushën e bardhë ja stcliste një gjerdan floriri. Dy gëersheta i der-

dheshin pëpa që nga cepi i lahurisë qëndisur me oja e me zhizha, e i arrinin gjer te beli. Pa, kur shkonte ajo sokakut, majrat e gërshetave luanin valle e kërçenin. Dhe për gjoksin e saj ç' të them? Të bardhë si dëbora e të fortë si shegë.

Babai e kishte të vetme dhe e donte e e donte si dritën e syrit. Kur sillte ndër mënd se po i afronte koha vajzës e një ditë duhej ta martonte e të ndahej nga ajo, atëhere pikëllohej dhe një e therur i kalonte tej e pértej. Si do t'i dukej shtëpia pa Trëndafilen, si do të ulej në tryezë e si do t'i shkonte ajo bukë, pa e pasur dritën e syve aty pranë?

Po vjen një ditë që pjeshka, e pjekur dhe e mbushur plot me lëng, del nga fletët e pemës ku qëndron fshehur e, duke zbuluar gjithë bukurinë e saj, duket sikur i thotë udhëtarit, që kalon aty pranë: «këputmë e futmë në gjil!» Dhe sado e rëndë që të jetë ndarja e këputja nga pema, ajo e pret atë ditë me një gëzim të përbajtur. E në mos e këputë njeri, ajo pikëllohet, tretet e bie vetë në tokë. Oh! po ta dini, more shokë, sa e hidhur e sa e dhimbëshme është kjo rënie!

Dashurinë s' e kish njobur Trëndafilja dhe jastëkun nuk e kish lagur natën me lote të nxehëtë, nga gëzimi i takimit a nga malli i ndarjes. Ajo i donte të gjitha me një dashuri naive e fëmijërore. Ajo donte edhe nënën, edhe babanë, edhe saksitë me karafile, edhe kecërit me ato leshra të buta si kadife, por dashurinë e madhe akoma s' e pat njobur e zëmra për trimin s' i kishte rrahuar.

Njëherë, veç njëherë, kur Trëndafilja ishte një-mbëdhjetë-dymbëdhjetë vjeçë, që tronditur dhe kish mbetur si e mbërthyer në vënd nga vështrimi i syvet të një kaçaku që pat ardhur në shtëpinë e tyre.

Ai ishte ndeshur ballë për ballë me 'të në krye të shkallëvet dhe që andej i kish thërritur Dhaskal Sotës:

— Jotja kjo çupë, o Dhaskal?

— Imja — i që përgjegjur ai.

— Shiko ma ruaj mua këtë, se e paske shumë të bukur. Ta dish, po s' ma dhë, do të ta rrëmbej — dhe si kish thënë këto fjalë, përsëri kish vështruar me ata syt e tij të zjarrtë Trëndafilen që rrinte si e zalisur mbështetur pas parmakëvet.

Ajo në fillim e pa me frikë e pastaj me inat, si gjithë vajzat e vogëla, kur u zënë ngoje punë marte-se. Dhe nga turpi u bë në fytyrë si ato lulukuqet e aravet. Ndejti atje në krye të shkallëvet me kënaçen në duar dhe me ndrojtje në zemër se mos kaçaku kthej e thoshte edhe ndonjë fjalë tjetër.

Po kaçaku s' tha asgjë më tepër. Vec, kur i kaloi përpara, u mat e zgjati dorën si të donte ta përkëdhelte në faqe, pastaj u pendua, dora e zgjatur u ngrit gjer në takije si pér ta përshëndetur, i buzëqeshi krenar dhe zbriti tatëpjetë shkallëvet. Xhufka e zezë e takijes i tundej me fodullëk mbi mëngoret e anterisë dhe maya e myllit që i arrinte gjer te kocinar' i këmbës, i kërciste duke u përpjekur pas basamakëvet të shkallës. Pastaj kaçaku iu afrua doriut, i kérceu mbi shalë dhe kali, duke ndjerë se kish përpara rrugë të gjatë, hingëlliti e turfulloji. Patkonjtë e doriut nxuarën shkëndija kur u përpoqën në kalldrëmin e oborrit e doriu me kailorsin u nisën si shigjeta në shenjë. Trëndafilja pa vetëm xhufkën e takijes që u tendos prapa si pendë shqiponje dhe pluhurin e hollë e të verdhë që ngrihej atje ku shkelte kali. U duk jo sikur iku, po sikur kish fluturuar. Dhe oborri mbeti i qetë e i shkretë dhe Trëndafilja ndjeu se diçka i mungonte dhe atë që i mungonte iu duk se ja kish marrë ai kaçaku me vete. Ah po, ai i kish rrëmbyer zemrën.

* * *

Kishte pritur ato ditë se mos e shikonte, por më kot: kaçaku s' ishte dukur. Dhaskal Sota mbante lidhje të ngushta me kaçakët që kishin ngritur krye kundër

Turqisë dhe ata hynin e delnin atje si në shtëpinë e tyre. Shumë vinin, shumë iknin, veç «ai» s' dukej.

Trëndafilja i shikonte me bishtin e syrit. Ajo dëshéronte të pyeste për atë, të dinte prej nga ishte e kundodhej tani, po ku i gjënden gjurmat kaçakut e si të pyesish për një njeri që nuk i di as emrin?

Kaluan vjete dhe tronditja e parë e Trëndafiles kish mbetur si një vegim i largët dhe nuk e dinte në i kish ndodhur vërtet apo e kish parë ëndër. Ajo punonte gjithë ditën e, duke punuar, qeshte e këndonte e tok me të qeshte gjithë shtëpia, qeshnin edhe saksitë e lulevet, qeshnin edhe ujërat e burimevet që gjendeshin aty në përrua. Veç në mes të këtij gjëzimi të thjeshtë e të kësaj qetësie shpirtërore, xheku i kujtohej kaçaku dhe e merrte malli për atë vështrimin e tij fodull e çapkën.

E ku t'i shkonte asaj në mëndje, se një ditë do të takohej me të pa pritur e pa pandehur! Pojeta kështu e ka: herë na rrëmbe lumtërinë që kemi në duar dhe herë na e sjell këtë lumtëri nga an' e anës, në mënyrë të pakuptuar.

Undodh një pasdreke në burim e, tek po mbushtë ujë, dëgjoi trokun e një kali që ngjitej shtegut të përroit. Vajza vazhdoi të mbushte ujë dhe as e ktheu kokën ta shikonte, kurse kalorësi, me t'u afruar në burim, ja shtrëngoi frerin kalit dhe ja mbajti vrapi.

Shikon kalorësi në burim, si në pasqyrë, fytyrën e vajzës dhe habitet. A është vasha me të vërtetë kaqë e hijëshme sa c'e tregon burimi apo ujërat e gënjejnë? Ai kërkon t'i shohë fytyrën, ndaj i flet pa zbritur nga kali:

— E kujt je, moj gjeraqinë?

Vajza nuk i përgjigjet. Faqet i skuqen prej turpit, ngreh pakëz kokën e i hedh një vështrim vjedhurazi kalorësit. Atëhere, pa dashur e pa e kuptuar se përsë, një drithërimë i përshkoi gjithë shtatin. Iu duk sikur atë vështrim krenar e çapkën dikur e kish ndeshur, sikur ata sy diku i kish parë... «O Zot, mendoi, mos

është «ai»? Dhe kur i njohu në faqen e djathtë atë nishanin e zi, atëhere gjithë dyshimet iu davaritën, e iu duk se zëmra do t'i fluturonte nga krahroni.

Trëndafilja e kryqëzoi edhe njëherë vështrimin me kalorësin, psherëtiti lehtë-lehtë e përsëri uli kokën. Bucelat të mbushura me ujë po prisnin aty në diell e Trendafiles nuk i bënин duart t'i merrte e të ikte. Ajo me merak në zemër mendonte: «Vallë a do të më njohë?»

Kalorësi qëndronte hipur në kalë. Takijen e kuqe me xhufkë të zezë e kishte shtyrë pakëz prapa dhe mbi ballë i binte një baluke edhe ajo e zezë si pendë korbi. Edhe syt e tij të zes ndritnin e shkreptinin. Lëshoi frerin e doriut, se zëmra ja don-te të këmbente dy fjalë me këtë drenushe mali, e duke përkëdhelur lelen e kalit, u var nga vajza dhe i foli, po këtë radhë si me të lutur:

— Moj fëllënix' e malit, jepmë një pikë ujë sa të lag gërmazin!

Vajza përsëri nuk i foli; u ul, mori bucelat, i hodi në krahë e u mat të nisej; kalorësi e vuri re, kërcëu nga kali dhe, i shpejtë si fajkua, ja zuri rrugën tej e tej.

Atëhere i foli vajza me një zë të perënduar:

— Zot, më ler në punën time se im atë po më pret.

E kalorësi i përgjigjet duke vënë buzën në gaz:

— Pa më dhënë një pikë ujë, unë rrugën s'ta liroj.

— Ujë? — e pyeti vajza si e çuditur. — Në do ujë, ja tek e ke burimin. Aty është edhe më i freskët.

— Gjithë jetën kam pirë ujë burimevet e krojevet, po tani dua të pi prej duarvet të tua, dua të pi nga bucela jote.

Trëndafilja u mendua e pastaj me turp e ndrojtje i zgjati bucelën.

«Sa t'i jap të pijë e do të ikëj... Ai s' më njohu, dhe, siç duket, as ka për të më njohur. Ai më ka harruar.»

Duart e kaçakut u zgjatën e muarën enën, kurse syt e tij nuk ja ndau bukuroshes. Pastaj e ktheu bucelén si të ishte pllockë vere e piu e piu, pa ja ndarë sytë; e, si u ngop, e shtrëngoi bucélén pér gjoksi e ndeji i menduar. Diç mundohej të kujtonte. Ku i kish-te parë këta sy, ku e kishte parë këtë nur? Asgjë s' i binte ndër mënd...

Trëndafilja e përmëndi nga këto ëndërime:

— Zot, ma kthe bucélén se m'u bë vonë dhe në shtëpi më presin.

— Bucélén do të ta kthej po çdo të më falësh si kujtim?

Trëndafilja ngriti vetullat përpjetë me fodullëk e iu përgjegj krenare:

— S' kam q' të të fal, se jam vajzë e vajzat s' falin gjë.

Kaçaku mbeti ngushtë, ngriti dorën, përkëdheli atë baluken që i kish dalë nga takija dhe i foli:

— S' qënke vetëm e bukur, po qënke dhe e zgjuar, moj sarkadhe e malit. Ta dish që unë s'do të ndahem ty...

Psherëtitit Trëndafilja e, duke përbledhur gjithë fuqitë e saja, guxoi të thoshte:

— Pa kujtoju mos i ke dhënë fjalë ndonjë tjetre!

Ngriu kaçaku në vënd dhe më t'ju errësua ai vështrim i syve të zes dhe një re trishtimi i kaloi përbimi ballë. Dielli perëndoí prapa malit e pylli i pishavet përkundrejt u duk më i errët e hijerëndë. Ranë kambanat e kishës së Shën Prodhromit e dy harabela të trembur erdhën e u tulatën në fletët e shelgjevet. Keçaku e ndjeu që e humbi davanë dhe, duke tundur kokën, foli ngadalë:

— Ikë, moj fëllénxë, ikë; po ta dish që s' do të ndahem. Unë do të të rrëmbej — do të hedh në vithe të kallit e do të shpie në kaliven time.

Trëndafilja iu përgjegj me krenari:

— As më rrëmben dot e as më prek dot. Unë jam e bij e Dhaskal Sotës.

Atëhere kalorësi ndehti i menduar, fërkoi me gish-trinj majën e mjekrës dhe, duke kujtuar atë vajzën e mitur të Dhaskal Sotës, që e kish takuar në parmakët e skallës, i tha:

— Dhaskal Sota një vajzë që ka, e ka akoma të vogël. — Shikoi syt e Trëndafiles; shikoi edhe gushën e saj dhe sikur u përmënd. Ishin po ato tipare të asaj njomces, vec më të pjekura, më të gjalla e më të ndezura nga gjaku i rinisë, që i vlonë ndër deje. — Po në është e vërtetë ajo që the, dije se atëhere je e zgjedhura ime.

Vajza vuri buzën në gaz e i kërkoi bucelën.

— Mere bucelën, po unë një nishan e dua që ta quaj veten të fejuar me ty...

— S' kam çfarë të të jap.

— Nëm unazën tënde që ta kem peng për dashurinë tonë e të të përgjërohem se unaza do të më dalë nga gishti, atëhere kur të më dalë edhe frym' e fundit.

Trëndafilja shikoi duart e saj, fërkoi unazën me gisht e sikur u mat ta nxirrte. Pastaj tunç kokën e i foli kaçakut e vendosur:

— S' ta jap dot, o trim i malit. Po t'më pyesin në shtëpi pse s' e kam unazën, çfarë t'i them nënës, çfarë t'i them tatës?

— Thuaji nënës që të humbi, tek po mbushje ujë.

— Jo, o trim. s' i gënjej dot, se jam vajzë shqiptare.

Kali hingëlliti sikur kjo përgjigje ta kishte gëzuar, kurse kalorësi pshëretiti.

— Nëm bylyzykn' e dorës...

— Jo, o trim, nuk ta jap dot. Kot e ke që më vardisesh.

Sa më shumë krenare që tregohej vasha, aqë më shumë i pëlqente kaçakut. S' ish vetëm e bukur e zgjedhur e tij po që edhe trimë!

— Nëm gjerdan' e gushës. Do ta mbaj si hajmali; ja këtu, në gjoksin tim.

— Jo, o trim, nuk ta jep dot. Në më pyetë nëna, në më pyetë tata, si t'i them unë e shkreta?

— Thuaju tek mbushnje ujë, ta rrëmbeu shqiponj, e malit.

— S'jam e zonja të gënjej, o trim, se me të hapur gojën e di që do të më kuptojnë. Dhe po qe se ti më do vërtet, ashtu sikurse thua, atëhere nuk më mëson t'i gënjej, se sot gënjej ata e nesër ty.

Kjo përgjigje më shumë e gjëzoi se sa e çuditi. Ai hapi krahët e thërriti:

— Të gjeta ashtu si të ëndëroja, moj drenushe. Tani, në daç më jep nishan, në daç mos më jep, ti je imja që tani e gjer sa të më regëtijë zëmra në krahrror. Betohem për tokë e për qiel, se nuse tjetër nuk e kapërcen pragun e shtëpisë sime. — E, duke thënë kështu, bëri dy hapa përparrë, i mbërtheu të dy supet e Trëndafiles, që dridhej e tëra si fleta e plepit, e tërhoqi pas vetes dhe e puthi me ashk e me zjarr si natën e parë të martesës. Dhe Trëndafilja, mbështetur kokën në gjoks të tij, qante. Qante nga gjëzimi, nga dashuria, nga diçka që e ndjente thellë në shpirt, po s' e dinte si ta çfaqte. I dukej sikur duke qarë fliste e sikur lotët e saj thoshnin të atilla gjëra, që as goja e as zemra s'i çfaqnin dot.

— Pse qan, moj bukuroshe? — e pyeti kaçaku, duke ndjerë një dhëmbje në shpirt dhe duke mos ditur në kish bërë mirë a keq që ish sjellë kështu me vashën.

— Qaj se të kam pritur... — iu përgjegj ajo.

Trëndafiles i shkonin lotët çurg dhe donte të shtërgohej pas tij se i dukej sikur gjente mbrojtje e përkrahje, nga një e keqe që i kanosej. Duke futur kokën në gjirin e tij, ndjente atë erë e atë amëz të veçantë, që kishte trupi i kaçakut.

Ai ja fshinte lotët, që i shkisnin nëpër faqet, me mëngën e bardhë të tallaganit e mezi mundi ta pushonte. Pastaj të dy u ulën rrëzë shelgut e kuvënduan gjer e gjatë.

Aty muarën vesh se që të dy e kishin dashur njëri tjetrin, qysh atë ditën e takimit në parmakët e shka-

llës, dhe këtë çast të lumtur e kishin èndëruar në këta vjetë që kishin jetuar larg' e larg.

Aty dëgjoi Trëndafilja fjalët e para të dashurisë, e, duke i dëgjuar, e ndjente zëmrën të dehur e të velur nga lumtëria; i dukej se ngazëllimi i buronte në shpirt si ujërat e burimit e zëmra i thoshte se ky çast nuk do të kishte të mbaruar. Po kur hodhi sytë e pa në shalën e kalit dy jataganë që vareshin tatëpjetë dhe grykën e pisqollës që dukej e kuqërrëmtë nga rrezet e Diellit, atëhere gëzimi iu turbullua dhe u përmënd.

— E përse i mban gjithëmonë këta jataganë me vete? Trëmbem kur të shikoj kështu.

E trimi iu përgjegj krenar:

— Jam kaçak i malit. Dhe kaçaku pa armë është si luani pa kthetra e ca më keq akoma. E di si jemi ne kaçakët? Siç e thotë ajo kënga:

«Jastëk kanë gurët,
Përflénj kanë gunët,
Bie bora i mbulon,
Bie shiu i zbulon,
Bie djelli dhe i ngron...»

Armët na duhen si buka e si kripa. Tani jemi pakë, po kemi shpresë të bëhemë shumë, të ngrihemë të gjithë më këmbë dhe atëhere Turku do ta ketë keq. Madje, ai qysh tashti na e ka frikën, prandaj ka vënë ko shadhet që të na ndjekin këmba këmbës. Dhe përse na ndjekin? Se duam të jemi zotër në shtëpitë tona.

Tej, luginat u errësuan dhe që andej dukej sikur dilte e shkiste vjedhurazi muzgu i mbrëmjes. Ranë përsëri kambanat e manastirit të Shënpashkët. Hënëza lartë në qancell, sa vinte bëhej më e ndritëshme dhe drita e saj e ergjëntë mbuloi gjithë vëndin. Fletët e shelgut fëshfëritnin nga flindi i erës dhe burimi dukej si i ndezur e sikur një tufë rrezatimesh të quditëshme e të padukëshme e ndriçonin që poshtë ëmbëlsisht. Doli dhe ylli i mbrëmjes, duke vezulluar midis drurëve të

kreshtës së malit dhe atëhere, vajza u ngrit të ikte.
Kur u ndanë ai e pyeti?

— Nesër a do të vish në burim?

— Do të vij dhe, e mjera unë, s' do më pritet gjer
sa të ngryset.

Gjith' atë javë ata takoheshin te burimi, sa fillon-
te të ngrysej, dhe, aty prapa shelgjevet, putheshin e
përqafoheshin plot dashuri, si dy zogj të lumtur. Dhe
Hënëza në quell e ujërat e burimit qenë dëshmitarë
për dashurinë e tyre të pastër e të sinqertë.

Veç dashuria e lumtëria e tyre qe e shkurtër: më
e shkurtër se lulëzimi i trendelinës në verë, më e
shkurtër sejeta e manushaqes; ajo zgjati në jetën e
tyre aq sa zgjat vetëtima.

Koshadhet e turqëvet ndiqnin kaçakët shqiptarë
dhe ai u nda nga ajo, duke i thënë:

— Kasollja ime nuk është aqë e pasur sa e t'yt
eti, po dashuria ime do të të mbajë ngrohtë. A do të
vish?

— Ku të duash ti do të vij; edhe në një shpellë ma-
li, veç tok me ty të jem.

Kaçaku atëhere u hepuar nga kali, i përkëdheli gér-
shetat, e puthi në buzë dhe i la fjalë se do të kthehej
ta merrte pas një javë, kur të delte hën' e re dhe ajo
le ta priste aty në burim.

Pastaj u nis përrugë e u bashkua me shokët, që
po e prisnin mbanë pyllit.

Iku, po më s'u kthyë. U vra kaçaku në luftë kun-
dër koshadhevët të turqëvet dhe s' mundi ta mbante
fjalën e dhënë. E vdiq me merak në zemër. Mbështetur
në trungun e një pishe, u la amanet shokëvet që të
vinin e t'i jepni mandatën së fejuarës së tij, që po e
priste me një boçe në duar, në një nga burimet e Vos-
kopojës. E kur po jepte frymën e fundit, ngriti sytë
në quell e pa si nëpër mjergull dy shqiponja që ende-
shin lart, duke bërë rrathë të mëdhenj. Dhe atyre u la
amanet:

21989
LIBRARY OF THE SH. CECIL
GJEROKASTER

Hanko Labes

LETRA E TURKUT

Sulmi i komitëve shqiptarë kundër karvanit të postës turke, në grykat e Barmashit, qe i shpejtë dhe i befasishëm. Komitet vranë suvarinjtë që shoqëronin karvanin e postës qysh me të shtënati e para, pastaj duallën nga pusitë dhe me të thirrura e me të britura, siç e kishin zakon, u vërsulën në xhade, rrëmbyen paratë, thesin e postës, u muarën armët të vrapëvet dhe pas pesë minutash iu qepën shtegut përpjetë malit dhe u zhdukën në pyll.

Kur arritën në limer, kapedan i tyre, Zylyftar Mërtiri, u hoq mënjanë dhe, me që dinte turqisht filloi t'i lexonte letrat një për një, që të mësonte si ish gjëndja dhe morali në ushterinë turke.

Midis atij togu lettrash, ai vetëm një letër e hoqi mënjanë; të tjerat i hodhi në zjarrin që digjej aty pranë dhe me sy të pulitur e i menduar i bëri sehir gjer sa u bënë shkrumb e hi. Letra i kish kujtar Zylyftarit, shokun e tij, trimin kapedan Bogdan Muzakën. Ja, se ç' shkruhej në 'të:

«Bismilahi - Rahman el rahim!
E dashur Nëno!

Arritëm këtu në Arrnautllék. Si qënka ky vënd, moj Nëno, aman-aman, gur e shkëmb! Dhe, nga do që të

hedhësh sytë, male shikon, male hije rëndë e të mërzitur. Pa ta dish ç'më ka marrë malli për Anadollin tonë, moj Nëno; të dal njëherë në selamllékun e shtëpisë e të hedh sytë nga ajo fusha e gjerë, e pamatur, me atë ngjyrë të verdhë e si në të kuqe dhe të ndjej në gjoksin tim erën e ngrrohtë të shkretëtirës së Arabisë, atë erë që më dukej sikur më dehte, pa s' dua gjë tjetër.

Thonë kot për Anadollin tonë që është i shëmtuar dhe e shajnë se s' paska ujë e s' paska drurë; jo, Nëno, jo. Anadolli ësht' i bukur, të ngopet syri me pamje e me hapësirë dhe Dielli tek ne është ndryshe: më i nxeh të e më i kuq. E tani s'më hiqet nga sytë ajo fusha përpëra fshatit tonë dhe më vjen të qaj nga mallëngjimi, kur kujtoj dhëntë tona tek ktheheshin mbrëmjevet nga kulloata dhe karvanet e gamilevet, që shkonin fushës e nga Dielli më të perënduar dukeshin trefish më të mëdha ja, e sikur nuk ecnin në tokë, po qëndronin pezull në qiell. Mirëpo, që kur se kam ardhur në këtë djall vend, më ndjell zëmra keq e më duket sikur s' do t'i shikoj më kurrë. Këtu malet të marrin frymën dhe të shter-ngojnë zëmrën. Ti kapërxen një qafë dhe pandeh se do të shikosh fushë, po meazallah, mal tjetër ke përpëra dhe qafa e gryka sa të duash. E ndjen veten sikur ke rënë në fund të pusit; sipër shikon vetëm një copë qiell, ku fluturojnë duke bërë rrathë ca shqiponja ogurzeza, dhe asgjë tjetër.

Apo njerëzit e këtij vendi, sa të egër, moj nëno! Të thatë e të ashpër si malet ku rrojnë, të zymtë, të vrënjtur e të dobët si langonjt e gjahut. Ku u mbahet ai shpirt, xhanëm? Vetëm syt e zes u ndrijnë si të ujqërve të uritur në shkurt dhe kur ta ngulin atë vështrimin e egër (Allahu na ruajt!), të kallin datën e sikur të mbërthejnë me perona. Ja, kështu janë: të hojë, të thetë, po të fortë si djalli. Tani i shikon këtu, tani në qafën e malit e thua se s'vajtën më këmbë atje, po hapën ato tallaganet me mëngoret e gjëra e flutruan.

S' kam as tetë javë që kam shkelur në këtë vënd të mallkuar dhe në ke njeri hasm, mallkoje: «të shpënçin në Arrnautistan!» Ç' t'u pëlqesh këtyre? Dhe këngët e tyre janë si ulurimat e lukunisë së ujqërvet në dimër. Këndojnë gjithë bashkë e kush mundet thërret më tepër. I kam parë dhe kur dëfrejnë. Këta, kur dëfrejnë i harrojnë të gjitha: edhe helmet, edhe fukarallë-kun edhe Allahun. Atëhere hanë e pinë pa kursim dhe as e vrashin mëndjen në u mbetet gjë për nesër a jo. Milet i çuditshëm.

Me njeri tjetrin ndajnë kafshatën e gojës, po neve meazzallah se na japid kaqë gjë. Dhe ne e kemi gjetur kollaj. Të gjitha ato që na duhen i marrim vetë. Tani, ca të çmëndur kanë ngritur krye me armë në dorë. Kajmekami na tha, se as këta s'do ta kenë të gjatë e do t'i shkojmë në satëri si të tjerët, mirëpo të bezdisin. Po ç' më kanë parë sytë këto ditë, moj nëno... s' do ta harroj kurrë! Zumë një komit arrnaut të gjallë. Këtë komitet janë hairsëzë, njerëz që s' u dhimbset shtë-pia e fëmija, se i braktisin e bëhen firar muaj me radhë; me një fjalë janë njerëz të hurit e të litarit, po për të luftuar ama. dijnë të luftojnë dhe s'u trëmbet syri. Thoshnim ne që s' ka si jeniçerët e ushtrisë sonë, nga ata dridhet foshnja në bark të nënës, dhe atyre s'guxon t'u dalë kush përpara, po ja këta arnautët s'pyesin as për jeniçerë as për suvarinj. Zënë pusi në ca rrëpira e në ca gryka të ngushta dhe sulen me tërsëllëm mbi asqerin tonë, duke thërritur në gjuhë të tyre djalli e di se çfarë. Allah! Allah! Kur sulmojnë e kur zbresin nga malet turrap, u hapen ato fustane-llat e anteritë e bardha, e në ato çaste s' duken si një-rëz po si shqiponja që fluturojnë. Të kallin lemerinë. Ti i mban shënjë dhe e qëllon drejt në gjoks, ai të sulet më këmbë gjer në istikam. Dhe mos pandeh se s' e ka zënë plumbi; ti e ke shpuar tejpërtej, mirëpo duron derri e s'i thyen gjunjët dhe po të erdhi sipër, s' të le të gjallë.

Janë të këqinj sa më s' bëhet. Unë kam qënë në Siri, në Persi e në Palestinë po si këta s' kam parë.

Dhe atë komitin, që të shkrova më sipër, e zumë me dredhi. E di si i zënë kanarinat këtej? Nxjerrin kuvlinë me kanarinën femër dhe e varin në ndonjë degë, peme. Kanarina fillon të cicërojë e të ndjellë mashkullin. Ai e dëgjon, afrohet dhe e shikon me çudi kuvlinë me thupra. S' kupton pse s' fluturon dot ajo s' an-dejmi dhe, duke i ardhur rrotull kafazit, gjen derën dhe futet edhe vetë brënda. Mirëpo dera është bërë vetëm për të hyrë, derë për të dalë s' ka. Atëhere, njeriu del nga vëndi ku ka qënë fshehur e, duke qeshur, zgjat dorën e merr kuvlinë me çiftin e zogjvet.

Kështu e bëmë edhe ne.

Nga një afija jonë muarëm vesh se kryekapedani arrnaut, Bogdan Muzaka, na paska shtënë dashuri me një arrnautkë, bijë prifti dhe, njëherë në dy tre javë vinte ky Bogdani dhe takohej me 'të fshehur uratës.

Tursun Demirogluj, ai zabiti që mundej me arapët në fshatin tonë dhe që i hidhte të gjithë poshtë, ish betuar para kajmekamit të merrte gjakun e të vëllajt dhe të mos ikte nga Arnautllëku pa e vrarë Bogdanin. Dhe e përgjuam ne, fshehur në pyll dhjetë ditë me radhë. Të njëmbëdhjetën erdhi, aty ku e priste e fejuara. I rre-thuam ne, dhe i zumë që të dy në një korie lisash. Komiti u ndodh ngushtë se u gjend pa armë.

I dolli atëhere zabiti ynë Tursun e i tha:

— S' më shpëton dot nga thonjtë, o Bogdan Arnauti. Ti vrave tim vëlla e unë tanë do të vras ty. Gjaku lahet me gjak.

Kur, q'të shikonje ti! Iu derdh ky Bogdani si qen stani dhe, duke thërritur si i çmëndur, e zuri për beli dhe e hodhi poshtë Tursunin. S' ka q' i bën thamë ne, se e dinim që ish pa armë, megjithatë u sulëm nja tre katër veta që të ndihmojmë zabitin tonë. Japim e marrim që ta shkulim; meazzallah. Më së fundi i dhamë një yrysh dhe e shqitëm. Po q'të shikoje, moj nëno! Tursun Demirogluj përpëliste sytë dhe gjaku nga gry-

ka i vinte pizgë. Bogdan Arnauti ja kish ngulur dhëmbët në gurmaz si ujku deles dhe e kish shqyer. I kuq-nin sytë si ndonjë të çmënduri dhe gojën e kishte tërë gjak e ndër dhëmbë mbante akoma, pa qënë në vete, një kërcë të bardhë nga gurmazi i të shkretit Tursun. Më zuri tmeri. Kam qënë në Alep, në Bagdad e në Gjalilë dhe në luftëra kam marrë pjesë, po këtë s' ma kishin parë sytë gjékundi. C' tu bësh këtyre, moj Nëno? Këta të shqyejnë me dhëmbë si egërsira.

Dhe ajo arnautka e pa si ja coptuam me jataganë të vluarin, aty ndër syt e saj e pikë loti s' derdhi. Zëmër kish apo gur? Jo, moj nëno, gratë tonas' janë kështu.

Iu kthyem pastaj asaj bushtrës dhe e lidhëm. E bukur ajo arnautka, me sy të mëdhenj e të zes, me vetullën hark e me faqe pakë të zbehta. Bobo, ç' m'u drodh zëmra kur i pash ata dy sy, se ngjisin me të Gjylstanit tim. E muarëm ne, e me të shara e të shtyra ja shpumë bylykbashit. Ai lëpiu buzët kur e pa, pisillosi mustaqet dhe u kollit me djallëzi.

— Sonte, moj fëllënëxë, — i tha, — do të më kënaqësh mua, se kam tre vjet që s'kam rënë me grua.

Mirëpo kur i treguam ne se ç' ngjau, e kur i thamë se kjo helmin, që i vramë të vluarin, e ka të mbledhur në zëmër si gjarpër, bylykbashi u trëmb dhe pati frikë ta fuste në jatak. Me atë zëmër që kish arnautka e me ata sy të egër të mbyste kur të dojë, dhe aqë më tepër në ato çaste...

— Vrajeni! — tha bylykbashi. — Farë të mos mbetet nga ky pis mitet.

Unë rrija me sytë përdhe, se sytë e bijës së priftit më kishin kujtuar Gjylstanin tim e më kishin hapur plagët e zëmrës. Bylykbashi më vuri ré e më tha:

— Po ti ç'ke, o Nuredin, që rri kështu? Të ardhka keq për këto ndyrësira? S' je mësuar ti me këta, se tani ke ardhur, po dil e vraj që të argasesh.

Dhe dolla unë nga sëra.

Nxora jataganin.

Kaurka rrinte aty, mbështetur pas murit të kësh-tjellës, me duart lidhur prapa e me kokën lart. Dhe sytë e zes i shkreptitnin e flegrat e hundës i hapeshin e i mbylleshin me tërsëllëm. Dhe gjoksi nën linjë i hidhej përpjetë vup e vup.

S' më bëri zëmra t'i afrohem.

I them bylykbashit:

— Bylykbash! Dymijë shqiptarë nëmi këtu e t'i shkoj në thikë, veç mos më bëj ta ndyj dorën me grua.

— Vraje të them. Njësoj janë këta si burrat si gratë. Dhe u hoq mënjanë të bëjë sehir.

Obobo, moj nëno, si m'u err oborri!

Iu afrova zdruq e zdruq e qëndrova një jatagan larg.

Ngrita dorën me jatagan, ja terezita në zemër që të mos e mundoja shumë dhe më që s' pata guxim ta shikoja në sy, ktheva kokën mënjanë. Dhe e shtriva jataganin përpara, si i verbëri shkopin.

E ndjeva se maja e jataganit u mbështet në gjoksin e saj. Ajo bëri prapa, unë bëra përpara. E shtyva dhe pakë krahun. Kërrr ja bëri linja që u çà dhe pastaj ndjeva se maja e jataganit u fut në gji. E ndjeva se gjir' i saj u drodh e u përpëlit si zog e mua m'u drodh jatagani në dorë e m'u drodh zëmra në krahor.

Qëndrova me kaqë dhe ktheva sytë ta shikoj. Nga ana tjetër e gjirit i kish rënë gëersheta, nga kjo anë bajoneta. Ajo dridhej e tëra si ndër ethe. Nga sytë lotët i vinin çurg. buza e poshtme i qe varur e i përpëlitez e dhëmbët i kërcisin. Qante nga dhëmbja, po s' donte të bërtiste, duronte, derrja! E si ta kish pritur atë çast që ktheva kokën, më pështyu mu në ballë. Ndjeva të qeshurën e bylykbashit.

— Ha-ha-ha, Hi-hi-hi! Mirë ta bëri, o Nuredin.

Atëhere mora inat dhe e shtriva krahun sa munda e më tej.

Dëgjova një lebetitje të tmeroshme dhe ndjeva se m'u var mbi jatagan. I dhashë një shqelm pastaj dhe e

hodha tej. Fshiva pështymën nga ftyra dhe e hodha jataganin, se nuk e shikoja dot me gjak.

Mirëpo që atëhere më del natën në gjumë e s'më lë të fle. Thérres natën me lebeti se më duket sikur dikush më kafshon në grykë, si të shkretin Tursun, e s' më lë të marr frymë. S' para e ndjej veten mirë.

Vënd i mallkuar, tri herë i mallkuar, xhehnem, më mirë të mos qe fare mbi këtë botë.

Dhe na ka gjetur belaja se arnautët, që kur më suan këtë vrasje, janë tërbuar fare e tanë më s' dalim dot si përpara dy nga dy. Tanë kudo që shkelim shkoj-bylyk-bylyk.

S' di, moj nëno, pse më ndjell zëmra keq në këtë vënd e sepse këto kohët e fundit më ka marrë malli shumë për Anadollin tonë, për rërën e kuqe e për fu-shën e gjérë. Këta malet këtu po më shtypin, më duket sikur i mbaj në krahë. Jemi si në mes të ujqërvet. Në shpëtofsha, të bëjmë shyqyr.

Thuaj Hoxhë Firusit të bëjë një dua për mua e dhëntë Allahu të ikëj sa më parë nga ky dreq vënd gjithë gryka, shkrepë e male, ku i huaji e ndjen veten si në një labirinth. Në mos ardhça gjer për Sulltan Nevruz, dërgojini haber Gjylistanit të shikojë punën e saj, se s' është mirë ta mbaj dhe atë varur. Jepi të tit. Me zëmër e mëndje pranë jush.

Ju puth dorën e djathtë.

Unë, djali juaj, Asker Nuredin Islam.
Allahu u shtoftë gjithëvet ymrin!

Arnautllék — Vilajeti Janinës, më 8 të Vjeshtës së dytë — 1296 (1876)»

* * *

Kur e mbaroi së lexuari këtë letër, Zylyftari u bëri zë shokëvet të mblidhen e të dëgjojnë ç' thotë Turku me gojën e tij.

E pas kësaj, bënë këshillë që letrën t' ja dërgojnë nënës së Bogdanit dhe priftit; që të krenohen me fëmijët që rritën e të mos u vijë keq për humbjen e tyre, se vdiqën ashtu siç vdes shqiptari: më këmbë, të papërkulur dhe krenarë.

Tiranë, 1959

NË DASMË

Në qilar dëgjoheshin, më mirë se kudo gjeçkë, trokitjet ritmike të atyre që vallzonin sipër në odë dhe, së bashku me zhurmën që bënин këmbët duke u përplasur në dysheme, vinin të qeshura, të bërtitura, tringëllimi i gotavet dhe i pjatave, muzika e sazexhinjvet dhe, mbi të gjitha, ngrivej një poterë e mbytur dhe konfuze, e cila është e zakonëshme ndër dasmat tonë. Të gjitha këto përzjeheshin, ngatërrroheshin dhe zhurma herë ngrivej, herë platitej si dallgët në det, por gjithmonë vazhdonte dhe tamtanaja e gjëzimi i dasmës, përhapej në qetësinë e natës vjeshtarake, sa fqinjët — ata që s' kishin ardhur në dasmë — e kishin zor të flinin. Dukej sikur shtëpia ish kthyer në një kijke që tundej pa pushim e sikur, nga çasti në çast, dyshemeja do të këpütej dhe të gjithë ata, që ndodheshin sipër, do të binin poshtë me të thirrura e me të virru-ra, por pa e prerë gazin që i kish pushtuar.

— Dasmë po dasmë! — tha akciu Pandeli me një ton, ku shprehej habia për ato që ngjisin lart. Me systë ngjyrë plumbi, plot rrudha të thella anës, vështron-te Teto Marën, të zonjën e shtëpisë, dhe tundëte kokën për të treguar se nuk gjente dot fjalë të çfaqte, ashtu si duhej, kënaqësinë që ndjente në shpirt. Si akçi, i kishin dhënë një përparëse të bardhë, ku dukeshin akoma vijat e hekurosjes, dhe Pandeliu herë pas here, me

punë e pa punë, fshinte duart mbi 'të, duke dashur ta laturisë sa më parë, sepse ajo bardhësi e virgjër e bezdiste. Pakë më tutje, një burrë i shkurtër, me një qepshe në dorë, diç kaurdiste në një tenxhere dhe picërronte sytë për t'u mbrojtur nga tymi.

Teto Mara, me një zë të kapitur, sikur të mos i kish dëgjuar fare fjalët e Pandeliut a sikur të mos i kishin bërë përshtypje, foli:

— U lodha, u këputa... Gjithë ditën më këmbë, ec e jakë, m' u prenë gjunjët. Erdha të çlodhem një cilë këtu poshtë.

— Të çlodhesh, posi; dasma ka telashe, lodhet këputet njeriu. — Akciu Pandeli i nxori një fron të vogël prej druri dhe, duke e vënë afër murit, foli si t'i lutej:

— Ja, po deshe, ulu mbi këtë fron...

Teto Mara u ul e kënaqur, si pas një rruge të gjatë mes vapës dhe, duke shikuar Pandelinë, foli me një zë të butë, sikur kërkonte të çfajësohej:

— Vdiqa dhe për gjumë. Mbrëmë, ku fjetëm fare? Më dy ramë, më pesë u ngritëm.

Mbi kalldrëmin e qilarit, të cilin për shkak të dasmës e kishin kthyer në guzhinë, Pandeliu kish hedhur bar të thatë dhe fier. Nga kjo shtresë e butë dhe aromatike, nga tenxheret që zjenin, nga bukët e bardha që ishin vënë stivë, qilari nuk dukej i zyrtë dhe i trishtuar, megjithëse muret qenë pa suva, me gurë të vjetër të nxirë nga pluhuri e nga koha. Qilari tani kish marrë atë pamje që kanë dhomat e shtëpijavet të reja, të pamburuara akoma, ku të zotërit nxitohen të hyjnë brënda sa më parë, pa ja vënë re mungesat që ka.

Teto Mara vuri brylet mbi gjunjë dhe në pëllëm-bët e duarvet mbështeti kokën të cilën tani e ndjeu më të rënduar. Mbi shaminë e zezë, me të cilën mbështille te kokën, sot kish vënë një lahuri të bardhë, siç e donte zakoni, për të treguar se në shtëpinë e saj kishte dasmë e në shpirt gjëzim e dlrësi. Këtë e kish vënë qysh atë çast që nusja shkeli në prag dhe s' e kish hequr akoma, po tani që po dremiste, dukej se shamija

s' kish zënë vënd mirë e sikur era e kish hedhur atje kuturum.

Mbi zinë e gjatë e të dhimbëshme të Teto Marës, ajo cohë e bardhë që simbolizonte gjëzimin e lumtërinë, nuk ishte puthisur mirë e me këtë sikur donte të tre-gonte se në atë zemër nëneje, pakë vënd kish mbetur pér gjëzime.

Në qilar hynin e delnin ata që u shërbenin dasmorëvet. Sillnin pjata bosh dhe merrnin të tjera të mbushura me meze dhe, pasi i vinin mbi ndonjë tabaka a a ndonjë tepsi, iknin me vrap, gjithëmonë me etjen e pa-shuar pér t'u shërbyer sa më mirë të ftuarvet. Këta sillnin edhe të rejat që ngjisnin lart.

— Kumbarja ngriti një doli me shtatë gota.

— Çomja u pi, u bë xurxull. Do të ngrihet të kërcejë, po s'e mbajnë këmbët dhe shkon qoshe më qoshe.

— Vëllami i ngjiti në ballë njëqind lekë sazexhiut...

Akçinjtë dëgjojnë me vëmëndje e me buzën në gaz, sikur presin të ngjasë diçka komike që t' ja krisin të qeshurës. Edhe në qoftë se ajo, që dëgjojnë, ësh-të nga gjërat më të zakonëshme përsëri qeshin me gurmaz, si me pahir dhe, herë pas here, Pandeliu nuk harron të pyesë:

— Po Stefani ç'bën, a u dejt? Se ai, kur pi, bëhet i lezetshëm.

Teto Marën s'e vë re njeri. Ajo çlodhet mbi fron me kokë në pëllëmbët e duarvet dhe veshi pa dashur i dëgjon copra bisedash, të cilat hyjnë në mendjen e saj, por nuk shkoqiten. Truri i ngatërron këto biseda me të tjerat që ka dëgjuar përpara, i rregullon si do vetë, i lidh me ngjarjet e zhurmëshme të ditës. Kur mbylli sytë, Teto Marës i bëhen përpara vargjet e krushqë-vet dhe turma që sjell nusen në oborr, pastaj i dalin përpara sofrat mbushur me miq e me të ftuar, njerëz që ngrihen në këmbë e shkundin, si duke bërë ndonjë trimëri, kupat me rakinë që të përvëlon grykën, dhe përsëri njerëz të tjerë që sillen vërdallë pa kuptim. Ata qeshin, thërrasin, kërceinë e ven' e vinë, pastaj

dikush ja merr këngës. Të gjitha këto janë të paqarta, pa lidhje, mpleksen njera me tjetrën, vijnë duke u mje-gulluar e duke u shuar e pas pakë treten fare; atëherë Teto Mara qetësohet, s'dëgjon më asgjë dhe e mund gjumi...

Akciu Pandeli e vë re se si i falet koka Teto Marës dhe buzëqesh pa të keq. Me vete të tij i jep hakë Tetos së lodhur që fle mbrëmjen e dasmës, pastaj, si fshin edhe njëherë dorën me përparëse, i afrohet zjarrit dhe përshkëndit urët. Xixat ngrihen përpjetë e fluturojnë në oxhakun e lartë.

Teto Mara fjeti, por, pa kaluar asnjë minutë, u drodh në gjumë dhe klithi duke kryqëzuar duart përpara:

— E zeza unë, djali...

Akciu Pandeli u kthyte menjëherë, pa e lëshuar mashën nga dora dhe i foli i trëmbur:

— C'pate, moj?

Teto Mara pshërëtiti me ankth, e lodhur:

— Ah, unë e mjera, djali m'u çfaq në èndër...

Oh! çfar èndër të dhimbëshme kish parë Teto Mara! I kish ardhur djali i madh e kish qëndruar te porta jashtë sikur nuk guxonë të hynte brënda e t'i shqetësonë ata që këndonin e kërcenin me gaz. Vetëm nëna e kish vënë re, se ishte nënë e, po të mos e shikonte ajo, kush do ta shikonte? Dhe ai, me një zë të lodhur, sikur t'i vinte keq për atë që i kish ndodhur e sikur ta ndjente vehten të lënduar, i tha asaj:

— Moj nëno, po mua pse më harruat fare, pse s'më thërritet në dasmë?

— Jo, mor bir i nënës, ti je djali i shtëpisë... hajde brënda...

Po ay qëndronte te pragu i menduar dhe sikur nuk po vendoste dot, si i huaj në derë të huaj.

— Hajde, mor bir i nënës, hajde...! — Dhe Teto Mara që sulur ta merrte për dore e ta fuste brënda, por duke shkuar drejt tij që kujtuar: «Zot, o Zot, po ky ka vdekur, qysh erdhi te porta?». Atëherë mbeti për

një çast e ngrirë në mes të oborrit, po pastaj a mund të përbabahej zemër e nënës? E kuptoi që ishte në èndër e gjithë trupi iu drodh si një tel i hollë, nga frika se mos zgjohej pa përqafuar të birin dhe që sulur krahëapur ta pushtonte me zjarr, t'ja shtrëngonte kokën në gji, t'ja puthte ata flokët e dendur dhe të shuante mallin dhe dëmbshurinë që po i digjnin krahërorin katërmëbëdhjetë vjet me radhë. Ajo vraponte me të gjitha forcat të arrinte gjer te porta, po oborri sa vinte zgjatej, zgjatej, e ajo nuk arriu... u zgjua.

Teto Mara e kuptoi dhe një herë èndrën që kish parë dhe u mallëngjye e u drodh.

— Në èndër m'u çfaqe, o bir! «Pse s'më thërritët», më tha... — Teto Mara u pikëllua dhe më nga kujtimi i të birit. — Bir, o bir i nënës! — e ngashërimi iu ngjit sili kotkë në fyt, nofullat iu shtrënguan dhe lotët i shkuant kërr tatëpjetë. — Po ku të të thërrisnim, o bir i nënës! Ku të të gjente nëna ty, o moj zëmër...

Fytyra iu ndryshua menjëherë, u zbeh, sytë iu errësuan, lotët i shkisnin tatëpjetë dhe tanis as që e përbante dot veten.

— Unë bëj dasmë, o bir, po ti më tretesh në dhë. «Më harruat», më tha pëllumb' i nënës! E si të harrokam unë zemërzhuritura, unë zemërpërvëluara, o bir...

Pandeliu iu afrua dhe, duke i zënë duart, iu ul pranë.

— Na, moj, mbaje veten! S'bën kështu, — i foli me të rreptë.

Teto Mara nuk e dëgjonte e qante pa e ngritur zërin, me ngashërim.

— Në èndër m'u çfaqe, o bir, e si jetim më erdhe te dera, ti që do të më ishe në krye të vëndit tanis... O mbret i nënës, o mbret!

E shikonte botën nëpërmjet lotëvet dhe njerëzit e gjërat i dukeshin të mjegulluara, pa formë, pa jetë.

Pas pakë u mblohdhën rrëth saj nja katër gra, që mundoheshin ta mbanin e ta ngushëllonin, por ajo s'përbabahej dot se zëmra i qe mbushur dhe qante me

lotë tē nxehtha, e me ndrojtje se mos dëgjonin ata lart e prishej gëzimi i dasmës.

— Sot do tē martoja ty, or bir, po ti më kalbesh në dhe. Qysh duron kjo zëmër-shkreta?

Dhe ata që vinin për ta ngushëlluar, ngashërohesh
shin nga vaji i nënës e nga kujtimi i Paskalit. Shumë
syresh e kishin tē afërm dhe në këto çaste, kur në
shtëpinë e tij kërciste dasma, ndjenin mu në zëmër
një brengë e një boshllék. Dhe ja tani dhimbja e lotët
po u vërshonin.

Si është kjo botë! Atje ku ka gaz, vjen edhe hi-
dhërimi dhe s'e le gazin tē fryhet dhe tē rritet pa ma-
së. Ai me heshtjen e tij i thotë: «Më bëj vënd edhe
mua, o vëlla, se sikur tē mos isha unë as tū g'do kishe
vlerëm!

Gratë dhe vajzat që qenë mbledhur rrëthi Teto
Marës, në qilar, qanin pa zë; fshinin lotët me përp-
rëse ose me kurrizin e dorës dhe mundoheshin t'i jep-
nin zemër:

— Mblidh veten, budallaçkë! Mos bëj kështu, se
s'të ka hie...

Këto poshtë në qilar qanin, kurse lartë këndonin,
kërcenin.

Akciu Pandeli, i zënë ngushtë, se qilari, pa pri-
tur, kish marrë një pamje tjetër, vështronë i hutuar e
s'dinte ç'të bënte. Shau njady herë nëpër dhëmbë gra-
të dhe, pastaj, doli në oborr.

Pas pak erdhi në qilar një grua trupbëshme, me
ca sy tē mëdhenj e tē trishtuar, dhe pyeti, me tē hy-
rë te dera:

— Mos është Teto Mara këtu?

— Këtu është — iu përgjegj një grua tjetër — kë-
tu është, po mos e trazoni tani.

Gruaja me sytë e trishtuar u fut në mes tē grum-
bullit tē grave dhe tha:

— Hajde se po vëmë nusen në valle!

— Prit, se i ka sytë me lotë, — i tha një çupë — nuk
bën tē vijë kështu.

Vetëm atëhere gruaja e ardhur rishtas vuri re, se, jo vetëm Teto Mara, por edhe të tjerat i kishin sytë të shkëlqyer dhe të kuq nga lotët. Disavet u dukeshin nëpër faqet vijat që kishin lënë lotët duke shkarë ta-tëpjetë.

— Pika ju rëntë! Ç'kini, moj, që qani? — tha ajo me një ton t'atillë që tregonte habi edhe qortim. — Ti të thuash shyqyr që ja arrite kësaj dite, të martosh Andrenë...

— E, moj, e! — i tha Teto Mara duke psherëtitur, — po trimin tjetër ku e kam?.. Ma ka lënë zëmrën plagë. Unë e di... — Dhe duke, thënë kështu, shtriu duart përpara me dhimbje, pastaj i mbledhi e i vuri mbi gjoks.

— E po edhe do vriteshin, se skishin shkuar në dasmë. Trimat vritten në luftë.

Ajo fliste kaqë e vendosur dhe kaqë me guxim, sa të bënte ta nderoje pér zëmrën e madhe e të gjërë që i rrithet në krahror. Në ato çaste edhe asaj vetë i dukej sikur nuk kishte, përpara Teto Marën, një grua të thyer në moshë, por një fëmijë të vogël dhjetëvjeçar që ka nevojë pér këshilla e pér kurajë.

— Hajde se po të presin! — i foli duke e zënë pér krahun. E ngriti nga fromi ku qe ulur dhe, si cau sërish rrethin e grave dhe të vajzavet, doli me 'të në obor.

Në krye të shkallëve kishin vënë një llambë, së cilës ja kishin ngritur kaqë tepër fitilin, sa që pjesa e siperme e qelqit qe nxirë me kohë dhe llamba lëshonte një dritë të mekur sa mezi arrinte të ndriçonte shkallët; gjithë oborri kishte mbetur në një mugëtirë dhe vetëm në një copë vënd, aty ku binte ajo pllacka e drितेस që nga dritarja, dukeshin kapakët e gurtë me të cilët qe mbuluar oborri. E në këtë vënd, si fantazma në formë të çuditëshme, dukeshin e zhdukeshin hijet e njerëzvet. Aty te qoshja, jargavani me ato lule të varura si veshule, rrinte si jetim, i heshtur dhe kokëvarur e dukej sikur këtë gëzim tanë natën e kundronte së largu, e sikur edhe atij i qante zemra që të afrohej

në dritare dhe të bënte sehir gjëzimin e harenë që mbretëronte në dhomë.

Shkallët e drunjta kërcitën nënë peshën e dy gravet. Teto Mara, kur vajti në krye, i hodhi një sy llambës së nxirë nga tymi, po nuk i bëri asnjë përshtypje. Me të hyrë në sallon, ndjenë se në to u përplas duhia e ajrit të ngrohtë e të rëndë, që dilte nga dhoma.

Njerëzit akoma vazhdonin të vallzonin, po këtu, si për çudi, zhurma e këmbëve humbte e as që e dëgjonte njeri; këtu shikoheshin lëvizjet, të përdredhurat dhe ojnat e kërcimtarëvet. Ata që rrinin nëpër tryezat nuk e prishnin qejfin dhe pinin vazhdimisht pa u bërë merak të shikonin, se çëngjiste në dhomë. Nusja me vello të bardhë rrinte pranë së kunatës dhe, përti treguar dashuri, i kish hedhur dorën rrëth qafës dhe, herë pas here, shkëmbente me të ndonjë fjalë me zë të ulët.

— Nusja në valle! — bërtiten disa djem.

— Nusja në valle! — thërriten të tjerë dhe, nga gjëzimi e nga padurimi, filluan të përplasnin duart. U ngrit nusja nga vëndi si me turp, u ngrit dhëndëri krenar, u ngritet dhe të afërmit e tjerë të familjes. Njerëzit vështronin kureshtarë nusen që po futej në valle dhe kur ajo, nga tronditja që ndjente, u pengua pas qiliimit, të gjithë ja krisën të qeshurit pa të keq e disa i thërritet:

— Mbaju, nuse, mos na turpéro...!

Ai, që i binte fizarmonikës, deshi të tregonë gjithë zotësinë e mjeshterinë e tij. U ngrit në këmbë dhe filloi të këndonte duke e hapur gojën vesh më vesh.:

«Nusja jonë, ndër valle,
ndër valle.
Hiqe vallen mos e mbyll,
more yll...»

Këndonte me gjithë shpirt, por nga rakia që kish pirë që ngjirur e, sado që përpiquej ta tundëte dhomën,

nuk i delte zë fare, si atyre këndezave gollashë kur bëhen pleq. Nëpër tavolinat, terjaqinjtë e rakisë filluan të pinin përséri. Në një nga këto tavolina ardhi u ul edhe Andrea. Disa filluan ta shtynin të pinte:

— Hajde, dhëndërr, të trashëgohesh e jetë të lumbatur.

— Gjithë nga zëmra!

— Gëzuar, ore.

Dhëndëri nuk kishte qejf të pinte e vajti u ul pranë Dane Bregut që kish ardhur nga një fshat i largët. Atë e kishin vënë në krye të tryezës, si mikun më të çmuar e më të nderuar, dhe jo më kot: vëllai i tij, Petriti, kishte rënë, po në një ditë e po në atë përpjekje ku kish dhënë jetën edhe Paskali i Teto Marës. Kishin luftuar krah për krah, kundër nazistëve dhe kishin vdekur pranë e pranë.

Teto Mara filloi të hiqte vallen e, siç e donte zakoni, nusja e re po ja mbante. Teto Mara i hidhët këmbët pas melodisë, por dukej se mëndjen s'e kish aty dhe fytyra e saj nuk e ndjente lumturinë e këtyre çastevet. Akoma në vesh i tingëllonin fjalët e Paskalit: «Po mua, moj nëno, pse më harruat...?» Dhe i dukej sikur ai vështrimi i tij i ndrojtur e ndiqte prapa dhe e qortonte.

Ai që i binte fizarmonikës, u ngrit përséri më këmbë e filloi të këdonte:

«Nusja jonë ndër valle,
ndër valle,

Po kërcen me nënën e
me nënën e...»

Teto Mara më s'e kishte mëndjen aty. Ajo shikon te Danen, i cili zgjatej nga Andrea dhe, me lot në sy e me lëvizje të sakatuara nga e pira e luste duke e tërhequr prej mënge. Zëri i tij, gati më të qarë, dëgjohej shkoqur në gjithë dhomën:

— Andrea! dale të të puth një herë, se më nxjerr mallin e atij... të atij... merhumit.

'Andrea e shikonte i trishtuar dhe zgjatëtë faqen me turp. Ndjehej edhe i turbulluar nga kujtimi i të vëllajt dhe qe gati të bënte ç't'i thosh Daneja.

— Në buzë dua të të puth — lutej Daneja, — në buzë, si vëllai... vëllanë.

Teto Mara, që po hiqte vallen, ngriu në vënd duke shikuar këtë skenë. Një si valë e ngrohtë i përshkoi gjithë trupin, ndjeu se u turbullua, mjekra iu zgjat, buzët iu drodhën dhe ja krisi të qarit. Filloi të kërcente dhe, me shaminë që pak më parë e tundte me krenari, tanishinte lotët e donte të mbante ngashërimin, po as shamia s'arrinte t'i mblidhte gjithë lotët, dhe ata pikonin në dysheme para këmbëve të saj, duke formuar një rreth.

Disa gra u mallëngjyen dhe filluan të psherëtinë:

— Së shkretës i është djegur zemra...!

— Ç'heq nënë zeza në këtë botë...

— Ah! kjo lufta... — psherëtit një tjetër.

Teto Mara u shkëput nga vallja dhe doli mënjanë. Melodia e shtruar e «Valles së Nuses» nuk u pre se kishin për të kërcyer të afërmit me radhë, e nusja, sipas zakonit, do t'ua mbante të gjithëvet.

Teto Mara shkau, pa u vënë re, midis njerëzvet dhe doli në çardhak. Kishite një merak në zëmër e nuk e hiqte dot. Mos ai kish ardhur vërtet? Sa ta shikonte, sa të çmallej, pa s'donte gjë tjetër...

— Mos vallë është te porta e më pret? Si nuk pashtë një herë unë nënë korba?

Zbriti shkallët dhe shkoi atje me një frymë. Shikoi nga të gjitha anët, por në portë s'kish asnjeri. E dëshpëruar, vuri një dorë në kanatin e portës dhe mbi të mbështeti ballin. Në qill yjet e vjeshtës xixëllonin plot shkëlqim. Në dhomën lart vazhdonin të kërcenin dhe gjer te porta dëgjohej zëri i fizarmoniçisë:

«Nusja jonë ndër valle,
ndër valle,
Po kërcen me hallon e
me hallon e...»

BRAZDA E FUNDIT

Burrë e grua po leronin në arë që në mëngez hëret. Burri, i vrënjtur e i menduar, ngiste qetë; kurse pas tij, gruaja hidhte farë duke u çapitur më zor nga që ishte në muajin e tetë të barrës. Fytyra e saj ish e këputur nga lodhja dhe sytë i kishin vënë një rrëth mavi. Ecte duke marrë frymë shpesh dhe herë pas here hapte gojën e pshëritinte. Fëmijët — të trija çupat — i kishin lënë në shtëpi me të gjyshen. Ata vetë ishin nisur nga shtëpija sa kish filluar të zbardhëllëhej, se ara ishte larg, e Sterjos ia kish qejfi ta fillonte të mbjellët pa rënë dielli. Orndiet me farën ja kishin ngarkuar kalit, qetë i kishin vënë përpëra dhe ishin sosur në arë kur yjet në qiell sapo ishin shuar.

Në mëngjez puna u kish ecur mirë, po tani pasdrekë, Sterjos i dukej sikur s'po nxitonte aqë sa duhej, se qetë ishin lodhur e mezi i hidhnin këmbët. Tek lëronte, u kthyte nga e shoqja dhe e pyeti:

— Si thua, a do ta mbarojmë së mbjelli gjer në darkë?

Irini qëndroi. E mati arën me sy dhe krej iu duk larg, shumë larg. Pjesa e pambjellë iu bë përpëra syve si një fushë e madhe që sa vinte e zgjatej e s' ish e zonja t'ja shikonte ku e kish anën. Kur do të arrinin gjer atje? Ç'thotë ky Sterjua, a është në vete? A mbi-

llet gjithë kjo fushë sot? Prapulizi kapakët e syve, pastaj i shtérngoi fort si të donte të zgjohej nga killapija. Çfarë t'i thoshte? Ngriti supet.

Sterjua, sikur të mos kish nevojë për përgjigjen e saj, vazhdoi:

— Për vit në një ditë e kemi mbjellë, veç sot jemi ca prapa. Dhe Kazili mezi i hedh këmbët, sikur e ka zënë cérrma.

— U mplak, — i tha Irini — ç' do të bëjë dhe kau i shkretë! Sa kish fuqi, s'u kursye.

— U mplak, u mplak, — pshëretiti Sterjo Papuli — po mua më duhet. Po më la në baltë ky, (ai e kish për gjynah të thoshte: «po të më ngordhë») a po më ra në arë, me kë ta zë Murrashin pastaj? Kujt të vete t'i lutem, pa më thuaj? Koperativës? Ja veç atje s' vete dot... E di si mbetem unë pastaj? Si peshku pa ujë. — Oha, Kazil! Oha, Murrash brazdën! — A i hëngri misrishtat? — pyeti pas pakë.

— I hëngri po me zor... Mezi i mbillaçiste, i bëri gjithë jargë.

— I kanë rënë dy dhëmbë, të gjorit. T'i kishim sjetllë ca tagji, do të kishim bërë mirë, po ç' e do që s' na u kujtua. Moj, po sa të mbaroj të mbjellat kam hall unë, pa në vjeshtë, do ta nxjerr në pazaropull dhe do ta shes pa derman.

Sterjua i mbajti qetë e shikoi sllogjet që kish lëruar. Ara tani kish marrë dy ngjyra: pjesa që ish mbjetllë herët e që ja kish marrë faqen dielli, dukej ngjyrë kafe e çelur dhe si e zbërdhylur, kurse brazdat, që sapo ishin lëruar, qenë të errëta e të zeza.

Dielli digjte. Mbi arë fluturonin tufa arabelash. Lauresha e gëzuar nga drita e nga qelli i kaltërt, ciceronte pa pushim e plot gjallëri, lart, shumë lart. Një sépatë binte diku në pyll. Një zë i hollë fëmije, në shpatin përkundrejt, ndillte me ngulm një qën: — «Na, balo, na, naa...! — dhe zëri i tij përhapej anembanë e dukej si një këngë e trishtuar me nota të zgjatura e mono-

tone. E veç këtyre, ndiheshin, herë pas here, pëllitje lopësh, blegërima bagëtish dhe zëra njerzish. Më shkouqur nga të gjitha Sterjua dëgjonte grahjet që u bën kafshëvet dembele, pendarët e koperativës bujqësore. Ata lëronin aty afër, nja katër a pesë ara më tutje dhe, po të mbaje vesh, mund të dëgjoje edhe fjalët që këmbenin. Sterjua nuk e kuptonte dot në bënин më shumë fjalë se punë, nga që midis tyre ishte një kodrinë dhe ai s'kish nge të ngjitej majë saj e t'i shikonte në e punonin tokën me merak apo e bënин sa për t'i shkuar radhën. Ç'është e vërteta, ata erdhën në arë më vonë se Sterjua, atëhere kur kish rënë dielli, dhe ai i qesëndisi duke thënë me vehte: «Pse të nxitohen? Punë fshaçe. U bë, — mirë; s'u bë — pun 'e madhe...»

U grahu qevet dhe i shpoi me dobecin e hostenit. Qetë tendosën qafën përpara, zgjedha kërciti, parëmënda gërviu e plori luajti nga vendi. Sterjua rëndoi me këmbë mbi pllazin e parmandës dhe plori i ndritshëm e i ftotë u fut në tokë. Si urith, hunda e tij shpaloste dhenë duke e hedhur në të dy krahët.

Sterjua kish kujdes për lehët t'i hapte të gjera e të drejta që, »kur të vadiste arën, të mos ja grryenin uiërat.

— Oha, Kazil! Oha Murrash! Brazdën! Oha! Ja, ja, ja.... oshëtinte zëri i tij i fortë e kumbonjës.

Herë pas here kthente kokën e shikonte Irinin se si hidhët farë.

Nga dor'e saj e stërvitur kokrat e misrit binin vazhdë e pandëprerë si nga koshi i mullirit.

Ai e shikonte e gëzohej e përsëri nagaste qetë. Të lëruarit e kishte në qejf e i dukej se kjo punë nuk e lodhte. Ja, me dorën e djathtë, shtrëngonte dorezën e parmandës dhe ajo i dukej e lehtë, pëndë; kurse me të mëngjérën... ah! me të mëngjë-rën s'bënte dot ndonjë punë të madhe. Atë dorë Sterjua e kish të tharë, ajo i kish mbetur e vogël dhe e butë si një dorë fëmije. Gishtrinjtë i kishte, po ç'e do, ata qenë pa jetë, të pafuqishëm se ishin pa kocka e prandaj vareshin si një copë mish. Dhe lëkura që i mbulonte

këta gishtrinj kishte pamje e ngjyrë tjetër, ajo kish mbetur ngjyrë vishnje, si lëkura e foshnjavet të porsalindura dhe qe e hollë si fletë cingari, gati pér t'u skërfitur në prekjen më të vogël. Kjo forcë s'ish pér punë. Gishterinjtë të mbetur të vegjël e të hollë, rrinim me majë të puqura, e gjithmonë të kthyer pérbrënda e kësh-tu dora as hapej, as mbyllej. Kjo dorë dukej edhe më e vogël, e më e mjerë akoma kur vihej krah së djathës e, sikur t'i vinte turp nga krahasimi që mund t'iu bënje pa dashur, rrinte e ndrojtur dhe e mënjanuar; të shumtén e herës në xhep, ose e futur në një dorashkë të vjetër bojë hiri.

Nga kyç i dorës e lart, Sterjua krahun e kish në rregull. Ai këtë pjesë s'e linte pa punë: shtërgonte brylin dhe parakrahun pér gjoksi, fuste hostenin mishtës tyre dhe i ngiste qetë pér bukuri, sa ata nuk e kishin kuptuar kurrrë në i shponte një dorë sakate, aqë me térsëllëm u mëshonte Sterjua kur merrte inat.

Sa herë pat menduar sikur ta kish edhe këtë dorë të fortë e të shëndoshë e, nga që e kish merak, shpesh e shikonte në èndërr sikur s'kishte asnje cen dhe e përhëj, veç kur zgjohet e ndjente veten më të drobitur e më të dërmuar.

Vetëm një herë Sterjos iu duk se kjo dorë do t'i hynte në punë, e se Perëndia nuk ja kish dhënë kot ma-hananë. Ish ato kohë kur në fshatin e tyre bisedohej pér koperativën. Atëherë Sterjon e lanë mënjanë dhe s'i ranë shumë në qafë. «E ç'të më trazojnë mua? — mendoi Sterjua — Sakat njeri, unë. E shikojnë edhe ata vetë....»

Mirëpo këto punën e dorës që e kish përdorur si yckël pér të mos u futur në koperativë, kur u bë mbledhja e përgjithëshme e fshatit pér çudi, ai s'e përmendi fare. Ish menduar mir' e mirë dhe i kish thënë vetë:

«Sot, s'të pi ujë kjo pun' e dorës, o Sterjo. A s'i ke bërë gjer tashti të gjitha punët e tua, ti vetë? Léron,

korr, ngarkon kalin, bën dru, kthen vrahun; përse të ka penguar ty kjo dorë, pa na thuaj? Për asgjë. A s'i ke bërë ti të gjitha punët e bujqësisë si fshatarët e tjerë e ca më mirë se ata? Lëre, mos e përmënd fare këtë punët e dorës, se do të bëhesh pér turp e do të qeshin bota. Do më thonë: — Gjer tashti që ishe vetëm, ishe i zoti t'i bëje ballë punës, tani që je me shokë, tani s'qënke i zoti...»

Ndaj, atje në mbledhje, u ngrit e tha fjalë të tjera:

— S'e kundërshtoj koperativën, po jam i vetëm, o vëllezër, s'kam krahë pune. Pesë gojë presin nga unë dhe që të pesta femra. Kush do të më punojet mua? Gruaja me fëmijën në gji, çupat që s'kanë nisur të venë akoma në shkollë, apo plaka që është në mykët? Fshati ma di hallin: unë nuk se kursehem, po s'ja dal dot...

Dhe ata nuk iu vunë shumë; e lanë të bënte si të donte, me shpresë se një ditë do të bindej e do kërkon te të hynte vetë. Dhe tani, katër vjet pas formimit të koperativës bujqësore, në fshatin Peras, vetëm tre familje kishin mbetur përjashta: një plakë e mbetur qyqe dhe e kaluar nga mosha, Kic Kozeli që s'çante kokë pér bujqësi, se i dërgonin djenatë para nga qyteti dhe Sterjo Papuli, ose, siç i thoshin në fshat, Sterjo «Doraci».

Sterjua ndjeu një gjëzim kaqë të madh kur arat s'ja «muarën» e kur qetë i mbeten në patoz, sa iu duk sikur ja falën sërisht. Dhe në vënd t'i shuhet dashuria pér arat e veta, — tek i shikonte gjith të bashkuara, — iu shtua ca më shumë. Nëqoftëse gjer tashti e donte tokën e mallin pa e ndjerë e në mënyrë fare të zakonshme, tani kish filluar t'i dashuronte me pasion të madh, e ky pasion, si një darë e fuqishme, e kish përbledhur në dorën e tij, e shtrëngonte dhe s'e linte të merrte frymë. Ishte bërë skillav me dëshirën e tij dhe e ndjente veten që s'e kish në dorë. Pasioni i tij i përqjiste një lumi të rrëmbyer dhe ai as që mundohej t'i bënte ballë; e kishte lënë varkën në tekat e rrymës, dhe ajo luante më 'të e mund ta përplaste ku të donte.

Qetë i pëllismin në haur dhe ai, tek i dëgjonte, i bë-hej se e thërrisin me emër dhe u përgjigjej me dashuri kudo që të ishte. Ngrihej natën dhe u shtinte përtë ngrënë, vinte u mblidhët bar të njomë dhe tani s'e kish përturp të merrte fshesën e ta pastronte vetë hau-rin, gjë që më përpara s'e kish bërë kurrë.

Pa e ndjerë fare, kish filluar të punonte si djalli, dit' e natë, të bëhej qën' i punës, të mos linte gjë t'i shkonte kot, e të mblidhët sa më shumë që të rronte mirë, S'donte t'i thoshin bota: «Shikoji ata të kopera-tivës, rrojnë më mirë nga ti. Të rruat puna ty, që je zot nё mallin tënd...» S'donte të vinte ajo ditë që t'ja tro-kisnin këto fjalë, ndaj përpinqej me mish e me shpirt që të mos mbetej ngushtë e sido që të vinte puna, t'ish inë gjëndje t'i thoshte vetes: «Edhe unë e bëj rrojtjen si ata, e ndofta ca më të mirë se ata...»

Ai nuk e kuptonte, po pikërisht nga kjo gjë i buronte një energji e pashtetur dhe një ashk përtunë, të cilin s'e kish pasur kurrë. S'ndjente lodhje. Tani, kish ca kohë, thua jse nuk vinte re asgjë përvëç punës e, ajo ashtu si thith ujet sfyngjeri, ashtu ja thëthiste të gjitha mendimet e të gjitha forcat.

Ja, qëpari ishin shtruar të hanin drekë, nën hijen e asaj mollës së egër që gjindet përfund arës. Irini nuk hëngri, ajo mezi kapërxeu dy kafshata, kurse ky as që e pa. Përtpej e syt' e mëndjen i kishte gjetkë; shikontë arën dhe i kish hyrë meraku se ç'e vallë do ta mbaronin gjer në mbrëmje. «Jemi ca prapa, mendonte, të kishim arritur gjer te lajthishtat, tani nё drekë, do të ishte mirë. Pasdreke do t'i nxitoj qetë një çikë më shumë...»

Ai vetë hëngri shpejt e shpejt, si ujk i uritur, du-ke menduar të ngruhej e të fillonte sérish nga puna, se Dielli po merrte të tatëpjetën. Vetëm një herë, më të mbaruar, hodhi sytë nga e shoqja; ajo kish vënë duart mbi atë barkun e madh e po mendohej. Sytë i ishin këputur nga lodhja dhe i jepnin një pamje të mjerë, përdëllenjëse e fajtore.

E pyeti me një ton të thatë:

— E, moj, mbarove së ngrëni ti?

— Mbarova...

— E shyqyr, të ngrihemë të lërojmë...

Sterjua fshiu me kurrizin e dorës buzët, pastaj u zgjat, mori pagurin e ujit dhe, si ja hoqi vulomën prej flettrash, hodhi kokën prapa e filloj të pinte.

Uji binte erë fletë lajthie dhe kishte marrë një shijë të shpëlarë, shijën e aluminit të ngrohur në diell. Sterjua piu vetëm një gurmaz, pastaj tjetrin e pështyu duke përqmuar fytyrën.

— Valë qënka! S'u pika! Ti s'e kishe mbuluar?

— E mbulova me bar, po si duket e ka zbuluar kali.

Sterjua ja ktheu grykën pagurit poshtë e uji u derdh në ledhin e arës, duke kënduar gllënq-gllënq-gllënq.

— Mos e derdh! — I bërtiti Irini duke i mbajtur dorën.

— Ç'e do? Nga këta do të pish ti? — e pyeti me habi.

— Kur s'kam tjetër, ç'të bëj?

— Nuk pihet. Eshtë bërë nga dielli si për të larë kokën.

Iirini ja mori pagurin dhe piu me etje, me gjithëse nga shija neveritëse e ujit i erdhi të përzjerë.

Aty mënjanë Sterjua bëri kryq, u shtriq e pastaj u ngrit.

— Ngreu, ngreu se na zuri darka! — i foli së shoqes rreptë.

Irini donte të rrinte edhe një çikë, t'i çlodheshin kryqet, t'i çlodheshin krahët. Sa mirë ishte aty nën hije të mollës; vëndi i dukej i butë sikur t'ish mbi pupla dhe sytë i koteshin për gjumë. Kapiti sytë e koka iu fal përgjumësh mbi gjoks, po ja, përsëri u dëgjua zëri i pamëshirshëm e tingëllonjës i Sterjos:

— Ngreu, ngreu ta mbarojmë se iku dita.

Ajo vuri një pëllëmbë në ledhin e arës, dorën tjetër e vuri në ije dhe duke i dhënë forcë trupit, u ngrit. Një e therur i shkoi tejpërtej dhe fytyra iu shtrëmbë-

rua nga dhëmbja. Kafshoi buzën e poshtëme dhe lëshoi një rënkim.

Filluan të lëronin. Sterjua kish ikur përpara me pëndën e qevet. Merak në zëmër e kishte gjersa ta mbronte së mbjelli këtë «Arën e Lajthive», siç e quanin ata në shtëpi. Ara e kishte marrë këtë emër, nga që në ledhin e lindjes, kishte një korie prej lajthishtash. Sterjua e donte këtë korie dhe i bënte shërbim, sepse e kishte si një gardh që i mbronte arën nga bagëtia e huaj. Në vjeshtë, pastaj, dërgonte çupat t'i vilnin lajthitet që s'ishin pjekur akoma, nga frika se mos i hynin fëmijët e tjerë e i bënin dëm. Vërtet se ara ish pak larg nga fshati, po kish një të mirë të madhe: e kishte ujin te koka e mund ta vadisje sa herë të ta kishte qejfi, ndaj edhe misrin e bënte me tre kallépë e kokrrën sa një dhëmpallë. S'thoshte më kot Sterjua; «Po të mbjell Arën e Lajthisë, e kam të sigruar bukën e fëmijëvet. Ajo arë ma mbush hambarin mua, se ato karkurinat e tjerë, ku mbarsen ljetpurat, as mistrishta s'më bëjnë e jo misër...»

Sterjua lëronte e kthente kokën prapa. Nuk e kuptonte: e kishte Irini prehërin plot me farë, apo ashtu i dukej atij nga barra? Bërtiti:

— Hë, moj, luaji duart!

Gruaja s'foli.

Ai ktheu kokën dhe e pa.

Gruaja ecte ngadalë. Dora e saj tani lëviste e lодхур e me përtim.

Sterjua priste të nxitonte, kurse ajo u ul në tokë dhe u mundua të hiqte dherin që i ish futur në opingat e lopërtë. Futi gishtin nën oputën e zbutur dhe nxori ca kokla dheri, pastaj u ngrit. Bëri disa hapa e sérish opingat iu dukën të rënda plumb; atëherë zgjidhi gjilmitrit, i zbathi fare e i hodhi në ledh të arës; hoqi edhe çorapet e grisura dhe pastaj e ndjeu veten të lehtësuar e të çliruar. Trina e këmbës preku tokën e lagur e të butë dhe sikur e freskoi. Në arën e shkrifët e të njomë,

tani mbeteshin gjurmët e gishtirinjet dhe forma e tabantit të këmbëvet.

Afër tyre u ndjenë zëra burrash. Brigada e koperativës, si duket, kish mbaruar së lëruari dhe i kish çmbrëhur qetë, megjithëse Dielli akoma s'kish perënduar.

Pas pak ata u dukën krye kodrinës. Sterjua tani, pa dashur, dëgjoi edhe muhabetin e tyre:

— Shumë ka lëruar «Doraci»...

— Për ashtu a? Është qëni i punës ai.

— S'besoj ta mbarojë gjer në darkë...

— A t'i themi: «Mjaft, o Sterjo, lëshoi qetë tani, se ua more shpirtin!»

— Lëre, c'i flet? Nuk e shikon si është krrusur më dysh? As sheh, as dëgjon, vetëm punon.

— Jo, do t'i flas.

— Foli po deshe, kush të ndalon...

— Gëzuash, o Sterjo! Hajde tani, mjaft lërove, lër edhe ca punë për nesër... — i thirri Miti i Savës.

Sterjua bëri sikur s'dëgjoi: «E lënë punën këta, mendoi, se mos u dhimbset a? Jo, jo. Edhe tani kush e di, e kanë lënë arën përgjysmë dhe kusurin e bëjnë nesër a pasnesër... Hyrrja-pyrrja...!»

Irini iu afrua dhe i tha ngadalë:

— Sterjo, të uroi Miti.

Ai vrenjti vetullat.

— Ehe! Oha! Kazil! Oha, Murrash! Ja, ja, ja,...

Njëri syresh tha:

— E pe? S'të foli...

— S'dëgjoi, më duket, — u çfajësua Miti.

— Do të flasë kur t'i rriten fëmija... — qesëndisi një tjetër.

«Kur t'i rriten fëmija...» Sa i dogjën Sterjos këto fjalë! E shpuan atje ku i dhimbte, e therën si një majë thike që përdridhet në plagë. Ai thoshte shpesh këtu e dy vjet përpara: «Do të futem në koperativë, kur të më rriten fëmija...» dhe ja tani si po e tallte ai tjetri. Po kush ishin këta, xhanëm? Sterjua ngri-ti kokën e i pa: njëri qe Miti Sava, fqinj i tij; ai flo-

Guri i Gjikollarëvet
kë kuqi qe Guri i Gjikollarëvet; pas tij vinte Pirrua që ishte sekretar i rinisë, dhe ata dy të tjerët qenë nga mëhalla e përtjejme. Sterjua i njihte si fytyrë po emërin s'ua dinte.

Kishin vënë kafshët përpëra dhe po ecnin ngadalë. Pa pritur një ka doli nga monopati e u fut në arën e Sterjos. Ai e pa me bishtin e syrit dhe, duke rënduar mbi pllaz, e mbajti parmëndën. U këthyen nga ata e bërtiti me inat:

— Mbani kaun, se do t'ja thyej këmbët. I lëshoni azat. S'u dhimset ju, as malli juaj, as malli i tjetrit...

— S'e di kau që është ara e individit, pa nuk shkelte atje... — bëri shaka me zë të ulët, sekretari i rinisë.

— E de, se nuk të hëngri bimët, po mos bëj kiamet! — i tha si gjysmë i zëmëruar Miti.

— Më hëngri, s'më hëngri, është ara ime kjo.

U fut Guri i Gjikollarëvet i preu rrugën kaut dhe u mbyll ky sherr, që nisi aqë papritur.

— S'kanë turp, pale, dhe qeshin? Pfy, c'njerez, ore...!

Tani pas ikjes së tyre lugina u qetësua fare. Mbeti vetëm Sterjua me të shoqen e me pëndën e qevet.

Nga kjo heshtje që pllakosi përnjëherësh, lugina e pa veten të braktisur dhe ndjeu frikën e natës që po vinte.

Sterjua drodhi një cigare me të vetmen dorë të shërndoshë, e njomi fletën pas buzëvet dhe pastaj e ndezi. Sa të vinte Irini të mbushte prehërin me farë misri, ai do të pinte cigaren e do të pastronte plazin e veshët e parmëndës që ishin mbushur me dhë. E nxori parmëndën nga toka. Plori shkëlqeu si teh shpate në rrezet e diellit që po perëndonte.

Sterjo Doraci i hoqi sytë nga plori dhe pa lehët që kishte bërë. Atje dalloheshin mbresat që kishin lënë këmbët e njerëzvet dhe thundrat e qevet. Sterjos i kish mbetur zakon t'i sodiste gjurmët që mbeteshin pas lërimit dhe kjo gjë e argëtonte dhe e çlodhë. Ja ku

Gjurmët e Murrashit

dukeshin gjurmët e Murrashit, të rrumbullakta si kuptë e me një vijë në mes, ja edhe gjurmët e Kazilit me atë gjysmëhënëzën në këmbën e mëngjér të anës së prasme. Ja edhe gjurmët e opingave të Sterjos, të bëra me koperton makine; ato linin në tokë ca kryqe të vegjël e të bukur, si këmbët e zogjvet në dëborë. Përzjerë me këto, në vënd të shikonte gjurmat e opingave të Irinit, pa në arë vragën që la këmba e zbatthur. Irini e kish mbushur prehërin me misër e tani po kthehej; ajo vërtet ishte zbatthur. Sterjua e pyeti:

— Pse i hoqe opingat?

— Mu rënduan nga dheu e s'i mbaja dot.

— Ato të flamosura opinga e kanë atë të keqë: mbushen me dhë e rëndohen. Ty të duhen një palë llastikë, po ja që jemi një çikë ngushtë tani...

Lëruan akoma.

Tani u kishin mbetur vetëm dy lehë. Eh, shqyr, ja po e mbaronte. Pse ishte trëmbur në drekëherë? Kot. Dielli akoma s'kishte hyrë e atij q'i kishin mbetur? Vetëm dy brazda.

Djersa e kripur dhe e përzjerë me dhë e pluhur i shkiste ballit dhe i kishte bërë vraga nëpër fytyrë, si shtigjet që bëjnë ujërat në vjeshtë. Këtë shijën e kripur të djersës, të përzierë me pluhurin e tokës, e ndjeu në gojë. Pështyu. E kish provuar Sterjua edhe tjetër herë këtë shijë dhe e dinte, si çdo bujk në botë, se djersë e bukë janë të pandara.

Tani që po i afrohej fundit, s'i bënte përshtypje as shija e hidhur në grykë, e as fytyra e lërosur. Në darkë, kur të vinte në shtëpi e të dridhëtë një cigar pranë qoshes së zjarrit, në fytyrën e tij do të shihej prehja dhe krenaria për punën që kish kryer, ndërsa lodhja do t'i dukej si diçka e kaluar.

Në këto çaste dëgjoi zérin e Irinit, të lodhur, të përmbajtur, sikur të druhej për atë që do të çfaqte.

— U lodha, Sterjo...

Zëri iu duk i largët, i thellë e si nëpër gjumë. Ktheu kokën. Irini kish mbetur prapa, afër atyre laj-

thishtavet që qenë nga ana e lindjes. I erdhi e shara në majë të gjuhës e deshi të shfryntë duke malkuar «Plasja të preftë, për kaqë gjë s'duron dot!» po pastaj ktheu mëndje dhe instinktivisht e ndjeu se ish e udhës ta merrte me të mirë, ndaj i foli me një zë të butë, të cilin e shoqja s'e kish dëgjuar shumë herë në jetën bashkëshortore.

— Hë moj, duro dhe pakë... Ja, mbaruam. Shiko edhe dy brazda na kanë mbetur.

Gruaja zvarriti këmbët me zor. Eci dy tre hapa e përsëri qëndroi.

— U lodha, Sterjo, m'u prenë këmbët...

Zëri i saj këtë radhë sikur lutej e ankohej.

Sterjua tani kish dalë përfund lehës dhe po kthen te qetë.

— Hë moj, po duro një çikë... Për kaqë gjë ta lëmë? Është turp nga bota... Do thonë, ja, shiko e la përgjysmë, se s'qe i zoti ta mbaronte.

Ajo heshti. E shikoi në sy, siç shikon qëni të zonë, me dashuri e me frikë dhe si për të thënë diçka, ngriti vetullat përpjetë. Vetëm syt' e saj të kish parë Sterjua, të lotuar, të këputur, të përulur, të cilët shprehnin kaqë dhimbje e lutje, e s'do të kish guxuar të hidhte asnjë hap më tutje; do t'ja plotësonte menjëherë atë dëshirë aqë të vogël e të drejtë, mirëpo ai as që e shikoi në sy, dhe vazhdoi të lëronte.

— Ja, mbaruam tani... Sa të thuash pesë, i dalim mbanë....

Ajo s'foli.

Bënë edhe dy lehë të tjera. Sterjua shikoi nga perëndimi.

Andej malet qenë veshur me një hie kaltëroshe e të mjegulluar. Dielli po perëndonte. «Zor të mbaroj me diell, mendoi Sterjua, po do lëroj një çikë në muzg. Sonte ka edhe hënë...».

Dielli e pështeti faqen në mal. Tani në maj, perëndon mun mbqi shkëmbin e Malit të Bardhë. Një copë

diell mbeti për një çast mbi shkrep, si një sy i ndrit-shëm, dhe u duk sikur kishte merak të shikonte Sterjon në i shmbrehu qetë nga zgjedha apo vazhdonte të lëronte akoma. Hyn dielli, njeriu e kafsha lënë punën; zakon i vjetër ky, i mbetur që nga pleqtë, veç Sterjua sonte s'pyeti për këtë zakon.

I kishte hipur ajo babëzi, që thellë në zëmër e ka çdo bujk dhe donte ta mbaronte me domosdo. I dukej sikur i ish futur një lumi e kur i kish dalë mbanë e po matëj të hidhte këmbën në tokë të thatë, dëgjon një zë që e thërrret të kthehet prapa.

— Sterjo, aman, u lodha, m'u pre takati... Më vjen ara rrötull.

Zëri i saj i ngashëryer të këpuste shpirtin. Kish qëndruar në mes të brazdës, duke shtërnguar me një dorë prehërin që kish përfundi dy gjajtana të kuq dhe dorën tjetër e kish vënë në zëmër. Nga barra, fustani i qe ngritur përpara aqë lart sa i dukeshin kupat e gjunjëvet, kurse prapa i varej si bisht. Sterjua vriste mëndjen më kot ta gjente pse qe shkurtuar fustani në këtë mënyrë; ai shikonte vetëm këmbët e saj, të futura në dheun e bryllët dhe mendonte akoma për llastikat që duhesh t'i blinte.

— E, moj Irini, durove gjer tashti, për kaqë gjë ta lëmë? Kush vjen dhe një herë gjer këtu, me orndie, me farë e me qe... Apo mos është afër kjo e bekuar...?

«S'do ta mbarojmë dot, — mendoi Sterjua me pikëllim, duke shikuar vëndin e palëruar. Duhet ta mbaj me fjalë që të mos i vejë mëndja te lodhja, përdryshe...

— Dëgjon, moj Rini! Hajde, pa kur të vijë vjeshta, q'do të të bëj unë ty! Ehu! Ehu! Do të shesim ca nga ky misër e do t'u blejmë fëmijëve nga një palë rrobe të reja. Ty do të të blej një basmë me lule të kuqe dhe një palë llastika. Pa kur të vij unë nga pazari, do të të gjej ty me djalin në gji. «E moj, do të them unë, mos na e përkëdhel kaqë...»

Pas tij gruaja qau me hidhërim e psherëtitit:

— Uf, aman Sterjo... ç'thua... — dhe ra në lehë të arës si një fije bari e prerë nga kosa. Sterjua s'ndjeu gjë e iku përpara. Vazhdonte të fliste:

— ...se nuk e ke ndonjë bir pashai. Pastaj këtë vjeshtë do të të dërgoj të mjerzit e tu. Rri të mbledhësh veten, se u coptove dhe ti e shkreta, një javë, dy javë, sa të kesh qejf, unë s'do të të kërkoj. Do të bëj si të bëj me nënën. Ti do çmallesh me babanë e me Nukon. Veç një gjë do të kërkoj unë nga vjehra: kur të vish, të më sjellësh ca arra, nga ajo, që kini më oborr e që e kanë lëvezhgën të hollë sa çahen me dorë. Hë, moj, do më sjellësh apo jo? Pse s'përgjigjesh?

Ktheu kokën. Irinin s'e pa gjëkundi. I dolli zëmra pér keq e thërriti me sa mundi,

— I-ri-niii!

Askush s'iuh përgjegj, veç luginës që e përsëriti këtë emër me një jehonë të trashë e të mbytur, si të donte ta përqeshte.

E la parmëndën, lëshoi hostepin dhe u kthye me vrap në brazdën që posa e kish lëruar. Atë dorën e mën-gjër e mbante si zakonisht kur vraponte, të shternguar pas ijës e vetëm dorën e djathhtë e luante prapa e përpara, sipas hapave që hidhte. Irinin e gjeti përbys pra-në brazdës. Kishte rënë në tokë me dorën nën kokë dhe dridhej e tëra. Prehëri me misëri qe derdhur e ata dy gjatnët e kuq mezi dalloheshin. Aty pranë kishte rënë edhe torba e vogël me fasule e fara kungulli. Fytura e saj Sterjos iu duk e bardhë çarçaf dhe ngriu në vënd, pastaj vvetvetiu ra në gjunjë dhe i vuri dorën në ballë. Balli i digjej zjarr e Sterjua ndjeu dorën që iu lag si me vesë.

— Na, moj Irini, ç'bën kështu? Irini!

Ajo hapi sytë përgjumësh, ca sy të mëdhenj, të lo-tuar e të pafajshëm dhe me një zë të këputur i foli:

— S'jam mirë, Sterjo. Vdiqa... aman, shpëtomë...

Ai çakariti sytë dhe iu afrua akoma më shumë. Mbështeti ballin e tij përmbi ballin e saj, pastaj e hoqi përnjéherësh, se iu duk sikur u zhurit. Me ata syt e ve-

gjël e të trëmbur, veç fytyrës së saj, nuk shikonte as-gjë tjetër. I rrinte vetëm një pëllëmbë larg dhe zëmërdredhur ndiqte çdo lëvizje që bënин muskujt në fytyrën e së shoqes. Ish diçka e llahtarëshme ta shikoje atë fytyrë aqë afër; atje vuatjet e dhimbjet dukej se këtë fytyrë po e shikonte për herë të parë; kjo s'ish e shoqja e tij dhe nuk e kuptonte pse të ndodhej aty pranë, kush e kish sjellë.

Përsëri ajo hapi sytë:

— Më vijnë të dridhura, Sterjo, aman, hiqmë nga ara...

Ai s'kuptoi asgjë.

— Hë?

Irini tundi këkën dhe heshti. Vetëm tanë truri i mpirë i Sterjos e kuptoi se ç'tha ajo. Pernjëherësh e rrëmbeu si shqiponjë. I futi dorën e djathtë nën shpatulla dhe e ngriti, kurse me atë dorën sakate mezi arriti t'i pushtonte këmbët, duke i shtërtnguar me sa mundej për trupi.

Ekte me të shoqen ndër duar. Këmbët i fundoseshin në dheun e shkrifët. Trupi i saj i rrënqethetëj ndër krahë dhe të rënqethurat e pëershkonin edhe këtë sikur t'ishin korent. Ekte e dridhej edhe ky bashkë me 'të.

Dora sakate s'kish më fuqi t'i mbante këmbët e Irinët dhe Sterjua ndjeu se po i shkiste. Qëndroi në vënd dhe e shtrëngoi me sa mundej, po ja, këmbët sa vinin e shkisnin, sikur të ishin lyer me vaj... atëhere Sterjua u kërrus më dysh, i shtërtngoi këmbët e së shoqes midis gjoksit dhe kofshës së mëngjér dhe, duke çaluar, me mundim, e shpuri gjer në ledh.

Pylli i lajthishtavet ndërroi ngjyrë, u bë i errët e hijedëndur. Ca re të bardha duallën nga jugu. Malet sikur hodhën një tyl manushaqi e muzgu po binte ngadalë duke e mbuluar çdo gjë me napën e tij të mistershme. S'ndihej tanë në luginë asgjë, as cicërimat e shpesërisë, as sëpata në pyll, as zëri i atij fëmijës që ndillte qënin dhe as të qeshurat e koperativistëvet. Lugina qe e hesh-tur, e qetë memece dhe e frikëshme. Sterjua u trëmb nga kjo braktisje dhe ndjeu frikën e vetmisë.

Lartë qe qielli i madh, i kaltërt, i pafund e i hesh-tur e poshtë toka e ftohtë dhe e lagur. Dhe iu duk sikur midis qiellit e tokës, në atë hapësirë boshe e të frikësh-me kish mbetur vetëm ai me të shoqen, e s'kish më as njerëz të gjallë, as kafshë, as dashuri e as ngushëllim.

Kjo e bëri të dridhej, përpara kësaj hapësire e ndjeu vehten të vockël, të pafuqishëm e mënd klithi nga frika.

Dëgjoi një zë:

— Sterjo, Sterjo!

Nga i erdhi ky zë? Kush thërriti dhe pse?

Ktheu kokën dhe afër tij pa të shtrirë më kurriz në tokën e butë, të shoqen, vetëm atëhere sikur u përmënd dhe mblođhi veten. U ul pranë saj dhe po mundohej t'i thoshte diçka të bukur, diçka që ta bënte të shoqen të harronte hallin që kishte, mirëpo asnjë fjalë s'i vinte ndër mënd. E ndjente se ai duhej ta ngushëlionte, duhej t'i jepte zëmër, po fjalët s'i gjente dot. I rrinte atje pranë dhe i pëshpëriste vazhdimesht, të njëjtën frazë, sikur të ishte i pirë;

— Hë moj, mos u bëj merak, se nga të lodhurit e ke. Punove shumë s'ke faj. Po të çlodhesh, do ta mbledhësh veten.

F kuptonte dhe vetë se nuk ishin pikërisht këto fjalë që donte t'i thoshte, mirëpo në kokë s'i kish mbetur frazë tjetër dhe ai përsërisht duke ndryshuar vetëm radhiten këto fjalë, të cilat i dukeshin të kota e pa asnjë kuptim.

— Ja, hiç. Nga të lodhurit e ke...

— Jo, Sterjo, jo... Uff! M'u tha gjuha për një pikë ujë...

— Ujë?

Iu kujtua paguri me ata ujët e ngrohtë që binte erë fletë lajthie e alumin dhe u vërsul menjëherë përfund arës, ku kishte ngrënë drekë. Pagurin e gjeti përbys pranë thesit të farës. U ul dhe e mori. Paguri qe fare i lehtë. Mëgjithatë atij s'i erdhi mirë të bindej për këtë gjë dhe, pa qënë në vete, e shkundi pranë veshit: paguri qe bosh; asnjë pikë ujë s'i kish mbetur. Çfarë të bënte?

Tani i erdhi keq pér ujët që kishte derdhur më kot e mbeti atje duke rrrotulluar pagurin nëpër duar. S'i bën-te zëmra të kthehej pranë saj. Ajo me buzë të tharë e gojëetuar do priste të pinte ujë... kurse ky do t'i shkundëtë pérpara syvet pagurin bosh...

Një hingëllimë e scelli në vete. Sterjua ktheu koken i trëmbur dhe pa kalin e tij, që dolli nga pérroi si duke kërcyer nga që i kishin vënë pengëza. Sigurisht kali kishte vajtur të pinte ujë në përrua. Vetëm tani u kujtua Sterjua pér ujët që rridhët aty pranë. Pse qe mbërthyer aty, pse qe hutuar kaqë shumë? U sul me vrap. Pérroi tani që vadisnin luadhet, kishte fare pakë ujë. Sterjua u mundua më kot të gjente një vënd të thellë pér të mbushur pagurin; atëhere i ra ndër mënd një gjë tjetër; filloi ta merrte ujët me duar e pastaj ta derdh-te në grykë të pagurit.

Kur iu afrua Irinit, ajo po rënkonte. Të dy krahët i kish shtrirë anash, sikur ta kishin kryqëzuar dhe pér-pélitej. E tok me të përpéliteshin edhe dy lajthishtat, në të cilat ajo kish mbërthyer duart e shtrëngohet fort. Koken e luante pa gjetur qetësi herë më të djathtë e herë më të mëngjërt. Sterjua dëgjonte të kërcitura dhëmbësh dhe me çudi shikonte se nga sytë e së shoqes lotët rridhnin rrëke. Iu afrua akoma më shumë. Irini me kurorën e dhëmbëve të sipërme kafshoi buzën e poshtme, sa buza iu zbardh, pastaj i kërceu një cërkë gjaku e forma e dhëmbëvet mbeti pér një copë herë në mishrat e kaltëruara të buzës. Fytyrën e kishte të zbehtë e të djer-situr. Djersët i vinin palë-palë, ndërsa ajo regëtinte me dhimbje. Dhe përsëri djersë, djersë, kurrë s'kishte parë Sterjua aqë shumë djersë.

— Sterjo... s'jam mirë... Shko thërrit nënën...

Sterjua s'kuptoi asgjë. Ngriu në vënd e iu pre fuqia. Paguri i shkau nga dora e i ra në tokë. C'po thosh ashtu Irini? Vërtet kaqë e pati? Vallë kaqë shpejt vdesin njerëzit! Pas pakë ajo do të shtrihej aty e qetë, e heshtur; as nuk do të rrënqetë më, as nuk do të ankohej. Zëmra s'do t'i rrihte më, djersët do t'i pushonin dhe do të dergjej aty e ngrirë, e ftohtë. S'do të bëhej

merak për asgjë që mbetej paskëtaj mbi dhé; ç'do t'i hynte në punë në krei i arës mbeti pambjellë, në fëmijët s'kishin fustane e këpucë për dimër, në se Kazili që plak e duhej shitur? Të gjitha këto qenë boshe, gjëra të kota, të vogla dhe qesharake. Asgjë, asgjë s'do t'ia prishte më qetësinë së shoqes.

Sterjua ndjeu ftohtësinë që i hyri thellë në shpirt si një copë akull, zbrazësirën që e pushtoi dhe trupi iu kapit e koka iu var mbi gjoks. Edhe shtëpija pa grua iu duk e ftohtë, e shkretë dhe e mërzitëshme si manastir. I ra në gjunjë afër kokës e, me atë dorën e shëndoshë, i përkëdheli faqen, flokët, ballin e djersitur.

— Irini, ç'the ashtu... Mos, aman, mos! Shiko, unë budallai të mora në qafë. Bjermë në kokë, mos më lërrë të gjallë...

E habitur nga ato që dëgjonte, ajo hapi sytë e i foli:

— Më duket se do lind... Shko merr nënën.. me atë i kam lindur edhe fëmijët... e tjerë...

Vetëm tani u çlirua Sterjua nga ankthi që e kish mbërthyer ndër thonj dhe e kuptoi se ç'donte të thoshte e ku e kishte hallin.

— Nënën? Po ty vetëm të të lë këtu?

— Ti s'më ndihmon dot... Shko merr nënën...

Zëri i saj qe i ngashëryer dhe i këputur sa asnë s'do të kish fuqi t'i kundërshtonte.

Sterjua ngriti kokën e shikoi përqark. Përfund arës, në një lëndinë, pa perçen e bardhë të kalit. Fluturoi atje si era. Iu afrua kalit, ja zgjidhi pengoren me dorën e vetme e me dhëmbë e pastaj i kërceu në shpinë. Samari qe pranë thesit të farës, po ai as që e kujtoi. Edhe sikur ta kishte kujtar, nuk do të vinte ta merrte, sepse ato minuta që do të humbte atje, do t'i duke shin sa një ditë e tërë. Ja, tani ish gati për të ikur, për të fluturuar. U përkul duke zënë me dörë lejlen e kalit, ja ngjeshi këmbët pas barkut dhe kali u nis me të katra. Pas një minute ai u zhduk prapa kodrinës dhe mori rrugën e fshatit.

Në arë mbeti vetëm Irini, duke u përdredhur me mundim, sa nga njëra anë në tjetrën.

Sterjua hyri në shtëpi si furtunë, por, me të hapur derën, vrulli ju pre dhe e mbajti veten se nuk deshi t'i trëmbte e t'i shqetësonë fëmijët, të cilët gjyshja atë çast po i vinte në gjumë. Të tri çupat ishin shtritur në këndin e djathtë, mbi dyshegun që ish mbushur me fletë misri e që ato e kishin aqë qejf, se kur ferkoheshin pas tij, bënte fësh-fësh. Gjyshja i kish mbuluar me një jorgan ngjyra-ngjyra, duke u lënë përjashta vetëm kokën. Çupën më të vogël e kishte zënë gjumi dhe po flinte si një éngjell. Kish futur, siç e kish zakon, gishtin e madh në gojë dhe e thëhinte nëpër gjumë me kaqë éndje, sa të vinte mëndja se gishti lëshonte nektarin më të émbël të botës. Dy më të mëdhatë nuk i kish zënë gjumi akoma, se gjyshja po u tregonte përrallën e tojit që ndahet nga shokët.

«Dhe kështu, o motrani, toji u tha: — «U s'vij më tutje, o vellezër, do qëndroj këtu». — Hajde me ne, i thanë, mos u ndaj, — po ky s'deshi dhe ata ikën e e lannë e ky mbeti vetëm... Pa kur erdhi dimri...

Sterjos i cërriti në zëmër. C'djall i ish kujtuar gjyshes kjo përrallë që ngjiste me jetën e tij dhe pse po ua tregonte tanit?

- Del, i foli i përbajtur — se të kërkojnë!
- Kush më kérkon? — pyeti plaka si me inat.
- Ka ardhur një aty në çardhak...
- E pse s'vjen brënda, po rri jashtë në çardhak, neshtëpinë pse e kemi? — u çudit plaka dhe me përtesë u ngrit e dolli jashtë derës. Pas i vajti dhe Sterjua.

I foli ngadalë me të dalë në çardhak:

— Nuk të kérkon njeri, jo. Unë të desha. «Ajo» është sëmurë në arë dhe të kérkon ty. I vjen si ashtu — Sterjua s'dinte si ta thoshte atë fjalë — e de, e di ti, ka frikë se mos lindjë...

— Uh, o Zot të qofshim falur, na ndihmo! — tha gjyshja, duke bërë kryq, e fytyra iu çel e iu ndrit nga gëzimi. Pastaj u kthyte nga Sterjua e, si t'i tregonte një sihariq i foli: — Edhe unë në arë, të kam lindur ty... Shyqyr, o Perëndi, shyqyr!

Plaka hyri në dhomën tjetër, mori një qiri, e ndezi
dhe u drejtua pér te konizma.

— Lëre, pastaj e ndiz, kur të kthehem.

— Jo, o bir, jo, tani do ta ndez që ta kemi ndihmë.
O Zot, ta ketë djale, thuaj! O Zot e Zonja Shërmëri!

U kthye përsëri në dhomë dhe seç filloi të kërkonte.
Sterjos iu duk se po vonohej shumë dhe përsëri i bërtiti:

— E po luaj, ç'djall kërkon kështu?

Plaka s'e prishi gjakun dhe vazhdoi të kërkonte në
një kanistër të vjetër ca pelena. I mbloindi në një bohçe
dhe doli pas të birit në oborr. Sterjua kish qëndruar pra-
në kalit e po i fërkonte ballin.

— Ku ja ke samarin? — e pyeti plaka me inat.

— Mbeti atje... Ika nxituar...

— Po unë plaka ku të hipënji? Qëndroj dot unë ash-
tu? Ç'bën kështu, more bir, pse e humbe mëndjen? — e
qortoi ajo rreptë.

— Mbaju pas meje! — i foli Sterjua duke bërtitur.

E hipit të jëmën, hipit edhe vetë e pastaj ja lëshoi
vrapin kalit në të tatëpjetën. Patkonjtë kërcisnin duke
u përpjekur pas gurëve. Njerëzit e shikonin me habi e,
sa mateshin ta pyesnin, ai diç mërmëriste nëpër dhëm-
bë e zhdukej. Vec kur kaloi pranë shtrungës së kopera-
tivës, u detyrua t'ja mbante vrapin kalit se i dollën pér-
para një kope dhensh, të cilat s'kish si t'i kapërxente.

Miti që u ndodh atje pranë e pyeti.

— Ç'ke, o Sterjo, si është puna?

— S'kam gjë, jo — ja preu shkurt Sterjua duke e
vështruar shkarazi, e s'i tregoi asgjë.

* * *

Arritën në arë.

— Erdhe, néné?

— Erdha, bij e nënës...

— Aman, shpëtomë! S'e ndjej si herët e tjetra këtë
radhë...

— Do ta kesh djalë, ndaj. U shyqyr, o Perëndi, të më gëzohet edhe mua korbës prehëri më një nip. Hiç mos u trëmb, ti, më ke mua...

Sterjua u hoq mënjanë.

S'dinte ku të vinte.

Pështyu, pastaj ngriti sytë në qelli e pa ca re që fluturonin nga lindja. Iu duk sikur ikte gjithë qilli bashkë me 'to e iu muar mëntë. «Fluturokan dhe retë!» bëri çudi Sterjua. S'e kish soditur kurë qilllin kështu si sonte. Ai shikonte vetëm poshtë në tokë, e sytë i ngrinte lart vetëm për të parë motin në ish i mirë a i keq, domethënë në ish kohë e mirë për të vajtur në arë. Eh, sa i madh iu duk qilli Sterjos e sa shumë yje që kishte. Vrau mëndjen: përsë i duheshin qilllit gjithë këta yje?

Ndjeu se e thërriten në emër. U ngrit e u vajti pranë, duke i hedhur hapat ngadalë e me mëndje të mpirë mundohej të mësonte ç'kishte ngjarë.

— Dështoi! — i tha plaka e pikëlluar sa më s'bëhej, duke kryqëzuar duart. — Djalë, goxha djalë, sheleg.

Gjyshja psherëtiti e pastaj qau.

— Djalë, — tha Sterjua ngadalë, e vuri dorën në kokë — I shkreti! Po ajo si ndihet?

— Si të ndihet dhe ajo kërcure, ja ashtu ...

Përfund arës u dukën ca njerëz. Sterjua ktheu kokën e sado që u mundua, nuk i dalloj dot sa qenë. Kur iu afruan, njobu fqinjin e tij, Miti Savën, Gurin e Gjikkollarëvet, Gaqon e Kicit dhe Pirron, sekretarin e Rinisë. Ata e kishin parë tek ikte kaluar, me të jëmën prapa dhe e muarën me mënd se këtij njeriu diç do t'i kish ngjarë. Për të mirë a për të keq, le t'i ndodheshin pranë, fshatar e kishin, i tyria qe. Kush tjetër, veç atyre, do të shkonte t'i qante hallin.

— Si e ke punën, Sterjo? — e pyeti Gaqua.

Sterjua tundi kokën e dëshpërimi s'e la të fliste.

— Dështoi, e shkreta ... — tha plaka e ngashëruar, duke treguar me kokë të renë. — Djalë ...

— Dështoi, hë? — pyeti Miti me habi dhe deshi të shtonte: «po nga të mos dështonte, kur e merr nd'arë dhe e mundon si kafshën ... — pastaj u pendua e nuk

tha. S'deshi t'ia vriste zëmrën Sterjos më tepër. Ndofta këtë gjë, ai e kuptonte vetë tashti.

— Të bëjmë një vig e ta shpiem lehonën në shtëpi, se mos ftohet, — tha Gaqua.

Miti hoqi pallton, Guri peliqen.

Bënë një vig dosido, me litarë e me purteka.

Pirrua vajti çmbrehu pëndën e qevet. Ata kishin dalë nga brazda, parmënda kish rënë mënjanë e hunda e shkëlqyer e plorit shikonte qiellin me mospërfillje e me një mëri të heshtur. Qetë në Ledh, me zgjedhën në zverk po mundoheshin të rrëmbenin ndonjë gojë bar.

— Po atij c'do t'i bëjmë? — pyeti Sterjua për fëmijën — do ta marrim?

— Do ta marrim, po qysh, iu përgjegj plaka e vedor — do ta mbulojmë edhe atë si njeri...

U nisën për rrugë.

Në fund fare ecte Sterjua.

— Lëviz! — shpejtësisht urdhri u jepi. — Lëviz!

— Jep! — Këtë i vleu që Sterjua i dha kompjuta e tashme, që është këtë. — Ushqimet kurrë, jo që kurrë, që kurrë. — Përfundimisht, që është kurrë, jo që kurrë, që kurrë. — Kompjuta e tashme, që është kurrë, jo që kurrë, që kurrë. — Kompjuta e tashme, që është kurrë, jo që kurrë, që kurrë. — Kompjuta e tashme, që është kurrë, jo që kurrë, që kurrë. — Kompjuta e tashme, që është kurrë, jo që kurrë, që kurrë.

E FEJUARA

Ka disa trendafilë me një ngjyrë të zbërdhylur e si te shpëlarë të cilët, edhe ditën që çelin, duken si të vjetruar e sikur kanë lulëzuar prej kohësh. Këta trëndafilë, së largu, nuk të rrëmbejnë, syrin s'ta tërheqin e veç po tu afrohesh, ke për të vënë re, se fletët e tyre janë, për çudi, të bukura e të rregullta dhe kanë një erë të këndëshme si gjithë trëndafilët e tjerë.

Një trëndafil të tillë të kujtonte bukuria e Sadetes. Ajo rrinte e veshur me një fustan të vjetër e me një trikojeshile të dalë boje; fytyrën e kishte me tipare të rregullta e të ëmbëla, ngjyrën ezmere dhe lëkurën të lëmuar e pa asnje rrudhë. Vinte pakë e hequr dhe kjo dukej sikur ua shtonte bukurinë atyre syve të zes në formë bajameje; mirëpo të gjitha këto hijeshi rrinin të tulatura e nuk të binin në sy. Po ndofta edhe vetë Sadetja nuk dinte t'i vinte në dukje hirer që kishte. Flokët e zes i mbulonte me një lahuri të bardhë e, nga sa dukej, nuk kujdesohej fort për ta, pasi edhe ditën e Bajramit, kur hiqte lahurinë e i lëshonte supevet, nuk dukej më e bukur, përkundrazi flokët e shëmttonin, sepse i vareshin si fletë preshi.

Sadete Koçiu kishte shumë punë në shtëpi, sepse vajzat, që mbetën jetime e që kanë vëllezër a motra më të vogëla, detyrohen në një farë mënyrë t'i zënë vëndin nënës e të marrin, mbi krahët e tyre të njomë, gjithë brrën e rëndë të shtëpisë. Sadetes i kish vdekur e éma nga dështimi, duke e lënë të mitur dymbëdhjetvjeçare e me dy vëllezër më të vegjël. I ati, Myrtezai, ish në

atë moshë kur martesa pér së dyti është e vështirë dhe e pahijëshme. Megjithatë, në fshat pëshpëritheshin fjalë, posht e lart, se Myrtezait ja kish qejfi të martohej sërisht.

Tani vëllezërit qenë rritur: Smaili, i madhi, kish marrë pendën e qevent e i qe futur bujqësisë në këmbë të të jatit, kurse Qemali vinte në shkollën shtatëvjeçare të qytetit, ndonjë orë larg fshatit.

Shtëpia e tyre qe e vogël, me dy të ndara e me një çardhak në mes. Dhoma e zjarrit, ajo ku rrinin dimër e verë, qe me dysheme, muret nga që s'qenë lyer prej kohe, kishin marrë një ngjyrë të verdhë-kafe. Dhomën e kishin zbukuruar me ca pllakata që i kish sjellë Qemali nga qyteti, dhe me një portret të Skënderbeut. Brënda në mur kishin një dollap në të cilin futnin rrobat e fjetjes, kurse përfundi dhoma kishte disa minderë që bënin edhe punën e hambarëvet. Kjo qe e gjithë dhoma e fjetjes. Në dhomën tjetër mbanin enët e bulmetit, miellin, saçin pér të pjekur bukë dhe rrangulla të tjera, me të cilat mbushen shtëpitë në fshat.

Myrtezai i pasur s'kish qënë kurrë, po as varférinë s' e kishte ndjerë. Bukën e bënte pér gjithë vitin dhe, kur qëllonte moti i mbarë i tepéronte edhe pér të shitur. Veç që kur i vdiq e shoqja, ai i la pas dore punët e bujqësisë që s' i hynin fort në sy.

Tani, në këta dy vjetët e fundit, i kish hipur një merak i çuditshëm: donte të martohej. Ishte pakë i kaluar nga mosha, por ai e ndjente veten të fortë dhe nuk i vinte mirë ta ngryste jetën beqar. Kjo ide nuk i shqitej nga mëndja. Ai e dinte, se që të gjente një grua të njomë e të re, ishte punë mjaft e vështirë, por jo e pamundur, prandaj në mëndjen e tij pat stisur një plan dinak dhe kish filluar ta vinte në veprim. Sivjet, do të martonte Sadeten e do të martohej edhe vetë.

Myrtezait as që i shkonte ndër mënd se pér fejesë e pér martesë duhej të pyeste fëmijët.

«Është detyrë e prindërvet të martojnë fëmijët, thoshte ai, dhe s'do mënd, prindërit duhet të jenë ata që do të gjejnë dhëndërin a nusen».

Sa për punët e zëmrës e të dashurisë, Myrtezai nuk i besonte hiç dhe thoshte se dashuria vjen vetiu pas martesës. Ja, ai vetë, a nuk e kish dashur gruan e tij, megjithëse më përpara s' e kish njohur fare? Dhe a nuk ishte ky shëmbulli më i mirë që duhej të ndiqnin edhe fëmijët e vet?

Këto mendime i përsëriste shpesh me mëndjen e vet, dhe herë pas here, kur binte puna, ua thoshte edhe fëmijëvet. Sadetja e shikonte me ata sy në formë bajameje dhe tundëte kokën në shenjë pohimi. Vërtet, fëmijët duhet t'u binden prindërvet. Pse të mos e dëgjojë babanë, a mos vallë babai ja do të keqen kurrë fëmijës? Ajo e dinte nga përvoja se fëmijët rriten me shumë mundime, u sjellin një barrë andralla prindërvet dhe, pikërisht fëmijët duhet të jenë ata, që me dashurinë e bindjen e tyre, t'u gëzojnë zëmrën prindërvet. Vetë jeta e mbyllur që kishte bërë i diktonte të tilla mendime.

Edhe Smaili ishte i një mëndjeje me të jatin, kur se Qemali qe kundërshtar. Ai ish futur në jetën e shkolles, në botën e madhe të libravet, që lexonte pasditevet, e ato ja kishin ndriçuar mëndjen, i kishin hapur horizonte të reja, dhe ndonëse i vogël, gjykonte ndryshe nga i ati. Ai thoshte se, kur të martohej, kishte përta zgjedhur vetë gruan që do të merrte.

— E po ne s' themi për ty, — ja kthente Myrtezai me tallje — se ti je me shkollë. Ne themi përfshatarët.

— Fshatarë, qytetarë, njerëz janë që të gjithë,

— E, e, njerëz... Je i vogël ti akoma, s' i di këto punë.

Myrtezai përpinqej t'i mbyllte shtegun sa më parë këtij muhabeti të rrezikshëm dhe kur e shikonte se puna merrte ters, nuk përtonte t'i hiqte ndonjë shukretë turinjëvet të birit, që ta mësonte se përpara babait nuk flitet dosido.

Myrtezai, në sy të Sadetes e të Smailit, përqeshte ata prindër që i linin fëmijët tuz martoreshin pas kokës së tyre.

Një pasdite Myrtezai u kthye nga pazari gjithë qejf. I qeshte nuri dhe, duke ardhur rrrotull nëpër shtëpi, këndonte një havaz me zë të ulët. Sadetja e vërejti një herë me frikë e pastaj me çudi, e vetëm në mbrëmje, diç kuptoi nga ky gëzim i pashpjeguar i të jatit.

Si mbaruan së ngrëni darkë, ai nuk tha si tjetër he rë. «Hajde, Sadete, më shtro për të fjetur», po ndenjtë anës së zjarrit, duke pirë duhan e përsëri nga fytyra nuk i ish zhdukur ajo ndjenjë gëzimi e kënaqësie.

Qemali po mësonte, Smaili po dridhëtë një duhan nga kutia e të jatit, e aty më tutje Sadetja, me këmbët të mbledhura nën vete, thurte çorap.

— Nesër, o baba, them të vete për dru, po ajo sëpata na mbeti pa kalitur, — foli Ismaili.

— Mirë, mirë, punë që bëhet — ja ktheu Myrtezai, e duket se mëndjen e kishte gjetkë. Në një hop kohe u kthye nga Sadetja, e, duke e shikuar me vëmëndje e dashuri, i tha me një zë të butë:

— E, moj bijë, u rrite tani; të erdhi koha për martesë. Ja, edhe ne të duam, të duam, sa s' ka ku të vejë më, po gjithënjë me babanë e me vëllezërit nuk do rrish. Ti si thua?

Piste me ankth ç' do t'i thoshte e bija, mbasi kurë ndonjë herë më përpara nuk ja kishte zënë ngoje kaqë hapur punën e martesës.

Sadetja uli kokën nga turpi dhe gishterintë që i punonin shtizat i pushuan menjëherë, sikur të ishin paralizuar. Ndjeu se fytyra iu nxeh dhe e mori me mënd se do të qe skuqur gjer te veshët. Nuk iu përgjegj fare, veç se e shikoi të jatin me bindje e u duk sikur me atë vështrim i tha: «Mirë, baba, ti e ke në dorë.»

— Ashtu, çup' e Babajt, — foli Myrtezai. — Më hodi një fjalë njëri sot kur u takuam në pazar, po të shohim.

Myrtezai buzëqeshi i kënaqur, pshëretiti i çliruar e duke ngritur njerën dorë, filloj të paloste mustaqet

Jo shumë larg shtëpisë së Myrtezait gjindet një arrë e madhe e plakërishte. Dy çatajt e saj ngrihen përpjetë sikur duan të kërcënijnë qiellin e kaltër. Ka disa vjet që edhe asaj i kanë dalë thinjat. Tani, përmbi shtressën e gjelbërt të fletëvet të rralla, duken disa degë të holla thatanike, shtrëmbanike e të shëmtuara. Degët s'e kanë njomësinë e përkulshmérinë e parë, ato thyhen shpejt e përkëtë shkak asnjeri nuk guxon ta shkundë. Por as frutet nuk shkojnë dëm, se Sadetja shkon mëngjes përmëngjes dhe mbledh nga një prehër plot me arra, pastaj, kur i sjell në shtëpi, u heq shargun dhe i nder në diell që të thahen.

Një natë, kish fryrë erë e fortë dhe në mëngjes Sadetja e gjeti vëndin të mbuluar me arra e me fletë. Ajo filloj t'i mblithte në kapica dhe po mendohej se duhej të vinte në shtëpi që të merrte ndonjë thes. Kur pa pritur dëgjoi një zë që iu duk si i njojur:

— Mjaft mbledhe, moj Sadete, lër edhe përmëngje ca kokrra...

Ktheu kokën dhe pa Raifin, djalin e Rizait, që ish fqinj me ta.

E turbulluar, iu përgjegj pa menduar shumë:

— Pse, do ti? — Me të thënë këto fjalë që dukej se i kishin shpëtar pa dashur, u skuq dhe qortoi vreten: «Po unë q'thashë kështu?»

— Dua, posa — iu përgjegj Raifi me buzën në gaz.

— Eja, merr sa të kesh qejf, — e ftoi ajo, — veç jo nga këto të mbledhurat.

— Jo, jo, të gatëshme nuk dua unë; do të mbledh vetë këto që janë futur nëpër gurët e nëpër ferrat e që s'i merr dot ti.

Filluan të mblidhnin të dy. Sadetja qe fare e qetë, kurse Raifi, i hidhte vjedhurazi nga një vështrim. Ajo, si përdreq, s'e ngrinte kokën fare; dukej sikur puna që kish përpara e tërhiqte më tepër se ç'do gjë tjetër në ato çaste. «Ma bën kastile, a po ka turp?» — pyeste veten Raifi dhe s'i jepte dot përgjigje. «As që më shikon fare me sy».

Si mbushi grushtet me arra, iu afrua Sadetes dhe i tha:

— Hape përparsen t'i hedhim edhe këto që mblodha unë.

Ajo ngriti kokën ngadalë dhe e shikoi me habi.

— Jo, jo, merri për vete — i kundërshtoi — se ato kot do të shkonin ...

— Faleminderit, moj Sadete, unë të provova zëmren, pa, sa për arra, kam ngrënë plot.

Raif Basholli qe një djalë nga 28 vjeç, me trup të bëshëm e të fuqishëm. Kishte një fytyrë të mbushur dhe energjike. I pëlqente e mbante ca mustaqe, me gjithëse ngjyra e tyre s'qe për t'u pasur zili, pasi s'ishin as të zeza as gështenjë, po vinin në ngjyrë të kashtës së pjekur. Shtëpinë e kishte afër Sadetes dhe, kur e sillte puna, hueshin si fqinj që ishin.

Raifi ja mbértheu sytë drejt në fytyrë, pastaj e zbri ti vështrimin gjer te këmbët, sikur të donte të vinte re ca hollësira që s'i kish parë më përpresa. Sadetja e ndjen te se ay po e përpinte me sy dhe u turbullua. «Ç'ka ky që më shikon kështu, sikur s'më ka parë kurrë?»

Si një njeri që zihet ngushtë e s'di ç'të bëjë, filloi t'u hiqte shargun arravet e duart i dridheshin. Dhe që t'i jepte fund sa më parë atij shikimit që s'e duronte dot, i foli:

— Gabim bëre që s'i more arrat! — Në tonin e zërit të saj ndihej më tepër lutja se sa qortimi.

— Se mos erdha për arrat, unë — iu përgjegj Raifi.

Aty për aty ajo nuk e kuptoi ku shponte thumbi i shakasë dhe veç kur vajti në shtëpi i ra ndër mënd. U skuq, kur i mendoi ato fjalë të thëna me shejtanllék e kur iu parafytyrua vështrimi i tij ngulmonjës. Në the llësi të shpirtit asaj i vinte mirë. E a ka vajzë në botë që të mos e ketë ndjerë shqetësimin e parë të ndjenjës së dashurisë me të rrähura zemre? Sa të lumtura e ndjejë veten vajzat kur pa pritur kuptojnë se dashurohen. Atëhere pa e kuptuar fillojnë të thurin kështjellaën drash lumturie për të ardhëshmen. Po Sadetja në vënd

që ta zbulonte këtë ndjenjë, e ndrydhi në fund të shpirtit të saj dhe nuk guxoi t'ja çfaqtë as vetes.

* * *

Raifi kish filluar ta dashuronte Sadeten. Shtyrja për këtë dashuri do të duket pakë qesharake dhe e çuditëshme, po në botën tonë të gjitha janë. të mundëshme. Në shtëpi të Raifit, s'kish ditë që mos hapej muhabeti për fejesën e tij. I ati, Rizai, i mërzitur mbasi ja kish thënë për të njëqintën herë, tani së fundi kish hequr dorë dhe nuk ja zinte më ngoje, kurse nëna nuk i shqitej:

— Martoju, mor bir, se të ikën vafti; çupat nuk do të presin ty!

— Ka vaft — i përgjigjej i qetë Raifi, mbasi e kish kaluar atë moshë, kur njeriu është gati të martohet pa menduar asgjë.

Një mbrëmje shtatori, si kishin mbaruar së ngrëni bukë, Raifi po pinte duhan i menduar. Ndjehej pak i trishtuar dhe, për t'u englendisur, shikonte dredhat e tymit të duhanit.

— E, mor bir, mos u mendo, — i tha e ëma, — po martoju që të gëzohesh. Kush u martua e s'u gëzua!

Raifi bëri sikur s'e dëgjoi. E ëma vazhdonte:

— Lërma në dorë mua; do ta gjej nusen e do të ta sjell në shtëpi si një kukull.

Ai sikur u përmënd nga këto fjalë. Bëri buzën në gaz dhe i tha me shaka:

— Pa hë, të shohim, kujt ja ke vënë syrin?

— Ja, për shtëpinë tonë, unë do të merrja të bijën e Myrteza Koçit. Atë e ke për të gjitha: ndo punëtore, ndo të bukur, ndo t'urtë.

— Sadeten, moj? — qe çuditur i biri.

— Sadeten, po kë tjetër? Kur e kemi në derë të shtëpisë, pse të kërkojmë gjetkë? Këtë e njohim e na njeh. E di si thoshin pleqtë a po jo? Gruan, e merr nga vëndi yt, që ta njohësh e të të njohë. S'ishin budallenj pleqtë, jo.

Raifi iu përgjegj duke vënë duart prapa kurrizit e duke përdredhur buzët:

— Sështë gjë ajo, nuk më pëlqen; thashë se do të më kishe zgjedhur ndonjë tjetër.

— Kur s' të pëlqen ajo, bëj si të duash, — ja ktheu e ëma me zémërim — në daç shko u bëj dervish.

— Lëre, ç'ja zë ngoje martesën, se ky do të bëhet meleq, — foli me tallje Rizai që nga ana tjetër e zjarrit.

I shtyrë nga ky bisedim, Raifi atë javë e kish parë me tjetër sy Sadeten. Dhe ajo i qe dukur e bukur, veçse bukuria e saj e thjeshtë s' të binte në sy, dhe qëndronte e fshehur si ato luleshtrydhet nën fletët. Gjertani, meqënë se ishte një dhjetë vjet më i madh, e kish vështruar gjithmonë Sadeten si një fëmijë. dhe as i kish vajtur mëndja se ajo qe rritur e qe bërë përmartesë.

Dhe ja ku kish shkuar dhe e pat takuar. Përshtypjet nga takimi i parë ai i kish shumë të turbullta dhe të paqarta, po në vetvete e ndjente se ç'do ditë po e donte më shumë.

* * *

Dy ditë u sorollat Raifi kot së koti, pa ditur ku vinte e çfarë të bënte. Tani nuk habitej pse po i pëlqente kaqë shumë, por vriste mëndjen përmjë gjë tjetër: Si nuk e kish vënë re më përrpara Sadeten, si nuk i qe afruar, të bisedonte me të gjer e gjatë; e, atëhere, pas njoħjes e miqësisë, do të lindëte dhe dashuria.

Vendosi ta priste përsëri te arra. Natën kishte rënë një vesë shi dhe e kish ftohur motin pa pritur, siç ngjet zakonisht vjeshtavet. Nga fletët e gjera të arrës shkisnin pikat e shiut duke formuar një melodi të quditëshme, përmallonjëse e monotonë. Raifi përmirësua parë e dëgjoi këtë melodi.

Në qiel i po fluturonin akoma disa copra resh të bardha, të cilat tani dukeshin si mëndafsh i krehur.

Raifit nuk iu duk me vënd ta priste te arra, sikur i kishte zënë pusi. Më mirë të largohej e kur të vinte

Sadetja, ai do tē shkontakte aty pranë gjoja rastësisht; e pastaj mund tē bisedonte.

Dhe kështu bëri.

* * *

— Mirëmëngjesi Sadete!

— Mirëmëngjesi! — iu përgjegj ajo duke e shikuar me ata sytë gështenjë.

— Shpejt qënke ngritur...

— Unë shpejt ngrihem kurdoherë, — iu përgjegj ajo.

«S'e nisa mirë» mendoi Raifi. «Shpejt qënke ngritur!», përqeshi veten, sikur s'e di unë që ngrihet shpejt. Hajde ç'budalla që jam.

— Po babai ç'bën?

— Babai ç'të bëjë, rri...

— Mos do vejë tē premten në pazar? — pyeti përsëri kot.

— S'e di, po edhe mund tē vejë, se kemi pér tē shi-
tur një lopë...

— Cilën lopë, atë tē kuqen...?

— E, atë tē kuqen, — pohoi Sadetja.

— Shiko, po qe se do vejë babaj në pazar, më
thuaj.

— Mirë, — iu përgjegj ajo — do ta pyes e pastaj tē
lajmëroj.

Raifi s'kish pér tē shkuar asgjékundi, po u ngatë-rrua në këtë muhabet e s'dinte si tē delte. Filloi tē pshe-rëtinte përsëri e s'dinte si ta sillte muhabetin atje ku-donte.

— Po Smaili ku shkoi sot? — pyeti kot dhe përsëri u pendua. «Hajde tuaf, hajde, pyete pér gjithë njerëzit e shtëpisë, sikur ke ardhur nga kurbeti».

— Smaili shkoi tē lërojë; tē kthejë një ugar.

— Po sot sikur është e rëndë koha...

Raifit iu duk sikur ky muhabet u zgjat shumë dhe po torturohej. E mbloindi veten dhe, duke kapërxyer pështymën, i foli:

— Moj Sadete, unë do të të them një fjalë...

Ajo ngriti supet e shikoi drejt në sy dhe, pa e kuptuar as vetë se për ç'shkak, u trëmb. E parandjeu se këtu kishte një farë rreziku.

— Mua? — Pyeti e habitur.

Raifi u përtyp e s' dinte si të vazhdonte, por pastaj atypëraty e vendosi: «do t'ja them, le të dalë ku të dale...»

— Po, ty. Ja, mua më ke hyrë në zëmër dhe, po të jetë se do edhe ti... atëhere...

Sadetja u skuq dhe, me qënë se qe meleskë, i rani një nur e një bukuri të cilën Raifi s' e kishte vënë re kurrë. Ai e shikonte me bishtin e syrit dhe me zëmër të mpirë priste të dëgjonte atë «po» që, në të tilla raste, vajzat e thonë me kaq zë të ulët, sa të vete mëndja sikur ato vetë kanë frikë e turp të dëgjojnë ç'tha goj' e tyre. Sadetja ngriu. Asaj as që i kish shkuar ndër mënd se dikush mund ta pveste në këtë mënyrë. Si t'i përgjigjet Raifit, a mund t'i thoshte që e donte, pa pyetur më përpara të jatin? Gjersa kjo ish një punë, të cilën e kish në dorë vetëm babaj, gjëja më e mirë do të qe, ta drejtonte në familje. Dhe kjo asaj i dukej njësoj si të kish pranuar të dashurohej me 'të. Ndaj, para se të përgjigjet, mati fjalët mirë dhe, duke këthyer kokën mënjanë nga turni, i foli:

— Unë nuk e di se ç'të them... Pastaj unë s'jam e vetëme, kam baba, kam vellezër... shko në shtëpi... dhe ç' të të thonë ata... — e, duke thënë këto fjalë, dridhej e tëra sikur të ish ndër ethe.

Raifi ja ktheu:

— Mirë; unë edhe në shtëpi do të vete, po më përrapa dua mendimin tënd. Pranon ti apo jo, që të mos mundohem koti në shtëpi?

Sadetja, e ndrojtur dhe e përbajtur nga natyra, dhe ca më tepër skllavë e mendimevet të të jatit, iu përgjegj ngadalë:

— Po ja, edhe sikur të dua unë, po të mos dojë babaj, nuk do të bëhet gjë... Unë ja kam thënë edhe bajt: «Ku të duash ti, atje dua edhe unë.»

Raifi fërkonte padashur kopsën e xhaketës dhe shikonte pulpët e Sadetes, të cilat qenë bërë, nga të ftohtit, kokrriza-kokrriza. Për një çast atij iu duk sikur nuk ishte te arra e Myrtezait, po në një vënd tjetër, të largët e të panjohur; dhe propozimi që i kish bërë Sadetes, iu duk se pat ngjarë kohë përpëra e tanit, pa pritur, që vjetëruar.

— Mirë, mirë, — i foli nëpër dhëmbë — unë edhe babait do t'i them, veç mos e bëj fjalë.

Ajo nuk iu përgjegj, po i bëri shenjë me kokë, se e kish kuptuar atë që i tha.

Raifi, duke u larguar, mendonte: «Duket i vjen gjyc të më thotë «jo» e prandaj më dërgon te prindërit. A po më do dhe ka turp ta thotë? Këtë gjë ai s'e shpjegoi dot».

* * *

Dhe ja, një mbles trokiti në portën e Myrtezait. Po ky s' qe shkues i dërguar nga ana e familjes së Bashollarëvet, ky qe një kushëri i largët i Myrtezait, me të cilin ai pat biseduar javën e kaluar në pazar. Tani, nga sa dukej, ai kish ardhur të sillte përgjigjen.

Fytyra e mikut buzëqeshte e nga kjo Myrtezai e kuþtoi se punët qenë në vijë dhe plani po i shkonte mbarë. Mikun e priti me përzëmërsi e me nderime duke i lëshuar kryen e zjarrit. Sadetes, që hyri atë çast në dhomë, i bëri me shenjë që të delte përjashta e t'i linte vetëm.

Egeremi, sense kështu e quanin mblesin, kishte një fytyrë rrumbullake e ballin plot rrudha. Mblesëria i shkonte mbarë se kishte shumë fjalë dhe dinte t'i përdorte të gjitha me masë e me sërë: lutjen, miqësinë, ryshfetin, qortimet, sharjet, lëvdatat.

— Si është puna? — e pyeti Myrtezai.

— Prit, duro.

— Thuama shpejt se s'më durohet.

— Do ta them.

— A pranuan?

— Në fillim sikur s' deshën, po pastaj ua mbusha mëndjen.

— Më rrofsh! — i tha Myrtezai duke i rrahu shpatullat.

Të premten e javës kaluar, Myrtezai qe takuar me Eqremin në pazar. Eqremi e solli e e mbështolli muhabetin, që të merrte vesh në vallë Myrtezai e kish dhënë gjëkundi fjalën për fejesën e çupës, kur u sigurua nga kjo anë, atëhere i tha, se mund t'ja rregullonte ai në një vënd shumë të mirë.

Myrtezai nuk u gjëzua, ashtu sikurse priste Eqrem Kërçaku, dhe, duke pshërëtitur, i tha se e kish hallin ndryshe.

Më në fund, pas një bisede të gjatë, duke i qarë hallin si mik e vëlla, i pëshpëriti në vesh, se ai vërtet çupën për të martuar e kish, po puna ja donte të martohej edhe vetë, sepse kish nevojë shtëpia!

«S'ka kush të na lajë, s'ka kush të na ndrrojë, na duhet një femër në shtëpi.»

— Marto djalin, — e këshilloi Eqremi.

— S'ka sërë djali për t'u martuar, se s'ka bërë ushterinë akoma.

Atëhere Eqremi e kuptoi menjëherë planin që kish stisur Myrtezai dhe, duke vënë buzën në gaz, i shkeli synë.

— E mora vesh ku e ke hallin. Ç' ke ti, ta rregulloj unë atë punë. Di një vënd tjetër që ka këtë hallin tënd. Dhe do t'ja them. Po të jetë puna në rregull, unë do të vij vetë në shtëpi nga java tjetër.

Këtë gjë kish èndëruar Myrtezai këta dy vjet: don-te ta martonte vajzën me këmbim, dhe prandaj i kish përcjellë gjithë mblesërit që i kishin ardhur në shtëpi, duke i pritur ftohtë e duke u thënë se çupën e kish akoma të vogël.

Tani të dy miqtë, me nga një gotë raki përpara, po bisedonin anës së zjarrit.

— Puna është e mbaruar. Çupën ai e ka si hëna pësembëdhjetshe. Do ta marrësh e do më kujtosh. Dhe ja njeri me fat.

Mbi fytyrën e gjerë prej babaxhani të Myrtezait, u ndër një buzëqeshje plot kënaqësi. Mustaqet e tij të dëndura si tufë, e që i vareshin në të dy anët e gojës, u drodhën lehtë nga gjëzimi. Duke kafshuar njerën anë të mustaqes, pyeti me merak:

— Shiko, Eqrem, mos na marrin vesh e pësojmë gjë, se kështu bie një çikë keq në sy. Ja, do' thonë, i këmbyn vajzat, dhe do ta pësojmë si ata që tregojnë. Këto gjëra i shikojnë tashti, s'është si më përparrë që bëje si të doje me evlatin tënd.

— E kám menduar edhe atë, — i tha Eqremi. — Ne, për të humbur gjurmat, do të hapim fjalë se ti e fejove çupën e dhëndri jep erparasi, gjashtëdhjetë mijë lekë. Atëhere kujt do t'i vejë mëndja se ju kini bërë këmbim? Pas nja tre muajvet, kur të jetë vjetëruar kjo mesele, ti merr çupën e tij dhe martoj. Hajde ti, se i di unë këto punë!

I shternguan dorën njeri tjetrit e pastaj me duar të tokura, u ngritën e u përqafuan me dashuri. Fejesa e Sadetes dhe martesa e Myrtezait qe tanë një punë e mbaruar.

* * *

Sadetes iu drodh zëmra kur dëgjoi të trokiturat në derë, sepse pandehu mos Raifi kish dërguar njerëz për të biseduar me babanë; mirépo në vënd të tyre pa Eqrem Kërçakun. Ardhja e këtij mysafiri nuk i kish pëlqyer. Njëherë pandehu, se mos Eqremi ish kthyer kot më kot nga pazari, po kur i jati i bëri me shenjë që të delte përjashta, atëhere s' i mbeti asnë dyshim për qëllimin e vizitës dhe, zëmërdredhur, priti se ç'do të ngjiste.

Në mbrëmje i jati me fytyrë të çelur e thërriti pranë vetes:

— Hajde këtu, çup e babait, se s'do të të kemi dhe për shumë kohë në shtëpi. Babai të ka gjetur një burrë të mirë dhe dasmën nuk do ta mënojmë.

Sadetja dëgjonte e topitur, me zëmër të ndrydhur e gati më të qarë.

Të nesërmen Sadetja mezi u ngrit nga rrobat. Kukën e kishte të rënduar dhe gjithë trupin e ndjente të drobitur, sikur të kishte hequr lëngatë. Kishte bërë një gjumë të çrregullt, me èndra të këqia dhe dy herë, natën, pat thërritur e trëmbur pa qënë në vete.

Ja pra, babai e kish fejuar, por me kë e në ç' vënd as që i kishte thënë. Dhe ajo, e trëmbur nga e panjohura që i kanosej. e kishte humbur toruan e s' dinte çfarë të bënte. Vallë a do të qe burri i saj ashtu siç e kish èndëruar ajo, i mirë, i dashur, i sjellshëm e punëtor?

Në mëngjez i kish menduar me një farë frike këto gjëra dhe sepse e ndjente veten të trembur dhe një rrezik i pakuptuar i dukej se e kërcënonte.

* * *

Në shtëpi të Myrtezait, Sadetja flinte e fundit dhe zgjohej e para. Po kjo gjë, si gjithë gjërat e tjera që arrijnë e bëhen të zakonshme, qofshin edhe heroizma, nuk bien fare në sy. Vetëm një mëngjez, kur Qemali u zgjua herët e u çudit që e gjeti Sadeten duke fshirë oborrin, i tha:

— Unë s'e marr vesh, kur fle ti, motër? Ti na shtron e na mbulon e në mëngjes përsëri, kur çohemi ne, të gjejmë në këmbë.

Sadetja kishte qeshur e i kishte përkëdhelur flokët. Ajo e ndjente se nga të dy vëllezërit Qemalin e donte më tepër dhe i vinte keq që ndjenjat e saj e bënin këtë dallim. Edhe kur ndante gjellën e frutat, pasi shikonte, se cila qe pjesa më e mirë, thoshte: «Këtë do t'ja ruaj Qemalit». Karakteri i tij i dashur, fjalët e émbla e përkëdhelëse dhe mënyra me të cilën fliste, duket se qenë shkaku i këtij afrimi. Kurse Smaili, tani që kish marrë pjesën më të madhe të punëve të bujqësisë, e hiqte vreten si zot shtëpie. Dhe kjo anë e karakterit të tij çfaqej më qartë kur mungonte Myrtezai. Atëhere ai fliste një-

soj si i jati: «Hajde shtrona bukën tashti», ose: — «Sadete, ngreu na sill një ujë.»

* * *

Fejesën e Sadetes akoma s'i kishin hapur, por në fshat të gjithë e kishin marrë vesh.

Duke ardhur rrrotull nëpër shtëpi e duke u marrë me punë të ndryshme, ajo mundohej ta shkundëte atë trish-timin që e kish kllapitur e s'po e linte të merrte frymë lirisht. Mundohej t'ja mbushte mëndjen vetes se pikërisht kështu duhej të ngjiste. Mendimet e saj kundër-shtonin njera tjetrën. «Sa budallaqe që jam edhe unë; në vënd që të gëzohem, u hidhërova kot së koti». — «E moj e zezë, e, po ku e di ti si është ai!» — «Ky qe kës-meti im, kështu qe e thënë përmua; pse mendohem 'kot?» — «Po jo, kësметin e bën vetë njeriu». — «Tani mbaroi puna, kot që mendohesh» e qortonte veten dhe pastaj, si e zgjuar nga èndërimi, vazhdonte punën që kish lënë në mes.

Dhe, sa herë që mundohej të përfytyronte atë «burrin» me të cilin pas disa muajvet do të martohej, përpara syvet të mëndjes, atje pranë tij, i delte edhe Raifi, me ato mustaqet si në të verdhë duke buzëqeshur me ndruajtje e duke luajtur me kopsën e xhaketës. Tiparet e atij tjetrit nuk i dallonte dot qartë; ai ishte si i mbësh-tjellë në mjergull dhe s'shikonte gjë tjetër veç formën e një trupi mashkulli të shkurtër e të trashë e me vësh-shtrim të egër. Ai s' qe kështu dhe vetëdija e saj gabohet. Ndofta ai qe i mirë, i dashur, i bukur... ashtu siç e kish èndëuar.

* * *

Frym erë me shi. Era lot me pikat e imta të shiut, ua ndron drejtimin, i shtyn, i kthen, gjersa më në fund i përplas në çdo gjë që gjen përpara. Strehët e çative pikojnë. Nga shkaku i shiut fusha është e mbuluar si me mjergull dhe asgjë nuk dallohet qartë. Në kohë të tillë njeriut ja ka ènda të afrohet në dritare dhe të vërejë një

copë herë, pa i kapsallitur qepallat, ndonjë sqollë uji ku flluskat e shkakëtuara nga pikat e shiut notojnë në të gjitha drejtimet. Ato zhduken, si flluska që janë, formohen të reja dhe procesi vazhdon. Shiu ndjell kujtimet e së kaluarës, i ndrydh ndjenjat dhe i hedh në pell-gun e apatisë. Fshati Plakë në kohë të tillë duket edhe më i heshtur.

Ja, në rrugë po kalon një udhëtar. Duket se po vjen nga qyteti, pasi era e shiu ja kanë skuqur e ja kanë ndezur faqen e djathtë, kurse anën tjetër thuajse e ka të panjomur fare. Udhëtarë shkon duke ngritur me bezdi këmbën e mëngjér më lart se zakonisht, pasi shualli i këpucës i është hapur gojë e ai ruhet të mos e përthyejë duke e shkelur.

Pas pakë duket një grua, që shtyn me këmbë e me duar një viçok. Gruaja ka hedhur një thes mbi kokë që të mos e lagë shiu; viçoku mezi i hedh këmbët, është mbledhur, është bërë një dorë nga shiu dhe shikon me topitje matyrën e egërsuar.

Sadetja i vëren të gjitha këto nga dritarja e shtëpisë, pranë së cilës po thur çorape. Duart i punojnë me kanikisht, kurse sytë dhe mëndjen i ka gjetkë. Këto çorape do t'ua shpierë darovë njerëzve të burrit. Të gjitha vetë po i bën, e mjera vajzë! Ka kaqë kohë që mundohet; gjer tashti ka mbaruar së enduri velenxën e pajës, disa qëndizma, por ka akoma shumë për të bërë e duart i janë lodhur e mpirë. Të kishte nënën, ajo do ta ndihmonte, do ta këshillonte, po nënë zeza dergjej nën dhë.

Sadeten e kishin pllakosur ca mendime të trishtuara. Që kur qe fejuar e këtej, po e kujtonte më shpesh nënën dhe, herë herë, qante pa zë. Mbi këmishën që ^{cento} binin sumbulla loti, që linin një copë herë mbi pëlhirë një njollë të rrumbullaktë; pastaj loti avullohej, njolla zhdukej, dhe Sadetia, e kapitur dhe e mërzitur, linte këmishën e ngrihej të bënte punë të tjera. Sa më ^{rrë} që lotët zhduken e slënë giurmë: se sikur lotët, që janë derdhur prej kohësh në këtë botën tonë, të duveshin e të mos shlyheshin, sa zor do ta kishim ne, të qeshnim pa merak.

Në kohën e drekës shiu pushoi: veç qìelli rrinte akoma i vrejtur, sikur donte të tregonte se nuk e kishte zbrazur akoma gjithë dufin.

Në derë u dëgjuan të trokitura. Myrtezai, që po qep-te një kapistall, ngriti kokën e i tha së bijës:

— Pa del shiko kush është!

Sadetja la çaropin, rregulloi fundin që ish përthyer pakë dhe dolli përjashta. Kur hapi derën, u step në vënd: përjashta që Raifi. Ai e pyeti i qetë:

— E, moj Sadete, ç'bën?

— Ç'të bëj, mezi iu përgjegj ajo.

— U fejove tani — pshërititi ai.

Sadetja u skuq u bë flakë dhe u mbështet pas derës.

— Po ti kur e kishe me 'të, pse s'më the mua? S'është ndonjë gjë, atë deshe atë more.

— Babai me fejoi; unë s'kisha asgjë me atë; mos të të vejë mëndja...

Raifi heshti si të mos i zinte besë e nuk ju përgjegj.

— Raif! — vazhdoi t'i thotë Sadetja, duke vënë dorën në gjoks dhe u mat të fliste, po në këtë çast i jati thëriti që brënda.

— Kush është, moj Sadete?

— Raifi ka ardhur... — iu përgjegj ajo me zë të lartë.

Mysafiri kapërceu pragun duke përkulur kokën e hyri në çardhak.

— Ku je, o Myrto? — i foli pa hyrë në dhomë — na mbylli në fole ky shiu...

— Na mbylli vallahi, na mbylli, po s'kemi ç'bëjmë se vjeshtë pa shi, e behar pa lule s'ka.

— Ashtu vërtet, po ja që s'na vjen mirë. Ç'po bën ti, po qep, hë? E di nse kam ardhur? Të të kérkoj një çikë atë limën e hekurit.

— Pse, ç'do bësh?

— Do të mpreh kosorin. Jam që jam pa punë, çfarë të bëj, thashë. Kaqë herë më ka thënë edhe nëna, shko na prij ca shelgëtira e na bëj një kofin, se ai i vjetri u bë copë fare.

— S'rri dot pa punë ti. Të njoh unë. Jepja, moj Sadete, atje në dollap e kam vënë.

Raifi mori limën, i shikoi edhe një herë ata sytë në formë bajameje të Sadetes dhe u largua me hapa të rënda.

— Ç'djalë punëtor që është! — tha Myrtezai me vete dhe e hoqi tej kapistallin,

Sadetja e përçollti me sy gjersa ai humbi në të kthyerën e rrugicës, pastaj filloi të merrej me përgatitjen e drekës.

* * *

Sadetja nuk e dinte se për fejesën e saj në fshat po pëshpëriteshin fjalë. Disa ditë pas shpalljes së fejesës, që marrë vesh se Myrtezai paskish kërkuar 60 mijë lekë. Se nga kishte dalë kjo fjalë, ishte zor t'ja gjenje burimin. Disa thoshin: «M'i lumtë Myrtos, se e bëri si burrat, pas zakonit!» Të tjerë e shanin dhe thoshnin se zakoneve të tilla u ka ikur koha e janë poshtëronjëse si për atë që i jep, si për atë që i merr. Të tilla zakoneve u duhej dhënë fund, se gruaja është njeri e as shitet as bilihet,

Myrtezait s'i erdhi hiç mirë, kur dëgjoi se po e gojosen posht' e lart. «Do na gjejë ndonjë bela» mendonte i heshtur.

Dhe një mbrëmje i dolli ajo që priste. Haku, sekretari i organizatës së Rinisë, bashkë me një të ri tjetër nga mëhalla e përtejme, i erdhën në shtëpi. Myrtezai e mori me mënd përsë kishin ardhur, po nuk u dha të kuptionin dhe u mundua t'i priste me buzë në gaz, e sikur të ish gjëzuar nga vizita e tyre.

Përpala të gjithave, Myrtezai largoi Qemalin që të mos i nxirte ndonjë ngatërrresë me atë gjuhën e tij brisk. E thërriti pranë, i tha diçka në vesh dhe ja bëri me shënjë: «Nisu!»

Pas përshëndetieve të zakonëshme, Haku nuk'u mundua ta vërtiste fjalën rrëth e rrëth po ja tha copë.

— E fejove çupën, o Myrteza?

— E fejova — u përgjegj Myrtezai — çfarë të bëja,

tani i erdhi mosha. Ja edhe nevojë kemi, pa s'kishim ç'të bënëm. — Duke folur kështu, i bëri me kokë Sadetes që të delte përjashta.

Hakiu që e vuri re, i tha Myrtezai:

— Jo, jo, s'ka gjë, le të rrijë këtu edhe Sadetja; ne nuk po fjalosemi pér gjëra të fshehta.

— Nuk i duhet asaj të dëgjojë muhabetet e burravet.

— Myrtezai është me të vjetrat akoma, — foli ai i riutjetër.

— Oji, — qeshi Myrtezai, — na fute në të thella tani, o djalë, se s'ta di as emrin.

Ata qeshën të dy, por Hakiu ndenjti i vrenjtur,

— Dëgjo, o Myrteza — i tha me zë të prerë e të fortë, — ne kemi marrë vesh se ti e ke fejuar çupën pa e pyetur dhe i ke kërkuar atij mblesit gjashtëdhejt mijë lekë. Këto gjëra, ti e di më mirë se të gjithë, janë të ndaluara tani.

Myrtezai dëgjoi gjakftohtë si një njeri që e priste prej kohësh këtë gjë. Drodhi një cigare, lagu anën e lëtrës me pështymë dhe foli pa u nxituar:

— I di, mor vëlla, i di Myrtezai këto gjëra, mos ki keq. Ju e kini marrë vesh gabim. S'kini faj ju, se ashtu ju kanë shpuar të tjerët. Unë, o vëlla, nuk e kam fejuar çupën pa e pyetur, se sa ja dua të mirën unë, s'ja doni ju. Ja ku është çupa vetë dhe le të flasë ajo.

Balli i Sadetes u mbulua me djersë. Uli kokën nga që nuk guxonte t'i shikonte në sy dhe u skuq e u bë prush.

— Folë, moj çup' e babajt, a nuk të pyeta unë ty?

Vështrimet e të trevet u drejtuan nga ajo, duke pritur me shqetësim fjalën e saj si deponimet e një dëshmitari me rëndësi në gjyq.

Sadetja përkuli kokën në shenjë pohimi e s'tha asnjë fjalë.

Myrtezai mori zëmër.

— E shikon, ja ku e thotë çupa vetë. Or po ç'fjalë që hapin bota! pse s'shikojnë punën e tyre xhanëm? Dhe sa pér atë fjalën e parave që zure ngoje zotrote, atë ta marrësh prapë, se unë s'kam kërkuar gjë. I di unë edhe zakonet edhe ligjet. Bota shpifin se kanë inat që u fejua çupa ime.

- E ç'inat do tē kenë bota? — pyeti Hakiu.
- Di unë ç'inat kanë? Po ja ku duket. Kështu, o vëllezër, t'i kemi sahanët pa kapak, se unë s'di tē gënjej.
Hakiu s'donte t'i dorëzonte armët.
- Natën e mirë, Myrteza; po na e hodhe, më duket.
— i tha duke dalë.
- Sadetja i përçollti gjer te dera.
- Po ti pse s'erdhe pardje në mbledhje? — e pyeti Hakiu pa pritur.
- S'erdha dot... — iu përgjegj ajo me zë tē mekur, duke ngritur supet për t'u çfajësuar.
- Sadete, eja brënda! — i thirri i ati.
Kur dualën më oborr, Hakiu i tha shokut:
- Kemi bërë një gabim tē madh, o Meti, që lëre mos e nga! S'e bëmë me mënt, por vajtëm si budallenjtë. E ç'prisnim ne tē na thoshte? Edhe shënjtor tē ishte, do gënjenjtë, jo Myrtezai. Tani as që do ta lërë ai Sadeten tē vijë nëpër mbledhje a tē fjaloset me njeri. Pfu! ç'gabim!
- Ndofta bota flasin kot — tha Meti me mëdyshje.
- E, ore, e, me atë mëndje shko ti.

Myrtezai, në shtëpi, e vështronë me admirim Sadeten. Sikur ajo tē kish thënë faqe atyre tē vërtetën, ai do ta kish shtruar në dru a mund ta kish ndjekur edhe nga shtëpia në inat e sipër. Tani që ajo kish gënjer, s'guxonte as ta falënderonte se kish frikë mos shpërthente ndonjë furtunë.

Të dy nuk folën asnjë fjalë dhe sikush u muar me punët e veta.

* * *

Myrtezai pothuaj nuk delte nga shtëpia, kishte frikë mos i ngjante ndonjë ngatërrresë dhe gjithë ditën e kallonte brënda, duke ardhur rrötull kot së koti. Sadetes nuk i bënte zëmra për asgjë, punonte pa qeif, si angari dhe që bërë akoma më e heshtur. Tani mëndja e saj nuk ëndëronte më dhe, shpresë, «kjo motër e mjerimit», s' kish si ta gënjenjtë më tutje. Ajo e kish parë «atë» dhe s'e kish pëlqyer fare, e megjithatë do ta kishte shok tē jetës; me atë do tē treste ëndrat e rinisë, me atë do tē

kapérxente këtë jetë të shkurtër me halle e derte. Sadetja kish ngulur këmbë, si kurrë ndonjë herë, që ta shikonte para se të martohej dhe Myrtezai, deshi s' deshi, u detyrua t'i bënte rrugë së bijës. Caktuan një ditë dhe dualën së bashku e u poqën në qytet. Shyqyri Beliu nuk ishte i shkurtër, sikundër e kish parashikuar Sadetja, ai vinte i gjatë dhe pakë i kërrusur. Kishte një çehrë të vrarë e të verdhë si ata që dalin nga burgu. Në kokë mbante një kasketë me strehë, të cilën e kish ngjeshur thellë, sa mezi i dukeshin veshët dhe Sadetja dyshoi se mos e kishte kokën tullgë. Sa për vjetët, ajo nuk priste ta shikonte të ri, po as kaqë të thyer s' ja merrte mëndja. Ai, pothuajse, iu duk i një moshe me të jatin dhe zëmra iu ndrydh e iu mpi nga helmi i pikëllimit. Goja iu bë farmak, si të kishte një pare bakri nën gjuhë dhe gjithë kohën, sa ndenjën bashkë, s' e hapi gojën. Edhe kur krushku i gostiti në klub me nga një revani, ajo s'vuri asnjë drudhe në gojë. Të gjitha këto krushqit i panë, por nuk u vajti mëndja për të keq; pandehën se nusja e ardhëshme qe e turpëshme dhe e mbyllur dhe për këtë sikur iu bë qejfi. Vetëm Myrtezait s' iu duk shënjë e mirë, po s' e bëri veten dhe, në sy të tyre s' i tha gjë së bijës. U bëri muhabet krushqvet, i ftoi t'i vinin në shtëpi, se tani qenë bërë «der» e pa ndarë», bëri ndonjë shaka pa kripë e hodhi ndonjë thumb, sa ata e pëlqyen shumë dhe si me marifet ja thanë se ai qënkeshe tamam burrë si ata të vjetrit: i zgjuar, fjalëmatur, e me mënd në kokë.

Myrtezai natyrisht u shit më tepër se ç'ishte, sepse ashtu ja donte puna. Në syt e tyre ishte edhe krushk, edhe dhëndër.

Kur dualën përjashta klubit, Sadetes iu duk sikur shpëtoi nga një kafaz, ku e kishin mbyllur dhe e mbanin me forcë.

Myrtezai i hodhi dorën në qafë që ta merrte me të mirë dhe me një zë të butë e pyeti:

— E, moj, e nxore merakun tashti? E pe ç' burrë që ishte? Ta ka qejfi ta kesh në krye të vëndit.

Sadetja nuk i foli.

- Pse s' flet, moj?
— Ç' të flas?
— Po ja, thuaj si t'u duk. S' ke gojë ta shash.
— I mirë qe, — i tha ajo nëpër dhëmbë e paqejf.
Nga fytyra e vrarë dhe e mërzitur e Sadetes ai e kuptoi se ajo kish për të thënë diçka më shumë.
— I mirë qe... — e përqeshi i ati, duke shtrëmbëruar gojën. — Thuaj drejt, pse ndruhesh?

Sadetja qëndroi në vënd e vuri dorën në gjoks. I foli me një zë ku ndihej ngashërimi dhe nië lutje e heshtur:

— Baba!

Myrtezai u drodh e qëndroi në vënd. Prapa kësaj fjale, të thënë me kaqë ngulm, ai e kuptoi se fshiheshin mendime të tjera.

— Baba, ku më fejove kështu?

Myrtezai u përkul më shumë nga ana e saj, i habitur për ato që dëgjonte.

— Hë? — Tha si të mos kish marrë vesh asgjë. Sytë iu ndezën nga një shkëlqim i ftohtë dhe i egër dhe dora iu mblohdh grusht.

— Baba, aman, pse më plagose kështu?

Myrtezai e mblohti veten.

— Moj, a je në vete a po lojte! Ç' flet kështu? Mbylle gojën dhe të mos të dëgjoj herë tjetër të tilla fjalë, se, për Zotin e vërtetë, të ndaj më dysh. Ti e di kur më merr inati mua.

Sadetja mbuloi fytyrën me duar dhe filloi të qante.

— Këmbës t'i bijesh tashti, atë do të marrësh, se ai qe kësметi yt. Nuk turpërohem unë në syt e botës. Dhe një çupë me mënd nuk ja nxin faqen të jatit po e dëgjon dhe i bindet.

Të qe ndonjë çupë tjetër, aty zjarr për zjarr, do t'i kish thënë: «Po, vërtet, se ti ke bërë pazar më 'ta», po Sadetja u ndrojt e nuk tha gjë.

— Oj, të rrita të bëra kaqë dhe tani ma kthen nga myka! — ankohej Myrtezai po gjithmonë me zë të ulët nga frika se mos e dëgjonin bota.

Sadetja, tani, po e shikonte për herë të parë, se zakonet e vjetra i pengojnë prindërit të dëgjojnë të rrata.

hurat e zëmrës së fëmijëvet dhe bëhen shkakëtarë të martesavet fatkeqe e të vrazhdëta. Dhe, si era e ju gës që fryn me shi e lëpin papushim baltën e llaçin, duke i shkallmuar muret ngadalë, ashtu edhe mendimet e saj, po i gryrenin gjykit e vjetra e varfanjake, që kishte mbi botën.

* * *

Në familjen e Myrtezit qe hapur një hendek, i cili, ndonëse nuk dukej, ndihej. Nga njëra anë qenë të fuqishmit Myrteza e Smail — kurse në anën tjetër ndodheshin Sadetja me Qemalin. Dhe shkaku për këtë ndarje qe fejesa. Ajo, që ditën që e kish parë atë, e ndjente zëmrën të copëtar dhe rronte në ankth. Nga dita në ditë po tretej e zbehej. Nganjëherë, bile, arrinte gjer atje sa të mallkonte veten që kish ngulur këmbë ta shikonte.

«Ç'm'u desh që e pashë? Më mirë ta merrja pa ditur gjësendi dhe, si të martohesha, s'kisha ç'bëja; do ta mblidhja veten. Apo mos kushedi ka zëmër të mirë? E ç'zëmër do të ketë ai, moj e mjerë! Si do të dal unë me të për krahu? Kurrë mos ardhët ajo ditë! Ai duket si babai im. Mirë e thotë kënga: «më rrite baba, më rrite, erdhi koha e më shite...» —

«Mos e merr, mos e merr, mos e nxi jetën!» — i fliste një zë përbrënda, po ajo kish frikë ta dëgjonte këtë zë, se i dukej sikur s' qe zëri i arësyesh së saj.

«Si të mos e marr? O Zot, sa turp! Se mos do besojnë bota që e lashë unë? Do thonë: ai e la, kushedi se ç'të metë ka. E kush do vijë të më kërkojë pastaj? Kam frikë se do të mbetem pa martuar.»

Shpesh mendimet e saj shkonin te Raifi.

«Të më kish kërkuar Raifi në shtëpi, kushedi, punët do të kishin marrë tjetër rrugë e s' do të isha futur në të tilla ngatërresa. Sikur të më thotë përsëri: «të dua, unë s' kam hequr dorë prej teje!» Ah! ç' èndëron kot, moj e shkretë, sikur s'ka vajza të tjera!»

Sadetja s' kish me kë të këshillohej: Lotët dhe zëmra e saj i thoshin me ngulm: «mos e merr» po vetëm

kaqë. Ç'vinte pas këtij mospranimi? Si të qëndronte në një shtëpi tok me babanë, që do ta turpëronte në syt' e botës me aqë mospërfillje? Dhe sikur të ikte, ku të vinte? Jo, s' kish çfarë të bënte. Duhej të ulte kokën e të pranonte, pa bërë zë, atë që i kish caktuar fati me dorën e babait.

Një ditë, nga që s'i duronte dot të gjitha këto mendime që e mundonin pa prerë, ja tha Qemalit (Veç punën e Raifit nuk ja zuri ngoje). Ai e dëgjoi me vëmëndje, si burrë i pjekur e pastaj i tha:

— Gjer sa nuk e do, mos e merr. Si mund të rrrosh gjithë jetën me një njeri që s' e do?

Në fillim, ajo i kish folur me zë të ulët, nga frika se mos i dëgjonte kush, pastaj dalngadalë, pa e kuptuar, kishin filluar që të dy të flisnin me zë të lartë. Fjalët e tyre dëgjoheshin fare shkoqur në çardhak, ku Smailli kish hyrë për të marrë një sëpatë, e cila qëndronte varur gjithëmonë aty në një peronë të trashë. Ky, në fillim, as e kishte mëndjen te muhabeti i tyre dhe s'po ua vinte veshin, veç kur tha Sadetja: «Nuk e dua atë, ai eshtë plak», atëherë Smaili u bë kureshtar. U mbështet afér derës dhe e dëgjoi gjithë fundin e bisedimit të tyre.

Qemali: — Ti mos prano. Njeriu duhet të ketë një çikë guxim. Kur të vini për celebrim, në gjendjen civile, e kur të të pyesin: «E do?» thuaj: «Jo, nuk e dua» dhe atëherë prishet fejesa.

Sadetja: — Më vjen turp të them faqe të gjithëvet t'atilla fjalë. Pastaj s'është çudi që celebrimin ta bëjmë pas martesës.

Qemali: — Atëherë thuaji babait ta prishë fejesën.

Sadetja: — Posi, dëgjon shumë babai...

Qemali: — E di ç'të bësh ti, Sadete? Dërgoi një letër gazetës «Zeri i Rinisë» dhe atyre ua thuaj fill e përpe si të ngjau. Atëherë ata pa tjetër do të të ndihmojnë. Kështu bëri një vajzë nga Mirdita.

Sadetja: — S'di si të bëj. Aman, mos i thuaj njëri...

Në këtë çast dera u hap ngadalë duke kërcitur dhe brënda hyri Smaili, me një pamje të rëndë e kërcënognjëse.

— S'është nevoja t'i thotë njeriu, se i dëgjova vetë të gjitha.

Sadetja u zverdh, u bë dyllë dhe e shikoi të vëllanë me frikë si një qëngj i trembur. Ai vazhdonte:

— Bravo të goftë, të tilla mendime paske ti. Tani të erdhën mëntë e mendoke të tilla gjëra. Tani është vonë. Këto t'i kishe menduar e t'i kishe thënë përpara se të gatuhej çorba. Do ja them edhe babait... — pastaj iu kthyte Qemalit — Po ti, mistrec, i mban anën, hë? U bëre dhe ti të japësh mëndje, spurdhjak! Këndon ca libra dhe të duket vetja kushedi se ç'je...

Qemali u ngrit më këmbë. Tani, me që e ndjente veten të fyter, qe gati të bënte sherr që të çfrynte dufin. Prandaj i tha:

— Shiko, me mua i mbaj të pakta, se s'të shkojnë! Smaili bëri «përc» me buzë dhe shkeli njerin sy.

— Aman, ore, mbaj dorën! — i foli me qesëndi.

— Përgjon si ata spiunët...

— Si the? Si the, — çkrofëtiu Ismaili dhe po i afrohej me hapa të ngadalëshme; sytë i lëshonin xixa nga inati e dukej se do ta godiste. Sadetja u ngrit dhe u fut në mes të të dyvet.

— Lere, mos e godit të them! — i tha me të rreptë...

— Hiqu këtej, se s' të duhet ty!

— Mos e godit, të them! — i bërtiti Sadetja dhe e zuri nga duart. — Pastaj u këthyte nga Qemali e i tha: — Ikë ti!

Ai, i shpejtë e i gjëzuar që po shpëton nga druri, kërceu si një keç e u ndodh përjashta.

— Do të të zë unë, s'më shpëton dot nga thonjët! — bërtiti Smaili, pastaj, duke u këthyer nga Sadetja: — dhe për ty do t'i them babait, që të ta rregullojë qejfin...

Ajo i ktheu krahët e nuk i foli.

Në darkë, kur i ati po e ndihmonte të shkarkonte thasët me miell në oborr, Smaili ja tha të gjitha ato që

kish dëgjuar. Bile edhe e qërtoi të jatin po qe se ishin të vërteta fjalët që pëshpërteshin posht e lart se ai kish kërkuar para për këtë fejesë.

— Këtyre gjërat u iku vafti njëherë e mirë, o baba, dhe s' na duhet të futemi në të tilla ngatërresa. E mira do të qe të mos ja jepnim fare atij, se thonë që qënka shumë i thyer në moshë, aqë sa pasqë dhe një çupe në moshë të Sadetes, po, nejse, tani e fejuam e s'kemi q' bëjmë. Po ta ndajmë nga ai s' është çudi që të na mbetet motra në shtëpi pastaj.

Smaili fliste si burrë i pjekur, dhe Myrtezait i erdhi inat, aqë më tepër se të gjitha ato që kish thënë i biri ishin të vërteta. Myrtezai u trondit shumë, po e mbajti veten e të birit nuk i tha as gjysmë fjale. Nuk e kish menduar kurrë se për shkak të atyre paravet, për të cilat hapën fjalë kot, për të fshehur një dumbarallëk më të math, do të bëhej kaqë zhurmë, dhe, or' e çast, mallkonte Eqremi që i kish dhënë këtë mëndje.

Megjithatë nepsi nuk e linte të prapësohej dhe ai ish i vendosur të ecte përpara e ta shpinte punën gjer në fund.

Nga një anë kish edhe frikë, se mos Sadetja, e pakënaqur nga kjo fejesë, thoshte ndonjë fjalë në këshillin e fshatit ose në organizatën e rinisë dhe atëhere do të delnin ngatërresa më të mëdha. Donte ta shpejtonte dasmën, por më përpara duhej të merrej vesh me krushqit, sepse ata duhej të caktuin ditën e martesës. Sidoqoftë, gjersa të vinte ajo ditë, ai duhej t'i bënte sytë katër dhe të tregohej i matur.

* * *

Organizata e Rinisë e fshatit Plakë vendosi të bënte një mbledhje të posaçme për çështjen e Sadetes. Aty do ta thërrisin edhe atë e do t'i luteshin t'u tregonte të vërtetën. Ky do të qe një shëmbull i mirë, si për prindërit që të hiqnin dorë nga të tilla zakone, ashtu edhe për vajzat e tjera. Që Myrteza Koçiu kish kërkuar para dhe, e kish fejuar të bijën pa e pyetur, për këtë ata s'kishtin pikë dyshimi, veç ndruheshin në vallë Sadetja do të kishte guximin të tregonte të vërtetën, se sikur të ngjiste ndryshe, gjithë plani i tyre do të përmbysej.

Për të lajmëruar mbledhjen e organizatës së Rinisë në një fshat të madh e të hapur, siç qe Plaka, përdornin nxënësit e shkollës filllore. Ata, duke u shpërndarë si tufë harabelash, do të lajmëronin vëllezërit, motrat e të afërmit e tjerë. Sadeten e lajmëroi djali i fqinjës dhe ajo me gjësim të madh vendosi të vinte në mbledhje, pa ditur se përse do të bisedohej. Sidoqoftë, ndjente një mall e dashuri të pakufishme për shokët e shoqet e fshatit të saj, me të cilat po ndahej e po u linte lamtumirën. Filloi të vishej me të shpejtë. I ati e vuri re dhe e pyeti:

— Për ku po nisesh kështu ti?

Ajo bëri sikur s'dëgjoi.

— Ty, moj, të them, për ku po bëhesh gati?

— Do vete në mbledhje.

— Në ç'mbledhje?

— Në mbledhjen e Rinisë..

— S'ke punë në mbledhje ti, po rri aty e mos luaj nga shtëpia.

— Si? Të mos vete? — u kthyte ajo me fytyrë nga i ati.

— Të mos vesh, pos! S'do vesh ti dhe u bë qameti!

Sadetja iku duke turfulluar në dhomën tjetër që të çvishej. Myrtezai ndezi një cigare dyke marrë një thën-gjill me mashë dhe u shtrua këmbëkryq pranë zjarrit.

Pas ndonjë ore, në derë u dëgjuan të trokitura e Sadetja u mat të delte. I ati i bëri me shënje që të qëndron-te.

— Prit, mos del ti, se do dal vetë. — hodhi pallton krahëvet dhe doli duke çaluar nga që i ish mpirë një këmbë.

Te porta kishin ardhur tri vajza të një moshe me Sadeten. Njëra — një flokëverdhë e lezeçmë — e pyeti:

— Brënda është Sadetja? Thuaji të vijë në mbledhje se po e presim...

— Sadetja është e sëmurë e s'vjen dot...

— Vërtet? — pyeti ajo e habitur — po ne si s'e pas-kemi marrë vesh? Ejani të vemi ta shikojmë, — u tha të dy shoqevet që kishte në krahë dhe i zuri nga duartë.

Nga frika se do t'i delte gënjeshtra në shesh, Myrtezai nuk luajti nga dera e nuk u hapi rrugë. Rrudhi vetullat dhe lëpiu njérën anë të mustaqes.

— Pse, doktorë u bëtë ju që do vini ta shikoni?

Të tria vajzat u stepën dhe menjëherë e kuptuan hiljenë. Asaj leshverdhës nuk iu durua.

— Pse thua éshtë e pamundur, thuaj më mirë s'dua ta lë të vijë në mbledhje...

— Edhe atë e them, pse, mos kam frikë, a? S'ka punë ajo me ato mbledhjet tuaja. Ajo éshtë e fejuar tashti.

Vajzat ikën duke murmuritur diçka nëpër dhëmbë. Kur po delnin nga dera e oborrit, u gjendën ballë për ballë me Qemalin, i cili atë çast po kthehej nga shkolla shtatëveçare e qytetit.

— Ja, këtë merrni në mbledhje! — u foli Myrtezai.

Ato se ç'i pëshpëritën atij në vesh dhe Qemali la çantën e libravet e iku pa ngrënë drekë.

* * *

Mbledhja e priti me mërmëritje lajmin, se Myrtezai nuk e kish lejuar Sadeten të vinte aty.

Në rendin e ditës qe vetëm një pikë: «Martesa dha familja në pushtetin popullor! Siç shihet, titulli qe shumë i përgjithshëm e teorik, po Hakiu i ra shkurt, siç e kish zakon. Tha nja dy fjalë, sa për të hyrë në temë e pastaj ja filloj:

— Organizata jonë éshtë njollosur me një turp të madh. Ju e dini fare mirë se Sadeten, e cila éshtë anëtarë e organizatës sonë, i jati e ka fejuar pa e pyetur me një burrë që deshi ai vetë. Dhe për fejesën thonë se i ka kërkuar dhëndërit një sasi të hollash. Ai ka vepruar sipas zakonevet të vjetra, por edhe ne nuk jemi pa faj në këtë çështje. Ne nuk i dhamë rëndësi, nuk qemë të zotët ta paralaimëronim me kohë. Sadeten është dinte si të vepronte. Të tierët do thonë, dhe jo pa hakë, mashallah! ç'i edukoka organizata e rinisë!»

Hakiu ishte nxehur dhe fjalët i delnini pa pengesë, sikur t'i kishte shkruar në letër. Tregoi edhe budallallë-

kun që kish bërë, duke vajtur me Metin në shtëpi të Myrtezait.

Pas tij e mori fjalën Qemal Koçiu. Ai, pa u ngutur, tregoi se si qëndronin punët. Foli edhe për bisedën që kish bërë me Sadeten e më në fund, i papërmbajtur nga vrulli djaloshar dhe nga dashuria për të drejtën, foli atë që i donte zëmra atij:

— Por ajo nuk e merr atë, sepse ai është shumë i kalluar nga mosha. Ajo ka vendosur të ndahet.

Këto fjalë të rinxjtë, të ndezur nga afshi i diskutimit, i pritën me duarrokite, duke e ndjerë se nderi i organizatës po vihej në vënd dhe se Sadetja, me këtë gjest, po bëhej një shëmbull shumë i mirë edhe për vajzat e tjera, që mund t'u ndodhnin këso punësh.

Por, mjerisht, fjalët e Qemalit qenë tepër të nxituarë dhe të pasakta, pasi Sadetja s'kish vendosur asgjë dhe s'dinte në ç'rrugë të ecte: në atë që i tregonë babai dhe morali i shoqërisë së vjetër, apo në rrugën tjetër, që kish filluar t'i pëlqente asaj vetë. E ndjente se kjo e dyta i pëlqente më shumë, mirëpo a ish e zonja ajo t'i kundërshtonte babait?

Fjalët e Qemalit, në mbledhje, Raifi i mori si krejt të vërteta dhe iu drodh zëmra nga gjëzimi. Iu duk se edhe ajo e donte dhe ndofta shkaku kryesor që do të ndahet nga ai tjetri që dashuria e Raifit. Ah sikur të ishte këshfu! Raifi dyshonte akoma dhe e hante meraku se mos ajo donte ndonjë djale tjetër dhe ky s'kish marrë vesh gjë. Por jo, nuk ish e mundur. Ajo vetë a nuk kish dashur t'i thoshte diçka atë ditë që i vajti për t'i kërkuar limën? Tani Raifit iu kujtuan të gjitha: Sytë e saj, në formë bajmje, me atë vështrim të ndrojtur e të turpshëm, zëri i saj që dridhej prej emocionit, dhe keqardhja që nuk mundi të fjaloste.

Doli nga mbledhja me shpresë të ngrohta e, duke iku, mendohej të gjente rrugët për t'u takuar me Sadeten.

* * *

Tani, në këtë pikë që kish arritur puna, Raifi as mbles nuk mund të dërgonte e as vetë nuk mund të vinte.

Të gjitha gjérat i dukeshin sikur endeshin në një mjer-gull: Sadetja s'qe as e ndarë, as e fejuar; ai dinte se e dashuronte, por nuk ishte i sigurtë në vallë dashurohej.

Nuk i vinte mirë të priste rrjedhjen e ngjarjevet duarkryq: Vërtet qe pak i ngadalshëm, tipi i njeriut fleg-matik, por kur e vendoste për një gjë, do bënte çmos që t'ja arrinte qëllimit. Veç këtu kish mbetur më ngushtë nga ç'e kish menduar. Donte ta takonte edhe një herë Sadeten, por ajo pothuaj se nuk delte fare përjashta. I kish shkruar nja dy letra e ato i kishin mbetur në xhep, se s'kish më kë t'ja dërgonte. T'ia jepte Qemalit, kish frikë se ai nuk do pranonte t'i shpinte letra së motrës e t'i futej një ngatëresë të tillë, që s'dihej ku e si përfundonte.

Një ditë, i pikëlluar, po i mendonte këto në vreshtë. Aty përnjéherësh, kur po hante rrush, i ra ndër mënd një gjë shumë e thjeshtë dhe praktike. Sikur t'i dërgonte asaj disa veshulë rrushi? Rrushi s'është letër dashurie e s'bie në sy, por nga ana tjetër a nuk do të qe një nishan për t'u marrë vesh?

Këputi disa veshulë rrushi, më të mirët e vreshtës, i futi në një qeskë prej letre dhe priti Qemalin sa të kthej nga shkolla.

— Qemal! — i thërriti — na, jepja Sadetes këta rrush.

— Pse? Ne kemi vetë rrush... — ja ktheu ai.

— Kini, por jo kaqë t'ëmbël sa të vreshtit tonë, — qeshi Raifi — jepja kur të thonë!

— S'dua t'ja jap, — kundërshtoi ai.

Dora me qeskën e rrushit mbeti e zgjatur për turp.

— Mos ja jep — ja ktheu Raifi, sikur të mos i kishin bërë përshtypje fjalët e Qemalit — ajo vetë i ka kërkuar.

— Ashtu thuaj — u zbut Qemali, të cilit as i vajti mëndja te gënjeshtra e lezetëshme e Raifit — nëmi këtu atëhere, se do t'ja shpie.

Qemali iku. Raifi mori rrugën e shtëpisë. Shtëpia e tij qe në një vënd pakë të ngritur. Nga an' e veriut kish një kopësht të madh, të cilin e mbillnin me zarzavate e me patate. Nga rruga që shkonte përmes fshatit Plakë, degëzonte një ulicë e ngushtë, e cila më të dy anët kishte ca mure të lartë. Kjo rrugë sikur të qe nja gjysmë metro

më e ngushtë dhe e pashtuar me kalldrëm, nuk do të kishte asnjë dallim nga llogoret që ndërtojnë ushtarët. Raifi e kish shumë zët këtë rrugicë; në behar, kali, i ngarkuar me duaj, mezi shkonte dhe anët e mureve mbanin taksë-kalimi: kallëza gruri, thekri e tershëre. Sa herë u që lutur të zotërve të aravet t'i ulnin muret e ta zgjëronin rrugën; po ata s'pranonin se kishin frikë mos u hyrin bagëtitë e u bënin dëm. Kjo rrugicë të nxirrte në oborrin e Raifit.

Riafi nuk rrinte dot pa punë nga gëzimi e nga shqetësimi që ndjiente. Filloi të thurte kofinin që kish lënë përgjysmë dhe, pas ndonjë ore, e mbaroi. E shkuli nga dheu e ja tregoi nënës.

— Na, se më bëre rezil — i tha me të qeshur — shiko sa të mirë e kam bërë.

— Të lumshin krahët, o djalë, të florinjtë m'i ke duart, veç nusja të mungon — ja ktheu eëma.

— Do ta gjejmë edhe atë — foli duke psherëtitur Raifi e hodhi sytë nga shtëpia e Myrteza Koçiut.

* * *

Myrtezai qysh atë mbrëmje që mori vesh se ç'mendonte Sadetja, në vënd që të sillej ashpër e t'i fliste rënëdë, ashtu siç priste Smaili, filloi të sillej më butë se kurdoherë tjetër. Sadetja e kish vënë re, po nuk ishte në gjëndje ta kuptione shkakun e këtij ndryshimi. Ndonjëherë i vinte mëndja se tani që po afronte koha e marte-sës, i ati nuk donte t'ja prishte qejfin që të mos ndaheshin me zemër të thyer. Ndonjëherë tjetër dyshonte se mos babai e ndjente që kish vepruar gabim e tani me heshtjen e tij i thoshte: «Unë, si plak, e bëra këtë gabim; ti je e re dhe i kuption më mirë gjërat; bëj si të duash, se unë s'të them gjë».

Të gjitha këto qenë vetëm ëndëra. Myrtezai s'dinte ta shkelte fjalën e dhënë. Fjala fjalë e burri burrë. Atij i kish rënë në vesh se përsë qe bërë mbledhja e rinisë dhe lavdëronte Krishtin e Muhametin që u ndodh në shtëpi e nuk e la Sadeten të vinte atje. Sikur të kish vajtur ajo në mbledhje, kushedi se ç'rrugë do të kishin marrë punët. Pat marrë vesh edhe fjalët rebelonjëse të Qemalit dhe

kish ndjerë se si i që nxehur trupi e i hante dora që t'i jepte një dru të shëndoshë, mirépo, që ta rrihte pér atë shkak, nuk guxonte se kish frikë mos maiseshin më keq punët. Priti të gjente ndonjë shkak tjetër e ta rrihte më gur në thes. Dhe shkakun iu duk se e gjeti kur një ditë Qemali u këthye nga shkolla me një qeskë rrush ndër duar.

— Ç'i ke ata? — e pyeti Qemalin sa po hyri brënda. Në tonin e zërit të tij ndihej dëshira pér të ndezur sherr.

— Rrush. — Iu përgjegj Qemali fare i qetë.
— Ku i more?

Qemali nguroi dhe u mat t'i thoshte që ja kishin dërguar Sadetes, po menjëherë i shkoi mëndja, se ajo mund t'i kish kërkuar fshehurazi, pa ditur gjësendi Myrtezai. Me sytë ulur përdhe, iu përgjegj:

— Në pazar.

— Po pse, s'kemi rrush ne? — bërtiti Myrtezai i inatosur dhe e vështroi të birin egërsisht.

— Kemi, po këta janë më të mirë.

— Më të mirë? — këlthiti i ati duke u ngritur në këmbë. Ta tregoj unë ty, sa të mirë që janë. Kështu i bën paratë që të jap unë? Rrush e kumbulla, hë? — dhe fap! ja ndezi turinjvet me pëllëmbë. Qemalit i shpëtoi qeska nga duart dhe me t'u përplasur në dysheme, u çà. Kokrat e rrumbullakta të rrushit u shpërndanë si rruzujt e en-gjërdhisë më të katër anët.

— Ke fituar ndonjë lekë ti që i prish paratë kështu?
— gjëmonte i ati dhe e godiste.

Sadetja me Smailin që u ndodhën brënda në dhomë, u habitën nga kjo sjellje kaqë e ashpër e të jatit dhe me frikë në zémër prisnin sa të mbaronte rrebeshi. Myrtezai që nxehur tej masës, e kishin zënë ato të tiat, siç thoshte ai, pasi njera anë e mustaqes i dridhej pa pushim. Smailit i erdhi keq pér të vëllanë, aqë më tepër se iu duk sikur i ati po e godiste kot, prandaj u ngrit dhe me një guxim të paparë, ja zuri krahun në erë të jatit.

— Ç'bën, ore, je në vete ti? Lëre, se t'i jap unë ato njëzet lekë! — e sytë i lëshonin xixa nga marazi. — As hajvani s'goditet kështu!

— Ja të bëhet, ja të mos bëhet fare. Kështu si është, nuk e dua...

Myrtezai nuk qëndronte dot në dhomë. Mori pallton, e hodhi krahëvet e doli në oborr duke turfulluar. Sadetja shkoi me të shpejtë afër Qemalit, u përkul mbi të dhe filloj i përkëdhelë me dashuri flokët dhe qafën.

— Të rrahu shumë, o xhan i motrës. Ngreu, ngreu, mos qaj, hajde të tē shpie në dyshek. Ajo e zuri nga duart dhe iu lëndua zëmra, kur ndjeu mbi dorën e saj lotët e nxeh të Qemalit. Dukej se ai donte të qante akoma, nisi nuk po luante vëndit:

— Lermë, mirë jam këtu...

Smaili u kujtua se kish për të çarë dru e doli nga dhoma, duke i hedhur një vështrim të mallengjyer Qemalit, supet e të cilit po dridheshin nga ngashërimet.

Qemali e mblodhi veten, kur pa se, përveç tij e Sadetes, nuk gjindej tjetër njeri në dhomë. Çudi është, por menjëherë pas të qarit kemi nevojë të qeshim, dhe kjo të shumtën e herës shkaktohet kot fare.

— I zi, i zi, si je bérë! — i tha e motra e filloj të qesh-te, po njëkohësisht, nga që i vinte keq, i duallën edhe lötë.

— C'qesh ti, moj.? — e qërttoi ai i zemëruar e zuri të qeshte edhe vetë — se për ty e hëngra këtë dru, më duket.

— Pse për mua? — u çudit Sadetja.

— Ja, për ata rrushtë që kishe kërkuar ti.

— Unë kam kërkuar rrush?

— Ti, po kush! Bën edhe sikur s'e di. Unë rrushtë s'i bleva në pazar, m'i dha Raifi për ty...

— Ah! — i shpëtoi një tingull habie Sadetes — Ra-i fi, — tha ngadalë.

Sadetja uli kokën dhe ndënji e menduar. Nuk i beso-hej ajo që po dëgjonte.

— Si nuk i tregove babait?

— Nuk i tregova se do ta pësonim të dy, kështu, të paktën, e hëngra drurin vetëm unë. Pastaj se mos më rrapuh për rrushtë e se mos i erdhi keq për njëzet lekët atij;

më rrahu për atë mbledhjen e rinisë... e dija unë që ma kish bërë benë e donte të më gjente rastin, po s'ka gjë,

Megjithse qe mundur, ai e ndjente veten hero dhe zë-mra i rrihte gjithë gas. Së fundi kish bërë edhe ai një sakrificë të vogël, dhe ajo që e gëzonte më shumë ish se këtë e kishte bërë jo për veten e vet po për një tjetër. Ky njeri, në këtë rast ish e motra, po ai e ndjente se po këtë gjë do të bënte edhe po të ish një tjetër në vendin e saj.

Kush hahet dot me krenarinë e të vegjelvet, kur ata arrijnë t'i dalin mbanë ndonjë pune të vështirë? Një krenari të tillë ndjente edhe Qemali në ato çaste.

* * *

Sadetja ndjehej e lumtur se shpresën e saj s'e kishte ushqyer më kot. Ai vazhdonte ta donte si më përpara e të mendonte për 'të. Dhe kjo asaj i derdhej në shpirt si një ballsam shëronjës. Shpirtin ia kishin pushtuar ndjenja të ëmbëla e freskonjëse dhe ç'do gjë i dukej gjithë drithë. E ndjente veten të lehtë e të lirë si zog. Mund të hidhej nga kali, ku i jati e kish hipur pa vullnetin e saj dhe s'kishte më frikë se binte në batak. Tani, krahët e fuqishëm të Raifit e prisnin me dashuri.

Kur dy të rinj dashurohen e gjejnë mënyrën si të meren vesh qoftë dhe sikur të janë qindra kilometra larg, qoftë edhe sikur të tjerët t'i ndalojnë a t'i përgjojnë. Raifi, mbasi mori guxim nga queska e rrushit, i dërgoi Sadetes një letër të shkurtër me vajzën e vogël të një komshije. Në këtë letër të shkruajtur qartë me gërma rrumbullake e të mëdha, ai i çfaqte hapur dashurinë e tij.

Sadetja u çel e u gjallërua si përpara fejesës. Punon-te duke kenduar dhe rrathi i zi që kishte nën sy, shenjë e lodhjes dhe e pagjumësisë iu zhduk si me magji. E nga sytë nuk i delnin më lotë po shkëndija gëzimi e hareje.

Dhe një mbrëmje ata u takuan të dy.

Sadetja sa kishte qejf aqë kishte dhe frikë. Duke vënë dorën në gjoks e duke shikuar rrotull i tha:

— Unë s'e marr dot me mënd si do vejë kjo puna ime tashti.

— Mos u bëj hiç merak — i jepte zëmër Raifi. — Ti atë s'e merr njëherë...

— Më mirë varrin se sa atë! Mbaroi ajo punë tanë, ç'ma përmënd.

— Atëhere ne do të përfundojmë së bashku. — Ai e kish përdorur kastile fjalën «do përfundojmë», se i vinte gjyç dhe iu duk'e turpëshme fjala martesë.

— Si do përfundojmë? Babai im s'bindet.

— Ç'ke me babanë ti, të marr unë në shtëpi dhe merr fund puna...

Sadetja e shikoi sikur t'i kërkonte mëshirë e duket se nuk i pëlqyen fjalët e Raifit.

— Jo, jo ashtu se është turp. Do thonë bota u rrëmbye. Më mirë t'i themi njëherë babait.

— Kush t'i thotë babait? Unë mbles s'dërgoj dot; kjo është punë që s'bëhet, se do ta thotë: «një çupë që kisha e fejova, tjetër s'kam;» e s'do t'i qasë fare në shtëpi. As vetë s'mund t'ja them, se kushedi si e merr...

— Atëhere do ja them unë — tha Sadetja e vendosur. Raifi tundi kokën me mosbesim e pëshpëriti:

— Kot!

— Pse, kot të duket ty?

— Kot më duket, moj shpirt — i tha Raifi dhe, duke e shikuar drejt në bebzëzën e syrit, zgjati dorën dhe e zuri prej llëre. Sadetja e vështroi e trembur dhe iu lut me një zë të butë e përmallonjës.

— Mos, mos Raif, aman se na shikojnë.

Raifi as i dëgjoi fare këto fjalë. Ai i zuri dhe krahun tjetër, pastaj e tërhoqi dhe e mbërtheu në gjoksin e tij.

Ajo ndjeu se gjithë trupi iu drodh e iu telekos si nga një lodhje e pakuptuar dhe e la veten krejt të lirë në duart e tij. Raifi e puthi në gushë dhe, duke ndjerë flokët e saj që i gudulisën fytyrën, u deh dhe pastaj ja ngjiti buzët me afsh në sy, në faqe e në buzë.

N'ato çaste qe gati ta merrte në krahë e ta shpinte gjer te ajo korieja atje tej, ku fletët e dashkut kishin marrë ngjyrën e bakërit.

— Aman, lërmë se na shikojnë — i foli ajo, duke e larguar Raifin me duar.

* * *

Sadetja nuk donte t'i shtynte punët e të torturohej përditë, duke menduar q'do t'i thoshte të jatit e si do t'i përgjigjej ai. E kish vendosur t'ja thoshte që atë mbrëmje.

Myrtezai kishte planet e tij. Duke u sjellë me butësi e me takt, do të vinte një ditë që Sadetja t'ja thoshte me gojën e saj ato që mendonte.

Dhe vërtet ai s'u gabua: i dolli ajo që priste:

— Baba! — i tha ajo, duke mos guxuar ta shikonte në sy, — do të të them një fjalë, që e kam mbajtur të kyçur gjer tashti.

— Posi jo, moj çup e babajt, thuaje ti, pse ta mbash fshehur.

— Ndamë nga ai! — iu lut ajo me përunjësi. Smaili e Qemali hapën sytë të habitur dhe shikonin me frikë si do xhindosej i ati.

Sadetja priste e shqetësuar përgjigjen e të jatit dhe e shikonte në sy si qeni të zonë.

— Hëm — përdrohhi buzët e trasha Myrtezai — po këtë sikur e ke thënë pa menduar, më duket. E si të ndakër-kam? Pse, q'bëjmë, lozim mikezira? Jo, moj çupë, mos mendo të tilla turpe...

— Aman, baba, si do rroj unë me 'të e q'nusëri—zezë do shkoj unë?

— Si gjithë bota — iu përgjegj i ati me të butë — pse veç botës kérkon të bësh ti? Dhe për të dashur, do ta duash ti atë, sa nuk do ta këmbesh as me më të bukurin e dheut. Shorti duhet shumë. Këtë e thonë të gjithë.

— Duhet shorti, kur e njeh e jo si unë që s'i kisha dëgjuar as emrin më përpëra. — Sadetja habitej se nga i kish ardhur gjithë ky guxim që të bisedonte me të jatin si me një shoqe të saj.

— Uuu! — lëshoi një tingull habie Myrtezai — për këtë ke keq ti? Vjen dashuria pas martesës e çfarë dashuri, njëqind herë më e mirë se ajo që bëjnë këta të rinjtë ferravet.

Sadetja tundi kokën. Smaili seç i tha në vesh Qemalit.

— Mbaroi ajo punë tashti. Ti, po të doje — i ati i fliste akoma me zë të butë e të dashur — më thoshje mua: «Baba, unë do të martohem **me dashuri**» dhe unë pastaj ta **hiqja kapistallin e të lëshoja azat pazarit**. Atëherë të bëje që të të donte qejfi e të mos pyesje më as pér baba as pér vëllezër.

Sadetes iu dukën të drejta ato që i tha i ati, po kjo zgjati **vetëm një çast**. «Jo, jo, tha **me vete, unë s'e marr Shyqrinë».**

— Nuk më hyri në zëmër, — i tha gati më të qarë — Kot!

— Moj, akoma ti! — bërtiti Myrtezai e ana e mëngjér e mustaqevet filloj t'i dridhej — kujt i flas unë?

Myrtezai qe i sigurtë se do të ishte në gjëndje t'ja mbushte mëndjen me të mirë Sadetes dhe ta kthente në rrugën që atij i dukej e drejtë. Si baba që ishte, ai do ta bindëte dhe punët paskëtaj do të shkonin pér bukuri, mirepo tani e pa se po i delte ndryshe. Këtë ai nuk e prishte.

— Atë moj, atë, do të marrësh! Atë që të jap unë, se ndryshe ta vë kokën në kërcu e ta pres me sëpatë! — bërtiti me inat. — Nuk turpërohem unë pér qejfin tënd; more vesh apo jo? Dhe mos të të shkojë ndërmënd të na bësh ndonjë të pabërë, se unë s'të lë të gjallë... ja kësh-tu...

Sadetja mbuloi fytyrën me duar dhe iku në dhomën tjetër.

— Ki keq pér çupa pastaj... tha Myrtezai si me vete të tij.

— Mirë thotë, — tha Smaili. — Tani mori fund puna.

— Pse thotë mirë? — kundërshtoi Qemali.

— Pusho ti, jezit, se nga ti na erdhën të gjitha këto iu shkreh Myrtezai, duke përpjekur mashën në gurin e oxhakut. Nga ti, edhe nga ajo mbledhja jote atje në rini; Dhe atë drurin që hëngre, s'ta dhashë pér lekët që prishe, po pér fjalët që the atje...

«Bobo, do ta rrähë prapë», mendoi Smaili.

— Folë de, pse s'flet!

Smaili e cëmbidhi fort në kofshë të vëllanë. «Shëët! — ja bëri ngadalë, — mos kthe fjalë!»

Smaili e Qemali filluan të hanin darkë në heshtje. Myrtezai, i nevrikosur, nuk deshi të hante, u kuspullos pranë oxhakut dhe, duke shikuar flakët e zjarrit, piu duhan një copë herë të gjatë. Diç bluante në mëndje.

Njohja nga Zgjalja * * * Dhe Përvizet.

Nëndori qe më të dalë. Edhe natyra edhe qielli, edhe pemët tregonin se dimri po afrohej. Qielli qëndronte i vrënjtur me ditë të téra; dhe dielli në këto ditë mezi arrinte të hidhte ndonjë vështrim të shkurtër mbi tokën sa për t'u çmallur. Binte një shi i imtë, i cili, me pamjen e zymtë që i jepte natyrës, ta trishtonte shpirtin.

Mëngjezevet, kur netët qenë të kthjellta e të ftohta, fushën e mbulonte një brymë e trashë dhe në vendet, ku s'e rrihte dielli e s'e hante juga, bryma mbetej gjithë ditën e ngjante me ato njollat e dëborës që mbeten më të hyrë të pranverës. Bari i shkurtër i luadhevët, i njomur nga shiu, kishte marrë një ngjyrë të gjelbërt të celur. Fundi i vjeshtës me fillimin e pranverës ngjasin shumë, si dy motra binjake. Të dya këto stina janë lajmëtarë të lulevet: njera e «luleve të bardha» dhe tjetra e luleve të natyrës.

Sadetja e hodës dyshimin e fundit se puna mund të rregullohej me të mirë, qysh atë mbrëmje kur bisedoi më të jatin. S'kish q'të shpresonte më e s'kish kujt t'i lutej. Ato shoqet, të dërguara nga ana e organizatës së rinisë, i kishin dhënë zëmër dhe i kishin futur disa mendime kryengritëse. Nuk i kishte hije Sadetes, që të sakrifikonte të ritë e veten e saj për hatër të zakonevet të këqia. Jo, le të ngrihej dhe le t'u bënte ballë me trimëri, të gjithë do ta përkrahnin, të gjithë do t'i jepnin dorën. S'kish pse të ndruhej: Raifin e kishte në krahë dhe kjo i mjaftonte për të hedhur atë hap të vështirë në jetë. Vendosi të ikte nga shtëpia.

Kur ja thaq tek arra për herë të parë këtë mendim. Raifi, asaj i qe dukur i pazbatueshëm dhe jashtë fuqive të veta, po tanë, si një njeri i rrëthuar, kur e di se gjithë shtingjet janë të zëna prej armiqvet, bën rrugë pa rrugë dhe ecën nëpër skërkë, të cilat më përpara do kish frikë edhe t'i enderonte.

Tre javë para se të martohej me Shyqriun — atë ditë që e hënë — ajo veshi një fustan të ri, u kreh përpara pas-qyrës, zbrazi gjymet dhe u mat të delte nga dera.

— Ku vete? — e pyeti Myrtezai.

— Në krua — iu përgjegj ajo, duke e shikuar me frikë.

— Po pse je veshur kështu si pér të kremte...

— Kot... provova këtë fustanin...

— Mos u vono shumë! — e këshilloi ai pa e shikuar në fytyrë.

Po afronte dreka. Në qìell fluturonin ca re, si togje pambuku të krehura e të pastruara me kujdes.

Te kroi Raifi vej e vinte i shqetësuar. Sot e kishin lënë ditën që ta rrëmbente e ta shpinte në shtëpinë e tij. Ai herë pas here vinte dorën si strehë mbi ballë e shikonte nga shtëpia e Myrtezait. Më në fund e pa Sadeten tek po vinte me gjyme.

Atëhere pshërëtiti, i lehtësuar, si pas një rruge të largët dhe sytë i shkrepëtitën nga gëzimi.

— Ç'ke që dridhesh? — e pyeti.

— Më vinë si ethe...

— Ti u vonove... e unë thashë ç'i ngjau kësaj...

Ajo shikoi rrëth e qark e nuk iu përgjegj:

— Se si më vjen... më duket sikur kam frikë... — i tha pas pakë:

Ai ju afrua dhe i zuri dorën. E shikonte me afsh në ata sytë në formë bajameje dhe buzëqeshte me ndruajtje.

— Kur jemi tok, pse të kesh frikë?

— Jo frikë, po s'di si të të them...

— Hë, se të kalon... Të pa njeri kur ike?

— Më pa babai e më porositi të mos vonohem. — Sadetja pa e kuptuar, filloi të mbushte gjymet me ujë, sikur

do tē kthehej nē shtëpi. Pastaj u habit edhe vetë. — Uh! po unë ç'bëj kështu?

— Eja, eja tē ikim — i tha Raifi dhe e zuri pér krahu — nē shtëpi po na presin... pse ke turp?

— Aman si më rreh zemra, pa vër një çikë dorën, — i tha ajo.

Raifi i vuri dorën nē anën e mëngjér tē gjoksit dhe s'i dëgjoi hiç tē rrahuat e zemrës. Ai ndjeu nē dorë vetëm formën e gjirit tē butë e tē ngrohtë.

Sadetja, e tronditür dhe e zverdhur, mezi i hodhi hapat e para. I qenë prerë gjunjët dhe pengohej nëpër gurët.

— Do tē vij me ty, kudo që tē më shpriesh... — i tha duke e shikuar nē sy.

Në rrugë duallën nja dy gra. Ato e kishin pikasur kë-të skenë dhe tanë që i panë tē zënë krah pér krahu, nē mes tē ditës, duke shkuar drejt shtëpisë së Raifit, e muarën me mënd si qëndronte puna.

Sadetja, e mbështetur pas krahut tē Raifit, ktheu edhe një herë kokën nga shtëpia e babait, si pér t'i thënë lamtumirë vajzërisë dhe u nis.

Pas tyre, si roje pér çdo tē papritur, ecte një kushëri i Raifit, një djalë i fuqishëm e fytyrë—rrumbullak.

Në çezmë mbetën vetëm gjymet e Myrtezait; gjymet qenë mbushur me kohë e tanë ujët po lëpinte sipërfaqen e lëmuar tē metalit të tyre.

* * *

Gratë, që i kanë aqë qejf fjalët dhe sehiret, vajtën me tē shpejtë te shtëpia e Myrtezait dhe trokitën nē derë.

— Myrteza! — thërriti njëra prej tyre — dil një çikë këtu!

Myrtezai doli ngadalë me një pallto shajaku hedhur krahëvet.

— Tët bijë ta rrëmbyen! E rrëmbeu djali i Riza Ba-shollit — i tha ajo me një zë gazmor e gjithë naze, sikur t'i jepte ndonjë sihariq.

— Hë? — ja bëri ai nga që s'kuptoi gjë.

— Jot bijë u rrëmbye, me djalin e Riza Bashollit... dëgjove? — i foli përsëri ajo shkoqur e ngadalë.

— C'thoni, moj, ju vraftë një rrufe! — mallkoi Myrtezai dhe u prapsua, sikur të kishte përpara një gjarpër. Palltoja i ra nga krahët e, duke u përplasur në tokë, ngriti një re pluhuri. — Kur m'a bëri këtë hata?

— Ja tani s'ka një çerek ore. Meri edhe gjymet se të mbetën në krua.

— Ah! — ja bëri Myrtezai më tepër me gërmaz se sa me gojë dhe gjaku i hipët në kokë. Sytë i çakariti si prej të çmënduri, dhe ngriu në vënd për disa sekonda. Tani as shikonte as dëgjonte. Pastaj, sikur ndokush ta kishte shkundur me forcë, u hodh prapë dhe u kthyesh me vrap në çardhak. Aty rrëmbeu sépatën që ishte varur në mur dhe, duke shkelur mbi pallton, doli përjashta kokëvarur e i kërrusur si një ujk. Qe zverdhur, që bërë limon, dhe vetëm në mollëzat e faqevet i kishin mbetur dy vurrata të kuqe, si të sémurëvet me ethe tuberkulozi.

Nga dritaret e shtëpisë së Raifit e panë tek po vinte dhe u trembën.

— C'patët? — pyeti Rizai, kur ndjeu murmuritje shqetësonjëse nëpër dhomë.

— Po vjen Myrtezai... — iu përgjegj Raifi.

— Myrtezai? Krushku? Po dili përpara, c'pret?

— Më duket se ka një sépatë në dorë.

— Sépatë, the?

— E, sépatë...

— Oj — bërtiti Rizai, Këtë gjë s'e prisnin dhe se si do të përfundonte kjo punë, tani asnjeri s'e merrte dot me mënd.

— Hajde t'i dalim tok përpara! — e urdhëroi Rizai.

'Pas tyre doli edhe ai kushërirri.

Në oborr, Rizai shikoi me sy të çakërdisur se çfarë mund të merrte në dorë që t'i bënte ballë. I vajtën sytë te kofini, të cilin e kishin lënë të thahej në diell. Përnjëherresh atij i shkrepit një mendim. Në raste kritike mëndja e njeriut punon me një aftësi të jashtëzakonëshme.

— Raif! merr shpejt atë kofinin dhe dili përpara. Ai do të mundohet të të goditë me sëpatë; ti ngrih kofinin përpjetë dhe mos e lër. Hic s'ka ç'të të bëjë!

Raifi rrëmbeu kofinin, e vuri përpara si përkrenare dhe u sul.

— Del ti nga ajo anë! — urdhëroi Rizai të nipin dhe, ndërsa Raifi me kofinin përpara ecte në rrugicën e ngushtë, këta dy të tjerët shkonin matanë kthisit, një më të mëngjér e tjetri më të djathtë, sikur do të bënin ndonjë rrethim.

Në mes të rrugicës së ngushtë, Raifi u ndesh ballë për ballë me Myrtezanë. Vështrimet e tyre plot egërsi u kryqëzuan si thika.

— Ti ma bëre këtë turp, o i poshtë! — shau Myrtezai nëpër dhëmbë.

— Hidhe sëpatën poshtë! — i bërtiti Raifi.

— Sëpatën s'e hedh, or, jo... Sëpatën e kam për ty e për atë... — dhe duke thënë kështu e ngriti përpjetë me shpejtësi vetëtime.

— Afrohu! Mos e lër të të goditë! — dëgjoi një zë Raifi dhe e kuptoi instiktivisht se ky qe zëri i të jatit. Raifi bëri një kërcim përpara sa trupi i tij edhe për pakë preku Myrtezanë. Kofinin e mbante përpjetë mbi kokën e kundërshtarit dhe nuk lejonte që sëpata të fitonte hapësirë e ta godiste.

Sa u mat Myrtezai t'i jepte një shqelm në bark, ndjeu dy duar të fuqishme që e mbërthyen nga prapa dhe po e shtrëngonin si në mengenë. Rizai me të nipin i kishin kërcyer që nga muret e rrugicës dhe, para se Myrteza Kogiu të mblidhë veten, ata ja kishin marrë sëpatën dhe e kishin shtritur për tokë. Ai bërtiste duke kërcitur dhëmbët:

— Lëshomëni Kodoshë! Edepsëzë!

Rizai i vinte rrrotull e, duke i folur me të butë, mundohej ta qetësonte:

— Po ti hajde si njeri. Kështu vihet te krushku, me kobilevë në brez?

— Hiqmu se s'dua të të shikoj përpara syvet. Bëmu def!

— Mos u rrëmbe, se bëhesh me turp; çfarë kërkon ti?
— Çupën që më rrëmbyet, çupën time.

— Je në gabim, o Myrteza. Çupën s'ta rrëmbeu njeri. Duheshin fëmija dhe i dhanë karar të martohen. Ç'të keqe ka këtu?

— S'kam çupë unë — bërtiste Myrtezai, duke i rënë tokës me grusht — Një që pata, e fejova.

— Ore, po ja që s'donte çupa atje ku doje ti... Flije mëndjen.

— Ma rrëmbyet, se s'ma bënte çupa ime këtë turp. E njoh unë... — dhe qante nga inati. — Lemëni ta shikoj, të më thotë me gojën e saj.

Raifi me të jatin u vështruan sy në sy.

— Mirë, i tha Rizai, — hajde ta shikosh në shtëpi.

E muarën dhe, duke e mbajtur për krahu, e shpunë brënda. Graria i hapën rrugë, të trembura, sikur të kishin përpara tyre një të pire.

Ai hodhi një vështrim të egër rrith e rrotull dhe kur e pa të bijën të stolisur, i hipit gjaku në kokë. Tani po e besonte se çupa e kish bërë këtë gjë me dëshirën e saj. Të dy cepat e mustaqevet i dridheshin e i lëviznin në mënyrë qesharake.

— Moj vrromë, moj kurvë! — bërtiste me sa zë që kish-te — ç'na bëre kështu, moj?

Ajo s'guxoi të fliste. Në vënd të saj u përgjegj një grua tjetër.

— Burrë deshi, burrë mori.

— Mbylle gojën ti, jevgë e keqe, se s'të foli njeri ty — i tha me neveri Myrtezai, pastaj iu kthye së bijës — Ma nxive jetën që t'u nxiftë shpirti e t'u bëftë katran. Hajde në shtëpi me të mirë, përndryshe gjer këtu të vejë gjaku, unë s'të lë! — dhe duke thënë, i binte dyshemesë me grushte.

— Rri, ore krushk, mos e merr nxituar!

— S'kam bërë krushqi me ty, dhe as për katërqind vjet nuk bëj.

— Mbaje gojën se je në shtëpi të botës — i tha ai kushë-riri — se, për besë, të mos ishim këtu, të bëja pestil!

Trupi i vogël e i shkathët i Rizait i sillej rrëth Myrtezait.

— Pse ngutesh? Ka këshillë ka polici, ka gjyq, kështu zgjidhen këto punë sot e jo me dyfek si qëmoti.

— Lëreni të vijë me të mirë! — u bërtiste Myrtezai grave, që qenë mbështjellë rrëth Sadetes.

— Si ta lëmë, ore, je në vete ti? E kemi nusën e shtëpisë! — i foli e éma e Raifit.

Si e pa Myrtezai, që s'bënte dot gjë, mori vrull e doli nga dera.

— Do më shikoni ç'do t'ju bëj, o stë poshtër, o maskarenj pa nder e pa cipë! — Tundëte dorën me kërcënimi në drejtim të shtëpisë së Rizait dhe thoshte fjalë që s'kishin asnjë kuptim.

Duke ecur nëpër ara e duke turfulluar si kalë nga inati mori rrugën pér në qytet.

* * *

Pas ndonjë ore, te lëmi i Raifit qëndroi një «gaz» i vogël, e prej tij zbritën nga katër veta: një toger policie, dy policë dhe Myrtezai.

Togeri trokiti në derë sa pér edukatë, e pa pritur përgjigje, u ngjit nëpër shkallët. Në krye të shkallëve qëndronte Rizai, i mbështetur pas parmakëvet, i trëmbur dhe i mbledhur një dorë. Mendonte me frikë: «Bobo, sikur ta marrë nusen me këta policët, ç'turp do jetë pér mua e pér djalin...»

— Kjo është shtëpia e Riza Bashollit? — pyeti togeri.

— Si urdhëron, kjo — iu përgjegj Rizai duke anuar kokën me nderim.

— Ju kush jini, Rizai? — foli togeri pa u nxituar.

— Si siurdhëron, unë jam...

— Djali juaj ku është?

— K — këtu është, — iu muar goja Rizait — ja, në këtë dhomë.

Togeri hyri në dhomën e gravet e pas tij edhe të tjerët.

— Kush është Raif Basholli? — pyeti i qetë.

— Unë jam! — iu përgjegj Raifi.

— Ky qytetari, — i tha togeri duke treguar Myrtezanë, — na u ankua se ju, bashkë me disa njerëz të tjera, i kini rrëmbyer vajzën me forcë. A është e vërtetë?

Tani, «qytetari Myrteza» kish vënë duart prapa kurrit e me një pamje të rëndë e autoritare qëndronte i mbështetur pas murit, sikur donte të thoshte: — «Të shohim se kujt do t'i shkojë fjala tani».

— Jo, o zot i mirë — iu përgjegj Rizai, — s'është e vërtetë...

— Prit — i preu fjalën togeri — se tani po pyes këtë.

— Mirë, si të duash, — s'e prishi gjakun Rizai.

— Nuk është hiç e vërtetë, — iu përgjegj i qetë Raifi — ne dashuroheshim dhe me që ky s'deshi dhe e fejoi në një vënd tjetër pa e pyetur, ne vendosëm të martoheshim pa lejën e tij.

— Vajza ku është? — pyeti ai shpejt e shpejt. Dy policiët shikonin rrith e rrotull dhe njëri nga ata filloj të buzëqeshtë. S'ish e para herë që ndodhnin të tilla gjëra.

— Këtu jam, — tha Sadetja duke u skuqur.

— Ti, moj motër — i tha togeri me zë të butë, duke e shikuar me ëmbëlsi — do na thuash si qëndron puna. Në qoftë se të kanë rrëmbyer me forcë, atëherë folë, se këtë veprim e dënon ligji.

— Jo, s'më kanë rrëmbyer me forcë. Ne e kishim bërë me fjalë që përparrë. Unë këtë desha e këtë mora.

Myrtezai u bë sikur t'i kishte rënë pika.

— Edhe një pyetje kam, — tha togeri — sa vjeç je?

— Njëzet.

Fytyra e togerit u ndriçua dhe buzëqeshi duke zbuluar dhëmbët e bardhë.

— E po atëherë të trashëgohi! — i uroi ai duke përkulur kokën, pastaj iu kthye «qytetarit Myrteza» dhe, me një gjest kuptimplotë, hapi krahët e ngriti vetullat përpjetë, si për t'i thënë «S'kemi se ç'u bëjmë, janë brënda ligjit».

— Na vjen keq, shoku qytetar, që na gënjet.

Myrtezai, i cili gjithë këtë skenë e shikoi si në ëndër, tani rrinte pezmatuar, frynte bullçinjtë dhe lëshonte nga një «puh» herë pas here.

Togeri u bëri shënjë policëvet dhe ata u matën të delnin, po Rizai i zuri nga mënga e s'i lëshonte. E ndjente vreten të gjuar, se çdo gjë, me njerëzit e qeverisë, kish përfunduar ashtu siç ja donte zëmra e dëshëronte t'i qeraste me domosdo.

Përpara se ata të pinin rakinë, Myrtezai doli nga dera, i mërzitur, i vrarë shpirtërisht e pa qejf.

Në shtëpinë e Rizait, ahengu i dasmës vazhdoi gjer në mes të natës.

* * *

Një ndajnat—herë, në shtëpi të Raifit erdhi Qemali. Hyri i ndrojtur e me turp, si në një shtëpi të huaj. E motra e puthi dhe e përqafoi me mall dhe u shkri në lotë se e ndjente që tani ish futur **në një jetë tjetër dhe u kish thënë lamtumirë për gjithmonë vëllezërvet** dhe babait. E pyeti pér nga shtëpia.

— Ç'bën babai? Ta dish, Qemal, sa më vjen keq, po unë s'i pata faj.

— Ç'të bëjë, pi duhan dhe mendohet. «Ma bëri koka, këtë», thotë gjithënjë i mërzitur.

— Nuk do na vijë ndonjëherë? — e pyeti Sadetja, duke e shikuar në sy.

— Jo, as ai as Smaili. «Kurrë, thotë, nuk do t'i shkel në derë dhe s'dua ta shikoj përpresa syvet». Janë zemëruar që të dy, po Smaili më duket se ka frikë nga babai a s'do t'ja prishë, se mua më tha fshehurazi: «Mirë bëri që mori Raifin, se tani do ta kemi motrën këtu pranë.»

— Po ti, si thua? — e pyeti ajo me buzën në gaz.

— Unë e kam thënë fjalën time që atë ditë që të solla rrushtë. Pse, s'e kuptova unë?

E motra e përqafoi dhe e puthi me dashuri.

* * *

Kanë kaluar gjashtë muaj, e Myrtezai akoma s'është pajtuar, po tani inati e zëmërimi i janë shuar. Koha thërmont drurin e gurin, e a është e mundur të mos zbutë dot zëmrën e babait?

Rehovë, Shtator 1956

SHOFERI I AUTOAMBULANCËS

Shoferi i spitalit qe shtruar në klub me dy shokë të tjerë e po pinte raki. Kish hedhur nga tri katër gota e qe bërë në qejf. Sytë i qeshnin, shpirti po ashtu e këtë gëzim që ndjente përbrenda donte ta shfrente duke kënduar. E ka shqiptari këtë huq: po piu një çikë, edhe do këndoje, se ndryshe s'i zihet, ndaj edhe Xhemili u kollit njady herë për të çelur zérin e, ja mbushi këngës:

Ç'janë këto llafe, moj xhane,
Që, moj, dalin nga fshati?
Të vërteta s'janë, moj xhane,
Dalin, moj, nga inati...»

Shokët që kishte pranë i mbanin iso dhe kënga do të kish vazhduar edhe më gjatë, sikur të mos u ish afruar kamari e t'u thoshte ngadalë, me zë të shuar e si i zënë në faj:

— Është e ndaluar kënga, o Xhemil. Ti e di vetë... në klub s'këndohet.

Shoferi ktheu kokën nga ana që erdhi zëri dhe pastaj e shtyri ngadalë kamarierin, duke i thënë:

— Ikë, o Koço, për kokën tënde! Lërrna rehat se kemi qejfin tonë tashti.

Zëri i Xhemilit qe i butë e i përmbajtur; në 'të ndihej vetëm dëshira që, të paktën, në, këto çaste, të mos i binin në qafë.

— E di, mor shpirt, po ka dhënë urdhër Drejtori. C'ti bëj unë Drejtorit? Pa të jetë sa për mua, unë atë dua...

— Atij Drejtorit tënd i thuaj të mos na çajë kokën tashti. Ku ka parë ai kështu, të pijnë raki njerëzit e të mos këndojnë? Pse, ore, ç'është këtu? Manastir? Ikë tashti dhe, po të foli, i thuaj: «S'kam ç'u bëj, u thashë, po ata s'dëgjojnë.» E po deshi, le të vijë vetë...

Kamarieri mblodhi pjatat bosh, i vuri mbi një disk të vjetruar dhe u drejtua për nga banaku.

Xhemili përsëri ja mori këngës:

«O ju male me dëborë,
E, o ju male.
Pse s'qani hallet e mia...
E, o ju male...»

Njëri nga ata të tavolinës, një burrë i shkurtër e kurrrizdalë, me ca sy të vegjël në formë bajameje, e pyeti duke i shkelur synë:

— E c'hall ke ti, o Xhemil? Me sa ma pret ky kungulli im unë them se vetëm një hall ke ti: mos mbetesh pa raki.

— S'ka njeri pa halle, jo — psherëtitë Xhemili. — E di ti që s'kam kopertona për makinën apo jo, dhe kam triditë që ngrysem e gdihem në klub?

— Dhe kthen nga një gotë, hë?

— Po ç'të bëj tjetër?

— Të kërkosh kopertona e t'i gjesh ku të jenë...

— U të keqen e mendjes!... Pse puna ime është ajo? Unë timonin di, atë kam në dorë unë. Kur nuk është i zotit shefi të mbajë dy kopertona rezervë, ç'do t'i bëj unë? Unë kam borxh, kur më mbarohet ndonjë gjë, a kur më prishet, të vete ta lajmëroj. Ama s'do të gjejë kopertona, le të mos gjejë. S'bëhet puna, do thuash ti, Demir; po le të mos bëhet, mua rroga më ecën.

Kur tha këto fjalët e fundit, e shtyri kapellën me një gjest të stërvitur dhe e hodhi përmbi sy. Me këtë desh të tregonte se s'i bëhej vonë.

Demiri qeshi dhe iu duk e kotë që ta zgjatëte këtë muhabet më tepër. Shtyri me brryl shokun që kish në krahë dhe i tha:

— Mjaft pive, o Lazi, se po të pa jot shoqe, do të të rrähë...

— Ajo gruaja e këtij, a? Ajo është e çmëndur. Nga ajo edhe unë kam frikë — e vazhdoi më tej shakanë Xhemili.

Lazi bëri sikur s'i dëgjoi këto që u thanë për 'të e përtë shoqen. Ai përkujdesej si zakonisht, që gota të mos i mbetej kurrë bosh, andaj as që pati mirësinë tu përgjigjej. E ktheu rakinë përnjëherësh në gojë, dhe si fryri bullçitë, e kapërxeu tatëpjetë; pastaj si i humbur, hodhi vështrimin përjashta. Nga dritarja e gjerë e klubit duket rruga kryesore e Kumeshit, një pjesë e sheshit, ku të premtevet bëhet pazari dhe çezma e vetme e qytetit. Me një fjalë, po të rrish në «Klubin e Madh» (siç e quajnë vëndësit këtë klub, për ta dalluar nga tjetri që është më i vogël e më i keq), ka mundësi t'i shikosh të gjitha këto që ngjasin në qytet.

Qytet i thënçin, Kumeshit. Është një fshat i vogël e i rrëgjuar, si gjithë fshatrat e kësaj krahine dhe, në e mori këtë emër të bukur e të hijshëm, le t'ja ketë përfalënderje pozicionit gjeografik: me që u ndodh në qendër e graduan dhe e pagëzuan qytet.

Në Kumeshin e vogël, të huajit çdo gjë i duket e qetë, e plogësht dhe e mërzitëshme. Nuk shikon njerës rrugës duke vrapiuar. Nxitimi këtu është lluks i tepërt dhe, në vrapon dikush, atij do t'i ketë ngjarë patjetër ja ndonjë hidhërim i madh, ja ndonjë gjësim i madh, përndryshe asgjë s'e turbullon Kumeshin. Të huajit i duket sikur këtu dita është e gjatë, e gjatë, dhe mezi ikën, i duket sikur plogëشتia ka hyrë edhe në shpirtërat e njerëzvet. Për çudi, vëndësit s'i kanë hiç këto mbresa. Për ata çdo gjë është e zakonshme, normale dhe bile e dashur. E njojin njeri tjetrin që së largu, e për këtë s'është nevoja t'i shikojnë fytyrën,

mjaton t'i vënë re ndonjë çip të palltos a të kapellës, kaqë shumë janë mësuar edhe me rrrobat e njeri tjetrit.

Ata edhe huqet ja dinë shoku shokut. Dinë kush mban shaka e kush është nevrik, cili pi duhan e cili s'e vë rakinë në gojë, dinë cili vuau nga ulçera e cili ble mish ditë përditë. Jeta e tyre është e mbushur, si kudo, me ato gjëra të vogla e të parëndësishme që janë pjesë e pandarë e qënies sonë dhe pa të cilat as që mund të kuptohet jeta edhe në caqet më të largëta. Ja, në rrugë po kalon Leksi. S'ka javë që mbi kurrisin e gjërë të këtij infermieri të mos luhet ndonjë reng, megjithatë Leksi s'e prish qeifin dhe shkon pazarit me duar prapa e duke vërvshëlyer. Është pakë si i leshtë, beson kollaj çdo gjë që i thonë, po megjithatë është djalë i kujdesëshëm e punëtor.

Ja, tani, me dy kova ndër duar, vajti në çezmë ndihmës i furxhiut, Nasho Qyqja. Ky Nashua s'e ka gishtin e madh në dorën e djathë, prandaj me krenari thotë: «Unë kam lindur përfurrxhi; shikoje si e kam dorën që trazoj brumin, si lopatë.» Dhe duke të thënë këto fjalë, ta luan me mburrje atë dorën e sakatepsur përpëra syvet. Më tutje, e shoqja e doktorit po ble patate në pazar dhe atë zymbylin e kuq e tund me fodullëk. Në krye të rrugës, përtej nga kooperativa e këpuçarëvet, duket kasapi që po mban në një shilurth dy mishra.

Përtej qytetit janë malet e lartë që e kanë futur Kumeshin në mes të tyre dhe duken sikur heqin valle rrëthtij e sikur e përqeshin që është i vogël e i pakët.

Megjithse ka ardhur qershori, majat e malevet kanë akoma dëborë, po ajo ka mbetur aty vetëm sa për t'u kujtuar njerëzvet dimërin e gjatë e të mërzitshëm.

— Eh! Na erdhi behari, — thotë Xhemili i kënaqur — se Çuka po e heq qeleshen prej dëbore... Shiko si blerojnë malet.

Pastaj në rrugë kalojnë nja katër fshatarë, duke mbajtur në supet një vig, të bërë dosido prej vërxomash. Një çip i velënxsës së kuqe, me të cilën është mbuluar vigu, ka shkarë mënjanë **dhe tundet si flamur**. Ca fëmijë **kureshtarë e të veshur** keq i janë qepur pas këtij kortezi, që

shkon i heshtur në mes të qytetit dhe mundohen të shikoj-
në fytyrën e të sëmurit.

— Ore, ç'fëmijë të prapë! Shiko si i vihen pas.

— Ç'do të jetë ky, o Xhemil? — pyeti Lazi.

— Ndonjë i sëmurë. Ja, kështu e bëjnë kurdoherë. I lë-
në gjer më këtë ditë sa bëhen për në velenxë dhe pastaj
na i kllupitin në spital. E ç'do t'i bëjë edhe Doktori? Shpir-
tin e tij s'ja jep dot, e!

— Njerëz të trashë këta fshatarët, — tha Demiri.

— Ti, je i zgjuar ti! — ja ktheu Xhemili.

— Shiko, paska dalë nga zyra edhe Shefi i shëndetësisë,
— tha Lazi duke treguar me gisht një njeri, që e cte rrugës
i menduar, sikur gjithë hallet e rrethit t'i kishin rënë
mbi kokë.

— Prite tani kur të vijë këtu, — tha Xhemili duke qe-
shur. — E ka zakon ai, po s'vajti njëherë nga spitali e po
nuk hyri në klub, s'i shkon buka.

E me të vërtetë shefi i seksionit të shëndetësisë mori
rrugën që të conte te dera e klubit. Ishte një burrë i shkur-
tër, flokë—gështenjë, i veshur si zakonisht, me një xhaketë
prej kadifeje e me një palë pantallona doku.

— A të shkon, o Xhemil? — pyeti me të vënë këmbën
në prag, e, natyrisht, jo pa qëllim.

— Më shkon që ç'ke me të. Do dhe ti ndonjë gotë?
Pse s'e thua copë, po i bije tërthorazi? — Pastaj u kthyte
nga kamarieri. — Jepi, o Koço, një gotë shefit dhe zëre në
hesapin tim.

Spirua e vuri re me kujdes të madh se si ja mbushi
kamarieri gotën, pastaj, si piu një gllënëkë, e mori në dorë,
e me vështrim ziliqar, po e përkëdhelte gotën. Dëgjoi Xhe-
milin që i thërriti:

— Hajde, o shef, pije këtu me meze e me nge siç ka
urdhëruar Perëndia.

— Jo, jo, se nxitohem. Ashtu kam një punë. Më mirë
po e pi kështu më këmbë.

— Të vranë punët ty. E dimë ne sa punë ke ti, po thua j
atë që është; ke frikë mos vjen Kryetari, të gjen këtu, duke
pirë e pastaj s'di ku të futesh!

— Pse, shaka e ke a? Apo i dilet përpara atij çalamani!
Nga këmbët topall éshtë, po gojën brisk e ka.

Xhemili i ra me brryl Demirit, dhe diç i pëshpëriti në vesh, pastaj foli me zë të lartë:

— Mor po, kur s'jam kujtar ndonjëherë të vete t'i qu-hem pér ty që më ke lénë pa kopertona. . . Si s'jam kujtar, xhanëm?

— Yt! se mos na bësh ndonjë punë, se aqë do ai. Apo s'më ka marrë dhe me sy të mirë!

— Pér Perëndi, do t'i vete...

— E, ç'ma nxore rakinë nga hundët, o Xhemil,! E, u bëfsh kusur! Nga vajta e u ktheva fare në klub.

Spirua iu afrua Xhemilit dhe, pér të zbutur muhabetin, që, me sa iu duk, mori rrugën ters, zuri e po i shtrëngonte atë zverkun e kuq e të fuqishëm. E kanë zakon disa njerëz të përdorin të tillë gjeste pér të çfaqur simpatinë e falënderimet e tyre.

Mirëpo Xhemilit s'i pëlqeu hiç kjo mënyrë falënderimi dhe prandaj ktheu kokën dhe e shikoi me inat. Spirua e hoqi dorën dhe foli si nëpër dhëmbë:

— Do vete të shikoj njëherë andej nga spitali.

— Ecë se i ka marrë malli. Bile më pyetën pér ty. Po e gjete, më thanë, na e dérgo.

Nga toni me të cilin i tha Xhemili këto fjalë, nuk mund të kuptoje në e kishte me gjithë mënd a po me të tallur. Demiri hetoi njëherë fytyrën e Xhemilit se mos dallonte atje ndonjë buzëqeshje ironike e pastaj i tha:

— Shumë çapraz folke me Shefin!

— E pse të mos i flas? Pse frikë nga ai do të kem? Dë-gjo, Demir, se ç'do të të them: s'ja kam nevojën njeriut, prandaj s'ja kam as frikën. Dhe flas me të gjithë si më vjen pér mbarë dhe ashtu si më duket mua e udhës. Lajka s'di unë; as im atë s'dinte.

— Po të flasësh siç éshtë pér të folur, s'domethënë që të kesh frikë.

— Të flas me edukatë, thua ti?

— Po makar me edukatë, quaje si të duash.

— Ah, ç'të ka zënë ngeja! Tek mua e tek Spiro Çakë-rri mbeti edukata...

— Hajde gëzuar, ngriheni nga një herë — ua këpüti bisedën Lazi, dhe i pari e shkundi gotën me fund.

* * *

Mbi një bicikletë, të vjetër, e të shkatërruar, me rrota të bytynta, nga ato që përdorte posta ushtarake italiane, mbetur që nga koha e luftës, u duk infermier Gaqua, ose «Gaço Kokëmadhi», siç e kanë zakon t'u vënë nga njënofkë njerëzvet këtu në Kumesh. Gaqua e mbështeti pas murit atë bicikletën, që s'dihej se ç'fuqi e mbante akoma më këmbë, dhe hyri në klub shumë i nxituar. Atje, shikoi njëherë rrëth e rrrotull e, me ta parë Xhemilin, psherëtiti i lehtësuar.

— Këtu qenke, o Xhemil? Shyqyr që të gjeta. Unë s'la shë vënd pa kërkuar...

— Ngadalë, ngadalë mos u rrëmbe! Ç'paske vrapuar kështu, sikur të ndjekin gjermanët prapa!

Të dy shokët e tjerë ja krisën të qeshurit dhe, nga mënyra se si e shikonin Gaqon, dukej se ishin në merak të dëgjonin përgjigjen e tij. Gaqua bëri sikur s'dëgjoi.

— More, lëri këto dhe hajde shpejt se të kërkoni Doktori.

Xhemili shkeli një sy gjithë nazë.

— E ç'më do Doktori mua?

— Ka ardhur një grua e sëmurë. Do shpënë urgjent, në G...

Ky lajm as e tronditi as i bëri ndonjë përshtypje Xhemilit. Gaqua tek e shikonte u qudit, sepse herët e tjera, kur e kish thërritur për këso punësh, Xhemili ngrihej përnjëherësh nga vëndi e thoshte:

«A e kini gati ju që të mos vonohemi?» dhe linte në mes çdo punë a muhabet që të kish filluar. Kisht qëlluar që ish ngritur edhe nga dasma, kurse sot s'po luante nga vëndi. Vallë mos kishte pirë?

— Pika që s'të bie edhe ty edhe Doktorit. Unë makinën e kam ngritur në tako, ti vjen e më kërkoni urgjent. Po ti, mor kokëbuall, s'e ke parë? Me se ta shpie unë, me krahë?

Vetëm tani iu kujtua Gaqos autoambulanca që dergjej prej disa ditësh, prapa spitalit. Dhe e përfytyroi ashtu siç qe: me një mushama të vjetër përsipër e me dy trungje nën disqet e rrotavet të para.

— Nuk e di unë — pëshpëriti me fuqi të prera e i zënë ngushtë. Unë s'erdha nga koka ime... Doktori më porositi. Ti, po deshe, hajde, po deshe mos hajde.

— Nuk vij — tha Xhemili i vendosur e pothuajse me të bërtitur. — Ja, s'vij!

— S'vjen? Kurrë mos ardhç! Ç'kokë që ke, or t'u mbylltë! Të jem unë në vend të tyre, s'të mbaj njëzet e katër orë në punë... Do t'i them doktorit që s'do të vish.

— Thuaji! — ja preu shkurt Xhemili.

Gaqua nuk dinte çfarë t'i thoshte më tepër, po inati i zjente pérbrënda e sikur s'i vinte mirë të largohej. Më në fund shau nëpër dhëmbë dhe iku duke folur me veten e vet.

Te dera sa nuk u pérpoq me një grua të bukur, e cila atë çast po hynte në klub.

— Mbaji frenat, Gaqo! — i thërriti Xhemili me rrōmuz e duke qeshur.

Gaqua doli pérjashta; ja hipi asaj bicikletës me rrota të bytynta dhe u largua me të shpejtë. Xhemili as që e vu ri re. Ai kish tjetër punë tashti: po shoqëronte e po e pér cillte me vështrimin e tij ziliqar gruan e bukur që hyri në klub. Nga kjo anë ai s'kishte ndonjë ndryshim nga shofe rët e tjerë.

— Ama grua që t'i rëmbesh kokënështë! — tundi koken e pshérëtit si ashik i përvëluar-Shihe, mor aman, ç'këmbë që ka! Eh, botë, botë! Një grua të bukur, një shtëpi, një kupë raki dhe thuaji botës si ma ke qejfin pastaj.

Gjithë muhabeti u vërtit rrëth grave që s'qëndrojnë të bukura kurdoherë e qëmplaken shpejt dhe rrëth hallevet që e zënë njëriun sa vjen ndër mënt e tia e gjersa mbyll sytë.

* * *

Doktori i Kumeshit po ecte rrugës, i krrusur, ballë-vrenjtur e i menduar. Duart i kishte futur në xhepet e futës së bardhë, megjithse nuk bënte ftohtë, vështrimin e mbante përdhe e dukej se diçka e madhe e mundonte. Edhe atyre që e përshëndetnin me respekt sot nuk po u përgjigjej, e bile as që i vinte re fare.

Doktori ishte plak. Sot s'e kishte as kapellën, dhe lë-kura e kokës tullace i shkëlqente në diell. I kishin mbetur vetëm pakë flokë të thinjur mbi veshët e prapa, në zverk, e kjo dukej si një kurorë e përhime. Po kjo s'ish as kurorë lavdie, as kurorë suksesesh. Ish kurora e pleqërisë së parakohëshme. Ai kishte njëzet e dy vjet që punonte mjek krahinash dhe tanë lavdia i dukej punë boshe e èndër rinie.

Dikur kish èndëruar edhe për lavdi edhe për pasuri, mirëpo me kohërat që erdhën hoqi dorë nga këto èndra dhe tanë nga gjithë pasionet e herëshme i kish mbetur vetëm një: të luante tavëll në klubin e gjuetarëvet.

Xhemili, me ta parë doktorin, e ndjeu instiktivisht se s'kish bërë mirë që nuk pat përfillur urdhërin e tij, dhe i erdhi keq. Pse s'e kish dëgjuar? Kot! Ashtu iu shkrep në ato çaste e ashtu bëri. Mirëpo tashti i vinte turp nga vetja e vet dhe, tek shikonte doktorin, mendonte i penduar:

— «Ja, pra, në vënd të vija unë tek ai, u ngrit e erdhi doktori tek unë. Shihe, mezi po ecën, i shkreti».

Dhe priti i qetë e i bindur shfryrjet e të sharat që do t'i thoshte doktori. E ndjente veten të zënë në faj dhe as që kish ndër mënd t'i kundërshtonte a të mbrohej. «Le të thotë, e ka me hakë», mendoi.

Doktori iu afrua e si tha asnje fjalë. Atij tanë as që po i binte ndër mënd të pyeste pse nuk ish zbatuar urdhëri i tij. Dukej sikur e kish mbërthyer diçka tjetër më e madhe, më e rëndësishme, dhe ajo që kish ngjarë përpara i dukej si një vogëlsirë e rastit që s'meritonte as ta përmëndje.

Xhemili u ngrit, shtyri karrikën prapa për të hapur rrugën dhe vuri kapelën në kokë.

— E di përse më do, o doktor, hiç mos ma thuaj! — i tha duke tundur dorën. Po q'të të bëj unë? Ti e ke parë vetë se në q'katandi është autoambulanca.

— E di, e di, po di edhe një gjë tjetër: ajo duhet shpënë pa tjetër në G... Po s'u dërgua për dy tri orë, mori fund meseleja. — Doktori ferkoi duart me njera tjetren për të treguar se çdo gjë, pas këtyre orëvet, qe e kotë.

Xhemili ngriti supet.

— Ç'të të bëjë vëllai?

Doktori, sikur të mos e kish dëgjuar fare, vazhdoi:

— Merren më qafë dy shpirtra...

— Pse shtatzënë qënka?

Shoferi hapi sytë, i tronditur, dhe vetëm tani iu kujtua ai vigu që suallën ata fshatarët dhe ai cepi i velenxës së kuqe që tundej si një flamur.

— Mos është ajo që suallën ata fshatarët ndonjë orë përpara?

Doktori pohoi me kokë. Pastaj, si të fliste me vehten e vet, vazhdoi duke shikuar drejt në bebëzat e Xhemilit:

— Gjëndje serioze. Paraqitje me dorë, e kupton? Nuk është lindje normale, ka dalë vetëm një dorë e fëmijës. Tani, operacioni e shpëton...

Doktori qëndroi në vend. Ata syt e tij, tëmplakur e të mijegulluar, u mbërthyen në fytyrën e shëndetëshe me të Xhemilit, dhe u duk sikur prisin prej andej mëshirë e shpresë.

— Ç't'i bëj unë? S'jam kirurg e as vegla kam, — foli sërisht. Doktori ndihej shumë i turbulluar dhe heshti duke picërruar sytë. — Dhe tani, o Xhemil, shpëtimin e asaj gruas e ke më shumë në dorë ti, se sa unë...

Xhemili mbajti frymën dhe u drodh. E shikoi me respekt fytyrën rrumbullake dhe babaxhane të këtij njeriu të shkencës, dhe e ndjeu të afërm si prind e i vinte t'i hidhte duart në qafë, ta shtërngonte fort e t'i thoshte: «Ah doktor, ta dish sa zëmër të mirë që ke ti!» N'ato çaste ai kish arritur në një gjëndje e në një tension shpirtëror t'atillë, kur njeriu është gati të bëjë çdo gjë, çdo sakrificë, pa u penduar kurrë.

— Thuam, doktor, çfar të bëj! Thuam ti dhe unë do ta bëj... i tha i emocionuar!

— Ja, ta shpiesh në G... këtë dua unë.

Xhemili psherëtiti e buzëqeshi me hidhërim.

— Aman, doktor, mos më vraj me fjalë. E me se ta shpije?... Pa më thuaj! Gjemë një makinë e po si' bëra të 50 kilometrat në gjysmë ore, mos më thënçin Xhemil.

Ka një farë njerëzish që me të keq s'u dilet. Këtyre, siç thonë, «u hahet koka me të mirë». Ata me kercënime e me të shara nuk duan t'ja dinë e nuk u bën asnjë përsh-typje, mirépo po të dish t'u thuash një fjalë të mirë e të butë që t'i prekë atje ku u dhëmb, atëhere janë gati të bëjnë çdo gjë me zotësi të madhe e me energji të pashtetur. Një nga këta ishte edhe Xhemil Shkëmbi. Sa i ishte bërë qeffi nga ato fjalët e thjeshta e të sinqerta të doktorit: «Tani, o Xhemil shpëtimin e asaj gruas e ke më shumë në dorë ti, se sa unë...»

Me këto fjalë ai e kish shkelur në kallo dhe e kish bë-re të mendohej.

— Ah, mor Xhemil, kur të kisha makinë pse të të kér-koja ty?

— E po unë më krahë ta shpije?...

— Rri, rri, më mirë mos folë. Kur s'na bën dot gjë, pse flet?

— Sa herë ja kam thënë shefit — filloj të nxehet Xhemili — «Shiko, mos na lër në Diell, përpiku për dy koper-tona»; po ai i merr punët llolloollo e as që çan kokë. Hajde ta gjejmë tashti e ta bëjmë maskara.

Fytyra e doktorit u vrënjt dhe, me një ton që s'pranonte diskutim, ja preu:

— Lëre, s'është koha për ato punë tashti...

Po ecnin në një rrugë të ngushtë të shtruar me kall-drëm. Më të dy anët e rrugës kishin mbjellë para disa vjetësh eukaliptë, të cilët tani ishin mbushur plot fletë dhe rruga kundërmonte një erë të mirë si prej myshku. Çdo gjë për rrëth qe e lehtë, e parfumuar, e freskët dhe nanuritëse. Kumeshi kredhej në plogështinë e tij; vetëm Xhemilit s'i delte nga mëndja se duhej të bënte diçka, po se çfarë, as vetë nuk e kishte të qartë.

— E, mor doktor, ç'më zure ngushtë, e, mor doktor... Këto fjälë më shumë ja thoshte vetes, se sa mjekut; pastaj, si të ishte kujtuar për diçka të rëndësishme, e ndaloi doktorin dhe, me një farë shprese, e pyeti:

— A telefonove në spitalin e G... mos na dërgojnë ndonjë makinë prej andej? Hajde vemi në postë!

Duke thënë kështu, i papërmbajtur, i futi krahun doktorit, si të donte që atë copë rrugë ta bënin duke vrapuar. Doktori s'luajti nga vëndi.

— E bëra këtë punë përpara se të ma kujtonje ti. Andej s'del gjë, flije mëndjen. Një makinë që kanë të saktë e paskan dërguar gjetkë dhe as ata vetë s'e dinë kur këthehet. Le që s'pret puna... — shtoi duke tundur kokën.

— E po si t'ja bëjmë atëhere? Vemi njëherë nga Komiteti i Partisë.

— Ç'farë të bëjmë në Komitet të Partisë?

— T'i kërkojmë makinën Sekretarit.

— Shko ti vetë. Unë pse të vij? Kot?

— Jo, hajde dhe ti, se ndryshe eshtë kur i vemë bashkë. Pastaj kë do të dëgjojë Sekretari, doktorin apo mua që jam shofer? Ti je autoritet, kurse unë... kush pyet përmua?

* * *

Duke shkuar për në Komitet të Partisë, doktorit i dolli përpara syvet ajo fytyra e asaj gruas së re, e menduar dhe e prerë nga dhëmbjet. Në atë fytyrë sikur ishin tiposur të gjitha ato që kish vuajtur ajo fatzëzë. Sytë të mëdhënëj e të lotuar, me një shirit të zi anës dhe ai vështrim i pafuqishëm e i këputur të lëndonin zëmrën, balli i bardhë dëborë e i djersitur, faqet të futura dhe buzët (oh ato buzë) të trasha, të enjtura, të thara e të plasaritura si një tokë pa ujë, e të bëra thela-thela nga të kafshuarit me dhëmbë kur ajo përpinqej e shtërzonte më kot.

Si e kishin sjellë këtë grua? Sa orë kishin bërë rrugës? Doktori s'e dinte e ndofta as që kish për ta mësuar kurrë. Veç tashti i vinte rëndë nga vetja e tij që i kish folur ashpër njerit prej atyre fshatarëvet, të shoqit të saj. Puna kish ngjarë kështu:

Doktori po matej tē dilte nga spitali, kur e lajmëruan se kishin prurë një tē sëmurë. Veshi përsëri futën, nxori feneudoskopin nga xhepi dhe dha urdhër ta futnin tē sëmurën në dhomë. Si e vizitoi me kujdes, doli tek dera shumë i vrenjtur dhe i shqetësuar.

Të katër fshatarët që e kishin sjellë më krahë nga një fshat i largët ishin shtruar te shkallët e spitalit e po shullëheshin në diell. Bisedonin për gjëra tē zakonshme dhe pinin duhan, si njerëz që e kanë kryer detyrën e tyre, e tani, tē qetë, presin tē dëgjojnë një fjalë tē mirë e tē kthenë përsëri në fshat. Me tē parë doktorin në krye tē shkallëvë, u ngritën në këmbë. Njeri prej tyre, ai më i riu, e fshehu cigaren prapa, pastaj e shkeli me këmbë. Fytyra e vrenjtur e doktorit nuk iu pëlqeu atyre.

— Kush është i shoqi? — pyeti doktori, duke zgjatur mjekrën përpara.

— Unë...

I doli përpara një burrë i gjatë, me një fytyrë tē qetë e tē heshtur, me një palë vetulla tē dendura, tē zeza e tē ngritura lart. Këto vetulla e tregonin Mihal Kostën sikur habitej vazhdimisht me tē gjitha ato që shikonte a që dëgjonte. Doktori vuri re se në veshin e djathtë i tundej një vëth i hollë prej ergjëndi.

— Ti je? Mirë; hajde pakë këtu brënda.

E futi në një sallon tē ngushtë, tē shtruar me pllaka mermeri në ngjyrë tē bardhë e tē kuqe dhe pastaj e pyeti:

— A nuk më thua, sa kohë ka kështu?

— Ja, që dje, aty më tē perënduar tē diellit, a një cikë më përpara...

Me tē dëgjuar këtë përgjigje, doktori luajti dorën me një gjest tē dëshpëruar, e me këtë deshi tē thoshte atë që zakonisht thonë njerëzit e zanatit tē tij në këto raste «Pha! C'njerëz kokëtrashë!»

— E pse s'e suallët më përpara? — i bërtiti me inat, dhe ai balli i gjérë iu përskuq tejetëj.

— Nuk e suallëm... Pritëm se mos lirohej...

Rrinin njeri kundruall tjetrit dhe vështroheshin si dy armiq. Mihal Kosta me kokë tē ulur, me zëmrën helm e pi-

kë, i hidhëruar e i zëmëruar me fatin e tij dhe në anën tjetër dotori i egër, i rreptë dhe i inaatosur.

— Jemi larg, o doktor, — foli Mihali, si për t'u çfajësuar, — pesë sahat rrugë. Jemi nisur me dy hosten diell...

Doktori e shikoi këtë fshatar të pafat, që vërtiste në duart e tij të mëdha një kapellë të vjetër dhe sepse i ardhì keq. Ah sa mirë i dinte doktori këto raste. Ai fshatari, tanë me siguri priste t'i thoshte doktori një fjalë të mirë, një «mos u bëj merak se ja, tanë do lirohet e do të shpëtojë...» kurse ky... Zëmra iu zbut dhe e kundroi me mirëdashje. Iu afroa e i vuri të dy duart mbi supet dhe po i shikonte ato vetullat e zeza e të larta që dukej se kundronin çdo gjë me habi.

— Ç'faj ke ti, xhanëm... Pëh! — psherëtiti doktori, duke i rrumbullakosur buzët, sikur frynte tym duhani.

Mihalit iu ngroh zëmra nga këto fjalë dhe e pyeti me një ton ku ndihej gjithë shqetësimi e dashuria që kishte ai për të shoqen.

— Aman, doktor, më thuaj! a do shpëtojë?

Priste me ankth përgjigjen, dhe në mënyrë instinktive e kuptonte se këto ishin minutat më të rëndësishme në jetën e tij. Janë ato minuta që e mplakin njeriun dhe e shkatërrojnë sa për dhjetë vjet, e për të cilat s'kemi se ç'themë më tepër, veç shyqyr që janë kaqë të rralla në jetën e njeriut, se s'u bëhet ballë, sado i duruar e gjakftohë të jesh.

Aty për aty, Mihalit iu duk sikur salloni luante, anohëj, epohej dhe doktori i dukej i madh sa një gjigand, dhe ai balli i tij i dukej i gjëre si një fushë e madhe, ku mund të lëronte. Ç'kuptim kishin këto? Ku ishte? Ku e kishin sjellë dhe pse?

Vetëm zëri i doktorit e përmendi:

— Si të të them dhe unë tashti...? E di si është puna? Duhet ta dërgojmë për operacion në G... Dërgova një infermier të thérresë shoferin tonë dhe, sa të vijë ai, do ta nisim...

Mihali ndjeu një valë të nxehëtë që i përshkoi gjithë trupin, duart iu lëshuan të kapitura pa forcë e pa jetë, dhe u mbështet me sup pas murit që të mos binte. Nga ajo që

kiske frikë, nga ajo nuk shpëtoi dot. Pse i ngjiste gjithëmonë kështu? Kur i ruhej a kur i trembej ndonjë gjëje, ajo do t'i delte me domosdo. Ja, edhe rrugës këtë kish menduar «Zot, o Zot, po sikur të mos e mbajnë aty e të thonë duhet dërguar në G...? Si i bëhet hallit atëhere?»

Tundi kokën pa shpresë dhe doktori pa se si iu turbulluan e iu mjegulluan sytë, si mëngjëz vjeshte kur bie shi.

— Po pse mërzitesh kështu? Mos u bëj fëmi; ja, do ta nisim që tashti, me autoambulancën tonë...

E në atë çast iu kujtua se makina e tyre ishte e prishur dhe qëndronte prapa spitalit, si një gjë e lënë, e harruar dhe pa vlerë.

Shprehja e fytyrës së doktorit ndryshoi menjëherë. Vendin e shpresës tanë e zuri brenga. Kafshoi buzën e poshtme dhe i hoqi duart nga supet e Mihos ngadalë, sikur të ishte duke çpështjellë bandën e ndonjë plage. Ata sytë e mëdhenj e tëmplakur iu rrudhën e iu trishtuan.

Atë çast në sallon kaloi një infermieri me një tufë lulesh në dorë e me një poç uji.

— Kristina — iu drejtua doktori infermieres — asaj gruas që erdhi tashti do t'i bëni kamfor, penicilinë dhe glykozë. Që tashti. Unë do të vete gjer në një vend dhe do të kthehem shpejt.

Doktori futi duart në xhepat e futës dhe, me hapa të ngadalëshme, u drejtua për nga dera.

Mihua mbeti në mes të sallonit. Shikonte pllakat e dyshemesë me mermer të kuq dhe as vetë nuk e dinte përsë po mendohej.

Doktori, sikur të ishte kujtar përdiçka, qëndroi te dera dhe i foli Mihalit:

— Po ti q'do të bësh aty?... Hajde...

Mihua u mundua të lëvizte nga vendi, po nuk i bënin këmbët të delte. Zgjati duart përrpara dhe iu lut:

— Mirë, doktor, mirë, por... sikur ta shikoja dhe një herë...

Doktori tërroqi derën me ngadalë dhe doli.

* * *

Komiteti i Partisë nuk qe larg.

Me të hyrë në oborr, Xhemili qëndroi, shikoi njëherë nga garazhi e pastaj foli nëpër dhëmbë:

— Kot që erdhëm, doktor, makinën s'e paskan këtu...

Me qënë se ishte e shtunë mbas dite dhe orari i zyra e kishte mbaruar me kohë, në Komitet të Partisë gjetën vetëm një reshter policije që kryente shërbimin e rojes.

— E mo Petro, c'bën, si vete? — iu drejtua Xhemili.

Petrua atë çast mbylli librin që po lexonte dhe pakë i turbulluar u ngrit në këmbë. Rregulloi rripin e mesit dhe kapellën dhe i ftoi miqtë të uleshin.

— Jo, faleminderit se nxitojmë — iu përgjegj doktori.

— Deshët gjë?

— Deshëm të takonim ndonjë nga të Komitetit të Partisë.

Petrua ngriti supet.

— S'ka asnë njeri brënda. Tani ka mbaruar orari. Doktori filloi të fërkonte mjekrën i menduar.

— Po Sekretari ku është? — pyeti Xhemili.

— Sekretari s'është fare këtu. Ai ka shkuar që dje me shërbim në Tiranë...

— A kthehet sot, thua?

— S'e besoj. Edhe në u ktheftë do këthehet natën, ose nesër.

— S'na pret puna — tha Doktori si duke folur me veten e tij.

— Pse? — pyeti Petrua me interesim — Ke ndonjë hall ti shoku Doktor, a?

— Kam një hall — tha pa qejf Doktori.

— C'hall ke të të ndihmoj unë — i tha reshteri.

— S'më ndihmon dot...

— Po ku dihet? Nga ai që s'e pret, nga ai të del ndonjëherë.

— Ja, dua një makinë për të vajtur gjer në G...

— Makinë s'kam, o Doktor, pa po të kisha, për ideal në ta mbaja.

Doktori erdhi këtu me shpresë se do ta gjente Ste-

fan Xhikun, Sekretarin e Partisë. Dhe, po ta gjente, ish-te i sigurtë se s'kish për t'i shkuar mundimi kot. Ai do ta dëgjonte me kujdes, ashtu sikurse e kish zakon, e më së fundi do t'i thoshte: — «Mirë, Doktor, merre makinën, ja tek e ke.»

Dhe, atypëraty, Doktori i harroi të gjitha mirësitë e lehtësirat që i kish bërë Sekretari i Partisë së Rrethit. Sekretari ish kujdesur që spitali të merte ushqimet më të zgjedhura e më të mira dhe njëherë për këtë çështje, i pat hequr vërejtjen në sy të Doktorit, Kryetarit të Komitetit Egzekutiv, i cili mishin e mirë e ruante për restorantin. As fondej nuk ja kishin kursyer kurrë spitalit, mirëpo këto tani doktorit iu dukën si gjëra të vogla. Ja, kur erdhi puna për të shpënë një të sëmurë urgjent në G... Sekretari s'ndodhej aty që t'i ndihmonte.

Ai erdhi këtu me shpresë të plota se do ta gjente Sekretarin e partisë, do të bisedonin së bashku e do ta zgjidhnin këtë hall, mirëpo ja, fati deshi që ai të mos ndodhej aty atë ditë dhe kjo e çorientoj doktorin.

— Po tani nga t'ja mbajmë? — pyeti i hutuar.

— Shkoni një herë nga Dega e Brëndëshme — i kë-shilloi reshteri.

— Ç'të bëjmë në Degë?

— Shikoni për makinë. Po ta kenë ata, nuk ua mbajnjë.

— More, s'thotë keq Petrua... — tha Xhemili.

E pëershëndetën dhe ikën.

Duke shkuar për nën Degë, Xhemil Shkëmbi s'po e ndjente veten të qetë e dufin që kishte përbrënda donte ta shfrente.

— E sa mund të rrojë një autoambulancë? Tre, katër, ja ta zëmë pesë vjet, më shumë s'vete dot. Kurse e jona ka shtatë vjet. Kaqë herë i kam thënë Spiros. «More Spiro, shiko mos i xhvataj ndonjë makinë të re Ministrisë, se kjo që kemi e hëngri çairin dhe është re ato plakat me një këmbë në varr...» Mirëpo ku fjalo-sesh dot me 'të? «I di unë këto punë, thotë, s'kam ne-vojë të më mësojnë bota». Edhe për kopertona kam dy javë që po i them...»

Doktori e dëgjonte pa qejf dhe ky bisedim tan i dukej fare i tepërt. Ai e dinte se për të siguruar një makinë të re, nuk ishte aqë kollaj sa ç' pandehte Xhemili.

As në Degë nuk gjetën makinë. Atje u doli përpara një toger i shkurtër, të cilin Doktori nuk e njihte. Ai i priti me shumë edukatë dhe i dëgjoi me kujdes.

— Më vjen shumë keq që nuk mundem t'ju ndihmoj në këtë situatë. Makinën e kemi në garazh, në G... E presim të na vijë nga çasti në çast. Me të ardhur bisedoj unë me Shefin dhe ua japim me gjithë qejf.

— E po s'kemi se ç'bëjmë. Atje ku s'ka, s'mer as Perëndia — tha Xhemili duke i dhënë dorën togerit.

Gjetkë s' kishin ku të vinin të kërkonin makinë dhe kështu në zëmrat e tyre, perëndoi çdo shpresë.

* * *

Muarën rrugën e spitalit. Doktori ishte i mërzitur e i dëshpëruar, kurse shoferi qe i inatosur dhe zjente përbrenda. Duke shkuar, bënte gjeste me duar, sikur ishte duke u grindur me njeri.

— Ç'ke? — e pyeti doktori.

— Flaka t'i bjerë këtij Kumeshit, kur s'gjetëm dot dy kopertona...

Të shtyrë nga një ndjenjë që as ata vetë s'e kuptuan u drejtuani prapa spitalit, ku ndodhej autoambulanca. U duk siukr vajtën nga vajtën e përsëri tek ajo u këthyen. Kurrë nuk ja kishin çmuar kaqë shumë vleftën makinës së tyre se sa në këtë rast. Dhe sikur të ishin marrë vesh me njeri tjetrin, i erdhën rrrotull makinës, ashtu siç i vjen rrrotull fshatari kalit, kur i ngordh në rrugë, duke e shkuar edhe me keqardhje edhe me zë-mërim.

Xhemili u mat t'i binte me shkelm, sikur makina të ishte gjë e gjallë e të përtonte të ngrihej, pastaj ndërroi mendje; e pështyu sa mundi dhe filloj të shante:

— Pty...! Ç'të të bëj tashti?

— Domethënë mbaroi kjo punë e s'ka ç'i bëhet...? tha doktori ngadalë. Xhemilit iu duk sikur këto fjalë i tha për makinën, ndaj nxitoi t'i përgjigjej.

— Ç'do t'i bëhet? Pa rrrota nuk shkohet në G...
— Eh! — psherëtiti doktori, duke vënë dorën në ballë
— s'më ka ndodhur ndonjëherë kështu...

Dikush e thërriti:

— Doktor, të kërkojnë.

— Kush?

— Të presin në shtëpi për drekë.

— Drekë? Mirë, mirë; thuaju që do të vijë... Jo, jo,
thuaju që hëngra në spital...

Xhemili u hoq mënjanë dhe ndezi një cigare. Vjedhu-
razi kishin ardhur aty pranë edhe të katër fshatarët, që
s'dinin ç'të bënin.

Doktori iu afrua Xhemilit, e zuri për krahu dhe shtërngrroi fort.

— A e di që duhet shpënë në G... — bërtiti si pa që-
në vete. — Ç'do t'i bësh. Xhemil? Folë!

Xhemili e përbajti vehten si asnijëherë tjetër e iu
përgjegj me një zë të butë, ku ndihej edhe një farë qortimi:

— Ç'faj të kam, o doktor? Mos kam makinë e s'dua ta
shpie...

Doktorit i erdhi turp për sjelljen e tij n'ato sekonda,
kur s'e zotëroi dot veten, dhe e hoqi dorën menjëherë.

Një nga ata fshatarët, një burrë korrozi, i veshur në
një palë rroba shajaku, u shkëput nga shokët dhe iu afrua
doktorit.

— S'kemi ç'bëjmë, o doktor, s'ka maqinë, s'ka; e Perë-
ndisë le të bëhet... S'ka gjë. Na jep ne një vig të mi-
rë, dhe e shpiem në krahi.

Doktori e kundroi me çudi dhe në fillim s'po i kupton-
te ato fjalë që i thosh ai; pastaj, kur u mendua, hapi sytë i
habitur dhe tundi kokën në shenjë mohimi:

— Është larg... është larg... 50 kilometra rrugë — pësh-
përiti.

— S'ka gjë, doktor, do Perëndia gjejmë rrugës ndonjë
makinë dhe...

Doktorit iu tret gjithë zemërimi që e kish pushtuar e
tani ndjente një dashuri të madhe e të fortë për këta fsha-
tarët me zemër kaqë të pastër, të singertë e të dhembshur.

Dashuria e tyre e lëndoi; ajo qe e thjeshtë dhe e pastër si dashuri fëmije dhe zgjoi në shpirtin e tij ndjenjën se dashuria e njerëzve për njeri tjetrit është më e madhe se sa lavdia e më e çmueshme se ajo.

— Është larg... Është larg — përsëriti doktori me vethen e vet dhe ngriti sytë në një nga dritaret e katit të dytë S'andejmi vinin rënkimet e shtatzënës.

* * *

Xhemili ishte hequr mënjanë, qe ulur mbi një gur, kish mbështetur kurrizin tek muri i spitalit dhe pinte duhan me usëll të madh.

Iku doktori, e pas tij ikën edhe ata fshatarët. Mbeti vetëm Xhemili e, afër tij, autoambulanca e prishur. Të dy qenë të heshtur, të mjeruar dhe të lënë mënjanë. Kush kish nevojë për ta?

Ah po! ajo gruaja po rënkon akoma. Vuan. Qan. Lebetitet. Kushedhi, së shkretës, i vjen keq të ndahet kaqë shpejt nga bota. Të gjitha këto i dëgjon Xhemili. Sa mire do ish të mos i dëgjonte, po a ka vend në botë ku të fshihej e të mos i dëgjonte?

U ngrit nga vëndi. I vajti mëndja të delte në xhade e atje të priste mos kalonte rastësisht ndonjë makinë, atëherë me siguri do ta rregullonin punën. Sa i pëlqeu kjo mëndje në fillim, aqë qesharake iu duk pastaj.

Kumeshi është një skaj i largët. Rrugët kryesore të automobilët e lenë mënjanë si bërryl, dhe lëvizja e automjetevet është e pakët, shumë e pakët. Njëherë në ditë vjen autobuzi nga qyteti G... që sjell postën dhe pasagjerët, dhe pastaj hiç. Veç në behar ndryshon puna. Në stinën e verës — e kjo nuk zgjat më shumë se dy tre muaj — kamionat radhijnë pa pushim. Vijnë e ngarkojnë lëndë druri, në një sharrë që gjindet nga 15 kilometra larg Kumeshit — e vetmja ndërmarrje e këtij rrathi. Para disa kohëvet, banorët e Kumeshit e ëndërruan qytetin e tyre plot gjallëri me makina që vej e vinin, me zhurmë e punë shumë, sepse në një fshat aty afër ish gjetur qymyrguri e flitej se do të hapej r. jë minierë e madhe, mirëpo

ëndërat e tyre shkuan kot, se vëndburimi nuk u vu në çfrytëzim nga që rezervat qenë shumë të pakta. Dhe kësh-tu Kumeshi mbeti përsëri Kumesh.

Të gjitha këto i shkuan ndërmënd Xhemilit pa dashur. Pastaj ferkoi ballin me dorë, si për të larguar ndonjë mendim që s'e linte të qetë dhe u ngrit më këmbë.

Nuk i rrihej në një vend. Hapi derën e prasme të makinës, i shikoi edhe njëherë kopertonat që i kish hedhur atje pa kujdes, e që u delnin llapat si gjuhë, e foli me zë të lartë.

— Nuk i mbajnë, jo, nuk i mbajnë kamerdaret, këta kopertona! Shiko si janë bërë: shoshë fare. E, ore Spiro, mos më rënëg në dorë!

Prapa spitalit, atë çast, u duk Gaqua, hipur mbi atë biçikletën e famëshme. Xhemili e pa me zili e mendoi: «Ky, të paktën, s'pëson avari nga gomat. Sa mirë! Po sikur t'i kishte dhe makina gomat kështu?»

E me të thënë këto, si vetëtimë i kaloi ndër mënd një ide, të cilën ai e rrëmbeu menjëherë.

— Po sikur... po sikur dhe unë t'i mbush..? Çfarë të mbush? Kopertonat? Do mbajnë thua? Pse të mos mbajnë..?

E kapi këtë mendim që i shkrepi në mëndje në ato minuta të vështira, dhe, si i marrë, u sul në spital. I dha një të shtyrë derës e, si për inat, ajo s'u hap. Atëherë i ra me bryl xhamit, e bëri copë-copë, futi dorën përbrënda dhe e hapi. Pas pak doli s'andejmi me një dyshek nën sphetull. Si e përplasi në tokë, e shqepi me nxitim dhe nxori një tok të madh me kashtë. Pastaj mori kopertonat dhe filloi t'i mbushte me kashtë e me lecka. Nuk po vinte re asgjë. I bëri duart e gishtërinjtë gjak dhe as që i ndjeu fare. Kur s'arrinte ta kapte telin me duar, e zinte me dhëmbë dhe e shtërgonte me një pasion të tillë, sa të vinte mëndja se ishte duke shqyer armikun e tij më të tmershëm.

Sa zgjati kjo punë? As ai s'e mori vesh.

Si e ngriti makinën në kriko dhe vendosi një nga rrrotat e përparme, u largua pakë, ngriti supet dhe e shi-

koi punën që kishte bërë me dyshim. Vallë a do mbante? A shkohej gjer në G... me të tilla rrata?..

* * *

Më në fund si e montoi edhe rrotën tjetër, zëmërdredhur, e provoi. Gjithë shprehja e fytyrës tregonte ankthin që e mundonte e gjithë mendimet i kishte të përbledhura vetëm në një pikë. Makina u drodh, motori u ndez, parafangua filloj të luante ritmikisht e Xhemili shkeli pedalin e hoqi frenën. Makina u nis, ajo ecte. Tronditej me shumë se zakonisht, sikur ishte duke shkuar në një rrugë me gurë, po, për të ecur, ecte. N'ato çaste, Xhemilit i rrahu zëmra gjithë gëzim (si atëhere kur mori timonin për herë të parë) dhe me një frymë i erdhi rrrotull spitalit.

Doktori, me të dëgjuar zhurmë makine, zgjati kokën nga dritarja dhe u çudit, kur pa autoambulancën e tyre që zvarritet ngadalë. (Pikërisht së sipërm i ajo dukej si një kafshë që zvarritet).

Makina erdhi e qëndroi te dera e spitalit.

— Ej Xhem, si është puna? — pyeti doktori.

Ai nuk u përgjegj, veç luajti dorën në erë, siç e kanë zakon shoferët, para se të nxjerrin ndonjë të sharë nga goja e pastaj doli nga kabina.

Doktori pyeti përsëri:

— Jona është?

— Jona, po e kujt?

* * *

Në pesë minuta, çdo gjë qe gati. Në ato çaste, sikur ta kishin porositur, erdhi «shënjtori Leks». Pyeti me habi të sinqertë:

— Xhemil-o, ku i gjete kopertonat?

— Ja, i rregullova kështu me copra e me tela... — iu përgjegj Xhemili serioz, pa vënë re se kush e pyeste.

— Do mbajnë thua? — pyeti përsëri Leksi.

— Do mbajnë që ç'ke me të...

— Po ti kushëdi kur sosesh në G... Nesër, besoj. Me këto rrota...

Atë qast Xhemili vuri re me kë po bisedonte dhe iu shkrep të tallej.

— Pse, vetëm me rrota do ta lë? Unë do t'i vë krahë makinës...

— Krahë, the? — hapi sytë i habitur Leksi.

— Krahë po, si aeroplan. Dhe do fluturojë makina, kur ta shikosh ti...

— Ikë, ore... E ku i ke krahët?

— Ja, tani do të na i sjellin nga kooperativa e zdruk-thëtarëvet. Erdhi Ndrekua e mori masën. Pse, mos ka ndonjë marifet të madh, a?

— More! — u çudit Leksi — po si të ra ndër mënd xhanëm?

— Ja që më ra...

— A më merr dhe mua, se s'kam hipur kurrë në aeroplan...

— Gomar je, o Leksi, mos të të vijë rëndë. Po edhe këtë e besove, or t'u mbylltë? — vuri buzën në gas Xhemili.

Leksi deshi të përgjigjej, po s'pati kohë se, në atë qast, nga dera e spitalit nxuarën shtatzënën mbi një vig.

Kur po e futnin në makinë, iu avit Mihali dhe e pyeti duke i afuar ftyrën si të dëshéronte ta puthte:

— E, moj Rina, si dukesh tani?

Ajo tundi kokën, shumë e dëshpëruar; ato buzët e enjtura iu drodhën dhe sytë iu mbushën me lot.

— Aman, Miho, mos më lër vetëm... Kam frikë.

— Jo, jo, mos ki merak...

* * *

Xhemili ndjeu se dikush ja shtërngoi krahun si me darë. Ktheu kokën dhe pa ftyrën e vrënjtur të doktorit dhe atë vështrimin e tij të rreptë që të përshkonte tejetë?

— Si thua, a do të na shpjjerë?

— Do na shpjjerë, me siguri! —

Xhemili foli kaqë i vendosur sa u çudit dhe vetë. Ai ja kishte frikën së përpjetës së Bredhit, po këtë nuk ja

tha asnjeriut, këtë ai s'donte t'ja thoshte as vehtes së vet.

Makina u nis. Xhemili e Mihua hipën përpara, kurse doktori s'deshi të ndahej nga e sëmura dhe hapi prapa.

Shkuan mespërmes qytetit. Kur kaluan përpara fu rrës, doli Nasho Qyqja dhe, siç e kish zakon, i përshtëndeti duke tundur mbi kokën e tij, atë dorën si lopatë.

Si bënë nga dy kilometra, një llapë e kopertonit nga ana e djathtë u lirua, e sa herë binte në tokë, bënte shllap, shllap, shllap... dhe, duke përzënë pluhurin, linte nga një shënjë, sikur e kishin vënë pér të matur rrugën. Dhe u zgjat e u zgjat kjo shenjë nga një qytet në tjetrin si një shkallë fitoreje në rrugën e dashurisë së madhe njerëzore.

Makina vraponte në rrugë dhe, prapa saj, ngrihej një pluhur i hollë në ngjyrë të tokës, i cili binte pastaj ngadalë, mbi bimët e grurit që sapo kishin filluar të ngallnin, mbi lulëkuqet që dukeshin si ca pika gjaku të shpërndara nëpër fushë dhe mbi lulet e kaltërtë të lirit.

Rrëzës dukeshin aty këtu fshatra, me shtëpija të ndërtuara me gurë e me çatitë prej tjegullash të kuqe, e më përtej ngriheshin malet e lartë, që rrrethojnë Kumeshin.

Të gjitha këto tanë dukeshin se kundronin me një farrë ankthi, autoambulancën e gjelbërt të spitalit, që shkonte mes aravet të mbjella me grurë duke lëshuar pas një tym të hollë.

E njinte Xhemili çdo pëllëmbë të kësaj rruge se e kish rrahur me qindra herë. Ja ura, ku u rrëzua dimrit një makinë, ja edhe tanksi i djegur qysh në kohë të luftës dhe i nxirë nga shirat, më përtej është një gorricë bufkë, pastaj vjen ajo ura e ngushtë prej druri. Xhemili e dinte symbyllur këtë rrugë, prandaj i dukej e shkurtër, kurse sot, sot kjo rrugë s'kish të mbaruar. Pse ishte zgjatur kaqë?

Xhemili kthente kokën e shkonte atë vëthin e er gjëntë të Mihos, aë tundej pa pushim. Ky vëth, vetëm ky, i tregonte se maqina ish në rregull dhe vazhdonte të ecte.

Prapa makinës mbeteshin vazhdë fije kashte që del-

nin nga kopertonat, po këto s'i vinte re as doktori as Xhemili; ato i shikonin vetëm shpendët e qiellit.

Si kapérxyen dhe të përpjetën e Bredhavet e dualën në fushën e Madhe, Xhemili ja shkeli gazin. Shpirtin e tij tani e kish përmbytur gëzimi i kësaj pune që po bënëte dhe të gjitha nervat e tij ishin të tendosura, si një hark shigjete i ngreher.

Ndjente një kënaqësi që s'e kish ndjerë kurrë. Sa të sëmurë kishte shpënë e kishte sjellë ai, po për të gjithë ai kishte mbetur pakë si i huaj e i largët, sepse edhe puna e tij ashtu ishte, të ngiste makinën dhe asgjë tjetër. Për shëndetin e për jetën e të sëmurëvet përgjigjej tjetër kush, kurse sot, kishte bërë edhe ai diçka.

Aty nga ora pesë arritën në Spitalin e Madh, me portat prej hekuri e me parmakë të lyer me bojë të gjelbër.

Makina u fut me të shpejtë në oborrin e spitalit. Shtatzënën e zbritën dhe e futën brënda në sallën e operacionit. Xhemili iu afrua doktorit, e zuri për krahu dhe e pyeti për atë gjë që i kish djegur zëmra gjithë rrugës:

— A do shpëtojë ajo gruaja, Doktor?

Doktori ngriti supet.

— S'e di, po duhet të shpëtojë, duhet... Doktori u mat t'i thoshte:

«Ti, Xhemil, e shpëtovë! Ti sot ke bërë një heroizëm që s'e ka bërë shofer tjetër», — po s'di se përsë nuk ja tha, e u mjaftua vetëm duke i shtërtnguar dorën. —

Kurse Xhemilit as që i shkonte mëndja se ish heroizmë të mbushje kopertonat me kashtë e me lecka e të transportonje një të sëmurë. Dhe kjo kuptohet fare qartë, se Xhemili pasi ndezi një cigare, u ul në sedilje, vuri duart në timon dhe filloi të mendohej, se erdhi që erdhi gjer në qytet, do ishte mirë t'u blinte fëmijvet ndonjë peshqesh, mirëpo ishte në hall se nuk dinte çfarë të zgjidhte.

LAKMIA

Nga jashtë, i përngjiste shumë «njeriut në këllëf» të Çehovit. Vishej trashë dhe kaqë keq i rrinën rrobat në trup, sa menjëherë formoje bindjen se këto roba dikush do t'ja kish falur pér lëmoshë. Në kokë mbante një beretë të zezë, të cilën e ngjishte gjer te veshët; xhaketa, e gjerrë e zhubrosur dhe e ndyrë, i vinte e gjatë dhe e tre grote të përcmuar; çipat e saj përpara i vareshin dhe i preknin gjunjët, sepse xhepet i mbushte me turli sendesh, kurse prapa i ngrihej në formë harku. Në këmbë, dimër e verë, mbante një palë çizme llastiku, edhe këto natyrisht jo si pas këmbës; përveç këtyre dimrit do ta shikoje me një ombrellë në dorë, kurse beharit me një farë bastuni; por kuadri nuk do t'ishte i plotë sikur të harronim një pipë gjysmë të djegur, të cilën s'e hiqte kurrë nga goja.

Vinte i shkurtër, i pocaqisur, fytyrën e kishte tërë zhubra si brumë të ardhur, hundën të hollë, të hequr e të verdhë, sytë i kishte të vegjël, dinakë si të shqarthit e me një shkëlqim të gjelbërt. Vetëm këta sy të lëvizshëm e të ndritshëm tregonin se brënda atij trupi kishëte një shpirt.

Mirëpo vetëm nga jashtë i ngjiste «njeriut me këllëf», kurse brënda në shpirtin zienin ca forca të tjera e ca pasione të çuditëshme. Nuk u ndruhej njerëzvet, përkundrazi mundohej të rrinte gjithmonë mes tyresh, të hapte

muhabet, të mësonte ndonjë gjë, kurse të tjerët mërzitesh
shin nga prania e tij dhe e përqmonin. Me ta parë këtë
njeri të vogël, të shpëlarë e të poqaqisur, njerëzvet u lin-
dëte dëshira ta poshtëronin, ta fyenin ose ta ngacmonin.
E ai e ndjente talljen, përbuzjen, përqmimin dhe, nga që
i ndjente, vuante ca më shumë.

Shpirti i tij i vogël nuk ëndëronte dot gjëra të më-
dha e të bukura, vetëm lakmonte. Lakmia qe rritur në
shpirtin e tij si kanceri, duke i atrofizuar gjithë vetijat e
tjera. Lakmonte rroba të bukura, një shtëpi të madhe,
lakmonte para, sidomos para. I dukej se paraja qe kyçi i
gjithë jetës, e se po ta kish atë, do të lartësohej menjë-
herë, e s'do të qe më Çule Peci, me të cilin tallej gjithë
qyteti i vogël.

Zilia dhe cmiri ishin rritur tok me të. Për këtë kish
faj edhe e éma. Xhulja (ky ish eméri i vërtetë) kish dy
vëllezër të tjerë, një më të madh e një më të vogël. I ma-
dhi qe i dobët dhe i handakosur dhe prandaj e éma
mundohej t'ia bënte qejfin më shumë. Ajo e pekulepste
Topullanë duke i dhënë gjellërat më të mira, kulaçin më
të madh, majën e gjërit. Çules nuk i vinte mirë, ckinjej
e me lakmi i thoshte s'ëmës:

— Dua dhe unë nga ajo që i dhe Topullajt.

E éma, natyrisht s'kish çfarë t'i jepte, atëhere ky,
përgjonte rastin e volitshëm, ja rrëmbente të vëllajt nga
duart dhe therte përjashta me sa fuqi që kishte.

Vëllaj i madh nuk rrojti shumë e, për çudi, kur vdiq,
Çules nuk iu dhimbë, sepse duke e parë gjithmonë të së-
murë ai ish mësuar me idenë se ky njeri do të vdiste
shpejt. Nga ana tjetër shpresoi se gjithë kujdesi i tepë-
ruar që tregonte nëna për vëllanë e madh, tanë do të bin-
te mbi këtë.

Mirëpo, pas vdekjes së vallajt as e éma nuk rrojti
shumë dhe, ndofta bëri mirë që vdiq, që të mos shikon-
te me syt e saj se si iu katandis i biri.

Pas disa vjetëvet — atëhere kur Çulja e quante ve-
ten të rritur Nexhmedin Beu që ishte nënprefekt i qy-
tetit, tallej dhe ia kish qejfi ta vinte në lojë këtë burrec.
Shakaja e tij ishte gjithmonë e njëllojtë. Kudo që të ndo-

dhej, në kafene ose tek sheshi i bashkisë, me ta parë Çulen e therriste:

- Çule, hajde këtu.
- Urdhëro, bej.

Çulja duke hequr këmbët zvarrë, i pakët dhe i kus-pullo sur si urith, vinte dhe i qëndronte përpara pa guxuar ta shikonte në sy.

- E po si vete, si shkon, mirë je?
- Mirë, falemnderit.
- Çule! — thoshte beu duke buzëqeshur me djallëzi.
- E.
- Urdhëro thuaj, mor derr.
- Urdhëro.

— E ke a po ta ka ngrënë macja? (Koka e Çules varej përbimi gjoks aqë sa i piqej mjekra në sternum) — Hë mor, folë, se më lajmëruan që ta ka ngrënë macja.

Ata që ndodheshin rrëth e rrotull fillonin të qeshnin e të hidhnik romuze.

— Hajde, çkopsitu në mos po i dhashë urdhër Thanas Politit.

Dora e Çules ngadalë çkopsitëte kopsat një nga një... Kërciste gazi rrëth e rrotull. Beu qeshte me gjithë zëmër duke mbajtur ijet me duar, pastaj çkopsiste qemerin e i hidhët Çules 2-3 lekë të këmbët.

— E paske, o Çule, merri këto dhe ikë tamë.

E Çulja ulej mblidhte lekët dhe, i përcjellë nga të qeshurat, ikte kokëunjur dhe i vrarë në shpirt.

Nuk çuditej që beu i hidhët paratë rrugëve dorë-hapur, se thoshin që Nexhmedin beut i ati ja kishte lënë florinjtë me barrë.

Nja dy herë, i inatosur nga poshtërimi që i bëhej, Çulja kish kundërshtuar me kokëfortësi, po atëhere beu dëfrente ca më tepër, se dërgonte tre katër veta ta zinin, dhe puna përfundonte po aty... pantallonat çkopsiteshin.

Nga përbuzja e shoqërisë së atëherëshme ndjenjat iu fishkën: keq-ardhjen s'e njoihu, mëshirën s'e kuptonte dhe, duke ardhur rrotull, rrëtej e jetonte pa e kuptuar përsë. Edhe guximi për të bërë diçka tjetër të panjohur i mungonte, kështu, të shtyrë herë andej, herë këtej, e gjeti

lufta. Po as ajo nuk e zgjoi. Atëhere Çulja hapi një kuvli të vogël ku shiste çikërrima po me që s'dinte se si bëhej tregëtia në kohë lufte, të shumtat e mallravet i dha vere-sie dhe, ai që vinte me shpresë se dikur për mallrat e shitura do të nxirte edhe kamatën, s'arriti të merrte asgjë. Megjithatë fletoren e veresievet e kish fshehur, tok me paratë dhe e ruante me kujdes.

Fitonte ca para se shiste biletat tē llotarisë së Kryqit të Kuq dhe disa libra fetare tē vjetra. Përveç këtyre, në fillim të çdo viti, shiste ca kalendarë fetarë sipas vitevet hixhri dhe rumi. Këta kalendarë e numuronin botën 580 vjet më prapa e sipas tyre tanë jemi në vitin 1379!

Por megjithse shpesh mund ta shikoje me libra ndër duar, ai s'i hapte kurë; ato i mbante vetëm sa për t'uashitur të tjerëvet e i shikonte si vlera që i jepnin lekë. E vetmja gjë që lexonte Xhulja qenë lajmërimet e vdekjevet që afishoheshin nëpër shtyllat e qytetit. I lexonte nga kurioziteti që të mësonte diçka tē re, e të kishte ç'të fjaloste me njerzit, apo thjesht për qejf, kjo është zor të përcaktohet. Sidoqoftë, pas ç'do lajmërimi tē tillë, ai thoshte me një farë gëzimi:

— Iku edhe ky! Na e la shëndenë!

Çulja e mblidhte paranë si plaga qelbin, sepse lammonte që një ditë tē bëhej i pasur, dhe paratë që vintë mënjanë nuk ja tregonte as kuit, bile as gruas së vet.

Kryetari i Komitetit Ekzekutiv e kish thërritur disa herë, sepse i vinte keq për 'të dhe donte ta vinte në ndonjë punë, ku tē kish, të paktën, një rrogë tē caktuar, po Çulja gjithmonë e kish kundërshtuar.

— Aman, mos më ngatërrro, kam frikë, se nuk e bëj dot — dhe largohej i kënaqur që s'ish futur në punë.

Duke ardhur rrötull, e kish bërë hesap që nxirrte më tepër se një rrogë dhe ishte i pari që përfitonte nga ndihmat që jepte pushteti, kurse, po tē futej me rrogë, atëherë ndryshonte puna. Ditën e pazarit shiste e blinte ca vjetërsira dhe atë drekë e hante përjashta.

Në familje ajo ish dreka më e qëtë dhe më e lumtur. Çulja kish një zakon tē keq: Kur hanin bukë e kur merrnin thelat e numuruara tē mishit, me sy tē çakërrim

tur vërente se si ndaheshin. Gjithmonë i dukej se dikujt prej fëmijëve i kish rënë thela më e madhe e më e mirë. Atëhere në mes të bukës zgjatëte dorën në anën tjetër të sofrës e ja rrëmbente thelén, duke i thënë:

— Dale se kjo jotja qënka më e madhe. Na, merr këtë timen ti.

Po kur e këmbente, përsëri bëhej pishman dhe i dukej se me dorën e tij i kish dhënë thelén më të mirë. Atëhere e kundronte me sy ziliqari dhe shfrynte gjithë inat kundër fëmijëvet hairsëz.

Sido që e shoqja mundohej ta kënaqte, duke i dhënë gjithmonë më shumë, zémra e tij e zilepsur ja verbonte sytë dhe pjesa e tij i ngjante kurdoherë si më e vogla e më e keqja. Ndaj, kur s'e kishin atë në sofër, të gjithë në familje e ndjenin veten të claruar e të kënaqur. Dikush do të thotë se ata do bënin mirë të hanin gjithmonë përparrë ose prapa të jatit, mirëpo Culja nuk shtronte dy sofra dhe duhej të mblidheshin të gjithë, pastaj të fillonte buka.

Nëpër xhepet e tij, përveç qeses së duhanit, do të gieje gjithmonë ca kopsa, rruaza prej xhami, ndonjë zar të vjetër, me një fjalë çdo gjë që sytë e tij të mprehtë e gienin të lënë ose të harruar në rrugë. Ai besonte se edhe këtyre sendevet do tu vinte koha që të hynin në punë dhe se në botë asgjë s'është pa vlerë. Veç për të vjedhur nuk vidhete.

Fjalët aë dégionte, i shpinte andej këtej me zell të madh. E gjithmonë kishte aejf të thoshtë gjëra që t'i trondiste të tierët e t'i bënte të mendoheshin. Ishte zë-dhënës i parullave disfatiste.

— Keq e kemi sivjet. Ka thënë nië baba teqeje se do të bëjë dimër i madh, sa do të ngordhin haivanuria.

I vinte mirë, kur i shikonte njerzit të ngrvsur në fiftërye dhe të heshtur, i dukej sikur merrte hakën për të këqiat aë i punonin.

Sot ndiehej i kënaqur se kish bërë dy punë të lever-disëshme. Kish gënijyer një fshatar duke i shitur një kalendar të vjetër, gjoja se ishte i këtij viti, dhe ajo që e gëzonte më shumë ish se pat përzënë të vëllanë e vogël nga shtëpia.

Këtë gjë ai e quante fare të natyrëshme dhe të drejtë. I vëllaj kish humbur nga gjashtë a shtatë vjet andej nga Tirana e tani, pa pritur e pa kujtuar, ish kthyer në shtëpi. Në darkë Çulja e gjeti në krye të odës.

Ardhja e të vëllajt nuk i pëlqeu. E mori me mënd se atë do ta kishin përzënë nga puna ose kish ikur vetë dhe, ndofta, këtu kish ardhur me të vetmin qëllim që të shishte shtëpinë, të merrte pjesën që i takonte e pastaj të kërtiste e të ikte.

Megjithatë, deshi të sigurohej, dhe me marifet e pyeti larg e larg, në i kishte sjellë gjë shtëpisë. Kur e mori vesh se ai qe trokë nga xhepi, s'i mbeti më asnje dyshim për qëllimin e të vëllajt, dhe u ngrit e me një gjest kuptimplotë, mori bastunin që e kish lënë prapa derës, e u afrua gjer në mes të dhomës.

— Pa më thuaj: pse ke ardhur? — e pyeti duke tundur bastunin në erë.

— Erdha në shtëpi, — iu përgjegj ai që nga kreu i vëndit.

— Në cilën shtëpi?

— Në shtëpinë time.

— S'ke shtëpi ti. Shtëpinë ma la mua plaka, se unë e mbajta kur vdiq.

— Po unë a s'jam yt vëlla?

— Jo, s'të njoh pér vëlla. Vajte bëre qejf sa deshe andej nga Tirana, dhe tashti më vjen e kérkon shtëpi. Hapt, këput qafën dhe të mos të t'i shikoj sytë! Vëlla je ti vetém pér të rrëmbyer? Qëromu nga shtëpia.

E shoqja i tha se ish turp ta përzinin nga shtëpia pa ardhur mirë, kurse Çule Peci s'pyeste pér turp, dhe mendonte se po ta linte pakë aty, ay do të zinte rrënëjë, prandaj sa më parë që të ikte, aqë më mirë do të ishte. Dhe pér këtë punë tanë i vinte mirë.

Duke ecur rrugës, sytë i panë një biçak të thyer. U ul, e mori, e ktheu nëpër duar, pastaj e hodhi në xhep. Më tutje qëndroi edhe njéherë, shkundi hirin e llullës në pëllëmbën e dorës, pastaj e fshiu pëllëmbën pas xhaketës. Si e mbushi me duhan të ri, priti gjer sa i kaloi pranë një burrë me cigare të ndezur.

I dolli përpara edhe e ndaloj duke i thënë frazën e zakonëshme që përdorte këso rastesh:

— Më fal ta ndez pakë!

Kur e mbaroi edhe këtë punë; shkoi ta pinte llullën në qetësi, prapa Komitetit Ekzekutiv, aty ku gjënden një sërë gërmadhash të mbetur që nga koha e luftës. Për çudi, ky vënd i shkretë e i rrënuar, që s'kish asgjë të bukur, i pëlqente shumë se duket i ngjante shpirtit të tij. Gjente kënaqësi kur rrinte tek ky vënd i shkretë dhe s'dihej se ç'farë mendonte.

Ja, edhe sot, kish hipur mbi një mur të rrënuar dhe tundëte këmbët si fëmijët e vegjël. Nga çizmet e ngrohura në diell vinte era e llastikut e përzierë me erën e rëndë të dwersës. Aty më tutje, nëpër gërmadhat, luanin ca fëmijë, «tregurëzi».

Kishin ngritur tre potka në njerën anë, tre potka në anën tjeter, qenë ndarë në dy skuadra dhe i qëllonin potkat me gurët që merrnin nga gërmadhat. Ana që i rrëzonte e para potkat e kundërshtarit kish të drejtë t'u hipte të mundurvet në kurriz. Fëmijët ziheshin, qeshnin, thërisnin duke e mbushur gjithë atë vënd të shkretë me gjallëri e jetë. Çulja i pa përciptazi, pa interes, dhe midis atij grumbulli fëmijësh dalloj Reshatin e Osmanit, Nikon e Stefanit dhe të birin e kurbatit Nuzman, të cilin Çulja e kish mëri se ai i thërriste ofiqe në mes të pazarit.

Këtu dikur kish një sërë dyqanesh dhe, në mes të tyre, si kala, ngrihej shtëpia e Nexhmedin beut. Në kohën e luftës, aeroplani englezë patën bombarduar njëherë qytetin, dhe bombat kishin rënë mbi dyqanet. Atë që s'e shkatërruan dot ato, e mbaroi zjarri dhe kështu, vëndi i quajtur mëhallë e Kallamavet ish kthyer në gërmadha. Në atë bombardim kish gjetur vdekjen edhe Nexhmedin beu me fëmijët e tij. Tani, duke e shikuar shtëpinë e tij gur mbi gur, Çulja ndjente përbërnda një gëzim të heshtur e të përbajtur, atë gëzim që kanë njerëzit me shpirt të vogël, dhe i dukej se po hakmerrej për të këqiat që kish hequr e për talljet që kish pësuar. Pikërisht duke e parë të rrënuar, ndjente nga brënda një kënaqësi të

ingrohtë. Ndofta ky ishte shkaku i fshehur që e pëlqente këtë vënd. Dukej se i thoshte:

«U talle me mua, po të zunë hakat e mijë... Aty, nën gurë të dolli shpirti.»

Edhe gjëzimi i tij, kur mori vesh vdekjen e beut, ishte ndryshe. Të tjerët u gjuan, se shpëtuan nga një satrap, nga një tradhëtar i Atdheut, kurse Çulja u gjëzua vetëm që shpëtoi nga e qeshura e tij, dhe nga okubetet që i punonte.

«Vdekja është ilaç,» tha me mëndje.

Çulja kishte një nderim të çuditëshëm për vdekjen. «Vdekja, ajo i fshin njerëzit, pa i pyetur si e tek janë. S'pyet ajo, në je i pasur a në je i varfër, në je i ri a në je plak, në ke pozitë a në s'ke». E nga kjo gjë e admironte heshturazi dhe i dukej se ishte e vëtmja fuqi që s'mban te hatër dhe përpara së cilës njerëzit dridheshin. Ndofta ai e admironte se përpara saj e ndjente veten të barabartë me njerëzit e tjetër...

E shkundi pipën pas një guri dhe e vuri në xhepin e vogël si ta kish stilograf.

Fëmijët tanë s'po luannin si më përpara dhe zhurma që platin tur menjëherë. Ishin mbledhur përfund një gërmadhhë dhe dic shikonin. Veshi i mprehtë i Çules dëgjoi:

- Më mirë të mos ja tregojmë njeriut...
- Unë them t'a shpiem në shtëpi të pionierit.
- Po sikur të jetë bosh?
- Dale ta shikoj... a është e rëndë?...

Çulja e mori me mënd se ata diç kishin gjetur. U bë kureshtar.

Zbriti nga kthisi ngadalë dhe, duke ecur me kujdes përmbi gurët, nga frika se mos e dëgjomin fëmijët, u afroa. Shkopin e futi nën sisetull dhe eci drejt tyre pa u ndjerrë fare, si një mace e shkathët. U vajti mbi kokë dhe, me atë vështrimin e tij të mprehtë, vuri re se Nikua i Stefanit kishte në dorë një kuti të vogël, të rrumbullaktë dhe të zezë. Reshati i Osmanit ja mori dhe e peshoi në dorë.

— Po sikur të jetë me florinj? — tha Reshati duke ngritur vetullat përpjetë e duke hapur sytë në mënyrë të jashtëzakonëshme.

Fëmijët e tjerë e shikuani me kureshtje e me habi. Çulja u drodh e u përmblodh si shqarthi kur bëhet gati të kércejë mbi gjahun e tij. Ata sytë e gjelbërt i ndritën e i lëshuan xixa nga shkëlqimi. Po sikur të ishte vërtet me florinj? Ndjeu se diçka ja zuri grykën dhe mëndja e trondititur nga kjo ide, si një gjë e ujëshme i luajti brënda në kapakun e kokës. Vizione të çuditëshme filluan t'i çafaqeshin përpara syvet. Tëmpthet filluan t'i rrahin me forcë.

Aty ishin në gërmadhat e Nexhmedin beut. S'është çudi të ishte ndonjë kuti mbushur me verdhushka, nga ato që Nexhmedin beut ja kishte lënë plaku me barrë.

Si t'ua merrte fëmijëvet, si t'i gënjeni? T'u jepte ato gjérat që kishte në xhep, vallë a do të bindeshin?

— Ta hapim! — tha njëri nga ata.

Cules iu drodh zëmra dhe ndjeu një tendosje në gjithë muskujt e trupit. Në qoftë se ata do ta hapin, Çulja e mori me mënd, se as që do të mund ta shtinte më në dorë atë kuti. Aty fshihej lumtëria e tij, dëshira e tij për t'u bërë i pasur, ikja nga ky qytet i vogël, gjithë pluhur verës e gjithë baltë dimrit, dhe èndra e ethëshme për t'u bërë njeri me dinjitet.

Instikti e mësoi ta mblidhët veten shpejt e t'ua hiqte mëndjen fëmijëvet nga ajo kuti e gjetur rastësisht në ato gërmadha.

U foli me një ton të qetë, gjoja sikur t'i këshillonte për mirë:

— Ore fëmijë, ç'ju duhet ajo? Lëreni atje ku e gjetët!

— Pse, ç'do ti?

Çulja përsëri foli, e ndërsa fliste, sytë s'i hiqte dot nga ajo kuti cilindrike, pakë e zgjatur dhe e zezë.

— Lëreni se kush e di mos ka brënda ndonjë xhind, se ata nëpër gërmadha rrinë — tha përsëri me dinakëri për t'i trëmbur.

Fëmijët qeshën.

— Xhinde! ku ka xhinde, tan? Ne kemi mësuar në shkollë se xhinde s'ka.

— Ma jep mua, o Reshit, se më hyn në punë tha Çulja sikur lipte ndonjë gjë.

— Pse, ç'e do ti?

— Ta bëj kuti pér duhan. — i tha me një zë të pér-vuajtur.

— Ku bën kjo pér duhan, kjo është kalbur fare.

— Hë, se ja heq zgjyrën unë.

Shikoi një herë rrëth e rrotull. I vinte të hidhej e t'ua merrte me forcë. Veç duhet të maste mirë hedhjen që ta kapte menjëherë, pérndryshe as që kish pér ta marrë kurrë. Fëmijëvet atëhere do t'u hynte dyshimi se kishin gjetur një gjë me vlerë e do ta mbronin me çdo kusht.

— Hajde se do të të jap një biçak dhe një zar prej çeliku.

— Ku i ke?

— Ja, këtu në xhep i kam.

— Nxiri t'i shoh.

Çulja futi dorën në xhep dhe nxori thikën që kishte gjetur në rrugë, ca pulla, një zar prej çeliku e disa çikerrima të tjera.

Djali i shikoi me kureshtje sendet që i vezulluan pérpara syve dhe u bind.

— Mirë, — i tha dhe i zgjati dorën të bënte këmbimin.

Mirëpo, atë çast, Nikua i Stefanit ja rrëmbeu kutinë Reshatit nga dora, duke i thënë me inat:

— Ja jep ti, po s'ja jap unë; pse ti e gjete?

— Hajde se do të të jap edhe ty diçka... tha Çulja me të lutur.

— Jo, s'dua.

Çulja e kuptoi se Nikon tani e kish pushtuar ajo kokëfortësi e çmëndur që i kap ndonjë herë fëmijët, të cilët, në ato çaste, pér t'i bërë qejfin vetes së tyre, sikur botën t'u falësh, nuk pranojnë të këmbejnë ndonjë send të pavlerë që mbajnë në duar. Po i ikte nga duart fati i tij dhe menjëherë e ndjeu vehten si një send të vogël e të rrumbullakët që rrukulliset tatëpjetë një greminë. Duhej t'ja rrëmbente me çdo mënyrë. Përgjoi çastin kur Nikua s'e kish mëndjen dhe, si një mace, u hodh e ja zuri dorën. Nikua s'bindej t'a lëshonte; atëhere Çulja ja kafshoi dorën me dhëmbë dhe ndjeu se sendi i dëshëruar mbeti në pëllëmbën e tij. Nikua, nga inati, i shkuli bere-

tën nga koka. Këto gjëra ngjanë kaqë shpejt, sa fëmijët s'patën kohë të vepronin dhe ndoshta u habitën kur për herën e parë panë Çulen e ngathët dhe të humbur të vepronte me aqë shkathësi e vendosmëri.

Kjo për ata qe një zbulim i ri.

Nikua u largua nga dy hapa dhe, duke qarë, filloi t'i bërtiste:

— Pse na e mer? Jotja është?

— Imja, po e kujt?

— Pse, ti e kishe fshehur?

— Unë e kisha fshehur, po kush, dhe ti vajte e zbulo-
ve. Hajde pa po s'i thashë tyt eti, të të zhdëpij në dru.

Nikua e shikoi me dyshim dhe nuk e besoi.

— Posi, ti e ke fshehur...

— Unë, po kush. Hajde pa po s'i thashë policit që trazoni nëpër gërmadhat... Dhe te direktori i shkollës do t'ju kallzoj.

Çulja, nga që e ndjente veten të pafuqishëm për të vepruar vetë, kishte zakon të përdorte gjithmonë autoritetin e një të treti, për të vënë nderin në vend, ose, të paktën, për t'i trëmbur fëmijët që ta linin të qetë. Emrat që përdorte më shpesh qenë: polici, drejtori i shkollës dhe babai i djalit.

Fëmijët u ngriten nga vëndi gjith inat, se trofeun e gjetur ua kishin rrëmbyer padrejtësish. Si u largua pakë, djali i Nuzman Kurbatit, filloi të qëllonte Çulen me guricka, dyke i thërritur:

«Çule — kokëfasule! Çule — kokëfasule!»

Këto fjalë i përsëritën edhe fëmijët e tjerë në kor, të kënaqur sa më s'bëhej. Pastaj, pa pritur, që nga rruga e qytetit u ndje një zhurmë e madhe dhe u duk krahu i gjatë i një eskanatori. Fëmijët e harruan Çulen se ua tërhoqi vëmëndjen kjo maqinë e çuditëshme, që s'e kishin parë kurrë e, duke thërritur, ikën me vrap si një trumbë zogjsh, duke mbushur me gaz e gjalléri rrugët e qytetit.

Çulja, i mbetur vetëm, futi dorën në xhep dhe me ata gishtrinjtë e trashë përkëdheli metalin e ashpër nga ndryshku të kutisë. Sikur vërtet të kish florinj! E pse jo? A nuk thoshin që Nexhmedin beu i kish me barrë?

Futi gishtérinjtë nën 'të dhe e peshoi. Kutia që mjaft e rëndë.

Zëmra filloi t'i rrihte me të shpejtë. U largua ngadalë nga pesëdhjetë hapa më tutje, duke shikuar rrëth e rrotull të gjente një vënd të qetë e pakë të fshehur që të mos e diktonte kush. U fut prapë një gërmadhe dhe u tullat pas gurëve. Nxori llullën, e mbushi me duhan dhe e ndezi.

Ngriti sytë. Dielli digjte. Qielli qe i pastër, i kaltërt e i kulluar. U ndje tingulli i ergjëntë i sahatit të kishës dhe këtë kumbim u duk sikur e përpiu qielli i pafund. Pastaj nga një megafon u dëgjuan tingujt e Radio-Tiranës dhe nisi melodia e një këngë popullore vlonjate. Çulja mbajti vesh. Nëpër rrugë tanë mesditë kish qetësi. Akrepët e sahatit nuk i pa, po e mori me mënd se po i afroheshin treshit.

Çulja e la shkopin mënjanë dhe nxori kutinë nga xhepi. Brënda në 'të iu duk se pa shkëlqimin e zjarrtë të floririt. E peshoi edhe një herë në dorë e pastaj e përpotoqi pas një guri. Ndjeu një tingull të mbytur e si të plogësht e dyshimi filloi ta brente. Vallë me se të qe mbushur? Duhej ta hapte. Shikoi edhe njëherë rrëth e qark, mos e përgjonte njeri e pastaj nxori biçakun prej xhepit. Ja hapi tehun ngadalë duke e provuar pas pëllëmbës e pastaj nisi ta shkyente kutinë. Nuk i durohej sa ta hapte e të mësonte ç'kishte brënda. Me dorën e mëngjër shtërngonët kutinë dhe me dorën tjetër ngulte majën e thikës në metal. Iu duk se e çpoi. Maja e thikës hyri thellë...

Atëhere pa pritur ngjau një diçka e tmerrshme: kutija i plasi ndër duar; tymi dhe flaka ja përzhitën sytë dhe forma plasëse e hodhi praptaz, mbi gërmadhën e gurëvet. Lulla i fluturoi nga goja si një zog pa krahë e pas një sekonde Çulja shikonte papushim një det me rrathë të kuq e të verdhë. Pastaj rrathët u shndrruan në monedha e Çulja lëvizte të dy krahët në erë, duke dashur t'i mbledhë, po ato sikur ishin të lëngëshme e të pakapëshme dhe i shkisnin ndër duar, e ai ndjente se bashkë me to, po binte nga një lartësirë e madhe drejt një humnere me shpejtësi të hatashme...

* * *

Kutija që u mori fëmijëvet kish qënë një bombë e vjetër dhe e ndryshkur e mbetur që nga koha e luftës. Veç nuk dallohej fare, sepse i qe kalbur rrypi dhe ajo mbulesa e bardhë prej alumini i kish rënë.

Bomba e plagosi shumë rëndë Çule Pecin, po për çudi, kur e përcuallën në spital, njerëzvet s'u erdhi shumë keq për 'të. Ai ishte si një kufomë e gjallë, të cilën me kohë, e kish sakatepsur shoqëria e mëparëshme dhe tani endej rrugëvet kot, dhe ndofta i vetmi shërbim, që i bëri njerëzimit, qe ajo ditë, kur lakmia e shtyri t'u shpëtonte jetën atyre fëmijëvet duke ua rrëmbyer bombën nga duart.

Tiranë 1959

... e tuzgashëria e lëshim se usiqylleriaq qëndrit e librit i
dëshirat e këtij vjetorit, qëndroj atë që dëshirat e tuzgashëria
e tuzgashëria qëndroj atë që dëshirat e tuzgashëria e tuzgashëria
e tuzgashëria e tuzgashëria e tuzgashëria e tuzgashëria e tuzgashëria
e tuzgashëria e tuzgashëria e tuzgashëria e tuzgashëria e tuzgashëria

Kujtimi të Heroit të Punës Socialiste

R. Ibrahimini

MINATORI PLAK

Një burrë i thyer, trupmadh, me shpatulla të gjëra
e pakë të kërrusura, duke tundur pas kofshëvet duart gjithë
xhongla, doli te dera e fjetores dhe, duke vënë dorën
si strehë mbi ballë, qëndroi papritur, sikur të ishte bërë
pishman.

Dëgjoi se dikush e pyeti:

— Ku po shkon, o Rakip?

Rakipi pa e kthyer kokën e kuptoi nga zëri se ai që i
foli ishte minatori pensionist, Jorgji Bratja.

— Andej nga klubi, them të vete, — iu përgjegj.

— Pse s'fle nga pakë tanj në vapë?

— S'fle dot. Një çikë po të fle tanj dhe s'më zë gjumi
tërë natën pastaj...

Xha Jorgji, që ish ulur në hije, rrëzë murit të fjetores
e po lexonte «Zérin e Popullit», u ngrit e, duke palosur ga-
zetën i tha Rakipit:

— Pritmë sa t'i jap Xhevahirit gazetën, se do të vij dhe
unë.

Rakipi e priti përjashta. Hieja e tij e shkurtër, sënga
dielli i mesditës, shtrihej mbi barin e thatë e të nxirë
prej pluhurit të qymyrit. Më tej, qyteti i vogël dremiste
nën rrezet e forta të diellit. Ky qytet i vogël minatorësh,
i ndërtuar në shpatin e një mali jo shumë të lartë, që mjaft

i ri dhe kishe përshtypjen se muret e ndërtesavet ruanin erën e llaçit të njomë dhe të gëlqeres. Ndërtesat vinin radhë, në formë patkoi: fjetoret, spitali, banjat, magazina, zyrat e dretorisë dhe klubit. Më tutje ngriheshin një sërë shtëpijash dykatëshe, ku banonin familjet e minatorëvet. Andej vazhdonin të ndërtonin akoma banesa të reja. Përpara të gjitha këtyre godinave, shkonte një udhë jo fort e gjerë, e shtruar me pluhur qomyri, të cilën minatorët me shaka e quanin «bulevard». Anës së këtij bulevardi, dhe në lulishten që gjindej përparrë klubit, kishin mbjellë ca fidane pemësh, po ato akoma s'ishin rritur mirë dhe hieja që lëshonin në tokë që e pakët.

Jorgji Bratja u këthye duke tundur në dorë kutinë e dominovët. I foli duke i shkelur synë me djallëzi:

— Si thua, vemi nga klubi bëjmë një «katërshe»?

— Vemi.

— Ama dje të mundën keq.

— E bre, ka zënë të mos më ecëj, — iu përgjegj Rakip Bardhi duke buzëqeshur. — Unë e kam vënë re: po më vajti puna ters në galeri, ters do më vejë edhe në lojë.

Të dy minatorët ecnin ngadalë në bulevard.

Rakip Bardhi me atë hundën pakëz të kthyer, me ballin e rrudhosur, me ata sytë e vegjël, të cilët qenë çuditërisht larg nga njëri tjetëri, qëndroi në vënd, duke shikuar rrëth e qark me habi. Në atë fytyrë, ku grimcat e qomyrit, duke rënë pér dyzet vjet me radhë, kishin lënë gjurmë të pashuara, u ndër një kënaqësi krenare.

— Ore Jorgji, tani që të prisja ty, po shikoja minierën tonë dhe u çudita; thashë jam zgjuar apo jam në tëndër. Nga duallën gjithë këto ndërtesa, xhanëm? Sikur mbinë nga dheu, më duket mua, po pér Zotin. Me spital, me klub, me banjë, me apartamente, me lulishte, me dyqane... A ta merrte mëndja të bëhej kështu? Ehu! si ka qënë e si u bë...

— Bëhet, o Rakip, po t'i vërë forcë Partia, të jesh i sigurt...

Rakip Bardhi me Jorgji Bratën qenë minatorët më të vjetër në minierë, ata e kishin nisur punën në galeri

thuajse së bashku, fill pas luftës së parë botërore dhe asnjëherë nuk ishin ndarë. Puna e jetë e kaluar së bashku i kish bërë shokë të ngushtë e i kish lidhur me një miqësi vëllazërore. Tani xha Jorgji e ka ngritur familjen nga fshati dhe e ka sjellë këtu në minierë. Vetë ka nja gjashë muaj që ka dalë në pension se e shtrënguan reumatizmat, kurse në minierë punon i biri dhe i nipi. Për këtë duket se ja ka zili Rakipi.

— E solle familjen ti, ë? Mirë bëre. Ay djali im s'ngrihet nga fshati, ka hedhur rrënje të thella si të lisit dhe s'tundet s'andejmi. Po edhe sikur të dojë, s'e lë kooperativa se e ka kryetar. «Hajde ti në fshat, më thotë mua, mjaft punove në minierë!» Mirëpo mua s'më iket, kemi shkuar një jetë të tërë këtu, u mësuam. Mua më duket se po të më heqin këtej, s'rroj dot. Hej, ç'qënka njeriu! «Nuk u lodhe?» më pyet ndonjë herë im bir. «Tani të lodhem? i them, tani është gjynah të lodhesh. Unë s'lodhesha atëhere, kur e nxirja qymyrin fill i vetëm, me thonj e me dhëmbë, jo tani. Tani lopataxhiun e kemi pas, vagonistin pas, armatorin po ashtu. Atëhere këto duhej t'i bëje të gjitha vetë. Mirëpo me kë të llafosesh, se mos merr vesh ai nga punët e minierës. Tani unë punoj duke kënduar.

— Ndaj ke nxjerrë shumë qymyr këto ditë... — e ngacmoi xha Jorgji, — duket ke kënduar shumë.

Mirëpo as kjo vrejtje me thumb nuk ja prishi gëzimin që ndjente në shpirt Rakip Bardhit. Duke e shikuar minierën me çudi, si i zgjuar nga gjumi, e duke soditur gjithë ato ndryshime që kish bërë miniera në këta pesëmbëdhjet vjet, nuk ja mori për të keq, por iu përgjegj me optimizëm.

— More, vërtet kemi nja tre katër ditë s'po nxjerrim hiç qymyr të mirë, po s'ka gjë. Sa të biem në damar kam hall unë, se pastaj a je i zoti të ngarkosh vagonat? Dhe do dalë qymyr i mirë atje, e kuptoj unë nga shënjat.

— C'thotë përgjegjësi i sektorit?

— Rexhepi s'thotë gjë, po kam hall e atij inxhinierit të ri unë. Ai sikur ka zënë e i përdredh buzët...

Para nja tre javëvet në minierë kish ardhur një inxhinier i ri. Qe një djalë me trup të lidhur, i pashëm e i shën-

detshëm. Nofullat e prera dhe vetullat e trasha e të bashkuara tregonin se ish një njeri energjik dhe i vendosur. Inxhinier Maluka ish nga ata njerëz që duan ta fitojnë autoritetin qysh ditët e para, me të vajtur në vëndin e ri, prandaj me punëtorët sillej pakë ftohtë e në mënyrë zyrtare. Mirëpo kjo sjellje nuk i kish pëlqyer minatorit plak, dhe inxhinieri i ri iu duk një çikë fodull e qibar.

Rakipi, me atë dorën e tij të zezë e me xhongla, përkëdheli kërcellin e hollë të një arre hindi.

— Shiko, more, edhe pemët e reja paskan zënë të gjitha. Ç'bukuri do bëhet këtu, me lulishte, me hije e ujë të ftohtë. Do nxjerrim dhe tavolinat pérjashta e do pimë birrë. Jo, ore, dhe thonë del në pension, pastaj? Po kur më punojnë duar e këmbë, qysh të dal në pension? Jo, pér Zotin, të kisha vdekur atëhere kur minierën e kish shoqëria aksioniste, do kisha vajtur zhur e do t'u lija amanet të gjallëvet: «Bëhuni çfarë të doni, fshesaxhinch, hamej, argatë, vetëm minatorë mos u bëni, se padronit duhet t'i japësh jo vetëm qymyrin po edhe gjakun. Kurse tani, me këto ditë që erdhën, e kështu siç u bë miniera, e kam pikë në zémër, që nuk solla dot një nga të familjes sime këtu e t'i jepja zanatin siç e di unë...»

Xha Jorgji ja preu:

— Edhe zanati s'do pijë ujë pér shumë kohë. Më tha drejtori që do të sjellin maqineri të reja të cilat do ta nxjerrin qymyrin vetë.

Këtë mendim Rakipi nuk e pranoi, dhe sepse pa dashur i erdhi keq nga fjalët që dëgjoi. Vërtet kështu do të ngjiste? Ky zanat që e kish mbajtur me bukë atë dhe familjen e tij pér vjete me radhë do të vinte një kohë që s'do të duhej më? Jo, kjo s'kish si të ngjiste.

— More, le të sjellin maqineri sa të kenë qejf, zanati duhet, ç'më thua ti! — e pastaj me një gjest të vendosur që s'pranonte kundërshtim: — Dhe kurdoherë ka pér t'u dashur! Ja, dëgjomë mua ti.

Të dy minatorët ecnin krah njëri tjetrit, të heshtur sikur pa pritur t'u ishin mbaruar fjalët. Dëgjohej fare shkoqur fërshëllima e mprehtë që lëshonin rrrotat e vagonave

duke shkarë mbi teleferik dhe zhurma e mbytur e qymyrat që zbrazej në bunkerin majë kodrës.

Ndërtesa e spitalit qe e heshtur e dukej sikur flinte, magazina ish mbyllur e vetëm në drejtori kishte një farë gjallërie. Zyrat e saj nuk mbylleshin gjithë ditën, sepse puna në minierë bëhej me dy turne.

Kur kaluan para drejtorisë, Rakip Bardhi pa dashur i mbajti këmbët, se iu duk sikur dëgjoi emrin e tij. Gjer në rrugë vinin fjalët e një diskutimi të ashpër që bëhej brënda. Rakipi njoju zérin e inxhinier Malukës. Inxhinieri bërtiste:

— Të lutem shumë, t'i jepet fund kësaj historie. Nga mua kërkohet realizimi i planit. Xha Rakipi kështu, Xha Rakipi kështu; pa më thuaj, c'është Xha Rakipi këtu, Drejtor apo inxhinier? Kini katër ditë që s'e plotësoni normën dhe qymyrin po e nxirni me gurë.

— Ai thotë se do ta gjejmë damarin... — Nga zëri Xha Rakipi e kuptoi se ky ish përgjegjësi i sektorit, Rexhep Dushku.

— Unë dhashë urdhër sot, të lihet puna në «oxhak» e të fillohet te «llava».

— Prit bre, duhet të merremi vesh edhe me këshillin teknik... — mundohej ta përbante Rexhepi vrullin e inxhinierit.

Duket se kishin mjaft kohë që po diskutonin për këtë çështje dhe tanë të dy palët qenë gati të mbyllnin diskutimin.

— Për mua po flasin — i tha Rakipi xha Jorgjit dhe ata syt e vegjël i shkrepëtëtën. — Dale, se do t'i vete brënda.

— Lëri, le të fjalosen. Ç'punë ke ti me 'ta? Po sikur të mos të pranojnë?

— Kush? Ai të mos më pranojë? — u çudit minatori plak — pse ç'u bë ai, padroni i minierës, Nazmi efendiu?

U këthyё menjëherë e me hap të vendosur ngjiti shkallët e drejtorisë e, duke çelur derën, u ndodh brënda. Rexhepit s'i erdhi mirë nga kjo vizitë e papritur, kurse inxhinier Maluka u step dhe heshti sikur ta kish detyruar një forcë e çuditëshme. U ndodhën pakë ngushtë, siç ndo-

dhen dy veta kur flasin keq pér një tē tretē e ai u del papritur pérpara. Nga ftyra e tij e vrënjtur e muarën me mënt se ai do ta kish dëgjuar një pjesë tē diskutimit.

— Vazhdo, vazhdo! — i tha Rakipi vrazhdët inxhinierit duke u munduar tē tregohej sa më i qetë.

Tjetri e mblođhi veten shpejt dhe me zë tē ulët ja ktheu:

— Më duket se nuk tē thërritëm, Xha Rakip.

— S'ka nevojë tē më thérresësh. Kur e dëgjoj emërin tim, përgjigjem vetë dhe ato që ke pér tē më thënë mua, s'ke pse t'ua thuash tē tjerëvet.

— S'kam thënë ndonjë gjë tē keqe pér juve.

— Ato ja thuaj ndonjë tjetri. Emrin tim e dëgjova vëtë.

Inxhinieri u mendua pakë, duke pulitur sytë. Mendoi se do ishte mirë t'i sqaronte punët me minatorin «më kokëfortë», siç e quante ai, dhe t'i jepete një mësim tē mirë se inxhinieri është inxhinier dhe duhet respektuar; urdhërat e tij janë ligj pér vartësit dhe tē drejta ose tē padrejta ato duhesin zbatuar. Pa ç'ka, le tē ish Xha Rakipi minatori më i vjetër dhe më me eksperiencë, inxhinieri është autoritet. Ai e ndjente se minatori plak e shikonte menjë farë mosbesimi e dyshimi tē heshtur e nga kjo pik-pamje qe një pengesë pér ambicjet që donte tē arrinte inxhinieri i ri. I foli me një zë tē thatë e tē vendosur:

— Mirë, pra, edhe me ty mund tē bisedoj. Me ç'të drejtë nuk i shpie forcat atje ku urdhëroj unë? Kush përgjigjet kur s'realizohet plani në minierë, ti apo unë?

— Ne që punojmë këtu, — ja preu Xha Rakipi.

— Pse nuk zbatohen urdhërat e mia?

— Se janë tē pastudjuara.

— Kush është inxhinier këtu, ti apo unë?

— Inxhinier je ti, po minator jam unë dhe unë e njoh minierën.

Inxhinier Maluka vuri re se kish tē bënte me një njeri tē zgjuar dhe krenar pér profesionin që kishte. E ktheu ndryshe:

— Pse s'ke nxjerrë qymyr, atëhere, sipas planit?

— Ashtu më ndodhi këto ditë. Kurse ti thua: lëre atë vënd e shkoni kërkoni gjetkë; të humbim edhe ca ditë të tjera thua ti... Jo, ore, s'bëhet ashtu.

Diskutimi sa vinte e po ashpërsohej. Të dy kishin filluar të bërtisnin. Rakip Bardhi e ndjente sedrën pakë të lënduar nga inxhinieri i porsaardhur, sepse ky djal'i ri s'kish vajtur të konsultohej njëherë me 'të, të mësonte nga përvoja e tij e gjatë, të pyeste makar njëherë për punën në minierë, po kish filluar një e një me urdhëra. Me këtë rast ai donte t'i tregonte inxhinierit të ri, se puna në minierë është shumë e ngatërruar dhe nuk mësohet në tri javë.

— Do bëhet kështu si them unë! — tha inxhinieri.

— Do bëhet ashtu si të jetë më mirë — ja priti Rakip Bardhi.

Inxhinier Maluka, duke çpështjellë një rrotë letre nëpër duar, tha si me keqardhje:

— Më vjen keq të ta them, shoku Rakip, por ti po bë-hesh pengesë për realizimin e planit.

Xha Rakipi u zverdh menjëherë në ftyrë. Këtë fjälë nuk e priste. Çdo gjë mund t'i thoshin këtij minatori, vetëm këtë fjälë jo. Ndofta do t'i ish dukur më e lehtë t'i kishin rënë me shpullë; atëhere do të ndjente dhëmbje, por nuk do t'i vinte keq, kurse tashti e kishin prekur në sedër, kishin fyter ndërgjegjen e tij prej minatori të vjetër. Me një zë të dredhur, ku shprehej gjithë shqetësimi që ndjente, pyeti si të mos ish në vete:

— Kush, unë bëhem pengesë?

— Pikërisht ti, — i tha inxhinieri i qetë, duke menduar me singeritet se kish plotësisht të drejtë.

— Unë që kam shkuar jetën këtu në minierë? Unë bë-hem pengesë? — pyeti Xha Rakipi me çudi e me keqardhje.

Ai s'e merrte dot me mënd një gjë të tillë e donte me çdo mënyrë që inxhinieri t'i përgënjeshtronë këto fjälë aqë të padrejta. Mirëpo inxhinieri tundte kokën, në shënjë aprovimi e me vete mendonte: «U nis që u nis kjo punë, le të vejë gjer në fund.»

— Mere prapa atë fjälë që më the! — gjëmoi Xha Rakipi.

— S'kam pse ta marr prapa. Unë kështu mendoj...

— Po a e di ti që unë e marr pensionin kur të dua, që nesër bile, po rri këtu vetëm që t'ju ndihmoj ju të rinjve?...

— Në goftë se të takon, gabim bën që s'e merr — i tha inxhinieri ftohtë.

— Gabim bëkam, ë? — Tani Rakip Bardhi e kuptoi se s'kish si të merrej vesh me këtë njeri, dhe kjo e nxehu akoma më tepër.

Jorgji e vuri re se Rakipi u nevrikos aqë shumë sa s'e mbante dot veten dhe u mundua ta qetësonë:

— Lëre, o Rakip, mos e shty më tej... Kemi ku fjalose mi për këto punë.

Me duart që i dridheshin, Xha Rakipi e shtyri mënjanë.

— Lërmë, Jorgji, mos më ngaj. U këthye përsëri nga inxhinieri me vrull dhe i shfryu: — Gabim bëkam, ë? Hiq më nga defteri, s'kam pse të rri më këtu e që sot do të ikij. — I këtheu kurrizin e, si të fliste me vete, shfryu me duf: — Ore! U bëkam pengesë unë që kam dyzet vjet në këtë minierë dhe më mirë njoh galeritë se odat e shtëpisë s'ime... Pfy!

Nuk e përbante dot veten, dhe gjithë trupi i dridhej. Sytë i shkëlqenin, të ndezur nga zëmërimi e nga inati, dhe duart s'dinte ku t'i mbante.

— Në goftë se dësheron t'ikësh, ikë. — ia ktheu inxhinieri. — Miniera do të punojë edhe pa ty, — dhe inxhinier Malukës nuk iu durua pa i hedhur një thumb: — Po më përpara mos harro të marrësh librezën e punës.

Xha Rakipi që kish ikur gjer te dera, u këthye përnjëherësh, qëndroi para tryezës së inxhinierit, u mbush plot me frymë e me duart që i dridheshin si nga ethet, corri jakën e këmishës nga krahu i djathtë dhe i tregoi supin e shtrëmbëuar dhe një shënjë të vjetër plage.

— E shikon, — bërtiti, — ja ku e kam librezën e punës unë...

Pastaj ngriti pantallonën gjer te gjunjët dhe i tregoi kockën e këmbës, e cila, e goditur nga një shkëmb qymyri, vinte e lakuar si lugë.

— Ja edhe një librezë tjetër ku e kam...

I habitur nga ky vrull dhe pakë i trëmbur, inxhinieri u step dhe në çast e ndjeu se e kish lënduar plakun dhe e kish shtyrë diskutimin më tej nga q'duhej.

Përgjegjësi i sektorit, Rexhep Dushku, duke rrasur në kokë kapellën prej meshini, e qortoi heshturazi inxhinierin duke iu kafshuar, sikur deshi t'i thoshte «Akoma po e shtyn?» pastaj u ngrit në këmbë dhe i hodhi duart në qafë xha Rakipit. Ndjehej i tronditur, dhe nuk donte n'asnjë mënyrë që Rakipi, «babai i minierës», të largohej në këtë mënyrë. Iu lut me përvuajtje, ashtu sikurse i lutemi një të sëmuri të pranojë ilaçet e mjekut.

— Xha Rakip, mos e merr kështu. Aman, dëgjomë mua. Ta bisedojmë njëherë me komitetin profesional...

— Ata i kanë veshët, dhe e dëgjuan se q'më tha, — bërtiti i papërmabjatur. E, si t'i kish ardhur keq për veten e vet, shtoi: — Unë u bëkam pengesë, ë?

Matej t'ikte dhe përsëri s'vendoste dot, sikur një forcë e pakuptuar ta kish mbërthyer aty. Vinte rrötull nëpër dhomë, duke përsëritur me dhimbje në zëmër atë frazë që i kish bërë aqë përshtypje dhe me këtë, sikur donte t'i kujtonte inxhinierit gabimin që kish bërë, dhe nga ana tjetër ish si një thirrje e heshtur që ai t'i kërkonte ndjesë.

Mirëpo inxhinier Maluka, megjithse tanë e kish kupuar se minatorin plak e kish prekur në sedër e ndofta pa të drejtë, krenaria nuk e linte të përkulej dhe nuk dëshëronte n'asnjë mënyrë t'i kërkonte të falur, sepse mendonte që autoriteti i tij, pas kësaj ngjarje, nuk do të ngrihej kurrë dhe marrëdhëniet me Xha Rakipin do të mbete shin ashtu si më përpara, gjë të cilën ai nuk e dëshëronte. Rrinte i heshtur dhe mundohej të tregohej i qetë, sikur atij aq i bënte, e kot së koti bënte topa të rrumbullaktë prej letre dhe i vendoste në forma gjeometrike mbi tryezë.

Me një gjest të dëshpëruar, Xha Rakipi luajti dorën në erë dhe doli nga zyrat e drejtorisë me hap të rëndë e të vendosur. Pas i vajtën të gjithë shokët e punës, minatorë, vagonistë, armatorë. Një pjesë prej tyre, të shtyrë nga kureshtja ishin futur në dhomë, kurse pjesa më e madhe kish qëndruar përjashta, dhe nga ftyrat e vrënjtura dhe

të zymta kuptohej pa vështirësi se nuk u kish pëlqyer hiç ajo që kish ndodhur. Ata mendonin se për këtë gjë duhej bërë një mbledhje e posaçme sa më parë që të ish e mundur. Shumica e tyre me mënd i jepte të drejtë Xha Rakipit, dhe thellë në zëmër u vinte mirë që i ish përgjegjur aqë bukur inxhinierit të ri; mirpo e kish prishur tani së fundi, mendonin ata, kur tha se do t'ikte fare nga miniera. Për këtë, atyre u vinte keq dhe prandaj e ndoqën pas gjer në fjetore, që të bisedonin me 'të e të mos e linin t'u ikte.

Rakip Bardhi shkonte bulevardit me hapa të mëdha, duke çaluar më shumë se zakonisht, i etuar që të arrinte sa më parë në fjetore. Xha Jorgji e arriu në rrugë dhe e tërhoqi nga mënga e palltos.

— Rakip—i foli ashpër, — i ke mëntë apo jo?

— Lermë, Xha Jorgji, mos më folë që të mos e prishim bashkë — e me kujdes ja hoqi dorën nga xhaketa. Të më fliste Nazmi efendiu, e mirrja vesh, po që të më bërtasë ky i pjelli im mua, këtë s'e duroj dot. Jo, pa shkollë mund të jem, po budalla s'jam.

Nga sa dukej ai ish nxehur shumë dhe ishte e tepërt të bisedoje. Xha Jorgji, që e njihte kokëfortësinë e shokut të tij, e pa se ish e kotë të vazhdonte me këtë rrugë dhe u mundua të bënte diçka tjetër; u këthye me të shpejtë te inxhinier Maluka.

* * *

Rakip Bardhi u fut në fjetore. Tani s'i mbetej gjë tjetër veçse të mblidhje plaçkat e t'ikte. Iu afrua krevatit të tij e, duke u zgjatur, hoqi torbën që e mbante varur dhe, me duart që i dridheshin e pa shikuar asnjeri në fytyrë, filloi ta mbushte. Nxori që poshtë dyshekut një palë brekë të gjata e një këmishë të re, pastaj zbrazi plaçkat që kish në sirtarin e komodinës, veglat e rrojes, një sapun, një furçë këpucësh, disa libra me kapakë të grisur e disa gazeta të vjetra, ku ruante artikujt që ishin shkruajtur për 'të e për minierën e, si i ngjeshi të gjitha top, i rrasi në torbë.

Pastaj hodhi vështrimin rrëth e qark dhomës, duke e shikuar çdo gjë me dashuri e mallëngjim dhe duke menduar se këto ishin çastet e fundit që po kalonte në minierë e se kurrë më s'kish për t'u këthyer mes shokëve, ndjeu zëmrën t'i ndrydhej nga hidhërimi; sytë iu mbushën me lotë dhe filloi të qante në heshtje. Ky burrë i fortë që s'kish qarë kurrë nga dhëmbjet e duronte në një mënyrë të habitëshme, tani qante nga hidhërimi, nga fyerja që ndjente thellë në shpirt e nga ai si gur që i kish plakosur krahërorin e s'e linte të merrte frymë.

— Xha Rakip, mos e bëj këtë — i tha një minator i ri me drujtje.

Rakipi deshi t'i fliste, po nuk qe i zoti. Iu drodh mjekra e belbëzoi me fyt diçka të pakuptuar.

Kur dolli te dera jashtë, minatorët e futën në mes të tyre dhe s'donin t'i hapnin rrugë.

— Nuk të lëmë t'ikësh, ore, je në vete ti. Ne të kemi «babanë e minierës».

Rakipi rrinte në mes tyre, i ngathët, i qetë, pa u munduar të kundërshtonte. Hidhërimi dukej se e kish paralizuar vullnetin dhe vrullin e tij. U tha, sikur të fliste për dikë tjetër.

— Ehë! Vdiq babai i minierës o djema. Ia vuri drunë inxhinieri i ri.

— Dale se do merremi vesh, s'ësht vetëm ai këtu, ka edhe të tjerë për mbi 'të.

— S'i mat fjalët kur i nxjerr nga goja ai djalë. Mua më nderon një qeveri e tërë, më ka shtërnguar dorën vetë shoku Mehmet për punë, ai më thotë je bërë pengesë. Dhe do rri t'i lutem atij unë, ë? C'e ka gënjiyer mëndja!

Rexhep Dushku, përgiegjës i sektorit, iu afrua dhe, si me marifet, ja hoqi torbën nga supi.

— More, thuaj si të duash, ne nuk të lëmë të na ikësh. Ja, unë s'ta jap torbën, ta dish mirë.

— Për çudinë e të gjithëvet, Xha Rakipi nuk kundërshtoi dhe as u përpoq ta merrte torbën.

— Mbaje, po deshe, — i tha ngadalë, — nuk më hyjnë në punë ato dy rreçka tani që e kam shtëpinë plot.

Përpara kësaj vendosmërie ish e kotë të kundërshto-

je. Āta, sikur t'u kish thënë njeri, i hapēn rrugë dhe e lanë tē lirë. Xha Rakipi s'po ikte. Kish ulur sytë përdhe e po mendohej. Pastaj u mbush me frymë e si një njeri që ka pér tē thënë diçka tē dhimbëshme e tē vështirë, foli me një zé tē ngashiéryer.

— M'i bëni hallall, o djema.

U lëkund pérpara, sikur atë çast tē mos i ishin bindur këmbët dhe filloi tē ndahej me shokët e tij tē punës. Nga lotët që i kishin rémbushur sytë e nga tronditja e madhe, nuk ish në gjëndje t'i dallonte, veç i puthte e i pérqafonte me një dashuri tē zjarrtë atërore, duke i shtrënguar pas gjoksit tē tij tē fuqishëm.

U largua prej tyre, ktheu edhe një herë sytë nga miniera, sikur desh ta pérqafonte me këtë vështrimin e tij tē fundit dhe e vështroi gjatë si një njeri që dëshëron ta ruajë mbresën e fundit tē skalitur kurdoherë në mëndje. Vështrimi i mbeti te një vagon i kthyer përbys dhe po vriste mëndjen si nuk e kish vënë re më pérpara, pastaj tundi kokën sikur desh tē thoshte, «ç'më hyn në punë mua, tashti?» dhe mori shtegun tatëpjetë.

Shokët e përcollën me sy e me dhëmbje në zëmër:

* * *

Xha Jorgji ish i bindur, se ikjen e Rakip Bardhit nga miniera, tani, mund ta ndalonte vetëm inxhinieri, prandaj u këthyen me tē shpejtë në Drejtori. Inxhinier Malukën e gjeti duke pirë duhan, tē menduar e tē vrenjtur. E pyeti rreptë, si t'i kërkonte llogari:

— Pse e përzure plakun?

— Nuk e përzura unë. Ai, iku vetë.

— Ti e përzure, — i bërtiti Xha Jorgji, — po ti, një e di e dy s'i di. Erdhe t'i i gjete tē gjitha gati dhe tē duket kollaj, ë?

— Nuk e kuptoj, ty pse tē dhimbset kaqë?

— Më dhimbset, the? — pyeti Xha Jorgji — Më dhimbset është pakë; më pikon në zëmër, tē thuash më mirë. Kam dyzet vjet që punoj bashkë me atë, unë. Dhe kur ai nxirrte qymyr këtu, ti s'kishe lindur akoma. Ç'e di ti,

mos ka qënë miniera kështu si sot, me klube, me spital, me mencë, me krevat me susta. E nxirrnim qymyrin me thonj e me dhëmbë ne atëhere dhe na binte bretku tërë ditën e ditës në punë, atje brënda në galeri. Po ti ke hadkë, se s'ke vuajtur dhe as e ke parë minierën si ka qënë përpara. Ne e njohim se kemi shkuar një jetë të tërë këtu. Dhe ja, erdhe ti djalë i ri, sapo dalë nga shkolla e përzurë «babanë e minierës» dhe e fyejte. Po s'bëre mirë, s'bëre hiç mirë, se ti s'e njeh as atë, as minierën.

Jorgji Bratja pshëretiti dhe deshi t'i tregonte gjer e gjatë se si kish qënë dikur kjo minierë, po fjalët iu lidhën në grykë e nuk ja tha dot.

Nuk i tha se punonin pa orar nga mëngjezi gjer në mbrëmje. Nuk i tha se galeritë qenë të ngushta e këta hiqeshin zvarrë si gjarpëri, duke dërmuar brryle e kurri, gjersa sikushdo vinte në «xhepin» e tij dhe atje, ulur galuc, me një këmbë nën vete e me kokën të ngjeshur në njerën anë të supit, i binin shkëmbit me kazmë. Skëterra nuk ish aqë e zezë sa miniera. S'kish atëhere as armator, as wagonist, as mbushës. Të gjitha këto minatori duhej t'i bënte vetë.

Qymyrin e nxirrnin nga galeria me arka prej drasse. Arkat kishin përparrë nga një copë litar dhe minatorët mbrihesin përparrë saj, si qentë në slitë dhe, të krrusur më dysh e hera herës zvarrë, e tërhiqnin me mundim mbi trarët e kalbur që ishin shtruar në galeri e që shërbën në vënd të dekovilit.

Nuk i tha se punonin ditë për ditë me vdekjen mbi kokë. Nga që padroni i paguante vetëm për okët e qymyrit që nxirrnin, minatorët s'kishin leverdi të bënin armatura dhe, për të nxjerrë një dhjeç më tepër, shtyhesin thellë e më thellë, gjersa tavani u shëmbej mbi kokë dhe, në mos i linte në vënd, do t'i bënte sakat për jetë.

Ndihmës së shpejtë e spitalit atëhere nuk ua dinin as emrin. Për ata që plagoseshin a pësonin shëmkosje ilaçi qe vetëm një, një ilaç i vjetër i trashëguar qysh nga kohët më të lashta: i plagosuri mbështillej me një lëkurë dashi të ngrohtë, dhe, shërohej a vdiste, kjo s'dihej, si ta kish të thënën.

Nuk i tha se minatorët, natën, flinin përjashta, nën qiellin e hapur, dhe që të mbroheshin nga era e tërbuar e malit, hapnin në tokë disa gropë që i quanin varre. S'kish atëhere fjetore. Këtu ish vetëm një barakë prej dhogash dhe atje s'të lejonte njeri të flinje. Shoqëria ak-sioniste e kish ndërtuar për të futur dinamitin dhe veglat e punës.

Bukën, të cilën e sillnin nga shtëpia mbështjellë në një leckë dhe varur në brez si granatë, e hanin aty përjashta në lëndinë dhe, pa u shkuar mirë në stomak, ngri-heshin e fillonin sërish nga puna. S'e kuptonin në hanin bukë a po qymyr. E zezë buka që kllisnin, i zi qomyri që nxirrin, e zezë dhe këlbaza që pështynin.

E nga do t'i dinte ky djal' i ri këto gjëra? Ky erdhi dhe e gjeti minierën të modernizuar, me ventilatorë, me elektrik, me kompresorë e me të gjitha kollajllëket e tjera: banjë, klub, bibliotekë, kinema, mencë.

— Kush të dërgoi në shkollë ty? — e pyeti papritur Jorgji Bratja.

— Pushteti! — iu përgjegj inxhinieri me krenari.

— Po kush është në pushtet? Ja, ne jemi në pushtet, ne të dërguam. Dhe ti shiko sa mirë që na e shpërbleve... Për tyjeta ka qënë shesh me lule. Kur u bë lufta, ishe i vogël. Mbaroi lufta, pushteti të futi në shkollë; mbarove shkollën, fillove punën. Për ty vështirësitë e punës dhe të jetës apo kanë filluar, kurse ne tashti po shikojmë një ditë të bardhë. S'ke qënë ti këtu në vitin 1945 dhe s'e ke parë ç'batërdi ishte këtu. Miniera përmbytur, galeritë shëmbur e shkatërruar, vëndi i braktisur, të merrte të qarët. Po ai Xha Rakipi që iku sot, ka ardhur i pari këtu e, duke ngrënë bukë e qepë, s'u largua një ditë nga miniera, gjersa e bëmë gati për prodhim. Ai njeh më mirë damarët e minierës së udhët e fshatit të tij. Po ta futësh në galeri, thonë se e ndjen me hundë nga ç'anë është qomyri e nga ç'anë duhet shpuar. Kështu, mor djalë, mos i merr punët rrëmbyer, po mundohu t'i njohësh njerëzit. Plani, plani, thërret kurdoherë ti; po më kë do ta bësh këtë plan? ja me këta njerëz; prandaj mos i fyey, mos ua thyej zëmrën.

Inxhinier Maluka e dëgjonte me kujdes. Tani, edhe këtij i kishte rënë inati dhe thellë e kuptonte se s'kish vepruar mirë.

Jorgji Bratja, duke ardhur rrotull nëpër dhomë, i fliste:

— Njeriu kur del nga shkolla nuk i di të gjitha. Ja, ti ke mësuar se gazi metan ndizet, po a e ke provuar? Jo. Pa më thuaj mua që e kam provuar mbi lëkurën time. Dhjetë vjet përpëra futet në galerinë tonë një minator me llambë. Pas tij futet dhe një wagonist i ri dhe si pa të keq ndez cigaren.

Unë e pashë dhe i thërrita si i çmëndur: «Na dogje!» mirépo qe vonë; gazi u ndez dhe na hodhi përbys. Mbetëm atje në galeri, në mes të flakëvet, me fytyrën të mbështetur pas tokës, që të paktën të mos na digjej ajo, po ç'e fsheh kokën? Rrobat të kanë marrë flakë, mishi digjet si të jetë dyllë dhe bije erë, një erë të rëndë që aman o zot, mish njeriu; dhe më e tmershmja në ato çaste është frymëmarrja. S'merr dot frymë, se s'ka ajër, ka vetëm flakë dhe ti me gojën hapur thith flakën jeshile që të ka mbështjellë si mur nga të gjitha anët. Fati ynë që nuk u ndodhëm shumë thellë. Na erdhën shpejt shokët në ndihmë. Rakipi sidomos. Qysh u fut në minierë në mes të flakëvet e qysh na nxori, ai e di. Veç më së fundi vumë re se ai ish djegur më shumë nga ne. Dhe ai minator iku sot.. dhe si iku. Turp, turp!

Xha Jorgji u nevrikos dhe heshti. Fjalët dhe tregimet e tij e kishin mallëngjyer inxhinierin e ri dhe e kishin bëre të mendohej. Me njerëz të tillë s'kish ç'i duhej autoriteti zyrtar që ëndëronte. Ai sot kish zbuluar vetëm një qoshe të zëmrës së tyre të madhe dhe tanë dëshëronte vetëm një gjë: të bëhej shok me 'ta, dhe ta ndjente punën në minierë njësoj si minatorët e vjetër.

— Nuk do të kthehet Xha Rakipi? — pyeti me gjysmë zëri.

— Jo, nuk këthehet. Ja di unë kokën atij, — tha Xha Jorgji duke fshirë ballin e djersitur me një shami të bardhë.

* * *

Me torbën të hedhur në sup, Rakip Bardhi zbriste tatëpjetë monopatit, duke i hedhur këmbët kuturum. Ajo peshë e rëndë, që e ndjente se i kish plakosur zëmrën, nuk i ish ndarë pér asnjë çast. Më kot e ngushëllonte veten se mjaft kish punuar gjithë jetën e tij, tani do të vinte në fshat, do të çlodhej sa të donte, kur të kish qejf do të prashiste kopshtin; kur të mërzitej, do të vinte tek fqinjët pér të bërë dy para muhabet dhe kohën do ta kalonte pér bukuri. Mirépo as shtëpia, as kopështi, s'ja hiqnin dot atë ndjenjë pikëllimi që i kish pushtuar shpirtin.

Që tani po e ndjente peshën e rëndë të ndarjes e të vetmise. Bujqesinë ai s'e kisn pasur kurrë qejr, une nga ky shkak nuk e çmonte. Vërtet, ai kish menduar se do të vinte një ditë që do të ikte nga miniera, po ajo ditë i ish dukur gjithmonë shumë e largët, e turbullt dhe asnjëherë nuk e pat menduar seriozisht. Kur krahët emplakur s'do t'i bindeshin më e, kur me dhëmbje në zëmër do ta shikonte se më nuk qe i zoti pér punë, atëhere do t'i linte shëndenë minierës dhe shokëvet, po kurrë s'i kish vajtur mëndja se do ta linte punën kaqë shpejt e në një mënyrë t'atillë.

Ktheu edhe njëherë kokën. Tani minierën ja fshihte një bregore dhe s'dukej asgjë përveç telavet të teleferikut dhe vagonavet që shkisnin nëpër tel e që, së poshtmi dukeshin si ca zogj të zes e të mëdhenj.

Rrezës së malit shtrihej fusha e qetë, e heshtur, duke pritur me mirëdashje rrezet përvëlonjëse të diellit të korrikut. Tej, matanë kësaj fushe të veshur me qiq nga vapa, tulatej fshati i tij i vogël, i mbështjellë me një napë të ncillë kaltëroshe.

Në darkë Xha Rakipi do të ndodhej atje. Sigurisht, njerëzit e familjes do të habiteshin kur ta shikonin të hynte tek dera në një ditë që s'e prisnin dhe, me siguri, do ta pandehnin të sëmûrë. Rakip Bardhi e kish bërë zakon që në shtëpi të shkonte vetëm të shtunavet dhe këtë zakon nuk e pat prishur me vjete. «Kurse sot është e mërkurë, mendoi. Po unë do t'u shpjegoj atyre që...» Çfarë t'u shpjegonte? Që kish ikur nga miniera? E kuptoi se për

këtë gjë nuk i vinte mirë të jepte shpjegime dhe as të fliste. Fundi fundit, atyre s'do t'u thoshte asgjë dhe le të pandehnin çfarë të domin. «Unë duhet të raportoj inxhinierin, kështu e kështu ma bëri. Do të dérgoj një letër atje ku duhet, që t'ja tregojnë qejfin mirë dhe mua pastaj sigurisht do të më thérresin në minierë.»

Pa e kuptuar, kish qëndruar në vënd e po mendohej. Poshtë fshati, lartë miniera e ky në mes. Ku të degdisej? Nga miniera kish ikur, kurse në fshat e ndjente se nuk i vihej. Dhe Xha Rakipi ndenjti atje në mes të rrugës duke vënë duart në ballë e duke u menduar.

Ky fshatar i ashpër, me trup të madh, me duar gjithë khongla e me fytyrë pis nga pluhuri i qymyrit, i rritur në minierë me ndërgjegjen e punës dhe të shoqërisë, ndjente dhimbjen e shkëputjes dhe i vinte të qante. Tani e kuptonte se e paskësh dashur minierën me gjithë forcën e zëmrës dhe, ndofta, u desh kjo provë e vështirë dhe kjo ndarje e tillë që të shkoqiste një gjë kaqë të thjeshtë.

Po tani ishte vonë, tani s'kish ç'bënte. Duhej të ikte. U ngrit dhe psherëtiti.

Ndjeu gjëmimin e shurdhër të minavet që pëlcitën. Sigurisht, këto janë minat e turnit që punon në sektorin e kërkimevet. E mori me mënt se ata, tani, e kishin çarë shtresën e përzjerë me shtuf dhe kishin rënë në qymyr të pastër, me faqen e zezë që shkëlqen si kristal i zi në drithën e fortë të llambës. Lopataxhinjtë tani mbushnin vagonat.

Këto shpërthime sikur e zgjuan nga ndonjë èndër. Vërtet po ikte nga miniera përgjithënëjë? E hoqi torbën nga supi dhe e pa me çudi. Fyerja, që kish ndjerë në shpirt, tani kish zënë të shkrihej duke ja lënë vëndin një boshllëku pa kuptim. Filloi t'i gjykonte punët me mëndje të qetë. Si kishin ngjarë kështu? Vallë a ish e mundur?

E rikujtoi skenën në zyrat e drejtorisë që nga fillimi e gjer në fund. Kështu, pra, ish zënë me inxhinierin dhe ai i kish folur ashpër, dhe Xha Rakipi, i fyer nga padrejtësia, po largohej nga puna, nga miniera, nga shokët.

Po a mund ta përzinte njeri Xha Rakipin?

«Jo, tha me mëndje të tij, pastaj thëriti fort», Jo,

mua s'më përzë dot ai. Mua s'ka burrë që të më përzërë nga miniera ime. Qysh ikërkam unë nga miniera kësh-
tu? Mua s'më përzë dot njeri edhe sikur të dojë...

I lehtesuar e i çelur nga ky vendim, mori përsëri rru-
gën e minierës. Këmbët i shkonin vetë, mëndjen e kishte
të qetë dhe gjëzimi si një vesë lulesh i derdhej në shpirt,
duke e freskuar me një ndjenjë kënaqësie të ëmbël.

S'e kishte menduar kurrë që e donte punën kaqë shu-
më dhe nga ky zbulim që bëri në ato çaste të vështira, i
erdhi mirë.

Pastaj me mënd e fali edhe inxhinierin dhe nuk iu
duk gjë e mirë të bënte letër e ta raportonte. Ishte i si-
gurt se, po të ankohej, inxhinierit të ri do t'i hiqnin vë-
rejtjen; mirëpo ja, këtë gjë tani nuk e donte Rakipi.

«Nuk është mirë ta dënojnë, mendonte me zëmër të
pastër, ai është i ri, sapo ka ardhur në minierë; nga do t'i
dijë të gjitha? Po ca nga ca do të punonjë e do të kalitet
dhe atëhere do t'i kuptojë punët më mirë. Veç një gjë ja
pëlqej unë këtij djali: është i zellshëm dhe i zjen koka për
planin, për atë, bravo i qoftë. Dhe unë u nxeva, e më kë?
me një që nga mosha është djali im...»

Ishte afruar në fjetore. Shokët e panë me çudi dhe
nuk dinin si ta prisnin, të gjëzoheshin a po të hidhërohe-
shin. Ata pandehën se Rakip Bardhi pat harruar ndonjë
gjë e tanë ish kthyer ta merrte. Mirëpo fytyra e tij e çelur
dhe ajo buzëqeshje që i ndriste në çipat e syvet i bëri të
shpresonin diçka më shumë.

— Thoni si të doni, — u tha Xha Rakipi, — po nga mi-
niera unë s'ikëj.

Shokët e përqafuan me dashuri, sikur të ishin ndarë
vjete përpara dhe gjithë ai pezmatim që kishin ndjerë, ta-
ni ish avulluar menjëherë.

Rakip Bardhi hyri në fjetore, i vuri plaçkat më ngé
në vëndin e tyre të mëparshëm, vari torbën në krye të
krevatit dhe doli njëherë andej nga klubii, duke i shikuar
të gjitha gjérat rrëth e rrotull i qetë e i vëmëndshëm, si-
kur asgjë të mos kishte ngjarë. Dhe vërtet, pas gjysmë
ore, shpirti i pastër, i qetë e i drejtë i këtij minatori, e
kish harruar fare atë ngjarje.

N g a c i k l i

«NATYRA dhe NJERËZIT»

— *Proza poetike* —

THE
LAW
REVIEW

... mëngjës qëndrueshëm. Në këtë rast po e bëhet një shembull i madh i përgjithshëm. Në këtë rast po e bëhet një shembull i madh i përgjithshëm. Në këtë rast po e bëhet një shembull i madh i përgjithshëm. Në këtë rast po e bëhet një shembull i madh i përgjithshëm. Në këtë rast po e bëhet një shembull i madh i përgjithshëm. Në këtë rast po e bëhet një shembull i madh i përgjithshëm.

Poetit të «Manushaques», Naim Frashërit.

1) LUKEKACET

Sot në mëngjes m'u kujtuan lulekaçet, m'u duk si-kur i kisha në dhomë e provova një diçka të çuditësh-me: ndjeva në hundë kundërmimin e tyre dhe zëmra m'u shkri e m'u ronit.

E di që jam larg, shumë larg prej tyre; po kjo aro-më nga më erdhi, kush ma dërgoi?

Apo ndofta malli që më djeg zëmrën më ngjalli erë-zën e tyre? Tani u bënë vjetë që kur s'i kam parë plajat, ku rriten lulekaçet dhe shpirti më digjet e më zhurritet njësoj sikur të më kishin ndarë nga e dashura. Mbyll sytë dhe ja, më dalin përparrë shpatet e maleve të Gramozit, ku mbijnë këto lule nazemëdha.

Ato rriten lart, lart në male, që të jenë sa më afër qiellit, sa më afër diellit.

Të lira e krenare, atyre s'u pëlqen të zbresin në fu-shë dhe, sado me kujdes që t'i mbjellin duart e vajzavet nëpër saksijat, ato nuk mbijnë. Fusha u mërzitet, saksi-jat u zënë frymën.

Lart në mal, natën, ulen yjet dhe puthin gushën e tyre e ato hargalisen; pastaj, ditën, të kapitura varin kryet mbi gjoks dhe u vjen turp ta shikojnë babanë diell në sy, njësoj si vajzat lozonjare kur bredhin tërë natën përjashta e stepen të ndeshin vështrimin e prin-dërvet të tyre.

Er' e tutekaçevet éshtë e ëmbël, delikate dhe velëse, si mjalt' i freskët nxjerrë nga zgérbonj e pyllit. A vallë ato ja japin atë parfum aqë tē mirë flladit që frys mbrëmjevet tē verës? Në mos ato kush tjetër?

Më kujtohet se sa herë vija në mal, mblidhja nga një tufë lulekaçesh e ja sillja motrës së vogël. I ruaja me kujdes: herë i mbështillja me bar, herë i mbuloja me zhaqetë; po kot. Ato s'e duronin dalmën e fushës dhe rrugës kapiteshin, telekoseshin, e vyshkeshin lulet e varnin kryet sa tē vinte keq t'i shikoje. S'i ngjallte më as ujët, as Dielli, dhe s'kish gjë më tē trishtuar se sa këto lule tē hedhura andej kötej nëpër oborr.

Ku ta dish ndofta edhe lulet e ndjenin se nuk ishin në mal, e i tretëte meraku se tanë e tutje s'kish për t'ë përkëdhelur rrezja e parë e diellit, s'kish për t'i përkundur era e pastër e malit, s'kishin për tē shijuar natën puthjet e yjvet. Dhe veniteshin.

Ato dor:n tokën e tyre, vëndin e tyre.

Tiranë 1958

2) STUHIA

Fluturuan mbi pyllin e madh një tufë shpendësh; fluturuan e s'qëndruan kundi, as për t'u çlodhur as për të kënduar. Dhe zërnat e tyre u përngjanin më tepër klith-mavet të dëshpëruara. Ashtu si erdhën, ashtu u zhdukën.

I pa pylli dhe u drodh.

Një e rrënqethur e përshkoi tejetej.

Pastaj u fshehën çocërrit, u tulat qyqja, pushoi këngën e gëzuar kanarina: një hop kohe edhe qukapiku sqepfportë i pushoi të goditurat përmbi trungun e pishës dhe, duke u mbështetur mbi bishtin e tij si krehër. mbajti vesh...

Retë varën krahët, të lodhura, të rënduara, të kapitura...

Dhe pylli e ndjeu fryshtë dhe të lagur të revet.

Për një çast sundoi qetësia, një qetësi e kobëshme. Pastaj, papritur, që nga shpellat e malevet përtetj doli era e marrë. E ndjenë pishat dhe fishkëllyen me ankim, e ndjenë ahet dhe u drodhën me trishtim, e ndjeu dhe panja e përpoqi ato fletë si pëllëmbë duarsh.

Diku, thellë, shkreptiti me forcë rrufeja. Bumbullima u ngjit pérroit përpjetë e do të kishte vajtur kushe-di se ku, sikur pylli i madh e zemërgjëre të mos e kish marrë e ta kish shuar në gjë të tij.

Pa ja krisi dhe shiu pikëmadh me rrebesh e me poterë. Pyllit iu err vështrimi dhe u step. Era dhe shiu u bashkuani dhe u vërvitën me furi të tërbuar përmbi pylliin hijedendur.

Donin ta mundnin, ta shkulnin, që tē talleshin me forcën e tij tē rrallë e t'ja përqeshnin bukurinë.

Brënda nē pyll kërcisinin degët, ankoleshin, përkuleshin, e qanin fletët pér tē keqen që i kishte gjetur, duke drithteruar me frikë, e pikat e shiut shkisnin prej gjethet e binin nē tokë si lotë. Stuhia e pa këtë e shpërtheu edhe më e rreptë. E tundi pyllin, e shkundi, e mundoi, duke u sulur mbi 'të si fryma e vdekjes; po kot u lodh, kot u rropat. Pylli mbeti atje ku ish: i fortë i qetë e madhështor si gjithënëjë.

Vetëm një ah shkuli nē pyll stuhia. Ai briti e krisi nga dhëmbja, duke nxjerrë rrënjet përjashta, po pér tē rënë s'ra. Trupi i tij u mbajt mbi bigën e një ahu tjetër si mbi krahun e një vëllai. E ashtu mbeti, i zalisur, as nē qiell, as nē dhe, veç me shpresë nē zëmër. Pylli nuk e la as atë tē binte e tē shtrihej pér tokë.

Motin tjetër ai përsëri lulëzoi.

Dhe ka shumë vjet që po qëndron ashtu. Lëkura, nē atë vënd ku takohen tē dy ahet, u është rjepur dhe sa herë që shtriga erë sulet përmbi pyll, krahët e tyre gërvijnë e vicërrijnë.

Çfarë i thotë nato çaste ai ahu i gjymtuar?

Mos i thotë me dhëmbje nē zëmër!

— Mjaft më mbajte, o vëlla, mjaft. Në tē jam rëndur, lëshomë, unë nuk tē zëmërohem. Pun' e madhe se më merr stuhia, pylli nuk prishet.

Kurse tjetri ja kthen me një zë tē fortë e tē rreptë:

— Ç'thua kështu, o vëlla?

Qafshtamë — Gusht 1956

3) XIXËLLOJAT

Përtérihet moti si gjithënjet; stinët ndjekin njera tjetren dhejeta s'ka fund. Bijen gjethet e zverdhura në vjeshtë, dhe pema shëmtohet, duket e thatë e sikur s'ka më jetë, por ja, me të ardhur pranvera, burbuqet e fjetura shkundin vesën e mëngjezit dhe, me sythin e porsahapur, pëershëndesin rrezen e florinjtë të diellit.

Të gjitha përtérihen mot e nga mot, me një rregull që s'prishet kurrë: mungallon bari, lulëzojnë pemët, bulojnë gjethet, zukatin bletët, ngallojnë grunjërat! Ç'bukuri!

E kur piqet buk' e re, zën' e dalin xixëllojat. Me të parë xixëllojat, zëmra jonë dridhet si telat e një kitare. Po pse vallë tronditet zëmra jonë? Ç'fuqi magjike kanë këto insekte që fluturojnë duke lëshuar pas një drithëzë të venitur në mbrëmjet e ngrohta të verës?

Ah, po ka të drejtë të shqetësohet zëmra jonë, se xixëllojat na kujtojnë atë kohën e lumtur, të shkujdesur dhe që nuk ka më të këthyer, na kujtojnë fëmijërinë tonë.

Kam ndjerë mall e s'kam ndjerë këta vitet e tjerë, kur kam parë xixëllojat, por si një mbrëmje në Voskopojë, jo tjetër herë.

Ishte një mbrëmje e vakët korriku. Lart në mal endej melodia e një kënge të vettmar; diku lehte një qen; ndiheshin këmborë e në shpatin përkundruell ndriçonte një zjarr. Qielli qe i zi e i mbushur plot me yje, yje të panumurt. M'u duk për një çast sikur yjet kishin zbritur në tokë dhe fluturonin nga të gjitha anët. Vrava mëndjen! Pse kishin zbritur yjet në tokë? Pastaj u përmënda e vura re se s'qenë yje po xixëlloja.

Kurrë në jetën time s'kisha parë aqë shumë xixë-
lloja!

E, duke i shikuar, m'u kujtuan të gjitha: fshati, shtë-
pia, mbrëmjet e verës, lodrat, shokët. M'u përfytyrua
vetja i vogël.

Kujtova ato mbrëmjet e qershorit, kur nëna kthehej
e lodhur nga ara dhe rrinte në sofat të portës duke bise-
duar me gratë e mëhallës. Unë, i lodhur nga lodrat e di-
tës, vija kokën në prehrin e saj dhe sytë më koteshin për
gjumë. Férkoja pas faqevet ato duar të ashpra që ruanin
akoma erën e athtë të barit të fushës, mbyllja sytë e s'do-
ja asgjë tjetër, veç të dremitja duke futur kokën në gjirin
e nënës. Por ja, papritur, aty më tej, fëmijët e tjerë fillo-
nin të ndiqnin xixëllojat duke u kënduar:

«Palare, bjer përdhe,
Se t'u ngjita me varë
Të të bëj copë-copë
Të të hedh më një gropë...»

Si nëpër gjumë dëgjoja melodinë e këngës e atëherë
shkëputeshë nga pëqiri i nënës dhe rëndja gjithë gaz pas
xixëllojavet që më dukeshin si yje të këputur a si mar-
garitarë të qiellit.

Gëzimi im s'kish kufi kur arrija t'i zë xixëllojat e t'i
vë në ballë.

Kush e përbante dot krenarinë time atëhere? Më
dukej vetja si heroï i përrallës «Djali me yll në ballë».

E se ç'më zuri ky mall, o shokë, e m'u ngjall një dë-
shirë e papërbajtur atje, në Voskopojë, të rendja pas
xixëllojavet si fëmijë, t'i zë e t'i vë në ballë, po kisha fri-
kë mos më shikonin shokët e do fillonin të qeshnin e të
më tallnin.

Dhe ndënja i menduar e po i soditja me zëmër të
dërmuar nga kujtimet. E po mendoja, vallë përsë ta ke-
të atë drithë xixëlla ja atë drithë që i shkurton jetën? Mos
që fëmijët të zbukurojnë ballin e papërlyer ku drita
shkëlqen ashtu si gëzimi në shpirtin e tyre?

Voskopojë Gusht 1957

4) PYLLI DHE DASHURIA

II vetëm po shëtisja në pyll.

Sa ma kish ënda! Ecja i shkujdesur dhe i lumtur. Çdo gjë për rrëth qe e pastër, e ndritëshme, e qetë dhe e thjeshtë. E ndofta ajo thjeshtësi, që zotëronte për rrëth, të bënte të mallëngjeheshe për diçka që as vetë s'e kuptoje.

Moti qe i butë; pylli ish i freskët, i qetë e plot drithë. Vetëm pishat e ngrohura nga dielli shpérndanin një aromë të ëmbël, të lehtë e dehëse si temjam. Kjo aromë pime të largonte mendimet e trishtuara, brengat e dhimbjet e shpirtit, e, si hashashi, të vinte në gjumë me ëndrat më të bukura. Veç, pas zgjimit, nuk ta vriste shpirtin si hashashi, pylli ta jepte atë aromë me gjithë zëmër, të bënte të lumtur e njëkohësisht të dehte e të mallëngjenë, si vajza kur të dhuron virgjërinë.

Kaqë më pëlgente ai ajër i kulluar dhe kaqë po e shikojë atë bukuri, sa në zëmër më lindën disa dëshira të çuditëshme dhe jo të zakonëshme. Doja të bëja diçka të madhe, të bukur, të paparë; doja të bërtisja, të ecja me vrap si fëmijët, të kërceja kollotumba, të fluturoja, që të derdhja përjashta gëzimin dhe energjinë e tepërme që më kish ngjallur pylli në shpirt.

E kë nuk do të dehte vallë ai shpat pishash në pyllin e Qafshtamës?

Papritur, vura re një mikun tim që po rrinte në këmbë me supin mbështetur në një trung pishe, i tretur në mendime dhe i harruar.

Ai nuk shikonte as majat e ergjënta të pishavet, as

fijzat e barit që përkundëte era, as dritën e gjëzuar të die-
llit, as kundërmimin e rrëshirës nuk e ndjente. Ai as
shikonte as dëgjonte.

Po vallë ç'kish ky njeri?
Dashuronte!

Po, miq, ai dashuronte dhe kudo që hidhte sytë, i del-
te përpara fytyra e praruar e së dashurës, me flokët lë-
shuar mbi supet, vështrimi ëndëronjës e melankolik i sy-
ve të saj të zes dhe ato buzët e kuqe e pakë të çelura, si-
kur të prisnin, prej kohe, një puthje të gjatë e të zjarrtë.

Këtë fytyrë magjiplotë, ai e ëndëronte, e shikonte me
syt' e mëndjes dhe ndofta i dukej se e kishte aty pranë,
të fshehur, diku prapa trupit të ndonjë pishe.

Kush qe më i lumtur, ai apo unë?

Dhe sepse n'ato caste m'u tret gjëzimi, o shokë, e zë-
mra m'u rrënqeth e ndjeva në shpirt një trishtim, trish-
tim...

Qafshatamë-Tiranë 1958

5) DRITA E YLLIT

Pse më trishton përkëdhelja e dritës sate, o yll? Pse më zë malli të të sodit në netët e ngrrohta dhe erëkëndëshme të korrikut? Përse nuk nginjem me të admiruar vezullimin tënd dhe ëmbëlsinë që derdh mbi botën tonë ajo drita jote aqë e gjëzuar dhe aqë e çiltër?

Shkëlqimi yt s'ka ndryshuar, o stoli e Qiellit të parfund. Dhe vështrimi yt, si një sy hyjnie, shikon me adhurim këtë botën tonë të vogël.

Po mua a më ke parë, o yll? Duhet të më kesh parë netëve të korrikut, kur flija me gjyshen në lëmë e kur, i shtrirë më kurris, të vëreja me dashurinë e me adhurimin e pastër të fëmijës e kur ajo drita jote e shkëlqyer më mbushte shpirtin me ngazëllim.

Ne ruanim togun në lëmë. Unë tulatesha pranë gjyshes e me zëmër prej fëmije shikoje vezullimin tënd dhe ëndra të bucura më përkëdhelnin shpirtin. Ti ishe lart, shumë lart drejt mbi kokën time dhe unë kisha frikë se mos edhe ti këputesh si ca yje të tjerë e më dukej se do të bije drejt e mbi mua. Atëhere të shikoja me frikë, dhe vija dorën në ballë e mbyllja syt, për tu mbrojtur.

Po ti ishe aqë i mirë e aqë i dashur!.. e, pas pak, drita jote e ëmbël m'i kapsallite sytë, e me dashuri m'i përkëdhelte qepallat. A s'më mban mënd?

Në mos më ke shikuar atëhere, duhet të më kesh parë një natë tjetër korriku, kur përkëdhelja me zjarr rinie një vajzë. Ne ishim në një lëndinë. Rreth nesh plepat e lartë fëshfërinin të përkundur nga flladi. Hëna derdhe mbi tokë një dritëzë argjëndore, xixëllojat fluturo-

nin si ca yje tē vegjël dhe tej dukeshin kunturet madhështore dhe tē heshtura tē malevet. Gjithë bota kishte rënë në një qetësi tē amëshuar; nata qe e heshtur dhe në heshtjen e saj kishte diçka hyjnore. Atëhere tē pashë tē pasqyruar në bebëzat e saj. Sa i bukur m'u duke! Kurre s'të kisha parë aqë tē ndritshëm.

Drita jote derdhej hirplotë mbi ne e dukej sikur gjëzohej së bashku me zëmrat tonë.

Pra duhet tē më kesh parë o yll, dhe s'është e mundur ndryshe, sepse një njeri që tē vështron gjithënjë me dashuri s'ke si tē mos e vësh re.

Ti ke miliarda vjet që shikon drejt mbi këtë tokën torë, si një dëshmitar i heshtur dhe i dashur. Më pe fëmijë tē vogël, më pe me vashën në krahëruar, do tē më shikosh edhe për disa vjet e pastaj kurrë më.

Ti do tē shikosh breza tē tjerë, fëmijë tē tjerë që do tē flenë pranë gjysheve, netëvet tē korrikut, djem tē tjerë që do tē përkëdhelnin tē dashurat e zëmrës, sy tē tjerë që do tē tē vështrojnë me përmallim.

Sa tē kam zilinë, o yll, e sa do tē dëshëroja tē isha në vëndin tënd, jo se kam frikë nga vdekja, po veç desha tē shikoja pranverën e njerëzimit që duket se po vjen mbi këtë Tokë!

Rehovë 1958

Përshtypje udhëtimi.

NË BRIGJET E JONIT TË KALTËRT.

Më kish mbetur merak që gjatë jetës sime si gazetar nuk më ish dhënë rasti të vizitoja rivierën e vëndit tonë: prej Vlore e deri në Sarandë.

Më thoshnin se është shumë e bukur, më thoshnin se është e mrekullishme; bile, kur binte muhabeti për bukuritë natyrore të vëndit tonë e kur ndonjë të pyeste ash tu shkarazi: — ti a e ke parë bregdetin? — Po t'i përgjigje she jo, atëhere tundëte kokën sikur donte të të mëshironte e të të qante hallin. Sigurisht ai me mëndje të tij thoshte: — Me që s'ke parë atë anë andej, më kot flet për bukuritë e vëndit tonë.

Kaqë më vinte turp të thosha jo, sa që disa herë u futta në gjynah duke gënjiyer.- Bregdetin? Po si s'e kam parë. I bukur shumë.

E kështu e merrni me mënd gjëzimin tim, kur, më së fundi, mora një fletë shërbimi për n'ato vënde.

Pastaj, të vjen edhe një çikë thartë, kur mendon, se me qindra turistë që vijnë nga an'e anës e vizitojnë rivierën tonë dhe shkruajnë përshtypjet e tyre në gazetë, kur se shokët e mi dhe unë, që s'qemë më larg se 200 kilometra, detyroheshim në një farë mënyre të lexonim ato që shkruanin ata.

Për bregdetin tonë është shkruajtur mjaft, e në shkrimet gjen tek-tuk gjëra të bucura; dhe, sikur dora e krye-

redaktorëvet, e stërvitur për shkurtim, të mos futej në veprim, ne do të shikonim në gazetë, jo vetëm jetën e fshatarëvet dhe të koperativavet bujqësore, por edhe bukuritë natyrore të pakrahasueshme të kësaj ane.

Në mëndjen time të varfër, ka mbetur i paharruar një përshkrim i saktë dhe i bukur, i shkruar prej dore mjeshtri, plot frymëzim e dashuri. Këtë e ka shkruajtur ai poeti i çalë, që la vëndin e tij plot mjergull e lagështi dhe, hipur mbi një gjemi me vela, zbriti në një skelë të Spanjës dhe vizitoi gjithë anën lindore të Mesdheut të kaltërt e plotëmbëlsi. E pa edhe vëndin tonë dhe, me dorën e tij të artë, shkroi vargje të paharruara për Shqipërinë e për Shqiptarët. Atij që lexon «Çajlld Harolld-in» a nuk i ndizet dëshira të shikojë këto vënde të bukura, ku-

Të ngrysur çohen lart përpara syve,
Si amfiteatër vullkanik natyre,
Së majti, djathtas, alpet e Himarës;
Rrëzës lënga lëviz me gjë të gjallë;
Blegrijnë grigjat, rrjedhin prrenjtë, kreshtat,
Po valaviten. Ja Aheron i zi,
Lumi q'u ishte truar varreve.
O Plut, ndë qoftë ferri yt si ky,
Elizit mbyllja portën, shpirti nuk ma do.

Gjithënë më kujtohen vargjet:

«N'Atikën e përmëndur rrallë sheh
Lugina kaq të bucura; S'ka Tempja
Stoli që aty s'e gjen; Parnas i dashur,
Megjithse vënd klasik i shënitëruar,
S'krahasohet dot me vise që fsheh ky bregdet.»

Më thoni pra, a mund të harrohen të tilla vargje?

E natyrisht, pas këtyre vargjevet që përmënda, përshkrimi im do të duket tepër i mjerë dhe i varfër, por unë nuk guxoj të them se bëra ndonjë përshkrim të mrekullishëm për bukuritë e bregdetit dhe për

njerëzit e tij. Unë do të çfaq thjeshtësish ato që pashë e që ndjeva dhe, jam i bindur se sado bukur që mund ta shkruaj këtë pjesë, nuk kam arritur të them e të çfaq as një të qindën, e asaj bukurie.

Nuk di pikërisht se nga duhet t'ia filloj, Ç'të shkruaj më përpara, për natyrën, për kohën, për njerëzit a po për historitë që më treguan. Që të gjitha janë interesante, që të gjitha kanë bukurinë dhe lezeten e tyre dhe me merak pyes vehten: A jam në gjendje t'i shpreh të gjitha ashtu sikurse i pashë dhe i ndjeva?

Nuk udhëtova me veturë a me taksi, por me kamionin e postës që shkon ditë pér ditë, nga Vlora në Himarë. Shoferi qe një djalë i ri, me një fytyrë të lezetëshme, me flokët kaçurrela e me vështrimin të dashur e të qeshur, por mua, ndofta, m'u duk më tepër simpatik se ç'qe, pasi kur iu luta të hipja përpara në kabinë nuk më kundërshtoi.

Nga Vlora u nisëm vonë; ora po afronte dymbëdhjetë, por dukej sikur qe më të ngrysur, se koha qe e vrënjtur e binte një shi vjeshte i hollë. Ishte një nga ato ditët e zymta të nëndorit, ku njeriu e ndjen shpirtin të trishtuar edhe në shtëpi e jo më në agjensitë e transportit, ku s'ke me se të merresh dhe vjen rrotull pa qëllim si ariu në kafazet prej hekuri. Gjithmonë, kur udhëtoj, mbaj me vete ndonjë libër, të cilin e lexoj, sa herë qëndroj nëpér vënde ku s'kam shokë e miq; por atë ditë, si pér djall, edhe libri qe i mërzitshëm dhe desha s'desa e mallkova nja dyherë atë shkrimitarin. Do ta kisha mallkuar edhe më rëndë sikur të mos e hiqja veten edhe unë një çikë si shkrimitar e sikur të mos e dinja se sa e vështirë është të shkruash libra të bukura.

Rugë prej Vlore gjer në qafë të Llogarasë duket e gjatë dhe ndofta do të qe edhe e mërzitëshme sikur vëndi të mos qe i veshur me ca shkure, të cilat qëndrojnë të gjelbërtë dimër e verë dhe me blerimin e tyre ja heqin natyrës atë trishtimin që ka vjeshta.

Po ngjitim të përpjetën e Dukatit. Përpara se të fillonim të përpjetën, shoferi qëndroi dhe, mbasi ja kontrolloi rrotat makinës, ja shtërngoi edhe një herë burgjitet nga të katër anët. Kur e shikon shoferin që tregon kujdes, të

vjen ta lavdërosh, por nga ana tjetër të duket sikur ai këtë kujdes po e tregon prej frikës se mos i ngjet ndonjë e papriur. Po sa gabim do të bënte njeriu të quante frïkakë shoferët e kësaj linje! Bile do të bëhej dhe qesharak në sy të tjetrëvet. Kush nuk ka dëgjuar për Llogaranë. Për këtë rrugë të ngushtë e të rrezikshme, kur njeriut i merren mëntë më këmbë e jo mbi timon të makinës? Ata janë heronj, po si çdo punë që arrin e bëhet e zakonëshme nuk bije më në sy; tani dhe atyre vetë kjo rrugë u duket fare e zakonëshme dhe me duart në timon këndoijnë si pa gjë të keq.

Udhëtimi është i gjatë dhe i vështirë, Makina kërcen nëpër gropat. Fryn erë; një erë e marrë, e tërbuar, e fushime dhe kujitëse. Sa i afrohemë Qafës së Llogorasë, aqë më e fortë bëhet era dhe mbulesën e makinës e fryn si gjyryk, sa që Jakua, — sepse kështu e quajnë shoferin — më një dorë mban timonin, kurse tjetrën e ka nxjerrë që nga xhami i derës së makinës dhe mban një cep të mushamasë.

Kot së koti mendohem pse i thonë Llogara: Me etimologji s'jam marë kurrë, por mëndja më thotë se kjo fjalë vjen prej greqishtes dhe ka kuptim llagar — i pastër, i qëruar. Ky mendim m'u përforcua kur dëgjova nga goja e Himarjotëvet, se, disa vjet përpara, aty qe ngritur pér turistët e huaj një kamp verimi. Vinin turistë nga an'e anës, të shëndoshë e të sëmurë pér të admiruar panoramën e pér të shijuar ujin e ftohtë e ajrin e pastër. «Ai vënd, o byrazer, ja të llagaris, ja të përcjell.» thonë Himarjotët. Dhe me sa duket kanë të drejtë.

Sa i afrohemë Qafës së Llogorasë, aqë më e tërbuar bëhet era. Në Qafë fryka erë dimër e verë dhe pemët, disa pisha të zeza që gjinden aty pranë, nuk janë konifere e nuk guxojnë të ngrehin kryet përpjetë, por janë si të rrëgjuara e të sakatosura. Të duket se dikush, pér t'u tallur, u ka rënë me shpatë e ua ka prerë pjesën e sipërme dhe i ka lënë si pa kokë.

Shoferi më tregon me kënaqësi se këtu era nuk rresht kurrë dhe shumë vjet përpara një tufan i fortë na paska marrë një gomar ngarkuar me misër, bashkë me të zotin — një fshatar nga të këtyre anëvet — dhe më t'i paska pér-

plasur nja njëzet metra tej pas një shkëmbi. Jakua ma tregoi edhe shkëmbin, sikur të ish ndodhur aty, në ato çaste tmeri e gazi.

Qelli është i vrenjtur e i rënduar. Poshtë tufavet të revet ngjyrë plumbi, fluturojnë e sillen rrötull ca re të vogla, te zeza pis, sikur të qenkeshin tym prej dinamiti, dhe pas pakë me çudi shikon se si retë e mëdha ngjyrë plumbi fryhen e nxihen duke iu kanosur tokës. Dhe ja, më në fund, dalim në Qafë të Llogarasë.

Pa pritur u duk sikur para nesh u hap perdeja e një teatri gjigand dhe, të mahnitur, vumë re një pamje të mrekullishme. Kurrë s'më ka gufuar zemra e s'kam ndjerrë ngazëllim t'atillë, e kurrë Atdheu s'më është dukur më i bukur se atë ditë. Me të vërtetë aty pamja është mrekulli e natyrës sonë të cilën njeriu nuk arrin as ta krijojë me fantazinë e tij dhe as ta shikojë në ëndërr. Mendoni një udhëtim të gjatë e të mërzitshëm, duke iu ngjitur një të përpjete në mal, ku syrin s'ta tërheq asgjë e veçantë, dhe, pas këtij udhëtimi, të dalësh në një qafë mali të lartë, ku, pa pritur, të shikosh një botë të re, një horizont të gjë- rë e të mahnitshëm. S'ngopesh së marri frymë. Të duket sikur q'do gjymtyrë të është rritur dhe ti je bërë përnierherësh gjigand.

Poshtë, nën këmbët e tua, nja 900-1000 metra në fund të rafshirës, duket deti në gjithë madhështinë e tij. Mbi det, vënde-vënde, bijen fashat e rrezevet të diellit, të cilat duken shkoqur si fryma e shënjtë që bëjnë piktorët nëpër ikonat. Këto tufa rrezesh dalin nga të çarat e reve dhe bijen mbi faqen e lëmuar të detit, duke e ndriçuar e duke i dhënë gas e shkëlqim, sikur nuk duan ta lënë vetëm në furtunën që po afrohet. Gjetkë, deti ka marrë ngjyrën e reve dhe është i zyrtë, i trazuar, i rrudhur, sa që, së sipërm, duket si një fushë e plasaritur, por po të vesh re pér një çast me hollësi, bindesh se je gënjerës në krahasimin që i ke bërë. Kjo faqe është e gjallë, dridhet e zhurmëron. Vër re më mirë bregun e detit: aty së largu të duket një vijë e bardhë si varak a si argjend i shkrirë, që lëviz pa pushim, duke puthur bregun e duke u tërhequr si me turp, po pastaj përsëri pasioni i jep vrull dhe deti me buzët e ergjënta puth tokën e shenjtë.

Si një rrip pa mbarim, në gjithë gjatësinë e detit, anës së bregut, duket një vijë e kaltërt e hapur, si në të gjelbërt; kjo vijë sikur kërkon të vërë kufi midis detit e tokës. Pas saj duket deti i gjërë i zyntë dhe i mérzitur. Veç në vendet ku bijen tufat e rrezevet të diellit, uji ndriçon si një copë pasqyrë dhe deti duket sikur buzëqesh e sikur pret, me përqeshjen e të fuqishmit, kërcënimin që i bën furtuna. Më larg akoma dallohet një si mjergull e hollë dhe deti shkrihet me retë ngjyrë plumbi; atje bije shi.

Drejt, përpara, dallohen shtëpitë e bardha e të pastra të Palasës e të Dhërmimit, kurse nga ana e lindjes janë malet e Vetëtimavet, impozantë dhe të madhërishëm, të mbështjellë me mjergull e të heshtur. Por heshtja e tyre është e rrëme dhe njeriu pret me ankth, se diçka, që këta male e mbajnë fshehur në gji të tyre, do të shpërthejë pa pritur dhe atëhere gjithë vendi do të dridhet e do të shembet. E si për të zbutur gjithë këtë stuhi e vrull, aty në Palasë duken trupat e drejtë të qiparisavet, të cilët me qetësinë e me bukurinë e tyre, ta zbutin zemrën; më të poshtëm duken bahjet me portokalle: gjithë këto sikur duan të të tregojnë edhe mirësinë e butësinë që ka ky vend. Ku gjetkë në botë gërshtohet krenaria e malevet me embëlsinë dhe butësinë e detit sa në këtë vend?

Po zbresim në të tatëpjetën e Llogarasë, në këtë mal krenar që është i téri shkëmb e ku natyra zëmërdhemshur, me mundime të mëdha, ka mundur t'ja mbulojë faqen e thinjur me shërbelë e me një bar tjetër të shkurtër që i ushqen fletët në të plasurat e shkëmbit.

Pas ndonjë ore, deti errësohet dhe mjegullohet. S'andejmi vjen shi me erë. Dhe s'di sepse, mëndja ime, pa dashur, në këto çaste, përsërit vargjet e bucura të një poeti popullor të këtyre anëvet, ku përshkrimi i bukur e i saktë i natyrës sonë harmonizohet me ndjenjat melankolike që thonë vargjet e mëpastajme e me melodinë nostalgjike dhe përmallonjëse që ka muzika.

«Nata po vjen,
Qielli ç'u nxi,
Deti gjëmon

Frym e vetëtin.

Dilë, moj dile

Dil' e dëgjo zënë

Kujto dashurinë. . .»

Ja edhe shiu nuk vonon.

Pikat e para e të mëdha të shiut që paralajmërojnë furtunë, përplasen në xhamin e makinës dhe, pas pakë, mushamaja e karrocerisë kërcet sikur të ishte një lëkurë daulleje e tendosur. Vetëtima si flakë çan qiellin dhe shkëlqimi i saj zigzag të mbetet për një çast në sy. Por vetëtimat e shumta duket sikur nuk i lëshon Zeusi nga qielli për të ndëshkuar fajtorët e për të treguar forcën e pushtetit të tij, por sikur dalin nga majat e malevet. Ndofta Tibuli, ai poeti i lashtë romak, në ndonjë kohë të tillë i ka parë këto male qëkurse i pagëzoi me atë emër që u përshtatet e u ka hije për madhështinë e tyre: «Malet e Vetëtimavet». Emër më i bukur e më kuqtimplotë nuk mund të gjindej për këta male.

Rrebeshi vazhdon. Bubullin. Shkrepëtin. Gjemon. Qielli e dheu dridhet. Kreshtat e Akroqeraunëvet janë futur në mjergullën e përhime e të duket sikur malet janë të llahtarisor të shikojnë ç'ngjet poshtë në këmbët e tyre. Por jo, për këta male s'vlen një krahasi i tillë. Po t'i soditësh me vërejtje, do të të duket se jo retë janë ulur, po sikur mali ka ngritur kokën përpjetë, ka çarë retë dhe i thotë qiellit me përbuzje e krenari: «Bëj ç'të duash, s'ta kemi frikën».

Erë, shi, furtunë, qiell, det e mal, të gjitha përzjehen në një harmoni heroike dhe njeriu ndjen forcën dhe bukurinë e pakrashaueshme të natyrës shqiptare. S'nginjesh së shikuari e së admiruari.

Vazhdojmë të ecim. Shoferit nuk i bën asnjë përshtypje rrebeshi dhe pi duhan fare i qetë.

Pasi kemi zbritur gjer në mes të Llogarasë, detyrohem mi të qëndrojmë pranë postës së kufirit bregdetar. Disa ushtarë të veshur mirë na përhëndesin dhe bisedojnë mi-qësish me njerëzit që njohin. Shiu pushon pa pritur, kurse era vazhdon me atë furinë e parë. Gjithë kamioni tundet sikur të jetë prej kartoni dhe të vete mëndja, se era, po

të dëshërojë, mund ta hedhë në greminë si një fije kallami. Jakua kishte një hall tjetër; me që mushamaja e makinës i qe shqepur në njady vënde, kish frikë se mos era e marrë ja merrte si katana fëmijësh dhe e shpinte kushti se ku, prandaj sa qëndruam atje, nuk pushoi së thëni:

— Ah! Llaqi, o Llaqi, ç'na bëre, o Llaqi... Bubu! ma mori makinën era.

Llaqi qe shoferi tjetër, i cili, në këtë kohë, kthehej nga Saranda dhe ne detyroheshim ta prisnim atje, pasi rruga në këtë vënd është tepër e ngushtë dhe në asnje mënyrë nuk mund të kalojnë dy makina bashkë.

Llaqi vjen dhe Jaku e porosit që, kur të dalë në qafë, të ketë mëndje se mos ja merr era mbulesën.

Vazhdojmë të zgresim në të tatëpjetë. Së largu, qiparizat e 'Palasës duken si kallamet e lule shtarës që mbijnë nëpër shpatet e malevet të larta. Shtëpitë e Palasës janë të bukura, thuajse të gjitha me dy kate, të suvatisura nga jashtë dhe me dritare të gjëra. Duket se për të ndërtuar të tilla shtëpija. këtu, është dashur të derdhet shumë djerësë në vëndet e huaja e të largëta, matanë malesh e detesh të mëdhenj.

Kisha dëgjuar përpara një krahasim, që e përdornin disa për të treguar se sa pakë tokë kishin: «kam një arë po q'e do, të shkryhet gomari i del bishti jashtë», por që të kish ara të tilla, unë s'e besoja në asnje mënyrë. M'u desh t'i shikoja këto vënde që ta besoja këtë të vërtetë. Nuk di në mund të quhen ara ato dy pëllëmbë vënd që njerëzit me mundime e vuajtje ja kanë shkulur malit shkëmbor. Kur i shikon këto «ara» të ngritura njera mbi tjetrën në pjerrësinë e malit, të duken sikur janë basamakë shkalle, mbi të cilat mund të hedhësh këmbën nga njera tek tjetra pa mundim fare, për t'u ngjitur lartë në mal.

Po natyra kjo, nënë e kujdesuar, s'ka lënë njeri jetim në botë. Në mes të shkretëtirës ka bërë oazin përdëllenjës, në mes të xhunglës e të vapës tropikale ka rritur kokon, këtë pemë që mban brenda një lëng të freskët e të ushqyeshmë për indianin e zhuritur. Edhe në këta anë natyra e ka treguar kujdesin e saj: këtu rriten ullinjtë, limonjtë, portokallet, fiqtë, mandarinat.

Kalojmë në mes fshattrash të tjerë: Dhërmi, Ilias dhe i afrohemë Vunoit. Ky fshati i fundit nuk qe fare i panjohur për mua. Dy prej shokëvet të zyrës qenë po nga ai fshat dhe nga goja e tyre kisha dëgjuar qyfyret dhe disa nga shakarat e nga thumbat me të cilat flasin zakonisht vunjotasit njeri me tjetrin. Nga të thënët e tyre kisha edhe një parafytyrim fizik të fshatit, po këtij parafytyrimi m'u desh t'i bëja korigjime të mëdha. Nuk më kish shkuar ndër mënd se fshati mund të ndërtohej në një vënd aqë të pjerrët e të thyer. «E mendoja vëndin pakë më të sheshtë dhe fshatin më të hapur.

Në këtë fshat qëndruam fare pakë, sa për të lënë postën, siç thonë shoferët. Megjithëse Vunoit nga xhadeja, e cila i kalon mspërmes, nuk duket as fort i madh as fort i bukur, udhatarit i lënë mbresë dy gjëra që normalisht duhet ta përjashtonin njera tjetër: Gjen akoma shtëpija të djegura, të cilat tregojnë braktisje e mjerim, po gjithashtu gjen edhe shtyllat me fijet e dritës elektrike, me të cilën ndriçohet fshati sot. E para është vepër e vandalëvet që shkelën në këto anë; e dyta është vepër e duarvet tonë, e epokës së re ndërtimitare.

Nisemi për rrugë. Shiu fillon përsëri dhe herë pas here shkrepit e deti i qetë, në madhështinë e forcën e tij, i shuan pa mundim shigjetat e zjarrta të qiellit, ashtu siç thotë Gorki në të famëshmin «Sgalem».

«Kap shigjeta vetëtimash dhe në gji i shuan deti...»

Ndërsa shiu vazhdon, në rrugë kalojnë vajza e gra të ngarkuara me thasë a me shkarpa, me faqe të skuqura nga shiu e nga lodhja.

Arritëm në Himarë, ose të them më mirë në Spile, pasi këtu gjendet Himara zyrtare e administrative. Këtu janë zyrat, postat, dyqanet, klubet. Në kundërshtim me njërit, natyra nuk tregohet mikpritëse. Bije një shi me rrësheke, si i thonë, e duke dalë nga makina me vrap futemi në një kafene. Atje, me porosi të shoferit, i zoti i kafesë na bëri dy kafe sade si për miq dhe na i shërbue duke na bërë muhabet. Piva shumë herë kafe te ky himarjot, dhe nuk dua të flas për kafetë e mira që bënte, po për diçka

tjetër, të cilën unë nuk e prisja: na qerasi me bujari katërpesë herë. E marr vesh se fshatari ynë i ka mbajtur me besnikëri zakonet e lashta të mikpritjes sonë me famë, po nuk ma merrte mëndja që të tilla cilësira të trashëgonte 'to. Po kjo dhe gjërat e tjera që pata rastin t'i vija re në qëndrimin tim të shkurtër, më bindën se Himarjotët përmikpritje e për të nderuar miqtë a të largëmit, atëhere kur duan, janë të vetmit.

Kish filluar të ngrysej. Deti qe shumë i trazuar. Valët përpinqeshin pas bregut me zhurmë dhe gjithë deti buçiste, lëvizte, tundej sikur kish shpërthyer gjithë zëmërimi i tij kundra qiellit e shiut, të cilët e kishin ngacmuar e i kishin prishur qetësinë. Kush mbjell erën, korr furtunën!

Në darkë hyra në kafenë e Gogos, nga që s'dinja kuta kaloja mbrëmjen. Kafja, si lokal, s'qe për t'i pasur zili. Të nxirrte mallin e atyre kafeneve të mesjetës që përshkruan Dumasi në romanet e tij. Qe e errët, vetëm me një dritare; edhe këtë e kishte nga ana e derës. Disa tavolina të vogla të pambuluara, disa lloje karrikesh e modele të ndryshme fronash. Kjo qe pasuria që dukej, dhe nga të pamët nusja nuk shitej, po pajën e kishte të madhe. Mbante një raki rrushi safi, e cila, edhe për një që s'ishte terjaqi, kishte një të mirë të madhe: nuk të linte të ikje me një gotë, por edhe gjysmë kilo të pije kokën nuk ta rëndonte. Sikur u prallisa shumë për këtë rakinë e zotë mos e dhëntë t'ju ngjallet dyshimi se jäm ndonjë terjaqi i madh.

Nga kjo raki po pinte Barba Haraqi, për të harruar dertet e hallet e tij. Nga fytyra dukej një plak i mbajtur mirë. Kuptohej se do të kish bërë ndonjë punë të lehtë që s'e kishte vrarë e tretur.

Më fton të ulem, pa më njobur, në tavolinën e tij dhe unë e pandeh për çakërqef, por megjithatë i vete. Bëjmë muhabet. Siç e kanë zakon shqiptarët, të pyesin një herë nga ç'anë je, me se merresh e pastaj kujtohen për emrin. Kështu filloi edhe muhabeti ynë. Iu bë qejfi kur mësoi se isha andej nga ato anë ku dielli na bën një të mirë; na shi-

kon një çikë më parë se të tjerët, sa po çel sytë mbi majat e malevet të Gramozit.

Iu bë qejfi, se duallëm patriotë.

— Edhe unë nga ato anë jam, po kam vjete që jam shkulur s'andejmi e kam ardhur këtu. Di unë sa u bënë tani? dyzet a pesëdhjet vjet... a.

Po ta vesh re të folurën e tij, të tingëllon në vesh me disa ndryshime nga ajo e himarjotëvet.

Bën çmos që të më mbushë mëndjen, se ai duhet të më qirasë mua e jo unë atë. «Na ke ardhur mik, thotë; ne duhet të të nderojmë e të të presim mirë që të mos e ndjesh.. (kërkon të gjejë fjalën që i duhet, po s'e gjen dot dhe bën grimaca të dëshpëruara)... si të ta them unë... ja... që je larg shtëpisë.»

Biseduam gjer e gjatë. Barba Haraqi ish shpërndarës i postës. Kish tetëmbëdhjetë vjet që merrej me këtë zanat.

Tetëmbëdhjetë vjet! Një jetë e tërë! Dhe çfarë punë kish bërë? Kish shpërndarë letra, telegrame dhe ftesa gjyqi. Në këta vjet ai qe bërë dëshmimtar i shumë ngjarjeve. Duket një punë pa rëndësi, mirëpo ja, ky plak ka marrë pjesë më shumë se të tjerët në gjëzimet e dertet e njerëzvet, ky u ka qëndruar më afër.

Pa më thuaj, a të bën zëmra t'i shpijesh një nëne telegramin ku i lajmërojnë vdekjen e të birit? Atëhere fytyra e shpërndarësit bëhet e heshtur, e vrenjtur, dora mezi trokit në portë, e zëri i dridhet dhe, duke tundur kokën, i pikëlluar, dorëzon telegramin. Ndryshe është kur lajmëron dasmë, fejesë a lindjen e ndonjë fëmije. Atëhere shpërndarësit i ecin këmbët vetë, tiparet e fytyrës i qeshin dhe fluturon nga gjëzimi.

C'do punë në botë paska rëndësinë e saj dhe të gjitha plotësojnë njera tjetrën.

* * *

Pas darke shkova në klub. Atje pata fatin të njihem me një personalitet tjetër të Himarës, me Barba Neçon, «përgjegjësin e transportit ajror, detar dhe tokësor», por, me që në Himarë s'ka as aerodrom, as skelë, kuptohet se përgjegjësi mbetet vetëm tokësor, e megjithatë kjo nuk ja

ul vlerën. Në Himarë të moshuarvet nuk u thëresin emrat, përgjithësonjës që përdoren në krahinat e tjera si «Dajë», «Xha» ose «Babë», por kanë marrë nga gregishtja atë «Barban» popullore dhe në gojën e tyre nuk tingëllon e huaj po duket thjesht shqip.

Klubi gjëndet buzë detit. Është një ndërtesë e vogël, e bukur dhe e pastër.

Në anën e jug-perëndimit ka një verandë prej dërrash që zgjatet gjer përmbi det dhe e cila, me sa duket, në muajt e ngrohtë të verës, duhet të jetë një vënd i këndshëme i pëlqyer. Brenda; klubi ish zbuluar me disa piktura (kopje) të Shishkinit, që tregonin skena gjahu e pamje nga pyjet ruse, e përvëç këtyre, kishte edhe disa kartpostale të punuara, si duket, nga ndonjë bojaxhi, pa gusto e me ngjyra të gjalla e të ndezura. Darkavet, zakonish në klub mblidhen shumë njerëz dhe, duke bërë muhabet, pinë nga ajo e bekuara djersë kazani, që t'u zgjidhet gjuha e të flasin shpenguar. Të tjerët, që ua këndaluar doktori ose xhepi, pijnë kafe dhe bëjnë sehir.

A po shqiptari është shqiptar e do ta bëjë beli kudo: pijen e do të shoqëruar me këngë, se ç'raki — zezë është ajo që s'të bën të këndosh! Dhe kështu në klub kërcet kënga gjer natën vonë.

Deti në njerën anë dhe malet në anën tjetër i mbajnë vesh kësaj melodie.

Të nesërmen i bëra një vizitë Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të rrëthit, Kosta Lolit.

Kosta është një burrë me trup mesatar e i lidhur mirë. Ka një fytyrë të qetë dhe energjike; buzët pakë të trasha dhe sytë si në ngjyrën e detit, i jepin shprehjes së tij një pamje të rëndë e serioze dhe vetëm kur flet do të vësh re në zérin e tij një butësi, që duket sikur nuk i përshtat atij trupi.

Më priti me përzëmërsi e ngrohtësi për sa kohë bëmë muhabet e, vetëm kur unë e pyeta se si shkonin me grumbullimin e bimëvet mjekësore, Kosta ndryshoi përnjëherësh, ndofta pa dashur, nga forca e zakonit. U vrënjt në fytyrë dhe filloi të më raportonte me një ton të prerë e

me një gjuhë zyrtare për çështjen e grumbullimit të bimëvet medicinale.

— Për sa i takon grumbullimit, ne, si rrëth, jemi mjaft mirë... gjer më datën kaqë kemi grumbulluar... etj, etj.

Pata durimin ta dëgjoja këtë raport gjer në fund dhe, duke u ndruajtur ta pyes për ndonjë çështje tjetër, e luta që si të mbaronte punët, të delnim të bënim ndonjë shëtitje tok e të bisedonim miqësisht.

Kosta Loli më tregoi se qeveria hartoij një plan të madh për agrumet, dhe rrëthi i Himarës, në këtë pesë-vjeçar, duhej të mbillte s'di se sa mijëra fidanë «Agrumet do të jenë kultura jonë kryesore; ne do të jemi rrëth i agrumevet, kështu thonë specialistët». Kryetari më foli për planet e ardhme, me dashuri e me optimizëm.

Vizituam, së bashku, fabrikën e vajit, punishten e vërës e të rakisë, depot e koperativës së konsumit dhe pastaj u ndamë si miq.

Deti Jon, nuk donte të qetësohej, e megjithse erë nuk kishte, valët përplaseshin me furi pas bregut dhe për një çast e gjithë rëra e imtë dukej sikur të qe mbuluar me një ajkë të bardhë prej qumështi. Ta këndë të rrije me orë të tëra duke soditur këtë pamje dhe të vinte keq që, pas disa sekondash, të gjitha shkriheshin e humbeshin sikur të mos kishin qënë kurrë. Vala i ngjet kohës dhe shkuma jetës. Më tej, atje ku bregu shkëmbor bie thikë mbi det, valët thyhen e stërkalat e bardha kércejnë si rruaza fildishi duke e bërë të lëshojë lotë faqen e ashpër të shkëmbit.

Ndënja edhe atë natë në Himarë. Pasditën e kalova me nge duke soditur detin e egërsuar dhe bëja çudi me veten time se kush ia jepte gjithë atë forcë valës?

Tani era kish pushuar dhe unë prisja të admiruja një det të qetë e të shtruar, por nuk ndodhi kështu. Duket se detit nuk i bie zemërimi kollaj e sa ndeja në Himarë deti uturiti e buçiti si i tërbuar. E, duke e shikuar këtë det të egërsuar, nuk e parafytyroja dot të qetë e të shtruar dhe fjalët e një vëndësi që më tha se deti në Himarë në kohë të mirë është i butë, i qetë, e i shtruar si vaj, sa të vjen ta rrufitësh, mua m'u dukën të pabesuarshme.

Si në çdo qytet të vogël, edhe këtu pritja e përcjellja e kamionit të pasagjerëvet qe gjëja më e rëndësishme e ditës.

Himara në çdo stinë është e bukur, me ato kodra të veshura me ullinj, me ato brigje shkëmbore që ngrihen anës së detit e ku vala lozonjare përkëdhelet e fërkohet pas tyre si vajza pas të dashurit; të gjitha këto janë të bukurë. Pa le atëhere kur lulëzojnë portokallet e limojtë! Kundërmon ajri i parfumuar dhe njeriu nuk ndjen të ngopur duke thithur këtë ajër. I bukur, i bukur je, o Atdhe!

Të nesërmen pasdreke, duke parë kohën të bukur e diillin që shkëlqente, m'u mbush mëndja të shkoja në Sarandë. Barba Neçua urdhëroi shoferin të më bënte vënd në kabinë dhe urdhëri i tij u plotësua menjëherë.

II

Ruga e ngushtë dredhon në mes të kodravet të gjel-bëruara dhe pas pakë Himarën e bukur e lamë prapa kra-hëvet. Pas shiut të fortë që kishte rënë, në rrugën me gro-pa kishin mbetur aty këtu sqolla me ujë shiu, sipërfaqja e të cilavet shkëlqente si xham nga rrezet e forta të diellit.

Shoferi, si mori vesh që po udhëtoja në këto anë për-herë të parë, u mundua ta kënaqte kureshtjen time me të gjitha ato që kish dëgjuar ose që i dinte edhe vetë.

Ai më tha se, me që në Himarë deti pati dallgë, këtej duhej të ish fare i qetë. Dhe vërtet, me të kapërxyer bre-goret që fshehin Himarën, na doli përpara një gji i vogël shkëmbor, ku ujët e kaltërt të detit shkëlqente si pasqyrë. Këtu s'ndihej as rrapëllima e valëvet, as buçima e mbetur e detit; të dukej sikur deti i fuqishëm e mbante me kimet këtë gjë, si një fëmijë të përkëdhelur, dhe s'don-te në asnje mënyrë t'i prishte gjumin. Aty qe kaqë ngrohtë e kaqë mirë, sa të vinte të zvisheshe e të hidhe-she të bëje not.

Pas pakë dualëm në qafën e Porto Palermos. Këtu të del përpara një Llogara e dytë; po ndërsa në Llogara buku-ria harmonizohet me krenarinë e madhështinë, këtu në

Porto Palermo gjen një bukuri të ëmbël femërore, të qetë dhe pakë të trishtuar e melankolike. Shikon se me ç'bukuri e ka stolisur natyra këtë vëndin tonë. Deti fle i qetë. Dhe, si një mrekulli prej natyrës së virgjër, në këtë gjë të qetë del nga toka si gjuhëze një gadishull i vogël. Duket sikur nuk është një copë tokë, por një medaljon i bukur, që varet në krahrorin e kaltërt të detit. Në këtë sinisi, që së largu duken muret e një kështjelle të vjetër. Me tokën mëmë lidhet vetëm me një rrip të ngushtë, mbi të cilën kalon rruga që shpie për në kështjellë.

Kështjella më thanë se është e Ali Pashë Tepelenës dhe i shërbente si port për marrëdhëniet me botën e jashtme. E shikova me dashuri dhe, për një çast, mbylla sytë e parafytyrova ato kohë. M'u duk sikur pashë në rrugë një tufë kalorësish duke ikur me të katra. Pas tyre ngritet një pluhur i hollë i verdhë dhe flokatet e fustanellat e bardha, të fryra nga era, shkëlqejnë e valaviten si flamuj lirije trimërie. Tufa e kalorësvet fluturon si suferina mbi rripin e tokës që lidhet me kështjellën, dhe prijesi i tyre, plaku Ali Pasha, me të arritur para portës, kërcen nga kali si një djalë njëzetvjeçar dhe hyn brenda me një hap krenar; pas tij hyn kali duke hingëllitur e duke ngritur kokën përpjetë. Mbi muret e kështjellës duallën burizanët dhe, duke drejtuar në qiell burijet e tyre të gjata hata, e përshëndetën ardhjen e prijesit me tinguj gazmori dhe i luten Allahut t'i shtojë ymrin e lavdinë...

Tani ka mbetur hieja e këtyre kohëve të kaluara.

Nuk e di historinë e kësaj kështjelle, por në është e vërtetë që këtë kala e ndërttoi Ali Pashai, atëhere dëshmon se ai ka qënë një strateg i zoti për kohën e tij dhe i hollë në shijë.

Pranë rrugës së automobilit, buzë xhadesë, nga an' e detit, gjendet një kishë e vogël dhe e vjetër. Këtë kishë duket se ai e ka ndërtuar për gruan e tij të dashur, për Vasiliqinë. Ndërtimi i kësaj kiske ka një histori të pabesueshme; ajo është imbaruar brënda 24 orëve! Kujt i besohet një gjë e tillë? Ali Pashë Tepelena thërriti disa muratore dhe u tha: «Në qoftë se nuk e mbaroni gjer sa të lindjë dielli, të gjithëvet do t'ju ther...» Po cili ka qënë shkaku

i këtij nxitimi kaqë të madh? Dashuria e pakufishme dhe e verbër për të shoqen a po një nga kapriçiot e tij të shumta e të pashpjeguara?

Vazhdojmë të ecim. Pamjet vijnë njëra pas tjetërës, si kuadro të një filmi, dhe ndjej një përshtypje që s'ë kam ndjerë kurrë: më duket sikur jam në të njejtën kohë edhe aktor edhe spektator. Më duket sikur shikoj në ekran ecjen e një makine me udhëtarë nëpër vënde të bukura e piktoreske. Ata që janë sipër në karroceri këndojnë. Fjälët s'i marr vesh mirë, por melodia s'po më pëlqen hiç: Këndojnë këngë labe.

I paharruar do të mbetet në kujtesën time Gjiu i Borshit me atë pamje të mrekullishme që ka. Poshtë deti i kaltërt, i qetë, nanuritës, sikur është futur të flerë e të pushojë në këtë gji të gjelbëruar dimër e verë. Dhe, si dhuratë prej natyre, këtu syri të çlodhet në një copë tokë që meriton emrin fushë, e vetmja në gjithë bregun e detit. Aty në mes të fushës është ngritur një fermë shtetnore, ferma e Borshit.

Nga bukuria natyrale ky vënd duket si një peisazh i mjeshtërvet të pikturës.

Lart në mal, mbi një shkëmb të madh, duket Qeparoi dhe, në anën kundruall, duken disa shtëpi nga të Borshit. Me një natyrë të tillë, çdo njeri duhet ta ndjejë veten poet dhe tani më duket fare e natyrëshme pasuria e folklorit që kanë këto fshatra dhe improvizatorët, të cilët, ndonjëherë bukurija e figuravet, lénë prapa disa nga poetët tonë.

Kur po ngjiteshim në të pérjetën e Borshit, takuam trugës një plak kokoroç, me syze, që po shkonte hipur mbi një mushkë. Samarin e mushkës e kishte mbuluar, si krushqit, me nja dy velenxa dhe prapa në koçaqet kish varur disa torba. Pa dashur e pyeta shoferin:

— C'është ky?

— A, s'e di ti këtë? Ky është mason. S'ke parë ç'njeri i çuditshëm është. Ja, gjithënjë me mushkë e shikon, ja hipën kësaj dhe qytet më qytet e pazar më pazar. Në automobil s'e kam parë të hipëj kurrë dhe thonë që mushkës nuk i bie kurrë as me shkop as me këmbë. E le të ecij më qejfin e saj pa i thënë kurrë oq! Sa të ecëj le të ecëj, dë-

mër a behar qoftë. Ku ta zerë nata, aty fle. Edhe bukën edhe gjellën i ka me vete. Me lugë, me pirua, me kripë, me tenxhere, të gjitha në torbë i ka...

— Po njerëz a ka ky në shtëpi?

— Ka, pos; ka plakën. Edhe fëmijët thonë se i ka burra dhe me punëra të mira. — Aman mor baba, i thonë ata, se na turpërove, mos bëj kështu. — Po ai s'i pyet fare. — Shikoni punën tuaj, juve, u thotë, s'kini gjë me mua. Mua sa të më punojë këmba e dora e sa të kem mushkën gjallë, do të bëj si të më thotë koka; juve nuk ju kërkoj gjë... Ç'pyet, ore, ka turli njerëz kjo botë.

— Ashtu vërtet, po shqyr që s'ka shumë si ky, tħuaj... Shoferi qesh e pastaj ndalon makinën se dikush kérkon të zbresë.

Zbret edhe shoferi, e shkon në anën e pasme të makinës pér ta «rregulluar» udhëtarin. Kam vënë re se të gjithë pasagjerët mundohet t'i «përcjellë» nga pakë dhe gjithë bakshishet që i japid ata e bën kabull të mos ua kthejë dorën e t'i futjë në xhep. Kur kthehet, i qesh fytyra dhe, para se të ndezë makinën, më pyet gjithëmonë sikur kérkon lejë: Nisemi tani?

Lart në mal, Qeparoi duket si një kështjellë mesjetare. Në Borsh qëndruam pakë më gjatë, se shoferi bleu një shportë me portokalle. Zbrita dhe unë nga maqina e anës së rrugës vura re një lapidar të thjeshtë, i ngritur pér dëshmorin Sofo Meksi. Ç'kujtime më ngjalli ky lapidar! M'u kujtua kënga aqë e përhapur në kohën e luftës:

Mun te Borshi më të dalë,
Lule Sofo, lule djalë.
Bëje luftë me gjermanë,
Lule Sofo, lule djalë.
Sofoja në vij' të parë

etj.

Ndëjtë një copë herë i heshtur pranë lapidarit. M'u duk sikur e njihja këtë njeri të rënë dëshmor në luftën pér çlirimin e Atdheut. Kënga ma kish bërë të njohur, të dashur e të afërm. Dhe i parafytyrova partizanët se si e kën-

donin këtë këngë. Qe dimër, kish rënë dëborë e bënte një ciknë e madhe. Papritur, në fshatin tonë u duk kreuz i një kollone partizane. Partizanët ishin të lodhur, të uritur, disa prej tyre ishin fare zbatuar. Mirëpo, me të ardhur në fshat, ja filluan këngës e valles. Këndonin këtë këngë: «Mun te Borshi më të dalë . . .» me një pasion të egër, disi të vrashtë, por burrëror. Dhe melodia pakë monotone dhe e varfër në ngjyra kishte një kadencë të rëndë, luftarake dhe gjëmonte si një trumpetë. Ata këndonin e kërcenin, kurse nga këmbët u rrithje gjak, i cili skuqte dëborën e ngrirë.

Unë isha i vogël atëhere, 11-12 vjeç, po ky përfytyrim më ka mbetur ndërmend e s'kam përtat harruar kurrë.

Çdo gjë në rrugët dëshmon luftën heroike që bënë vellezërit dhe baballarët tanë. Lapidarët e ngritur, skeletet e makinave të djegura, urat e rindërtuara, të gjitha flasin përluftëtë nacional çlirimtare. Ja, aty në Protopapë, xhadeja kalon fare afër buzës së detit. E në det, akoma edhe sot e kësaj dite, duket kulla e zezë e një tanksfashist. Partizanët e kanë djegur dhe e kanë hedhur në det. Tallazet përplasen me fuqi pas tij dhe valët tallen e përqeshin hekurin e ftohtë; me këtë, sikur duan t'i trajtë gjithë botës, ç'fat mund të kenë pushtonjësit.

Atje do të rrijë ai tanks, i prishur, i zyrtë, i heshtur dhe pikërisht pse është i heshtur, flet më shumë.

Po i afrohemë Lukovës. Ullinjtë janë arrirë e tani po i vjelin. Në Lukovë rruga automobilistike shkon përmes një ullishteje të bukur e të mbajtur me kujdes. Disa plaka e disa fëmijë të vegjël po mbledhin ullinjtë e rënë. Nuk nxitohen; të duket sikur këtë punë e kanë marrë mënge dhe kam përshtypjen se gjyshja, duke punuar, po u tregon edhe ndonjë përrallë me mbret, se ndryshtë, fëmijët çapkënë mërziten e kërcasin e ikin.

Dielli po perëndon. Deti Jon, me atë ngjyrën e kaltërt si një të gjelbërt të thellë, reflekton rrezet e kuqe të Diellit. Dhe duket sikur është ndezur flakë. Mbi malet shket hieja e padukur e muzgut dhe fletët e pemëvet ndryshojnë ngjyrë e bëhen më të errëta. Lart mun mbi sërtin e malit

po shkon një njeri dhe të duket sikur ai që s'andejmi po kundron këtë mbrëmje të qetë në madhështinë e saj, të heshtur dhe hijerëndë. Këtu, në çdo një kilometër, në të ardhëshmen do të ngrihet nga një kamp pushimi ose shtëpi turizmi dhe gjithë riviera jonë do të bëhet një **Côte d'Azur**, në mos edhe më e bukur. Turistët do të çmëndeshin me qiellin tonë të kaltër e të tejdukshëm me Diellin e ëmbël e të shkëlqyer, me malet tonë krenarë e me natyrën e virgjér.

Po ne gjer tashti s'na kanë lënë hallet të mendojmë për të tilla gjëra. Kemi pasur nevoja të tjera më të më-dha e më të kohës dhe duhet të na falet në e kemi lënë ndërtimin e vilave pas dore. Por shpejt do të vijë ajo ditë kur qendrat e turizmit e të gjuetisë do të janë të hapura dimër e verë, kur një rrugë automobili e asfaltuar do të gjarpërojë në këtë bregdet që s'e ka shokun nga bukuria, prej Shën Gjinit e gjer në Butrint. Do të vinë ditë të bukura e më të bukura, dhe në po mundohemi një çikë tani, le të mos na vijë keq: ne po punojmë për një të ardhme të madhe e dritëdhënëse.

Ecim gjithënjë drejt jugut. Tani kemi dalë në Shën Vasi, një fshat i bukur nga pozita, po tepër i varfër. Fshati gjindet në një qafë mali dhe e vetmja pasuri e tij janë fletët e sherbelës, me të cilat është i veshur gjithë mali. Kjo bimë mjekësore, me vlerë të dyfishtë ekonomike, gjëndet e përhapur në një mënyrë të çuditëshme. Male të tërë janë mbuluar me këtë bimë shumë-vjeçare, e duket se edhe sikur ta kishim mbjellë me dorë nuk do të qe rritur kaqë.

Dalim në një rrugë të tatëpjetë, të thatë e të zveshur. Rruga ka prerë në mes një faqe mali të pjerrët e shuruvinë. Poshtë, në anën tonë të majtë, kemi fushën e Vurgut. Shikojmë fshatra të shpërndara aty këtu dhe në një grykë mali duket Delvina e vogël. Prej këtej duket mirë vetëm maja e lartë e Minaresë që del përsipër dhe sundon mbi shtëpitë e tjera e mbi çatitë prej qeramidhesh të kuqe.

Po i afrohemë Sarandës. Habia e parë është se udhëtarët nuk pret të hyjë në Sarandë nga ana e jug-lindjes;

me që udhëtojmë drejt jugut, njeriu pret ta shikojë Sarandën përpara si çdo qytet a fshat tjetër; kurse këtu ne pa e ditur e kemi lënë Sarandën prapa, pastaj, pasi kapërxejmë një qafë mali, na del përpara Saranda e vogël dhe e bukur me ato shtëpi plot bahçë e të suvatisura përashta, me gjin e bukur të detit e me kodrat që ka rrëth. Është mbrëmje. Në qytet janë ndezur ndritat elektrike; një pjesë prej tyre reflektohen në ujët e detit dhe duken si ca yje të këputur. Sa i dashur të bëhet ky vënd! Hyjmë në qytet në mes një rruge të mbjellë me pisha. Në një dritare, një vajzë simpatike po vë një perde. Ajo bën ca lëvizje të sigurta e të ngadalëshme: profili i dallohet qartë dhe dy gërshtatë të lezetëshme i bien mbi krahërorin e fryrë. Sa herë kam kujtar Sarandën, më ka dalë përpara edhe kjo vajzë. Çudi është se si lidhen parafytyrimet nganjëherë: ndonjë gjë pa rëndësi dhe e rrastit arin të të lërrë mbresë të përherëshme. Më duket se, po të vete përsëri në Sarandë, do ta gjej atë vajzën simpatike duke shkuar perden po n'atë dritare.

Përkundrejt duket ishulli i Korfuzit, pak i zymtë dhe i mbuluar nga hijet e mbrëmjes. Një far ndizet çdo 8-9 sekonda, si një sy magjik, dhe ngazëllon detarin e kaptur se limani nuk është larg.

Nata është e freskët. Në hotel na dhanë një dhomë kundrejt detit dhe, të nanurisur nga shushurima e valëvet të detit, fjetëm një gjumë të lehtë e të pandërprerë.

Të nesërmen u gdhi një ditë e bukur me diell, e vakët dhe e parfumuar nga aromat e vjeshtës. Vizitova disa nga bahçet e dëgjuara të portokallevet, portin detar, Hotel Turizmin, dhe, si mbarova punët zyrtare, u enda lart' e poshtë nëpër qytet.

Edhe këtu po ndërtojnë punishte, fabrika, apartamente banimi. Sa mirë, që në çdo qytet tonin ndihen tingujt e çekanit të muratorit! Dikush mund të thotë e të pyesë: ç'tinguj mund të ketë çekani? Po, shokë, ai ka tingull, dhe tingull shumë të bukur, ai këndon melodinë e ndërtimit dhe kjo është muzika më e bukur që ndihet an' e kënd Atdheut tonë!

Deti Jon, sot, është fare i qetë. Shkëlqejnë guriçkat

e bardha e peshqit me luspa të ergjëndta lëvrijnë në të gjitha drejtimet, të kënaqur që stuhia ka marrë fund. Një peskarexho përkundet lehtas mbi det dhe, mbi direkun e saj, një marinat diç mundohet të kapnjë; një tjetër i jep urdhëra që nga poshtë.

Aty ku futet në det ujët e ftohtë të një vije mali, deti ka marrë ngjyrë tjetër: të kaltërt mavi dhe që nga sipër të duket se dikush, për t'u tallur, e ka prerë detin me thi-kë dhe i ka shkëputur një fashë nja pesë pëllëmbë të gjë-rë dhe nja dyqind-treqind metra të gjatë.

Rastësisht u takova me një shoqe shkolle. Edhe tanisë plot shëndet, si disa vjet përpëra dhe po ashtu e qeshur dhe e gëzuar. Unë ndjej një kënaqësi të veçantë kur në ndonjë qytet të largët takoj ndonjë shok a shoqe nga të klasës. Atëhere fillojmë e kujtojmë kohën e kaluar, bangat e shkollës, konviktin, prerjet e liridaljevet dhe plot vogëlsira të tjera të parëndësishme, të cilat, tanë, me që janë të shkuara, kanë marrë një notë përmallimi e nostalgjie. Veç tashti që u rritëm e kuptojmë se disa gjëra që atëhere i quanim heroizma, s'ishin veçse budallallëqe e çapkënllëqe të rinisë.

Të nesërmen, kur po haja drekë në tavolinën time, erdhi dhe u ul një prift. Qe një prift me një fytyrë të hollë e të gjatë e me tipare të lezetëshme. Sytë i kishte të vegjël e ëndëronjës, ballin të gjérë e të drejtë; buza e poshtme sikur të donte t'i jepte një pamje më hijerëndë, qëndronte pakë e kthyer, por e gjithë pamja e tij shprehët një qetësi shpirtërore. Qe veshur me një raso të përdorur, e cila, duke thithur për kush e di sa vjet, të shtatë ngjyrat e rrezevet të diellit, kish ndryshuar bojë e nga e zezë po bëhej e murme. Kemi ne disa priftërinj në fshatrat tonë, të cilët janë më shumë bujq se sa fetarë. Këta punojnë e ropëtohen si gjithë të tjerët, përveshin mëngët e rasos dhe lërojnë gjithë ditën e lume e shërbimin fetar e shikojnë më tepër si një punë shoqërore, si një punë që duhet bërë. Dhe nuk do qe keq këtu sikur të përmëndja se një nga priftërinjtë e shumtë të fshatit tonë, kur vinte puna më bë, nuk betohej më Krishtin a më Përendinë, por ruante akoma betimet e vjetra pagane dhe

s'e kish pér gjynah tē betohej: «Ja, pér këtë zjarr... pér këtë dhe... ose pér këtë bukë!» Dhe nuk qe ndonjë prift dosido, por i zgjuar dhe me shkollë.

Edhe ky dukej se bënte pjesë në këtë kategorji. Mjekra e hollë që përfundonte me majë, si një pykë, kish filloar t'i bëhej e murrme. Porositi vetëm fasule sade, pa mish, e filloj tē hante, pasi nxori që nga xhepet e tij tē thellë një copë kulaç. U çudita që po hante një gjellë kaqë tē varfér dhe fillova ta pyesja se nga ishte e ku po vinte. Prifti qe nga një fshat i varfér, majë një mali, nja tetë a nëntë orë më këmbë larg nga Saranda. Emrin e atij fshatit e harrova. Mbaj mënd vetëm se në fshatin e priftit s'u bëkeshin as ullinjtë as portokallet, pasi fshati bënte pjesë në një zonë tē lartë e, si pasojë, edhe shumë tē ftohtë.

— Po çfarë ka në fshtatin tuaj? — e pyeta.

— Kaçka, arra si u thonë; nga ato kemi boll...

Prifti e fliste me zor gjuhën shqipe dhe nga e folura dhe nga theksimi i ë-së dukej që do tē ishte minoritar.

E pyeta pér kishën e pér disa gjëra tē tjera që kishin tē bënin me profesionin e tij.

Prifti mblodhi buzët i dëshpëruar dhe dukej se po përgatitej tē fliste pér një temë tē papëlqyer. Nuk i vinte mirë që tani feja kish zënë tē çoroditej edhe në fshatërat më tē largëta dhe ai ndofta, i kujtonte me mall ato kohë kur njerëzit rronin me frikën e Perëndisë dhe me besimin kokëngjeshur tē fanatikut fetar prisnin përdëllim nga i Plotfuqishmi.

— PË! Të vjetrit vijnë në kishë e falen; pa këta tē rintjtë tani s'para shikojnë nga këto gjëra. Tani kështu u bë koha.

I kënaqur nga muhabeti, prifti nxori që diku nga ata xhepet e tij tē thellë një grusht me arra dhe m'i vuri përpëra në pjatë. Unë nuk desha t'i merrja, por ai nguli këmbë.

Bisedova me 'të sa mund tē bisedojë njeriu në një tavolinë restoranti dhe më mbeti merak që nuk e ngac-mova tē më tregonte diçka ngajeta e tij a tē paktën ndonjë histori. Megjithatë nga biseda e tij u binda pér një gjë tē cilën edhe më përpara e kisha menduar: populli ynë është shumë pagan dhe ndjenjat fetare s'ka-

në zënë kurrë rrënëjë thellë. Dhe atëhere nuk m'u duk hiç çudi — sado e pabesushme dhe qesharake që është — se shumë prej të krishterëvet e ndërruan fenë në kohën e Tanzimatit, vetëm e vetëm që të mos paguanin taksa.

Si në çdo qytet të vogël edhe këtu, në Sarandë, po t'i biesh vërdallë dy herë rrëth e qark, i ke parë të gjitha e s'ke çfarë të shikosh më, prandaj udhëtarët e kanë si zakon që, po qe se nuk dalin shëtitje, venë e futen në klubin e gjuetarëvet.

Ky është vendi i pikëpjekjeve, i bisedimeve akademike, i këngëvet, i pijes, i dominos, i tavllës. Saranda ka edhe klube të tjerë, të cilët janë shumë më të bukur se ky, mirëpo asnë nga ata s'ka arritur të bëhet kaqë tërheqës e popullor, e asnë nuk ja kalon nga fama.

Ato që i japin lezet këtij klubi janë ca shpendë të ballsamosur që qëndrojnë krenarë mbi banak, dhe duket sikur përshëndesin mysafirët me sytë e tyre të shkëlqyer si xham.

Në klub mund të shikoje shumë lloje veshjesh dhe përkë a shumë mund ta merrje me mënd se nga ç'krahina genë:

Një plak me një takije të bardhë e veshllapush bën-te pazar për të shitur ca dhën. Plaku i jepte e i merrte bashkëfolësit duke ja lëvduar mallin e gjënë, me sa i mundej, kurse tjetri e dëgjonte në heshtje, dhe hiqej sikur s'i bënte përshtype.

Në këtë klub gjahtarësh, përveç gënjeshtravet të gjahtarëvet, dëgjova edhe dy përralla, në mes të ditës, prandaj nuk di në e nderon klubin kjo gjë apo jo.

Këto i tregonte një fshatar nga Palasa e Himarës, i cili kishte një fytyrë të gjatë si të kalit e ca vetulla të zëza e të dendura si kreshta. Emrin s'ja mësova dot. Kishte një zë të fortë, zë burri, që i dilte nga ai kraharori i gjërë e eshtërmadh.

Përralla e parë qe për një dosë që gjente një qyp me florinj.

Me qënë se s'mbeti asnjeri pa qeshur nga ata që e dëgjonin, qeshi edhe vetë ai që e tregonte.

Përralla tjetër ishte për një qeroz që martohej me të

Bijën e mbretit, pasi plotësonte tre kushte që kishte vënë mbretit.

Kushti i parë qe që të fuste në thes një prift, por prifti të futej me dëshirën e tij. E dyta nuk e mbaj mënd se ç'qe dhe e treta, që t'i merrte unazën mbretëreshës me dëshirën e saj. Qerozi me dredhi e me trimëri i plotësoi që të trija kushtet dhe u martua me bijën e mbretit.

Një pasdite shkuam me një shok në kooperativën bujqësore të Vrionit. Vrioni është një katund i vogël, i ndërtuar mbi një kodrinë të vogël, e cila ngrihet si kurriz breshke mu në mes të fushës.

Në Vrion më mirë se kudo gjetkë mund të shikosh ndryshimet që ka pësuar fshati shqiptar, e rrugën nëpër të cilën ka ecur.

Dikur, e kjo dikur s'është shumë e largët, fshati qe çiflik, dhe gjithë fshatarët qenë raja. Rrallë herë dukej beu në fshat; Roma e Tirana kishin pallate lluksoze ku ai shkryhej e luante kumar djersën e këtyre fshatarëve që punonin gjithë ditën sa u binte bretku e natën futeshin të çlodheshin në ca kasolle të rëgjuara nga mjerimi e të heshtura si gurrë varri.

Reforma agrare u a dha tokën fshatarëvet. Ato ditë kanë qenë nga ditët më të lumtura në jetën e atyre fshatarëvet. Po u plotësohej ajo që kishin èndëruar tërë jetën jo vetëm ata po edhe gjyshërit e stërgjyshërit e tyre. Muarën tokë! Tokë! Tokë!

Kjo thirrje nga buzët e tyre ushtoi më me gjëzim se sa nga goja e atij marinarit të Kristofor Kolombit që zbuloi brigjet e Amerikës.

Biseduam me kryetarin e Koperativës. Ai qe një djalë i ri, i heshtur dhe pakë i ndrojtur. Ai na tregoi se koperativën bujqësore e kishin formuar qysh në vitin 1949. Në këta vjet, përparimet qenë kaqë të mëdha e qenë bërrë kaqë ndërtime, për të cilat në të kaluarën do të duhej një shekull.

Kryetari na foli pak për të kaluarën e dukej se më tepër kishte qejf të na fliste për të ardhëshmen.

«Do t'i ndrohet pamja fushës së Vurgut. Ai kishte

besim në këto fjalë të thëna nga Partia dhe shikonte me guxim të ardhëshmen.

Kush është pakë poet le të mos i verë fre fantazisë e le ta ëndërojë fushën e Vurgut si një bahçe e si një kopsht të lulëzuar dimër e verë. Le të mos ketë frikë se e tepëron: Vurgu i tillë do të bëhet. Do t'u themi udh'e mbarë ujërave që e përmbytin gjithë dimrin, e do të marrim dy e tre prodhime në vit. Do t'i ndërojë faqja fu-shës e pas disa vjetëvet nuk do të shikojmë pallto me andra në supet e fshatarëvet.

Më të perënduar të diellit u kthyem në Sarandë.

Dielli po ulej ngadalë në det dhe gjithë qelli nga ajo anë dukej sikur kish marrë flakë. Më e bukur nga të gjitha dukej pasqyrimi i rrezeve të diellit në det. Ajo duket si një rrugë me shkëlqim të florinjtë që zgjatej nga bregu e gjer në pafundësi.

Saranda është xhevair i bregdetit tonë. Ajo duket si një stacion turistik bukurie e harmonie. Të huajt që vijnë çmënden pas bukurisë së saj, pshëretijnë me një farë zili-çmënden pas bukurisë së saj, pshëretijnë me një farë ziliqe.

«Ah sikur të kishim edhe ne një Sarandë të tillë!»

E unë do të thosha: «Ah sikur të kemi nja tri katër Saranda gjatë bregdetit!»

Por nuk pshëretij me mall; unë ëndëroj se do t'i kemi dhe me siguri që ajo ditë nuk është e largët.

Para syve tanë, Atdheu është transformuar dhe mendoni se sa vuajtëm për të shëruar plagët e luftës. Tashi ti jemi më të fortë, më të pasur, e natyrisht do të ndërtojmë më shumë, më shpejt edhe më bukur.

E unë as që kisha ndër mënd t'i shkruaja përshtyp-jet e mia por ja që e nisa këtë punë dhe eci pena vetë. S'di akoma në janë këto që shkrojta ndonjë gjë që e vlen barra qiranë të lexohen, por unë shkrojta që të çmallen me ato vënde aqë të bukura, me ata njerëz të thjeshtë e të dashur dhe urimi që po bëj është: «E shikofsha gjithë-monë bregdetin tonë të kaltërt të bukur e më të bukur!»

Bregdet Vlorë — Sarandë — 1957.
